



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



100
VJET KLSH

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2024



WWW.KLSH.ORG.AL

© Kontrolli i Lartë i Shtetit

Materiali i paraqitur në këtë dokument i nënshtrohet të drejtës së autorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Materiali mund të kopjohet ose riprodhohet vetëm për qëllime jokomerciale, përkatësisht riprodhim për kërkime, studime private ose për qarkullim të brendshëm të kufizuar brenda një organizate për qëllime studimore dhe analitike. Kopjimi për qëllime jokomerciale duhet të shoqërohet me një njohje të mjaftueshme, të riprodhohet me saktësi dhe të mos përdoret në një kontekst tjetër.



Përmbajtja

MESAZHI I KRYETARIT TË KLSH-SË	04
1. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT	10
2. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	14
3. AKTIVITETI AUDITUES 2024	32
3.1 Auditime të Përputhshmërisë	33
3.2 Auditime Financiare	67
3.3 Auditime Financiare dhe të Përputhshmërisë	82
3.4 Auditime të Performancës	107
3.5 Auditime të Teknologjisë së Informacionit	125
3.6 Auditime për zbatimin e rekomandimeve	129
4. MENAXHIMI INSTITUCIONAL DHE ZHVILLIMI STRATEGJIK	
4.1 Monitorimi vjetor i " Strategjisë së zhvillimit Institucional 2023-2027"	134
4.2 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	138
4.3 Zhvillimi i vazhdueshëm profesional	141
4.4 Vetëvlerësimi vjetor sipas kornizës INTOSAI	143
5. KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL	148
5.1 KLSH dhe Kuvendi	149
5.2 KLSH dhe Media	156
5.3 KLSH dhe partnerë strategjikë	158
5.4 Vlerësime nga institucione ndërkombëtare	168
5.5 Programi i transparencës dhe e drejta për informim	169
6. TREGUESIT BUXHETORË DHE FINANCIARË TË KLSH-SË DHE OPINIONI I AUDITIT TË BRENDSHËM	172
7. ANEKSE	179



MESAZHI I KRYETARIT TË KLSH-SË, Z. ARBEN SHEHU

Në përmbushje të misionit tonë kushtetues dhe ligjor, edhe gjatë vitit 2024, KLSH ka vijuar me përkushtim ushtrimin e mandatit të auditimit të fondeve publike dhe pasurisë shtetërore, me qëllim garantimin e llogaridhënies, transparencës dhe përmirësimit të menaxhimit në sektorin publik.

Gjatë këtij viti, KLSH ka realizuar 159 auditime në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe në të gjitha format e auditimit, duke përfshirë auditimet financiare, të përputhshmërisë, të kombinuara, të performancës dhe auditime të sistemeve të teknologjisë së informacionit. Këto auditime janë zhvilluar në 205 subjekte publike, duke mbuluar qeverisjen qendrore, pushtetin vendor, institucionet e pavarura dhe ndërmarrjet shtetërore. Nga këto auditime kanë rezultuar 194 opinione dhe konkluzione auditimi, të shoqëruara me mbi 4378 rekomandime konkrete për përmirësimin e situatës në mirëqeverisjen e fondeve publike.

Në thelb të misionit të KLSH-së qëndron zbatimi rigoroz i standardeve ndërkombëtare të auditimit publik (ISSAI), me synimin që fondet publike të menaxhohen në mënyrë të ligjshme, të rregullt dhe efektive, në funksion të maksimizimit të vlerës për qytetarët. Parimi udhëheqës i punës sonë është që çdo njësi buxhetore të jetë e përgjegjshme për përdorimin e burimeve që i janë besuar, në përputhje me objektivat e politikave dhe interesin publik si standard përfundimtar.

Auditimet financiare të kryera, kanë nxjerrë në pah fenomene të përsëritura të keqklasifikimit të shpenzimeve dhe të ardhurave, të mosregjistrimit të pasurive publike, të mosregjistrimit të plotë të detyrimeve të prapambetura dhe raportimet e pasakta të tyre. Shumë nga këto problematika vijnë nga dobësitë në kontrollet e brendshme dhe mungesa e dokumentacionit ligjor duke shkaktuar



deformim të pasqyrave financiare dhe një pasqyrim jo të drejtë të situatës financiare të institucioneve.

Në auditimet e përputhshmërisë, administrimi i pasurisë publike vijon të jetë një fushë me risk të lartë, kjo pasi janë konstatuar prona të paregjistruara, mungesë certifikatash pronësie, si dhe pasuri të amortizuara që nuk përfshihen në bilance. Në disa institucione, mungojnë aktet e marrjes në dorëzim dhe nuk dihet qartë se kush mban përgjegjësi për administrimin e pasurisë publike.

Gjithashtu, vijojnë të identifikohen shkelje të legjislacionit në prokurime, si: mungesë gare reale, kritere të njëanshme, vlerësime të pabazuara të operatorëve dhe dobësi në menaxhimin e kontratave. Janë evidentuar kontrata të realizuara me një operator të vetëm, procedura me dokumentacion të munguar, si dhe shkelje në aplikimin e kritereve të përzgjedhjes. Në disa raste, janë kryer prokurime për shërbime që mbuloreshin nga kontrata ekzistuese, duke çuar në kosto të dyfishta për buxhetin publik. Në auditimin e zbatimit të kontratave publike janë konstatuar



pagesa për punime të pakryera, mungesë penalitetesh ndaj kontraktorëve, etj.

Në shumë institucione publike, është konstatuar planifikim buxhetor formal, pa lidhje reale me nevojat apo me prioritetet strategjike. Dokumentacioni mbështetës për kërkesat buxhetore ka qenë shpesh i pamjaftueshëm, ndërkohë që janë paraqitur projekte jashtë tavaneve të miratuara, pa argumentim të qartë. Ekzekutimi i buxhetit ka reflektuar devijime të shumta dhe ndryshime të vazhdueshme, të cilat kanë rritur riskun për krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe shtuar presionin mbi buxhetet e viteve pasuese.

Në fushën e të ardhurave publike, auditimet kanë zbuluar probleme me mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave doganore dhe tatimore dhe mosrikuperimin e borxhit doganor dhe tatimor. Ndërkohë ka vijuar të konstatohen klasifikime të gabuara tarifore dhe mospërdorim i masave ndëshkuese.

Një tjetër fushë që meriton vëmendje të veçantë është administrimi i burimeve njerëzore, mungesa e ndarjes së qartë të përgjegjësisë, mungesë procesesh disiplinore dhe largime të padrejta nga puna që vijnë të shoqërohen me kosto shtesë në buxhetin e institucioneve nga gjyqftuesit.

Auditimet e performancës kanë treguar se orientimi drejt rezultateve mbetet ende i kufizuar ose rezultatet janë të papërfillshme ose të pamatshme, mungojnë indikatorë të matshëm, dhe shpesh koordinimi ndërinstucional mungon. Politikat mbeten formale dhe nuk shoqërohen me buxhetim të integruar ose me plane konkrete zbatimi.

Në fushën e teknologjisë së informacionit, auditimet kanë nxjerrë në pah dobësi në menaxhimin e sistemeve, sigurinë e informacionit dhe përdorimin efikas të teknologjisë, mosrespektim të standardeve dhe planeve të rikuperimit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, KLSH ka vijuar të ndjekë në mënyrë aktive rekomandimet e lëna, përmes 13 auditimeve për verifikimin e statusit të zbatimit të tyre, të cilat kanë rezultuar të zbatuara plotësisht, pjesërisht apo janë në proces zbatimi, në nivelin 70%, pavarësisht nivelit të lartë të pranueshmërisë në masën 99%. Ky tregues mbetet thujtë i njëjtë me vitin e mëparshëm, çka nënvizon se ritmi i zbatimit të rekomandimeve ende kërkon përmirësim. KLSH do të vazhdojë të ushtrojë trysni institucionale për të nxitur zbatimin e plotë dhe të shpejtë të rekomandimeve, si një mekanizëm kyç për rritjen e efikasitetit të administratës publike.

Rezultatet e këtyre auditimeve janë përcjellë pranë Kuvendit së bashku me 139 raporte auditimi, në përmbushje të misionit për të garantuar mbikëqyrjen parlamentare mbi problematikat e konstatuara të ekzekutivit dhe theksimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna për përmirësimin e situatës. Si një risi për vitin 2024, ky komunikim është zhvilluar më tej nëpërmjet Nënkomisionit për Auditimin e Jashtëm Publik, të ngritur në Korrik të vitit 2024, në mbështetje të të cilit KLSH ka ngritur një strukturë të posaçme.

Për të promovuar rolin e vet, si institucion auditues, KLSH ka intensifikuar përpjekjet për të promovuar transparencën dhe ndërgjegjësimin qytetar për çështjet e menaxhimit të parasë publike. Janë publikuar buletinë informativë mujore, si dhe janë aktivizuar dhe 2 profile sociale me qëllim shpërndarjen e gjetjeve më të rëndësishme tek publiku i gjerë. Kjo qasje proaktive, ka për qëllim që qytetarët dhe të gjithë palët e interesit të jenë të informuara.

Në zbatim të objektivave strategjike insitucionalë, edhe gjatë vitit 2024, KLSH ka pasur në fokus konsolidimin e mëtejshëm të kapaciteteve të brendshme të institucionit duke miratuar dhe zbatuar programin e zhvillimit



profesional të stafit, përmes trajnimeve të specializuara në auditimin e performancës, auditimin e IT-së, menaxhimin e riskut dhe përdorimin e të dhënave. Ky proces është mbështetur edhe nga bashkëpunimet me institucionet homologe të Kosovës, Norvegjisë, Turqisë, Maqedonisë së Veriut, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime, takime pune apo auditime paralele.

Në spektrin ndërkombëtar, KLSH ka ruajtur dhe zgjeruar rolin e vet, si pjesë aktive e komunitetit të auditimit publik. Pjesëmarrja në rrjetet e INTOSAI-t dhe EUROSAT-t, si dhe bashkëpunimet me institucione partnere nga rajoni dhe më gjerë, kanë ndihmuar në shkëmbimin e eksperiencave dhe në ngritjen e praktikave më të mira audituese. Gjithashtu, ka vijuar bashkëpunimi me partnerë stragjikë si IDI , SIGMA/OECD, SECO.

Në kuadër të rolit tonë si kontribues në luftën kundër korrupsionit, KLSH ka theksuar rëndësinë e forcimit të kontrollit të brendshëm në institucionet publike duke synuar parandalimin e fenomeneve të papërgjegjshmërisë, neglizhencës në përdorimin e fondeve publike dhe ofrimin e shërbimeve të qytetari. Kjo, duke vënë në dukje në raportet e auditimit, jo vetëm shkeljet, por edhe arsyet sistemike që i bëjnë ato të përsëritshme.

I nderuar lexues,

Viti 2024 për Kontrollin e Lartë të Shtetit ishte një vit tjetër i vazhdimësisë në kontributin që ky institucion jep si garant i llogaridhënies, transparencës dhe integritetit në administrimin e fondeve publike. Në përputhje me mandatin e vet, KLSH ushtroi një veprimtari të gjerë auditimi në institucione të të gjitha niveleve dhe kategorive, duke siguruar një mbulim gjithëpërfshirës të sektorit publik.

KLSH riafirmoi edhe një herë, përkushtimin e vet për të përmbushur plotësisht detyrimet kushtetuese dhe ligjore duke ruajtur besueshmërinë si një institucion i pavarur, profesional dhe në shërbim të interesit publik. Kjo duke qenë të vetëdijshëm se besimi i qytetarëve fitohet përditë, përmes punës sistemike, objektive, analizës së paanshme dhe gjykimit të pavarur.

Përpara nesh qëndrojnë sfida të rëndësishme, përfshirë dixhitalizimin e mëtejshëm të proceseve, forcimin e rolit tonë parandalues, dhe rritjen e ndikimit në mirëqeverisje dhe transparencë përmes rekomandimeve që shkojnë përtej konstatimeve.

E ardhmja kërkon që të gjithë aktorët, Kuvendi, institucionet ekzekutive, shoqëria civile dhe vetë qytetarët, të angazhohen në ndërtimin e një kulture të re qeverisjeje: një kulture ku transparenca, përgjegjshmëria dhe integriteti nuk janë objektiva të largët, por norma të pandryshueshme për një administratë efikase dhe të besueshme.

Në këtë rrugë, KLSH mbetet e angazhuar të ushtrojë rolin e vet me profesionalizëm, pavarësi dhe përkushtim, duke vijuar të jetë një institucion në shërbim të publikut, një mekanizëm mbikëqyrës që ndihmon reformat dhe një zë i pavarur, sa herë që interesi publik çënohet.

ARBEN SHEHU









01

MISIONI,
VIZIONI DHE
OBJEKTIVAT

1 MISIONI, VIZIONI & OBJEKTIVAT



Misioni

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucion i pavarur, kushtetues, i cili nëpërmjet ekspertizës dhe auditimeve cilësore, mbështet Kuvendin dhe informon publikun dhe palët e interesit në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në menaxhimin e parasë së taksapaguesve, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike.

Vizioni

KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike, nëpërmjet auditimeve cilësore dhe luftës kundër korrupsionit, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni.

Objektivat

Përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2023-2027, objektivat e KLSH- së edhe për vitin 2024 janë:

- Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH-së si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike.
- Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.
- Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.

Në linjë me INTOSAI P-12 "Vlerat dhe përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit – Një ndryshim në jetën e qytetarëve", KLSH ka adoptuar parimet që përcaktojnë mënyrën se si institucioni duhet të përmbushë mandatin për të forcuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin e qeverisë dhe njësitë të sektorit publik, duke ruajtur vlerat që lidhen me: Forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe integritetit të qeverisë në njësitë e sektorit publik; demonstrimin e rëndësisë dhe konsideratës së duhur ndaj qytetarëve, Parlamentit dhe grupeve të tjera të interesit; dhe shndërrimin në një organizatë model, duke udhëhequr nëpërmjet shembullit.







02

PËRMBLEDHJA
EKZEKUTIVE

TREGUESIT KRYESORË, VITI 2024



159 AUDITIME

Në përputhje me mandatin ligjor dhe objektivat strategjike institucionale, gjatë vitit 2024, KLSH ka kryer 159 auditime nga 155 të programuara, si auditime financiare, përputhshmërie, performance, auditime të sistemeve të teknologjisë dhe informacionit, auditime të kombinuara, për zbatimin e rekomandimeve dhe auditime tematike për çështje të veçanta.

Financiare	45
Përputhshmërie	43
Të kombinuara	35
Performance	15
IT	8
Mbi zbatimin e rekomandimeve	13



194 OPINIONE/MESAZHE/KONKLUZIONE

Bazuar në evidencën e auditimit dhe gjykimin profesional të audituesit, në vlerësim të kriterëve të auditimit, materialitetit të gjetjeve dhe përhapjes së tyre, është konkluduar respektivisht me opinione/mesazhe/konkluzione auditimi, si më poshtë:

Financiare	80*
Përputhshmërie	78*
Mesazhe	15
Konkluzione IT	8
Konkluzione të tjera	13



4378 REKOMANDIME

Për mangësitë, parregullsitë dhe problematikat e identifikuara në misionet e auditimit janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, të klasifikuara sipas llojit, si më poshtë:

Masa organizative	2594
Përmirësime ligjore	28
Disiplinore	993
Administrative	66
Efekte financiare (nr)	697
Efekte financiare (në mijë lekë)	16,472,676

*opinione/konkluzione për auditimet financiare dhe ato të përputhshmërisë



TREGUESIT KRYESORË, VITI 2024



205 SUBJEKTE TË AUDITUARA

Në përputhje me mandatin ligjor, KLSH ka kryer auditime në institucione të pavarura, të qeverisjes qendrore, vetëqeverisjes vendore, shoqëri publike me kapital shtetëror mbi 50% dhe auditime të investimeve me financim të huaj, si më poshtë:

Të pavarura	13
Institucione qendrore	80
Vetëqeverisja vendore	75
Shoqëri publike	20
Inst. të administrimit të aseteve	17



70% ZBATUESHMËRIA* E REKOMANDIMEVE

Në përmbushje të detyrimit ligjor, KLSH ka kryer auditime mbi zbatimin e 3937 rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, me qëllim verifikimin e statusit të tyre, rezultatet e të cilëve paraqiten si më poshtë:

Masa të pranuar nga të cilat:	3882
Zbatuar plotësisht	1261
Zbatuar pjesërisht	578
Në proces zbatimi	866
Pa zbatuar	1177



1.94 EFICENCA E BURIMEVE NJERËZORE

Eficientia e Burimeve Njerëzore i referohet mënyrës se si KLSH menaxhon burimet njerëzore për të përmbushur me sukses objektivat e planit vjetor të auditimit.

Për vitin 2024 ka rezultuar se çdo auditues ka qenë i angazhuar mesatarisht në më shumë se 1 auditim në të njëjtën kohë (ose në 1.94 auditime).

*Në treguesin e zbatueshmërisë, përfshihen rekomandimet e zbatuara plotësisht, pjesërisht dhe në proces zbatimi.



TREGUESIT KRYESORË, VITI 2024



STRUKTURA

Për menaxhimin e burimeve njerëzore KLSH zbaton kuadrin ligjor në fuqi. Procedurat e rekrutimit të punonjësve përgjatë vitit 2024 janë zhvilluar në koherencë me Strategjinë e Zhvillimit të institucionit 2023-2027, si dhe me politikat e miratuara të menaxhimit të burimeve njerëzore, me qëllim që KLSH të sigurojë stafin e duhur me kualifikimet, aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të plotësuar nevojat aktuale dhe të perspektivës.


Punonjës gjithsej	216
Auditues gjithsej	162
Internship-e në ECA dhe GAO	6
Certifikim CPA/CIPFA	2
Nëpunës të certifikuar nga IDI	3
Certifikime “Auditues i brendshëm i avancuar” nga CEF	3
Certifikime “Auditues i Brendshëm”	21



KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI

Në zbatim të Strategjisë së Komunikimit 2022-2025, KLSH ka vijuar me publikimin e rezultateve të auditimit, të cilat kanë gjetur pasqyrim të gjerë përmes medias së shkruar dhe audiovizive, duke rritur vizibilitetin e punës audituese të KLSH-së. Gjithashtu, ka vijuar bashkëpunimi me partnerët e brendshëm dhe ndërkombëtarë, sipas marrëveshjeve përkatëse.

Raporte auditimi, të publikuara	106
Kërkesa/ankesa të trajtuara	326
Artikuj/kronika mbi KLSH	1830
Auditime paralele	3
Marrëveshje të reja bashkëpunimi	2
Projekt me SECO i përfunduar	1
Projekt me IDI i përfunduar	1



ZHVILLIMI PROFESIONAL

KLSH, në përmbushje të detyrimit ligjor, ka implementuar me sukses programin e zhvillimit të integruar profesional të punonjësve, në bashkëpunime më partnerë të brendshëm si ASPA, dhe të jashtëm si SAI-e homologe, INTOSAI, EUROSAL, IDI, CEF, Banka Botërore etj.

Ditë trajnimi/vit/auditues	26
Ditë trajnimi/vit/jo-auditues	20
Tema me trajnerë të huaj	75%
Tema me trajnerë vendas	25%
Konferenca, trajnime ndërkombëtare	58



2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, KLSH, në cilësinë e institucionit të auditimit të jashtëm publik, gjatë vitit 2024 ka realizuar gjithsej 159 misione auditimi në institucionet publike, të cilat përfshijnë auditime financiare, auditime përputhshmërie, auditime performance, auditime të sistemeve të IT-së, auditime të kombinuara, auditime tematike si dhe auditime verifikuese për zbatimin e rekomandimeve. Më konkretisht, u kryen 45 auditime financiare, 43 auditime përputhshmërie, 35 auditime të kombinuara, 15 auditime performance, 8 auditime IT, dhe 13 auditime të zbatimit të rekomandimeve.

Për sa i takon fushëmbulimit me auditim, në përputhje me mandatin e saj, KLSH i ka kryer këto misione auditimi në 205 subjekte, nga të cilat: përfaqësues të enteve publike të qeverisjes qendrore 97 subjekte, të vetëqeverisjes vendore 75, institucione të pavarura 13, shoqëri publike me aksioner shtetin mbi 50%, 20 subjekte.

Në përputhje me misionin e KLSH-së dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, objektivi i auditimeve është që, në përfundim të tyre, të konkludohet me opinionin apo konkluzionin e përgjithshëm të auditimit, shoqëruar me dhënien e rekomandimeve përkatëse, relevante për përmirësimin e situatës së subjekteve të audituara, për problematikat apo mangësitë e konstatuara. Kështu, në auditimet e kryera gjatë vitit 2024, janë dhënë 194 opinione / mesazhe dhe konkluzione auditimi, nga të cilat: 80 opinione/konkluzione financiare, 78 opinione/konkluzione përputhshmërie, 15 mesazhe auditimi performance, 8 konkluzione auditimi IT, si dhe 13 konkluzione të tjera për zbatimin e rekomandimeve.

Sa i takon cilësisë së Opinioneve, në 29 prej tyre është konkluduar me opinion të pamodifikuar, që do të thotë se vetëm në këto auditime, pasqyrat financiare u konsideruan të rregullta

në paraqitjen e drejtë të situatës financiare, të subjektit të audituar. Këto kryesisht i përkasin rasteve kur institucionet e audituara kanë respektuar në mënyrë të kënaqshme ligjet dhe parimet financiare dhe nuk kanë patur shkelje apo gabime materiale në llogaritë e tyre.

Në 7 raste, kur mangësitë janë vlerësuar materiale, thelbësore dhe të përhapura, KLSH ka dhënë opinion të kundërt. Pjesa tjetër janë opinione të kualifikuara, ku pasqyrat financiare paraqesin gabime materiale dhe jo të përhapura. Duhet theksuar se, çdo raport auditimi kalon procesin e kontrollit të cilësisë së auditimit, nga një strukturë e posaçme në KLSH, e cila shqyrton nëse auditimi, konkluzionet dhe opinionin janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, bazuar në evidenca të mjaftueshme dhe në analizë profesionale. Klasifikimi i saktë i tyre siguron që rekomandimet dhe mesazhi ndaj institucioneve të jetë i qartë dhe i diferencuar sipas rëndësisë dhe peshës së gjetjeve.

Opinionet apo konkluzionet e auditimit, janë shoqëruar me 4378 rekomandime të cilat përfshijnë: 2594 masa organizative, 28 përmirësime të kuadrit ligjor, 1059 masa disiplinore dhe administrative, si dhe 184 masa me dëm ekonomik, dhe 513 masa për adresimin e parregullsive me efekt negativ financiar.

Këto masa synojnë jo vetëm plotësimin e mangësive, nxjerrjen e përgjegjësive individuale apo menaxheriale, por mbi të gjitha parandalimin e përsëritjes së tyre në të ardhmen.

Si një tregues i punës audituese dhe në përputhje me detyrimin ligjor, KLSH, kryen auditime për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Gjatë vitit 2024, u krye verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna, në 97 auditime të kryera gjatë vitit 2023, ku u konstatua se, rreth 70% e rekomandimeve janë zbatuar plotësisht, pjesërisht ose janë në proces zbatimi nga institucionet përgjegjëse. Kjo përqindje tregon se pavarësisht nivelit të lartë të



2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

pranueshmërisë (99%), me qëllim rritjen edhe të nivelit të zbatueshmërisë, KLSH ka vijuar të nxisë institucionet nëpërmjet rikërkimit të zbatimit të plotë të rekomandimeve.

Sa i takon gjetjeve kryesore, për të cilat janë formuluar dhe paraqitur rekomandimet përkatëse në raportet përfundimtare të auditimit, të grupuara sipas fushave, ato paraqiten si vijon:

Çështje që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare

Në auditimet financiare dhe të kombinuara, janë konstatuar një sërë problematikash që prekin cilësinë e raportimit financiar dhe përputhjen me parimet dhe standardet e kontabilitetit. Një ndër fenomenet më të përhapura lidhet me keqklasifikimin e shpenzimeve dhe të ardhurave, çka çon në deformimin e pasqyrës financiare të institucioneve dhe cenon besueshmërinë e tyre. Kështu, janë konstatuar raste të regjistrimit të shpenzimeve të investimeve si shpenzime operative, apo të ardhurave të realizuara që nuk janë njohur në pasqyra në kohën e duhur, si në disa institucione qendrore dhe vendore. Këto probleme burojnë nga mungesa e dokumentacionit mbështetës dhe dobësia e kontrolleve të brendshme.

Një tjetër fenomen i rëndësishëm është mosregjistrimi i plotë i pasurive dhe mungesa e dokumentacionit pronësor, veçanërisht në pasuritë e paluajtshme. Në auditimet e kryera në bashki, janë konstatuar prona që nuk janë regjistruar në regjistrat kontabël, pasuri pa certifikata pronësie, apo asete që nuk janë përfshirë në procesin e amortizimit.

Janë konstatuar gjithashtu probleme të përsëritura me marrjen në dorëzim dhe mosklasifikimin e aktiveve sipas parimeve kontabël. Kjo sjell deformim të pasqyrave financiare dhe krijon risk për tjetërsim të pasurive publike.

Në disa raste është evidentuar mungesa e harmonizimit ndërmjet sistemeve të mbajtjes së kontabilitetit dhe të dhënave të raportuara në Thesar, fenomen ky që jep pasiguri në saktësinë e pasqyrave dhe ka vështirësuar procesin e auditimit.

Një problematikë që evidentohet në mënyrë të vazhdueshme është shkelja e parimeve të kontabilitetit publik edhe në regjistrimin e pasaktë të detyrimeve, debitore dhe kreditore. Në auditimet e kryera janë konstatuar raste kur detyrimet janë pasqyruar në periudha të ndryshme nga momenti i lindjes së tyre.

Një tjetër fenomen shqetësues është mungesa e regjistrave të plotë dhe të përditësuar të detyrimeve, si ato ndaj furnitorëve apo vendimeve gjyqësore. Në auditimet e disa bashkive është konstatuar mungesë evidencash mbi detyrimet e prapambetura, moslogaritje e kamatëvonesave, si dhe mosregjistrim i detyrimeve të njohura me vendim gjykate. Kjo krijon jo vetëm pasaktësi në pasqyrat financiare, por edhe rrezik real për rritje të detyrimeve në të ardhmen dhe përballje me penalitete të pajustificueshme, si kosto shtesë buxhetore.

Në auditimet e institucioneve me struktura varësie është konstatuar mungesë e konsolidimit të informacionit financiar midis njësive të varisisë. Pasqyrat janë hartuar vetëm për aparatën qendror, pa përfshirë të dhënat e drejtorive rajonale apo njësive të tjera shpenzuese. Gjithashtu janë konstatuar shkelje të afateve ligjore për dorëzimin e pasqyrave financiare, mungesë e rakordimeve midis bilanceve të viteve përkatëse, si dhe pasqyra financiare, që nuk përfshijnë të gjitha transaksionet e periudhës.

Një tjetër problem sistematik që doli nga auditimet financiare është mungesa e kapaciteteve dhe efektivitetit të njësive të auditimit të brendshëm. Në disa institucione, veçanërisht në nivel vendor, njësia e auditit të



2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

brendshëm nuk është funksionale, raportet janë formale ose nuk mbështeten në analiza të riskut. Njësitë e auditimit nuk kanë ushtruar funksionet e tyre të plota, gjatë vitit.

Në përmbledhje, auditimet financiare kanë nxjerrë në pah se, fenomenet e përsëritura si: keqklasifikimi, mosregjistrimi i aseteve, raportimi jashtë afateve, mungesa e rakordimeve, dobësia e auditit të brendshëm, diktojnë nevojën për përmirësime të mëtejshme të sistemeve të menaxhimit financiar publik.

Çështje që lidhen me përputhshmërinë e aktivitetit të institucioneve publike

Gjatë vitit 2024, KLSH ka kryer disa auditime të përputhshmërisë dhe të kombinuara, me qëllim vlerësimin e respektimit të legjislacionit dhe kuadrit rregullator në fuqi, nga institucionet publike.

Në tërësi, auditimet e përputhshmërisë kanë evidentuar një përhapje të gjerë të mosrespektimit të kuadrit ligjor dhe rregullator, në prokurime, raportimin fiskal, zbatimin e kontratave, etj. Këto problematika janë sistemike dhe të pranishme në disa nivele të qeverisjes.

Një nga fenomenet më të përhapura është mungesa e disiplinës buxhetore në të gjitha hallkat e ciklit financiar, duke përfshirë planifikimin, miratimin, ekzekutimin dhe raportimin. Në disa raste janë vërejtur rialokime të fondeve drejt projekteve që nuk kanë kaluar procesin e plotë të vlerësimit, e shoqëruar kjo edhe me përdorim joefikas të fondeve në dispozicion.

Janë konstatuar mangësi në planifikimin buxhetor bazuar në vonesat dhe pasaktësitë në përgatitjen e kërkesave buxhetore nga ministritë e linjës, duke dorëzuar dokumentacion jo të plotë dhe kërkesa shtesë përtej taveve të miratuara, për të cilat KLSH

rekomandoi forcimin e disiplinës buxhetore dhe respektimin strikt të afateve, formateve dhe argumentimit të projekteve të reja gjatë hartimit të projektbuxhetit vjetor dhe atij afatmesëm (PBA).

Fondi Rezervë u tejkalua mbi kufirin ligjor 3% dhe një pjesë e tij në shumën 304.6 milionë lekë u përdor për shpenzime që nuk ishin vërtet të paparashikueshme, por ishin të njohura qysh në fazën e hartimit të buxhetit.

Në lidhje me ekzekutimin e buxhetit dhe menaxhimin e investimeve publike, u konstatuan rishpërndarje buxhetore, me efekt në buxhetin e vitit 2023, ku sipas numrit unik konstatohen 2514 rishpërndarje buxhetore, nga të cilat 454 përtej kufirit kohor ligjor të datës 15 nëntor. Disa fonde investimesh u shkurtuan në momentin e lidhjes së kontratave dhe u rishpërndanë, duke rritur mundësinë për krijimin e detyrimeve të prapambetura, Gjatë vitit 2023, janë paguar rreth 9,226 milionë lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, ndërkohë që u krijuan edhe detyrime të reja për rreth 2,474 milionë lekë. Për këtë situatë, KLSH vuri theksin në rëndësinë e zbatimit të një discipline më të lartë të monitorimit të buxhetit për të shmangur ndërprerjen e fondeve të investimeve pa cikël të plotë, të paparashikuara në planin trevjeçar, nxitjen e zbatimit të projekteve të investimeve në afatet e parashikuara pa periudhë e kosto shtesë, si dhe dhënien prioritet uljes së stokut të detyrimeve të prapambetura, si një ngarkesë në buxhetet e viteve pasardhëse.

Në lidhje me përputhshmërinë e planifikimit dhe zbatimit të fondeve speciale, nga auditimi në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), u evidentuan mangësi në procesin e rimbursimit të barnave, për të cilat FSDKSH nuk vuri në dispozicion të plotë, të dhënat e detajuara të rimbursimeve në nivel përfituesi me kode unike identifikuese, gjë



2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

që pamundësoi kryerjen e testeve të plota mbi verifikimin e legjitimitetit të rimbursimeve. Pavarësisht kufizimit, për vitet 2021 dhe 2022, u konstatuan 60 raste të rimbursimeve të padrejta për pacientë që në fakt kishin ndërruar jetë. Këto raste, të shpërndara në rajone, mjekë dhe farmaci të ndryshme, tregojnë mangësi serioze në sistemin e kontrollit të skemës së rimbursimit. Në lidhje me rregullshmërinë e Listës së Barnave të Rimbursueshme (LBR) u konstatua se ajo nuk është hartuar dhe miratuar në kohën e duhur, duke mos përfshirë në skemë medikamente alternative më të lira, çka solli një kosto shtesë prej rreth 114 milionë lekë për buxhetin e Fondit.

Shkelje të përsëritura janë konstatuar në drejtim të respektimit të afateve ligjore të regjistrimit të urdhrave të prokurimit, të kontratave dhe të likuidimit të faturave në SIFQ. Ky fenomen është përhapur në mënyrë të gjerë në njësitë e vetëqeverisjes vendore, por është i pranishëm edhe në institucionet qendrore dhe shoqëritë publike.

Në fushën e administrimit të kontratave të Partneritetit Publik Privat (PPP) dhe koncesioneve, janë konstatuar shkelje të kriterëve të financimit, mangësi në monitorim dhe në vlerësimin e efekteve buxhetore afatgjata. Në disa raste është vijuar me pagesa për shërbime që nuk janë kryer, ose që janë kryer në vëllime më të ulëta se projeksioni. Fenomene të tilla janë vërejtur në kontrata të rëndësishme në fushën e shëndetësisë, ku raportimi i shpenzimeve ka tejkaluar buxhetet e miratuara dhe detyrimet janë likuiduar në kundërshtim me përmbajtjen kontraktore, përfshirë edhe TVSH-në.

Janë konstatuar angazhime pa fonde në dispozicion në vlerën 6.7 miliard lekë. Deri në 31.12.2023 detyrimet e akumuluar të ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizime rezultojnë të jenë rreth 30.9, miliard lekë dhe të subjekteve nënhuamarrëse 2.4 miliard lekë. Ndërkohë stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore paraqitet në vlerën 8.1 miliard lekë.

Nga auditimi **mbi rregullshmërinë e aktivitetit të institucioneve të administrimit të të ardhurave fiskale** u konstatua se:

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave rezultuan devijime nga kuadri ligjor në veprimtarinë doganore gjatë vitit 2023, të cilat u vlerësuan si materiale, megjithëse jo të përhapura. Për këtë arsye, KLSH dha Opinon të kualifikuar, duke tërhequr vëmendjen në çështjet e mungesës së përfshirjes në planifikimin e të ardhurave të degëve doganore. U konstatuan dobësi në funksionimin e kontrolleve kundër kontrabandës, ku nga Drejtoria përkatëse, disa kontrolle nuk finalizoheshin me masat e duhura, edhe në rastet kur zbuloheshin detyrime doganore të papaguara (shmangie taksash), autoritetet doganore nuk vendosnin gjobën e dyfishtë të detyrimit dhe nuk i klasifikonin shkeljet si “kundërvajtje doganore në neglizhencë”.

Një tjetër fenomen, me ndikim në të ardhurat doganore të mbledhura është ai i shkeljeve të rregullave për klasifikimin tarifor, vlerësimin doganor dhe llogaritjen e detyrimeve doganore. Praktikrat përfshijnë trajtim të padrejtë të çmimeve të mallrave të importuara, përdorim të pjesshëm ose selektiv të metodës së transaksionit, keqklasifikim të produkteve, si dhe shmangie nga pagesa e taksave dhe akcizave. Stoku i borxhit doganor, mw 31.12.2023, rezultoi 47.6 miliard lekë në 4495 subjekte debitorë. Ndërkohë, rikuperimi i borxhit doganor është në nivele të papranueshme, me vetëm 1.2% të stokut gjatë vitit 2023, çka tregon për mungesë kapacitetesh zbatuese dhe kontrolluese.

Për sa më sipër, KLSH rekomandoi përmirësimin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e riskut, koordinim më të mirë midis strukturave të planifikimit dhe atyre të kontrollit brenda administratës doganore, në mënyrë që planet e të ardhurave të jenë realiste dhe kontrollet të jenë të synuara e efektive dhe të kontribuojnë në uljen e hapësirave për kontrabandë e abuzime.



2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në Administratën Tatimore (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve) u konstatuan probleme në mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe administrimin e detyrimeve. Edhe pse DPT ka bërë përmirësime në disa drejtime, KLSH konstatoi devijime materiale që sollën opinion të kualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së saj, bazuar në:

Një stok borxhi tatimor të rritur ku, në fund të vitit 2023, totali i detyrimeve tatimore të prapambetura arriti në rreth 155.2 miliard lekë që i përkasin mbi 181 mijë tatimpaguesve debitorë. Vetëm gjatë vitit 2023, stoku i detyrimeve u shtua edhe me 40 miliard lekë. Për më tepër, në evidencat e DPT ekzistojnë rreth 2.35 miliard detyrime tatimore jashtë sistemit elektronik C@TS. Për këtë, KLSH rekomandoi që DPT të ndërmarrë dhe intensifikojë masa shtrënguese të parashikuara si: bllokime asetesh, ndalim aktiviteti etj., si dhe integrimin e plotë të të gjitha detyrimeve në sistemin qendror, për një paraqitje dhe monitorim të plotë.

Sa i takon rregullshmërisë së kontrolleve tatimore, si një formë e monitorimit dhe zbatimit të ligjshmërisë fiskale, u konstatua mosrealizimi i plotë i planit të kontrolleve tatimore, ku sipas të dhënave të DPT, nga 2982 kontrolle tatimore të planifikuara për vitin 2024, 109 kontrolle (rreth 4%) nuk u iniciuan fare. Kjo situatë vjen si rrjedhojë e mungesës së koordinimit midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorive Rajonale Tatimore që kryejnë kontrollet në terren. Gjithashtu, nga auditimi i funksionit të Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren u konstatua se nuk ka një rakordim sistematik me Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut mbi kontrollet e kryera dhe rezultatet e planeve operacionale.

Në përgjithësi, rekomandimet e KLSH-së për administratën tatimore synojnë rritjen e efijencës së mbledhjes së të ardhurave, zbatimi

i të cilave do të ndihmojë në uljen e evazionit, arkëtimin më të mirë të detyrimeve, rritjen e transparencës ndaj biznesit. Po ashtu, KLSH sugjeroi vazhdimin e digjitalizimit të shërbimeve dhe mbikëqyrjes tatimore, me qëllim uljen e kontaktit të drejtpërdrejtë mes inspektorit dhe tatimpaguesit duke minimizuar kështu mundësitë e korrupsionit.

Një tjetër fushë problematike e identifikuar është menaxhimi i të ardhurave nga shërbimet publike dhe burimet e veta, veçanërisht në njësitë vendore. Në auditimet e disa bashkive janë konstatuar mospërputhje midis të ardhurave të raportuara dhe atyre të arkëtuara realisht, mungesë rakordimi me bankat apo me regjistrat e pagesave. Në disa raste, të ardhurat nga taksat vendore nuk ishin regjistruar në kohë ose ishin përdorur për qëllime të ndryshme nga destinacioni ligjor.

Mungesa e menaxhimit të duhur të asetëve publike është një tjetër fenomen që përbën rrezik të drejtpërdrejtë për interesin ekonomik të shtetit. Në institucionet e ngarkuara me administrimin e kolateraleve dhe kredive të falimentuara, si në rastin e Agjencisë për Trajtimin e Kredive, janë konstatuar mungesa dokumentacioni, mosregjistrim i pasurive të konfiskuara, si dhe pamundësi për t'i identifikuar apo vlerësuar ato. Sistemet e të dhënave janë të paplota, me shumë rekorde të paidentifikuara, ndërkohë që mungojnë veprimet ligjore të nevojshme për të ndjekur debitorët, përfshirë edhe rastet e trashëgimisë apo falimentit.

Në disa auditime të kombinuara janë konstatuar probleme me regjistrimin e detyrimeve të prapambetura, të cilat janë raportuar në mënyrë të fragmentuar ose të pasaktë në pasqyrat financiare duke u reflektuar në periudha të mëvonshme dhe duke ndikuar në planifikimin real të buxhetit. Në disa raste nuk ekzistonin as aktet e njohjes ligjore të detyrimeve dhe as vendimet për konstatimin e shkeljeve që kishin



2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

sjellë pagesat përkatëse.

Auditimet e realizuara gjatë vitit 2024, konstatuan problematika në **fushën e prokurimeve**, të përhapura në institucione të administratës qendrore dhe vendore, universitete, spitale dhe ndërmarrje publike. Ato lidhen kryesisht me planifikimin joefektiv të prokurimeve, kufizimin e konkurrencës, parregullsitë në hartimin dhe zbatimin e kontratave, si dhe me mungesën e kontrollit të brendshëm. Në bashkitë e audituara, planet vjetore të prokurimit shpesh nuk ishin të harmonizuara me buxhetet apo nevojat reale. Në disa raste, kriteret e kualifikimit janë vendosur në mënyrë të tillë që kufizonin garën, ndërsa në të tjera mungonte dokumentacioni mbështetës për vlerësimin dhe përzgjedhjen e operatorëve. Gjithashtu janë konstatuar procedura me vetëm një operator konkurrues, dokumente të tenderit me kriteret e pajustificuara ose të njëanshme, si dhe përcaktim i paargumentuar i fondit limit. Në disa raste, është përdorur prokurimi për shërbime që mbuloheshin nga kontrata ekzistuese, duke çuar në dublim të kostove. Ndërkohë janë konstatuar vonesa në zbatimin e kontratave, mungesë aplikimi penalitetesh, pagesa për punime të pakryera apo të realizuara në mënyrë të pa plotë. Struktura e mbikëqyrjes teknike dhe e administrimit të kontratave shpesh mungon ose nuk funksionon siç duhet.

Gjithashtu u identifikuan problematika në administrimin e burimeve njerëzore në institucione të ndryshme publike. Një nga gjetjet më të përsëritura lidhej me largimet e padrejta nga puna dhe mungesën e dokumentacionit mbështetës për vendimmarrjet përkatëse. Janë evidentuar raste kur largimi nga puna është bërë në kundërshtim me Kodin e Punës dhe ligjet specifike të shërbimit civil, pa një proces të rregullt disiplinor apo pa dhënë mundësi për ankimim. Këto praktika kanë sjellë kosto shtesë në buxhetin e shtetit, për vendimet e gjyqfituesve.

Po ashtu, janë hasur raste të mbivendosjes së funksioneve ose mungesës së ndarjes së qartë të përgjegjësiave, që rrit rrezikun për vendimmarrje abuzive dhe cenon integritetin institucional.

Në tërësi, auditimet e kombinuara kanë dëshmuar se problemet me përputhshmërinë dhe ato me pasqyrat financiare janë shpesh të ndërthurura dhe ndikojnë ndërsjelltas në pasaktësitë në raportim, mungesën e transparencës dhe keq menaxhimin e pasurive, detyrimeve dhe fondeve buxhetore që institucionet kanë në dispozicion. Gjetjet dëshmojnë edhe një herë nevojën e rritjes së kapaciteteve institucionale, forcimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, rritjes së llogaridhënies dhe vlerësimit të mekanizmave ekzistues të mbikëqyrjes dhe monitorimit.

Sa i takon **auditimeve të performancës**, gjatë vitit 2024, Kontrolli i Lartë i Shtetit realizoi 15 auditime, të cilat u fokusuan në vlerësimin e efektivitetit, ekonomikitetit dhe efikasitetit të institucioneve publike në realizimin e detyrave dhe funksioneve të tyre, në fusha me ndjeshmëri publike si: shëndetësi, arsim, kulturë, barazia gjinore, mjedisi, dhe shërbimeve publike.

Në **sektorin e shëndetësisë**, auditimet zbuluan problematika në menaxhimin dhe shpërndarjen e pajisjeve mjekësore. Në spitalet si: QSUNT dhe Spitali i Traumës, mungesa e inxhinierëve bio - mjekësorë ka krijuar varësi nga shërbimet e jashtme për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve. Kjo, jo vetëm ka sjellë kosto të rritura, por gjithashtu ka krijuar pasiguri në menaxhimin e burimeve. Për më tepër, strategjitë kombëtare për shpërndarjen e këtyre pajisjeve nuk pasqyrojnë realitetin demografik dhe nevojat e popullatës, duke rezultuar në shpërndarje joefikase dhe mosplotësim të kërkesave shëndetësore.

Një tjetër çështje kritike është përkujdesja për pacientët me probleme të shëndetit mendor në shërbimin spitalor të specializuar. Auditimi evidentoi mungesën e një qasjeje



2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

gjithëpërfshirëse për trajtimin e tyre, ndërkohë që spitalet psikiatrike përballen me mungesa serioze në kapacitetet e akomodimit dhe shërbimeve. Spitali Psikiatrik në Elbasan dhe ai në Vlorë vijnë të përballen me sfida në trajtimin e pacientëve kronikë, ndërsa bashkëpunimi i pamjaftueshëm midis MSHMS dhe Ministrisë së Drejtësisë, ka penguar krijimin e institucioneve të specializuara.

Në fushën e mjedisit, auditimet e kryera identifikuan problematika serioze në trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve urbane dhe spitalore. Katër bashkitë e audituara, në veçanti Durrësi dhe Vlora, nuk kanë arritur të zbatojnë një menaxhim të integruar të mbetjeve, duke i lënë ato të depozitohen në kushte të papërshtatshme që rrezikojnë shëndetin e popullatës dhe ndotin mjedisin. Një situatë veçanërisht alarmante është ajo e mbetjeve që digjen në hapësira të hapura, ku çlirimi i substancave të rrezikshme paraqet një kërcënim të madh për mjedisin dhe komunitetin lokal. Në lidhje me mbetjet spitalore, spitalet rajonale në Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë kanë treguar mangësi serioze në dokumentacion dhe infrastrukturë për trajtimin dhe magazinimin e mbetjeve të rrezikshme.

Ndryshimet klimatike janë një tjetër sfidë e madhe për Shqipërinë, ku angazhimi i përgjithshëm mbetet i kufizuar. Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike, i hartuar në bashkëpunim me UNDP në vitin 2023, është ende i pa miratuar dhe nuk ka fuqi ligjore për zbatim. Për më tepër, mungesa e një kuadri strategjik për financimet klimatike dhe mos krijimi i sektorit të dedikuar për këtë çështje, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit kanë penguar zbatimin e masave për përshtatjen ndaj efekteve klimatike. Edhe pse ligji për ndryshimet klimatike parashikon krijimin e një fondi të veçantë për mjedisin, ai ende nuk është zbatuar, duke kufizuar burimet financiare për zhvillimin e projekteve të nevojshme.

Në fushën sociale dhe të barazisë gjinore, auditimet zbuluan problematika në procesin e birësimeve dhe fuqizimin e grave në zonat rurale.

Procedurat ligjore të birësimeve janë shpesh të ndërlikuara, me kufizime të forta që nuk garantojnë gjithmonë interesin më të lartë të fëmijës. Mungesa e një kornize të harmonizuar ligjore dhe administrative për birësimet, ka krijuar vonesa të konsiderueshme dhe komplikime që ndonjëherë pengojnë adoptuesit potencialë.

Barazia gjinore, veçanërisht në zonat rurale, është gjithashtu një sfidë kritike që kërkon vëmendje të posaçme. Gratë në këto zona vazhdojnë të përballen me kufizime në aksesin ndaj burimeve dhe shërbimeve që janë thelbësore për zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Mungesa e transportit publik, çerdheve dhe kopshteve, ndikon negativisht në mundësitë e tyre për punësim dhe përfshirje në tregun e punës, duke krijuar pengesa për rritjen ekonomike dhe sociale të tyre.

Në fushën e arsimit dhe kulturës, në lidhje me Fondin e Ekselencës për studentët, auditimi zbuloi mbivendosje të përgjegjësive ndërmjet institucioneve që menaxhojnë fondin, duke rezultuar në mungesë koordinimi dhe transparence. Orientimi në karrierë për të rinjtë në sistemin arsimor parauniversitar është një tjetër aspekt ku mungesa e mekanizmave të qëndrueshëm e ka bërë procesin joefikas. Auditimi evidentoi që shumë të rinj nuk marrin mbështetjen e duhur për të identifikuar dhe zhvilluar potencialin e tyre.

Sa i takon kulturës, nga auditimi rezultoi se, pasuritë kulturore shqiptare të listuara në UNESCO, si Berati dhe Gjirokastra, përballen me sfida serioze në ruajtjen dhe administrimin e tyre. Mungesa e planeve menaxhuese të miratuara dhe e fondeve të dedikuara, ka kufizuar ndërhyrjet për mirëmbajtje dhe



2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

restaurim, duke rrezikuar jo vetëm gjendjen e tyre fizike, por edhe statusin si pjesë e trashëgimisë botërore.

Në fushën e menaxhimit të hapësirave publike, plazhet publike përbëjnë një aset të rëndësishëm për qytetarët, por auditimet evidentuan mangësi të theksuara në përmbushjen e standardeve të sigurisë dhe cilësisë. Në shumë raste, strukturat e plazheve publike janë të paorganizuara dhe nuk përmbushin kriteret minimale për akses dhe komoditet. Për më tepër, rritja e sipërfaqeve të kontraktuara të plazheve, nuk ka qenë e lidhur në mënyrë proporcionale me të ardhurat e mbledhura nga tarifat përkatëse.

Ky disproporcion ka rezultuar në mungesën e investimeve të qëndrueshme për përmirësimin e këtyre hapësirave, duke kufizuar aksesin e qytetarëve në zona cilësore për rekreacion dhe pushim. Mungesa e ndërhyrjeve strategjike dhe investimeve në infrastrukturë ka ndikuar negativisht në vlerën dhe funksionalitetin e këtyre hapësirave, duke treguar nevojën për një qasje më të koordinuar dhe transparente.

Në tërësi, auditimet e performancës për vitin 2024 kanë evidentuar se orientimi i institucioneve publike drejt rezultateve dhe mungesa e matjes së ndikimit, nuk janë konsoliduar mjaftueshëm si qasje menaxhimi. Moskoordinimi ndërinstytucional, përdorimi joefikas i burimeve dhe dobësitë në planifikim e monitorim, flasin për mungesë efecience dhe efektiviteti të programeve / politikave / strategjive, duke cënuar cilësinë e shërbimeve publike dhe besimin e qytetarëve tek veprimtaria e institucioneve publike.

Auditimet e teknologjisë së informacionit të realizuara nga KLSH gjatë vitit 2024, kanë synuar të vlerësojnë sigurinë, funksionalitetin, integritetin dhe efikasitetin e sistemeve elektronike të përdorura nga institucionet publike në ofrimin e shërbimeve dhe

administrimin e të dhënave. Janë kryer 8 auditime IT, që kanë përfshirë institucione që administrojnë sisteme të rëndësishme për funksionimin e shtetit dhe shërbimet ndaj qytetarëve, dhe që kanë zbuluar disa probleme që tregojnë për dobësi të theksuara në planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e sistemeve të IT-së në sektorin publik por si dhe për mungesë të plotë të një kulture institucionale të menaxhimit të rrezikut informatik.

Një problem i përsëritur në disa institucione është **mungesa e politikave dhe procedurave për menaxhimin e infrastrukturës dhe sistemeve TI,** duke ekspozuar institucionet ndaj rreziqeve të brendshme dhe të jashtme; mungesa e dokumentacionit të formalizuar për menaxhimin e aksesit të përdoruesve, kontrollin e privilegjeve administrative dhe ndarjen e roleve kritike, Kjo krijon rrezik për manipulim të të dhënave, si dhe për përdorim të paautorizuar të sistemeve.

Gjithashtu është konstatuar **mungesa e punonjësve apo trajnimit të tyre për sigurinë kibernetike** dhe menaxhimin e sistemeve, çka rrit ndjeshëm rrezikun për gabime njerëzore dhe keqadministrim të sistemeve kritike; është evidentuar mungesa e punonjësve në departamentet e IT. Gjithashtu, në shumë institucione nuk zhvillohen trajnime periodike për përdoruesit fundorë, ndërkohë që personeli i IT-së shpesh nuk është i pajisur me trajnime/certifikime apo përgatitje të specializuara për teknologjitë që menaxhojnë.

Auditimet kanë nxjerrë në pah gjithashtu mangësi që i përkasin administrimit dhe sigurisë së të dhënave, si dhe **dobësi në mënyrën e ruajtjes së kopjeve rezervë.** Mangësitë në administrimin e të dhënave dhe niveleve të aksesit kanë rrezikuar integritetin dhe konfidencialitetin e informacionit. Në sistemin e administrimit të kundërvajtjeve rrugore e-Gjoba, mungesa e përcaktimit të rregullave për



2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

administrimin e të dhënave ka krijuar pasiguri në mbrojtjen e informacionit të të dhënave shtetërore. Po ashtu, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të dhënat e gjeneruara nga sistemi elektronik i lejeve janë lehtësisht të manipulueshme, pasi transmetimi i tyre kryhet në mënyrë të pasigurt.

Mungon një ndarje e qartë e përgjegjësisë për administrimin e sistemeve dhe sigurinë kibernetike. Disa institucione nuk kanë pozicione të dedikuara për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave, duke e bërë të vështirë zbatimin e masave efektive për sigurinë dhe privatësinë e informacionit. Për më tepër, procedurat për menaxhimin e bazave të të dhënave shpesh nuk janë të dokumentuara ose nuk ndiqen në mënyrë rigorozë, duke krijuar rreziqe për integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave.

Një tjetër problem i përhapur është **mungesa e kontrollit të funksionaliteteve të sistemeve**, duke përfshirë mungesën e testimeve të strukturuar, mungesën e dokumentacionit teknik dhe të politikave për ndryshimet në kodin burimor. Në disa projekte të rëndësishme të IT-së është konstatuar ndjekja formale e dokumentacionit, mosrealizimi i disa specifikimeve teknike dhe mungesa e raportimit të rregullt. Kjo është vërejtur në zbatimin e kontratave për sistemin e-Gjopa të vitit 2018 dhe 2022, ku janë hasur probleme të vazhdueshme në funksionimin e sistemit deri në fund të vitit 2023. Këto mangësi kanë ndikuar në cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe në besueshmërinë e sistemeve.

Në disa institucione, **sistemet informatike nuk kanë mekanizmat e nevojshëm për kontrollin e inputit**, duke krijuar rrezikun e popullimit të tyre me të dhëna të pasakta apo të paplota. Si shembull, në Sistemin e Ndhmës Ekonomike, mungesa e këtyre mekanizmave ka rritur probabilitetin e rezultateve të gabuara.

Gjithashtu, në sistemin për lejet minerare të AKBN-së, mungesa e kontrollit të të dhënave ka sjellë probleme si tejkalimi i afateve dhe dublikimi i informacionit, duke ndikuar në saktësinë e raporteve.

Një tjetër problem i përhapur në institucione varësie ose të pushtetit lokal është **mungesa e investimeve të nevojshme për përmirësimin e infrastrukturës teknologjike.**

Në disa institucione, pajisjet e përdorura për shërbimet e komunikimit dhe ruajtjes së të dhënave janë të vjetruara dhe nuk garantojnë sigurinë e kërkuar. Po ashtu, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, investimet e kufizuara në IT kanë ndikuar negativisht në efikasitetin operacional dhe sigurinë e informacionit.

Në tërësi, auditimet e teknologjisë së informacionit kanë vërtetuar se sektori publik në Shqipëri përballet me sfida serioze në fushën e sigurisë dhe menaxhimit të sistemeve digjitale. Dobësitë e konstatuara – që nga mungesa e Mungesa e politikave dhe rregulloreve të qarta, kapaciteteve të specializuara dhe kontrolleve të forta të aksesit ka ekspozuar institucionet ndaj rreziqeve të konsiderueshme. Këto problematika theksojnë nevojën për përmirësime të domosdoshme në menaxhimin e teknologjisë së informacionit dhe forcimin e sigurisë kibernetike.

Në drejtim të organizimit dhe menaxhimit institucional,

KLSH, përveç misionit të saj kryesor të auditimit, gjatë vitit 2024, ka vijuar me përkushtim, zbatimin e funksioneve të tij mbështetëse që lidhen me forcimin e kapaciteteve institucionale, komunikimin me publikun dhe bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë, me institucionet e tjera të brendshme dhe me organizatat ndërkombëtare të auditimit. Të gjitha këto veprimtari janë zhvilluar në përputhje me objektivat strategjike të përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit



2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Institucional 2023–2027.

Në lidhje me Qëllimin nr.1 të Strategjisë, gjatë vitit 2024, KLSH ka mbajtur një marrëdhënie të vazhdueshme me Kuvendin e Shqipërisë, si institucioni para të cilit raporton dhe prej të cilit siguron mbështetje institucionale për ushtrimin e mandatit të vet. Në këtë mënyrë është vijuar me dërgimin e raporteve përfundimtare të auditimit, raporteve mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme si dhe me dërgimin e Buletineve Statistike periodike. Si risi për vitin 2024, me ngritjen e Nënkomisionit për Auditimin e Jashtëm publik pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, janë organizuar dëgjesa për shqyrtimin e projektligjit të buxhetit 2025, si dhe për diskutimin e rezultateve të auditimeve të kërkuara, në përfundim të të cilave Nënkomisioni ka dalë me raporte rekomanduese për institucionet e audituara, me qëllim nxitjen e zbatimit të plotë të rekomandimeve të KLSH-së.

Në lidhje me Qëllimin nr.2 të Strategjisë, një nga fushat me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e impaktit të punës audituese është ndjekja e rekomandimeve të lëna në auditimet e kryera, në periudhat e mëparshme. Kjo detyrë ligjore është realizuar në mënyrë të standardizuar, përmes auditimeve tematike “mbi zbatimin e rekomandimeve”, duke ndikuar kështu në rritjen e përgjegjshmërisë dhe ndërgjegjësimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së në veçanti dhe ligjshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin publik, në tërësi. Në këtë drejtim, KLSH i ka kushtuar gjithashtu rëndësi të veçantë komunikimit të rezultateve të punës audituese tek publiku, media dhe palët e interesuara, duke përdorur mekanizma si publikimi në faqen zyrtare të raporteve të auditimit, buletineve statistikore dhe njoftimeve mbi aktivitetet e ndryshme.

Në zbatim edhe të rekomandimeve të Kuvendit, prej muajit Nëntor 2024, është hartuar dhe publikuar edhe një Buletin mujor informues si dhe janë hapur dy profile në rrjetet sociale Instagram dhe Facebook, në të cilat, aktiviteti i

KLSH-së, gjen pasqyrim në publikun e gjerë.

Githashtu, KLSH gjatë 2024 ka vazhduar të luajë një rol aktiv në rrjetet ndërkombëtare të auditimit si anëtare e INTOSAI dhe EUROSAL. Janë zhvilluar bashkëpunime me institucione partnerë si: IDI (Iniciativa e Zhvillimit të INTOSAI), CEF (Qendra e Ekselencës në Financë), Banka Botërore, SECO etj., në kuadër të rritjes së kapaciteteve dhe adoptimit të praktikave më të mira. Audituesit e KLSH-së kanë marrë pjesë në trajnime dhe projekte të përbashkëta.

KLSH ka forcuar partneritetet edhe përmes marrëveshjeve dypalëshe me institucione homologe si bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, Norvegjisë, Gjykatën e Llogarive Turke, Maqedoninë e Veriut, Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA) dhe SIGMA/OECD dhe GAO. Këto bashkëpunime fokusohen në harmonizimin e standardeve, kryerjen e auditimeve të përbashkëta ose paralele, si dhe shkëmbimin e ekspertizës teknike.

Në funksion të rritjes së transparencës dhe ndërveprimit me qytetarët, KLSH duke ndjekur një politikë të hapur komunikimi, ka administruar rregullisht ankesa, sugjerime apo informacione të dërguara nga qytetarët e që, më pas janë shqyrtuar në funksion të planifikimit të auditimeve apo të vlerësimit të rëndësisë apo ndjeshmërisë publike të çështjes së ngritur.

Në lidhje me Qëllimin nr.3 të Strategjisë, një komponent qendror i zhvillimit institucional gjatë vitit 2024, ka qenë zhvillimi profesional i stafit auditues dhe jo auditues, përmes një programi të strukturuar trajnime që mbështetet si në kapacitetet e brendshme të institucionit, ashtu edhe në bashkëpunimin me partnerë vendas dhe të huaj. Janë organizuar një seri trajnimesh të brendshme dhe të jashtme, që kanë përfshirë tematika në lidhje me: auditimet e performancës, auditimet IT-së, përdorimi i të dhënave në auditim dhe etikën profesionale. Është vijuar aplikimi i skemës së mentorimit dhe i rishikimit të brendshëm të punës së audituesve, me qëllim garantimin e cilësisë dhe përafrimin me standardet e INTOSAI-t.



2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në lidhje me organizimin dhe funksionimin e institucionit, edhe gjatë vitit 2024, KLSH është kujdesur për rritjen e kapaciteteve institucionale. Struktura e institucionit gëzon një përfaqësim të balancuar gjinor, me një pjesëmarrje të konsiderueshme të grave. KLSH ka ruajtur një organizim të brendshëm që i përgjigjet nevojave të misionit të vet. Strukturat organizative janë të ndara sipas departamenteve të auditimit të buxhetit të shtetit, të institucioneve të qeverisjes qendrore, të njësive të vetëqeverisjes vendore, të shoqërive me kapital shtetëror si dhe dy struktura të dedikuara për kryerjen e auditimeve të performancës dhe auditimeve të teknologjisë së informacionit, të mbështetura nga struktura të rëndësishme si ajo e metodologjisë dhe planifikimit strategjik dhe struktura e kontrollit dhe sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, organizimi i brendshëm siguron administrimin dhe vazhdimësinë e aktivitetit auditues, nëpërmjet strukturave mbështetëse të dedikuara.

Për vitin 2024, numri i miratuar i punonjësve për KLSH ishte 243 punonjës, në fund të vitit rezultojnë 216 punonjës nga të cilët 162 auditues. Sa i takon etikës dhe integritetit, KLSH i kushton rëndësi kultivimit të një mjedisi etik e profesional për stafin e vet. Gjatë vitit 2024 është rishikuar dokumenti i Kodit Etik, si dhe janë ofruar trajnime për etikën, parandalimin e konfliktit të interesit dhe sensibilizimin kundër korrupsionit.

Në përmbledhje, me një staf të kualifikuar dhe të trajnuar mirë, KLSH ka arritur të përmbushë objektivat e auditimit me cilësi dhe në kohë.

Investimi i vazhdueshëm në burimet njerëzore dhe profesionalizmin e tyre, përbën një garanci që KLSH do të vazhdojë të jetë një institucion kompetent, efikas dhe i besueshëm në rolin e vet mbikëqyrës.

Në tërësi, viti 2024 përfaqëson për KLSH-në një periudhë konsolidimi të mëtejshëm të rolit të vet, si garant i fondeve publike, ku përveç gjetjeve të rëndësishme të auditimit, institucioni ka forcuar ndjeshëm kapacitetet e brendshme, ndërveprimin me aktorët institucionalë dhe

publikun, si dhe pozicionin në rrjetin e institucioneve homologe ndërkombëtare. Ky zhvillim i qëndrueshëm institucional është thelbësor për rritjen e besueshmërisë, forcimin e integritetit dhe përmbushjen me përgjegjësi të lartë, të mandatit kushtetues në shërbim të interesit publik.

Si institucion i vetëm i kontrollit të jashtëm financiar publik, KLSH ka bërë përpjekje maksimale të luajë rolin e saj kyç në përmirësimin e qeverisjes publike, **rritjen e llogaridhënies dhe parandalimin e korrupsionit**. Gjatë vitit 2024, KLSH e ka theksuar këtë rol në disa drejtime:

Në drejtim të rritjes së llogaridhënies dhe transparencës në administratën publike, nëpërmjet çdo rekomandimi të dhënë, ku synohet forcimi kontrolleve të brendshme financiare dhe organizative në institucionet e audituara, duke quantifikuar në çdo rast ndikimin negativ të mungesës së këtyre kontrolleve, nxjerrjen e përgjegjësive dhe afatet për zbatim. Kjo, për një vëmendje më të madhe nga ana e institucioneve përgjegjëse/mbikëqyrëse, të cilat janë të detyruara të raportojnë mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Po ashtu, ndjekja e zbatimit të rekomandimeve siguron që institucionet nuk i neglizhojnë detyrimet e tyre.

Kjo kulturë llogaridhënieje e imponuar nga KLSH, ndihmon në krijimin e një administrate më të përgjegjshme dhe më rezistente ndaj korrupsionit.

Veçanërisht, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, synohen përmirësime sistemike që çojnë në mbylljen e hapësirave për interpretime dhe harmonizim të akteve ligjore dhe nënligjore, dhe rjedhimisht hapësirave për abuzim. Kësisoj, kontributi i KLSH-së shkon përtej institucioneve individuale dhe ndikon pozitivisht në reformat e qeverisjes publike në tërësi.



2 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ndër të tjera, KLSH ka referuar raste me elementë penalë tek organet e drejtësisë. Gjatë vitit 2024, KLSH ka dërguar 13 kallëzime penale, të cilat përfshijnë rastet ku auditimi zbuloi veprime ose mosveprime me shkelje të rënda të ligjit. Përveç kallëzimeve, KLSH ka përcjellë me kërkesë të organeve ligj zbatuese, edhe 35 materiale të tjera informuese për çështje që kërkojnë hetime të mëtejshme.

Në lidhje me **aspektet buxhetore dhe financiare të brendshme**, KLSH-së, sipas ligjit të buxhetit nr. 97/2023 dhe akteve normative në vijim, për vitin 2024, iu miratua buxheti në vlerën prej 630.5 milionë lekë, i ndarë në: shpenzime personeli, shpenzime operative (mallra e shërbime), dhe shpenzime kapitale, realizimi i të cilëve paraqitet si vijon:

Fondi për paga dhe sigurime shoqërore (shpenzime personeli) prej 538.1 milionë lekë u realizua në masën 97.7%. Në këto shpenzime përfshihen pagat e audituesve dhe stafit mbështetës, si dhe pagesat për ekspertë të jashtëm, të angazhuar me kontratë të përkohshme për ekspertizë specifike.

Shpenzime operative (mallra dhe shërbime të tjera) prej 75.5 milionë lekë që përbënin rreth 12% të buxhetit vjetor, u realizua në masën 94% dhe u përdor për të përballuar kostot e funksionimit ditor të institucionit. Vlen të theksohet se një pjesë shumë e madhe (57%) e shpenzimeve operative faktike për 2024 ishin për udhëtime, dieta dhe akomodime brenda vendit në funksion të realizimit të aktivitetit auditues në rrethe.

Fondi i veçantë (shpenzime speciale) në dispozicion, prej 1.5 milionë lekë, për raste specifike si daljet në pension, ndihma financiare për ngjarje fatkeqësie apo sëmundje të punonjësve etj., u përdorën në masën 77%. Pjesa e pashpenzuar, rreth 23% i kthehet buxhetit si kursim.

Zëri “Shpenzime kapitale” të miratuara për investime të KLSH-së për 2024, ishte 15 milionë lekë. Kësaj shume iu shtua gjatë vitit edhe një pjesë e mbetur nga një grant i huaj (projekti donator) i vitit paraardhës, në vlerën 3,181 mijë lekë, që mund të përdorej për qëllime kapitale. Në investimet kapitale, kryesisht u prioritarizuan pajisjet informatike, rikonstruksioni i ambienteve dhe blerja e një automjeti të ri. Këto shpenzime u realizuan në masën 70%.

KLSH ka arritur një realizim të mirë buxhetor, mesatarisht mbi 95% në të gjithë zërat kryesorë. Kjo do të thotë se institucionit i janë vënë në dispozicion burime adekuate financiare dhe ai i ka përdorur ato në mënyrë efektive për të përmbushur misionin e vet. Realizimi i lartë i shpenzimeve operative tregon një planifikim realist të nevojave dhe një administrim të kujdesshëm.







03

AKTIVITETI
AUDITUES
2024

AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

Auditimi i përputhshmërisë është vlerësimi i pavarur nëse një çështje e caktuar e shqyrtuar është në përputhje me kornizën rregullatore të zbatueshme të identifikuar si kriteret. Auditimet e përputhshmërisë realizohen për të vlerësuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet, në të gjitha rastet janë në përputhje me kornizën rregullatore, i cili qeverisë njësinë e audituar. Në përfundim të këtij lloj auditimi, konkludohet me opinion ose konkluzion. Opinion është një deklaratë e qartë në një format të standardizuar, i cili mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose refuzues, konkretisht:

Opinion të pakualifikuar, në rastet kur nuk janë identifikuar çështje materiale të mospërputhjes me kriteret e auditimit.

Opinion të kualifikuar, në rastet kur devijimet e pajtueshmërisë janë materiale, por jo të përhapura.

Opinion të kundërt, në rastet kur devijimet e pajtueshmërisë janë materiale dhe të përhapura.

Refuzim opinionit, në rastet kur audituesi nuk është në gjendje të marrë mjaftueshëm dëshmitë e duhura të auditimit mbi pajtueshmërinë dhe efektet e mundshme janë materiale dhe të përhapura.



43
Auditime



46
Subjekte të audituara

- 4 institucione të pavarura
- 29 institucione qendrore
- 7 institucione të vetëqeverisjes vendore
- 9 shoqëri publike



43
Opinione/
Konkluzion

- 1 opinione të pakualifikuar
- 1 i pakualifikuar me theksim të çështjes
- 26 opinione të kualifikuara
- 3 opinione të kundërt
- 12 konkluzione



1433
Rekomandime

- 8 përmirësime ligjore
- 763 masa organizative
- 410 masa disiplinore dhe administrative
- 203 efekte financiare



Efekte financiare
8,853,973 (mijë lekë)



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë:

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj dhe Aparatin e ministrisë, për periudhën e aktivitetit të vitit 2023, janë evidentuar problematika dhe mangësi në të gjitha fazat e planifikimit, miratimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit të buxhetit, për të cilat është dhënë **opinionin i kualifikuar** bazuar në sa vijon:

Gjatë procesit të planifikimit buxhetor në ministritë e linjës kanë rezultuar vonesa në paraqitjen e kërkesave, mangësi në plotësimin e formateve dhe kërkesa shtesë të paraqitura në fazën teknike, përtej taveve përfundimtare; me ligjin vjetor të buxhetit, me ndryshime, është planifikuar fond kontigjence në vlerën 14,980 milionë lekë, i cili nuk parashikohet si zë më vete në ligjin organik të buxhetit.

Fondi Rezervë i miratuar ka tejkaluar kufirin e miratuar në Ligjin Organik të Buxhetit prej 3%, përkatësisht me Aktin Normativ nr. 5 përlllogaritet në 3.13% dhe me Aktin Normativ nr. 6 në 3.38% të totalit të shpenzimeve të miratuara, ndërkohë Fondi Rezervë rezulton të jetë përdorur në 5 raste, në shumën 304.6 milionë lekë edhe për shpenzime të cilat nuk plotësojnë kriterin e “paparashikueshmërisë”, pra kanë qenë të njohura gjatë fazës së hartimit të buxhetit; është kryer detajimi i projekteve të investimeve publike pa kaluar ciklin e plotë të investimeve publike.

Gjatë vitit 2023, pas marrjes së Eurobondit teprica e likuiditetit total të të gjithë monedhave paraqitet në intervalin 75-131 miliardë lekë. Pjesa më e madhe e tepricave është akumuluar gjatë vitit në TSA në Euro, duke mos administruar si duhet mjetet monetare, të cilat së bashku me konvertimin e panevojshëm të valutave, kanë sjellë shpenzime të shtuara.

Në lidhje me zbatimin e buxhetit është konstatuar se gjatë vitit 2023, është bërë detajimi i planit buxhetor në 3 vite, për kontrata që parashikojnë periudhë faturimi më të vogël se një vit, shkurtime të fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin drejt projekteve të tjera të investimeve, duke rrezikuar krijimin e detyrimeve të prapambetura. Janë kryer 454 rishikime buxhetore, të cilat konsistojnë në 4478 transaksione pas datës 15 Nëntor; janë kryer detajime dhe rishpërndarje të fondeve buxhetore, për mbulimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën rreth 14 milionë lekë, janë kryer pagesa për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në 2427 transaksione në shumën totale 9,226 milionë lekë, nga të cilat pagesa për detyrime të prapambetura për investime në vlerën 6,791 milionë lekë, ose rreth 7.7% të investimeve kapitale me financim të brendshëm, duke deformuar vëllimin e investimeve të realizuar për vitin fiskal 2023. Konstatohet krijim i detyrimeve të reja në shumën 2,474 milionë lekë të subjekteve nënhuamarrëse, si pasojë e mosshlyerjes së detyrimeve përkatëse.

Sa i takon zbatimin të afateve ligjore, konstatohen 167 raste kur data fizike dhe regjistrimi në sistem i urdhër prokurimit i përkasin vitit buxhetor 2023, ndërsa data e kontratës fizike i përket viteve paraardhëse; 594 raste, ku urdhri i prokurimit është regjistruar në vitin 2023 por kontrata dhe urdhër prokurimi fizik i përkasin viteve paraardhëse; në 9137 kontrata që janë lidhur gjatë vitit 2023, nuk është respektuar afati 5-ditor për regjistrimin e kontratave në modulën e kontratave në SIFQ, nga data e nënshkrimit të tyre, ku 27% të totalit e zënë kontratat e njëjësive të vetëqeverisjes vendore; konstatohen 31717 fatura në total me vlerë 74,084 milionë lekë, të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30-ditor.



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

Në lidhje me raportimin, konstatohet se janë raportuar investime kapitale me financim të brendshëm të realizuara nga të ardhurat dytësore në vlerën për 1,176 milionë lekë, investime që nuk kanë plan buxheti të miratuar, në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar; nga FSHZH në 6 raste për 4 projekte investimi në vlerën 133,144 mijë lekë është bërë parapagim i kontratave, të cilat janë përfshirë në investime të realizuara; janë 39 projekte investimi, me kredi dhe grant, në vlerën 1,216 milionë lekë, të realizuara pa pasur plan buxhetor dhe 47 projekte në vlerën 775,769 milionë lekë janë realizuar në tejkalim të planit të buxhetit të miratuar; ndërsa 81 projekte në vlerën 1,120 milionë lekë, janë keqklasifikuar në llogarinë 231 “Investime për rritjen e aktiveve afatgjata materiale” pasi përfaqësojnë natyrë tjetër shpenzimi.

Vlera e fondeve të rindërtimit e shpërndarë me VKM përgjatë viteve, është mbi vlerën e përcaktuar në ligjet e buxhetit të viteve 2020-2023 për shumën 29,428 milionë lekë, pasi shpërndarja e fondeve me VKM nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së fondit të rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore, sipas tabelës 4 të ligjit të buxhetit vjetor.

Vlera e interesave/kamatëvonesave që i rëndon buxhetit të shtetit për mosekzekutim në afat të 3 vendimeve kryesore të GJEDNJ-së, deri më datë 31.12.2023 rezulton e vlerësuar në shumën 3,442,744 euro.

Pavarësisht se Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit bën vlerësimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm, ku përfshihen dhe shoqëritë aksionere konstatohet se, nuk është kryer një vlerësim i tillë për to, duke mos patur në këtë mënyrë një informacion të konsoliduar mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm publik, në tërësi.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH):

Në procesin e rimbursimit të barnave, për periudhën 01.01.2021-31.12.2022 janë evidentuar problematika dhe mangësi materiale dhe të përhapura, në bazë të të cilave është dhënë **opinion i kundërt**, bazuar në sa vijon:

Me gjithë kërkesat e vazhdueshme ndaj FSDKSH, për vënien në dispozicion të të dhënave të rimbursimit në nivel përfituesi, ku të përfshihej edhe numri unik i identifikimit personal ID, nga ana e subjektit të audituar këto të dhëna u paraqitën me kod pacienti, i cili nga auditimi rezultoi se, jo në çdo rast është unik për çdo pacient, duke bërë të pamundur kryerjen e testeve të plota mbi saktësinë e përfituesve të rimbursimit.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, u kryen teste alternative auditimi mbi një pjesë të përfituesve të rimbursimit (për vitin 2022 në total janë testuar 21090 pacientë dhe për vitin 2021 në total 13885 pacientë), për të cilët, në evidencat e paraqitura nga FSDKSH rezulton se kodi i pacientit është i njëjtë me numrin unik të identifikimit personal (ID).

Në vijim, sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka rezultuar se në 24 raste për vitin 2021, në vlerën 150,518 lekë dhe 36 raste për vitin 2022 në vlerën 221,843 lekë janë ekzekutuar receta me rimbursim për përfitues që kanë ndërruar jetë. Këto raste kanë materialitet cilësor dhe janë të përhapura në rajone, mjekë e farmaci të ndryshme, pjesë e skemës së sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor e që përfshihen në procedurën e rimbursimit të barnave.

Efektet e këtyre pasaktësive në fondet e rimbursimit mund të rezultojnë më të përhapura në të gjithë popullatën e përfituesve të rimbursimit.



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

Përveç kufizimit të mësipërm, pasaktësi të tjera janë identifikuar në procesin e planifikimit dhe kryerjen e kontrolleve, duke cënuar monitorimin e skemës së sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor lidhur me këtë çështje, që përfshijnë:

Lista e Barnave të Rimbursueshme (LBR) nuk është hartuar e miratuar në kohë, duke mos respektuar historikun e periodicitetit të miratimit të saj. Mungesa e hartimit të LBR në vitin 2022, ka sjellë efekte financiare në buxhetin e FSDKSH, si pasojë e mospërfshirjes minimalisht të 5 alternativave të reja me çmime më të ulëta, referuar regjistrin të barnave nga Komisioni i Çmimit të Barnave pranë MSHMS, për shumën 939,384 euro ose 114,323 mijë lekë, si dhe/ose me ndikim në shëndetin e pacientëve.

Kategoria me rritje më të lartë të shpenzimeve të rimbursimit, nuk rezulton të jetë pjesë e përfituesve të shërbimeve shëndetësore sipas skemës nga kriteri i të qenurit kontribues ose jo, por rezulton të jetë përfshirë nga kriteri i llojit të sëmundshmërisë që mbart, duke rritur nevojën për mbështetje buxhetore. Si rrjedhojë, buxheti i barnave të rimbursueshme është tejkaluar në krahasim me përcaktimet e bëra në ligjet vjetore të buxhetit, duke krijuar detyrime të prapambetura.

Detajimi i buxhetit në nivel drejtorie rajonale, qendre shëndetësore dhe mjeku, mbart problematika në lidhje me mungesën e evidencës mbi raportet midis buxhetit të alokuar me nivelet e mbulimit të popullatës.

Evidentohet një tendencë ekzekutimi e recetave në nivel mjeku, drejt farmacive të caktuara, sipas një shpërndarje jo normale që tregon për mundësinë e lidhjes midis tyre.

Nuk ka kontrole të implementuara në sistemin e recetës elektronike, për përmbushjen e kriterëve të rregullores së procesit të rimbursimit, që ka mundësuar, dhënien e më

shumë se 3 barnave për recetë për kategori të caktuara, dublikimin e mjekimit me të njëjtin bar për të njëjtën periudhë në receta të ndryshme për të njëjtin pacient etj.

Sistemi elektronik i të siguarve paraqet problematika në raportimin e të dhënave që përfshijnë fusha të paplotësuara, dubluara apo të pa përditësuara në lidhje me kodin e pacientit, ID, emrin e pacientit, mjekut etj.

Kontrollet e ushtruara në subjektet farmaceutike me kontratë me FSDKSH, për zbatimin e skemës së sigurimit të detyrueshëm shëndetësor lidhur me rimbursimin e barnave rezultojnë me problematika në drejtim të diferencave në inventar, disponibilitetit të barnave apo mos përmbushjes së detyrimeve për kontroll për subjekte të caktuara.

Edhe në rastin kur është kryer një kontroll me cikël të mbyllur, megjithëse janë evidentuar raste të përfitimit të rimbursimit në të njëjtën ditë me ndërrimin e jetës së pacientit, nga strukturat kontrolluese, nuk është dokumentuar një gjë e tillë dhe nuk janë nxjerrë konkluzione mbi ligjshmërinë e përfitimit të rimbursimit.

Në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtorinë e Shërbimeve Spitalore Universitare:

Për periudhën e veprimtarisë 01.01.2023-31.12.2023, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime nga kuadri ligjor përkatës, të cilat janë materiale por jo të përhapura, për të cilat është dhënë **opinionin i kualifikuar**, bazuar në:

Edhe për vitin 2023, kontrata koncesionare “Për ofrimin e hemodializës”, ka rezultuar me pagesa për shërbime të pakryera, konkretisht për 9241 raste nën projeksion dhe 1557 raste mbi projeksion, në shumën 103,527 mijë lekë.

Në lidhje me financimin e kontratave PPP, ka rezultuar se në tre kontrata, vlera e financimit



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

vjetor, si dhe parashikimet e financimit të tyre në PBA 2023-2025, janë përtej mbështetjes buxhetore të parashikuar për zbatimin e tyre, konkretisht:

PPP “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterilë, furnizimin me material mjekësor steril një përdorimsh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”.

Në vitin 2022 ishin parashikuar 1,700 milionë lekë, në vitin 2023 1,750 milionë lekë, në vitin 2024, 1,770 milionë lekë dhe në 2025, 1,790 milionë lekë, çka tregon edhe për tendencën në rritje të financimit të kësaj kontrate, vërtetuar kjo edhe nga pagesat e kryera.

Gjithashtu konstatohet se, numri total i ndërhyrjeve kirurgjikale sipas shkallës së kompleksitetit, në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022 është rritur me 3.1 % (63409 raste/61450 raste apo në vlerë monetare prej 1,749,982 mijë lekë/1,699,975 mijë lekë).

PPP “Shërbimi i hemodializës”, si mbështetje buxhetore për 10 vjet, sipas parashikimeve është në shumën 7,221 milionë lekë në total. Për vitin 2022, faturat e pranuar janë në shumën 807,647 mijë lekë, për vitin 2023 janë 851,974 mijë lekë, ndërkohë parashikimi buxhetor për këto dy vite, rezulton: 786,451 mijë lekë për vitin 2022 dhe 835,385 mijë lekë për vitin 2023.

Përsa i përket PPP “Shërbimi laboratorik” ka rezultuar se në vitin 2023, numri i ekzaminimeve është rritur me 182,816 raste, në krahasim me vitin 2022, ndërsa shpenzimet buxhetore me 111,836 mijë lekë.

Në lidhje me financimin dhe likuidimin e shpenzimeve për Kontratën e Koncesionit “PPP-Kontrolli Mjekësor Bazë” dhe “PPP-Sterilizimi i pajisjeve mjekësore”, vlera e shpenzimeve të kryera për dhënien e këtyre shërbimeve është likuiduar me t.v.sh., referuar kushteve të kontratave, por në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

Në lidhje me listën e barnave të rimbursueshme, ka vijuar të mos hartohet dhe miratohet në kohë, duke mos respektuar kriterin e periodicitetit të miratimit të saj, me pasoja në nivelin e financimit të rimbursimit. Referuar të dhënave të administruara rezulton se nga mungesa e hartimit të LBR-së në vitin 2023 dhe nga mos përfshirja e alternativave të reja me çmim më të ulët, janë shpenzuar pa efektivitet vlera të konsiderueshme nga buxheti i shtetit.

Kontrollet e ushtruara në subjektet me kontratë me FSDKSH për zbatimin e skemës së sigurimit të detyrueshëm shëndetësor lidhur me rimbursimin e barnave, kanë shfaqur të njëjtat problematika në drejtim të diferencave në inventar, disponibilitetit të barnave apo mos përmbushjes së detyrimeve për kontroll për subjekte të caktuara si dhe moskryerjes së kontrolleve me cikël të mbyllur.

Në Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive (ish Agjencia e Trajtimit të Kredive):

Për periudhën e veprimtarisë 01.01.2021-31.12.2023, KLSH ka evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat janë materiale dhe të përhapura, për të cilat është dhënë **opinionin i kundërt**, bazuar në konstatimet si vijon:

Nisur nga dispozitat ligjore sipas së cilës Agjencia mban në llogaritë e veta fonde të barabarta në vlerë me ¼ e buxhetit operativ vjetor, rezulton se për vitin 2023 janë derdhur në buxhetin e shtetit 29,493 mijë lekë më pak.

Agjencia nuk disponon një listë me të dhëna për pasuritë e lëna si kolateral në momentin e marrjes së kredisë, për të evidentuar vlerën e tyre dhe ndryshimet gjatë viteve. Mosveprimet nga ana e Agjencisë për vlerësimin e kolateraleve ka sjellë moskalimin e këtyre pasurive në emër të Agjencisë e më pas pamundësinë e shitjes së tyre në ankand, duke rrezikuar mundësinë e mbledhjes së huave.



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

Rezultojnë 5 pasuri të luajtshme të sekuestruara nga Agjencia, pa dokument pronësie për të cilat nuk është përlogaritur amortizim gjatë viteve; 12 pasuri të paluajtshme, të pakontabilizuara, për të cilat mungon certifikata e pronësisë; dhe 21 prona të kontabilizuara, por pa certifikatë pronësie. Mungesa e dokumentit të pronësisë dhe mos pasqyrimi i saktë i vlerës reale të tyre, rrezikojnë tjetërsimin e këtyre pasurive, zhvlerësimin e tyre në kohë për shkak të amortizimit dhe si rrjedhojë dhe mungesën e përfitimit të të ardhurave nga mos-shitja e tyre përmes procedurave të ankandit.

Nga Agjencia nuk janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha institucionet e parashikuara në ligjin “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar.

Sistemi elektronik i Kreditit nuk ofron një pasqyrim të saktë të kredive të trajtuara nga Agjencia, për shkak të mangësive në të dhëna të plotësuara ndër vite, prej mospërputhjeve të konstatuara me inventarizimin dhe mospërputhjeve në numër dhe vlerë të kredive; mangësi të trashëguara ndër vite nisur që nga momenti i marrjes në dorëzim.

Evidentohen 7167 rekorde klienti pa asnjë të dhënë identifikuese (veç emrit) me pasoja në mundësinë e rikuperimit të huasë. Sistemi nuk ofron një pasqyrë të kolateraleve të debitorëve, me qëllim analizimin e tyre dhe marrjen e masave përkatëse nga Agjencia.

Nga ana e Agjencisë nuk janë zbatuar të gjitha procedurat dhe masat shtrënguese për vjeljen e detyrimeve, pasi rezultojnë: 66 shoqëri, për të cilat Agjencia nuk i është drejtuar Gjykatës për shpallje falimenti dhe caktim likuidatori; si dhe nuk është vepruar me çelje trashëgimie për asnjë debitor, që është ndarë nga jeta.

Llogaria detyrimet ndaj KFW¹ (për Marrëveshjet e kredive të financuara nga KFW¹-ja për projektet Commodity Aid II, Commodity Aid III,

Commodity Aid IV) ka ardhur duke u rritur, konkretisht, nga vlera 2,013,983 euro në vitin 2022 në vlerën 2,210,455 euro në vitin 2023.

Në Bankën e Shqipërisë:

Për periudhën e veprimtarisë 01.01.2023-31.12.2023, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit është në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore e rregullative në fuqi, për të cilat është dhënë **opinion i pakualifikuar**, përveç disa çështjeve për t'u mbajtur në konsideratë nga drejtimi, si: mbulimi i rezervës negative nga rivlerësimi i valutave nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, brenda afatit të parashikuar në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Marrëveshjen “Mbi transferimin e fitimit neto të BSH pranë MF, dhe mbulimin e humbjeve të BSH datë 20.01.2015”, të ndryshuar.

Në lidhje me “Rezervën si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve”, Banka e Shqipërisë nuk disponon ndonjë dokument, manual apo udhëzim, që të përcaktojë mënyrën implementimit të këtyre standardeve, menaxhimit të tranzicionit drejt IRFS-ve si dhe krijimin dhe përdorimin e rezervës së krijuar për këtë qëllim.

Për një ankand, komisioni i ankandit ka pranuar dy kërkesa konkurruese, me të njëjtin nivel yield-i të kërkuar nga i njëjti subjekt, jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 31, datë 26.12.2013 “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të bonove të thesarit në formë regjistri”, i ndryshuar.

Në Degën e Doganës Kakavijë:

Për periudhën e veprimtarisë 01.01.2021 deri më datën 31.12.2022, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor dhe rregullator, për të cilat është dhënë **opinion**



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

i kualifikuar, bazuar në:

Mangësi dhe parregullsi në procedurat doganore, të vlerësimit doganor të mallrave dhe shpenzimeve të transportit në import, klasifikime tarifore jo në përputhje me përcaktimet e Nomenklaturës së Mallrave në Republikën e Shqipërisë (RSH), deklarime doganore me pasojë mos pagesën e detyrimeve të akcizës etj.

Janë konstatuar raste ku: për disa subjekte vlera e artikujve të importuar është trajtuar me transaksion, edhe pse dokumentacioni bashkëlidhur nuk i plotëson kushtet për t'u trajtuar si i tillë; i njëjti subjekt për të njëjtin artikull të importuar në shumë raste është rivlerësuar dhe për raste të tjera jo; deklarime të çmimeve të produkteve të gatshme nën çmimin e lëndës së parë; trajtimi i mallrave të përdorur me transaksion nën çmimin e lëndës së parë; si dhe për mallra të importuar nga vende jashtë Komunitetit Evropian, trajtimi i të cilëve është bërë me transaksion në momentin e hedhjes për qarkullim të lirë, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor, duke rezultuar në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, në shumën 85,374 mijë lekë.

Gjithashtu, janë konstatuar problematika lidhur me masat e ndërmarra si për vjeljen e borxhit doganor i cili rezulton në vlerën 410,475 mijë lekë në fund të vitit 2022, ku rritja e borxhit rezulton më e lartë se vjelja e tij, ashtu dhe për raportimin e borxhit doganor, duke mos përlogaritur saktë kamatëvonesat për vitin 2021 dhe 2022 në vlerën 1,438 mijë lekë më pak, apo mos marrjen në kohë të vendimit administrativ nga autoriteti doganor, pas mbajtjes së procesverbaleve përkatëse.

Janë konstatuar mangësi në vendimmarrjen administrative lidhur me problematikat e konstatuara për subjektet, që operojnë pranë kësaj dogane, duke rezultuar në të ardhura të munguara prej 93 mijë lekë për 4 raste, që i

përkasin vitit 2021; procedurat e ndjekurapërgjatë skanimit të mjeteve kanë rezultuar jo në përputhje me përcaktimet në aktet ligjore, që rregullojnë këtë proces; janë konstatuar mangësi në autorizimet e magazinave fiskale lidhur me mbulimin me garanci sipas legjislacionit doganor dhe kontroleve të kryera lidhur me akcizën; janë konstatuar problematika gjatë mbikëqyrjes doganore të subjekteve që operojnë nën regjimet doganore, duke rezultuar me të ardhura të munguara në vlerën 1,605 mijë lekë.

Subjekte të veçantë kanë importuar mallra të natyrës kafshë të gjalla për majmëri të klasifikuara në kapitullin 1, bazuar në kriteret dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 2 datë 03.04.2017 “Mbi procedurat e trajtimit të kafshëve të gjalla për majmëri”, për të cilat nuk dokumentohet veprimtaria verifikuese për importet e mallit nga Dega Doganore Kakavijë pranë doganave homologe, lëvruese të mallrave, për faktorët thelbësore ekonomike, që kanë sjellë kushtin e deklarimit KPM (përrjashtim nga tarifa dhe t.v.sh-ja), si dhe veprimtaria mbikëqyrëse nga ana e degëve doganore, të destinacionit të mallit.

Në Degën Doganore Tiranë:

Për periudhën e veprimtarisë 01.01.2022-31.12.2023, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator përkatës të cilat janë materiale por jo të përhapura, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, bazuar në: mangësi dhe parregullsi në procedurat doganore me pasojë të ardhura të munguara, të vlerësuara në shumën totale 417,679 mijë lekë.

Janë konstatuar raste të regjimeve doganore të tipit RLP me pasojë shkelje të afateve rieksportuese dhe autorizuese të shtyrjeve të afateve të veprimtarisë së këtyre aktiviteteve, në shumën totale 31,550 mijë lekë.



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

Në magazinën e mallrave të sekuestruara evidentohen 497 kode artikuj të ndryshëm të sekuestruar, në vlerën 11,892 mijë lekë për vitin 2022 dhe në përfundim të vitit 2023 në shumën 24,341 mijë lekë. Për këto mallra të bllokuara me dyshimin e cenimit të pronësisë intelektuale, Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale (si drejtori konstatuese) nuk ka në të gjitha rastet vendimmarrje për vazhdim procedurash asgjësimi, por vetëm procesverbal bllokimi dhe në mungesë të procesverbaleve të sekuestrimit, nga ana e sektorit juridik nuk janë përgatitur vendime për vijimin e procedurës së konfiskimit.

Në një numër të konsiderueshëm praktikash doganore të artikujve ushqimorë kryesisht kapitujt 1, 2, 3 dhe 4, 7 deri 24 të NM-së në RSH, mungonte dokumentacionin shoqërues ligjor me efekte administrative në shumën 2,500 mijë lekë për 125 raste deklarimi.

Për artikujt “qumësht Uht me 3.6 yndyrë dhe qumësht për kafe”, “Doreza Kirurgjikale” dhe “Hudhër e ftohtë”, “Spraj (vajra të lehtë), Praimer dhe Solvent” dhe “Vaj Lubrifikant” janë konstatuar problematika që lidhen me shkallën e tarifës doganore, pagesën e taksës QPL (taksa kombëtare e hirrës, qumështit pluhur dhe krem qumështi) taksave kombëtare të akcizës për mallin “S’praj (vajra të lehtë), Praimer, dhe Solvent” dhe “Vaj Lubrifikant”, për të cilat DPD duhet të kryejë veprime kontrolluese pranë selive të ushtrimit të aktivitetit të kompanive me qëllim ndjekjen dhe kontabilizimin e të ardhurave doganore të munguara, të vlerësuara në shumën 173,484 mijë lekë.

Borxhi doganor në DDTiranë, për vitin 2022 ka qenë në vlerat 18,368 milionë lekë me 1407 debitorë dhe viti 2023 me 18,620 milionë lekë me 1252 debitorë, për të cilin nuk janë marrë të gjitha masat me qëllim mbledhjen e detyrimeve. Për raste marrje vendimi për diferenca sasiore të konstatuara në sasi malli rezultuar më tepër dhe

të padeklaruara në deklaratat doganore respektive nga operatorët ekonomikë, nuk është aplikuar një gjobë doganore sa dyfishi i detyrimeve doganore të papaguara dhe shkelja doganore nuk është trajtuar si “Kundërvajtje doganore të kryera në neglizhencë”.

Janë konstatuar vendime administrative për shkelje në fushën e akcizës, për të cilat janë vendosur masa konstatuese nga struktura kontrolluese të DPD-së, por për të cilat nuk është propozuar masë për konfiskimin e mallit objekt shkelje doganore dhe më pas riblerjen e tij para hedhjes dhe çlirimit të mallit.

Janë konstatuar marrje të vendimeve në mosrespektim të legjislacionit doganor në fuqi, që lidhen me mosrespektim të afatit kohor për regjime doganore të tipit RLP në shumën totale 3,121 mijë lekë.

Në kundërshtim me përcaktimet e nenit 256.1/b të Kodit Doganor, që kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, zbatohet sanksion në masën 20 000 lekë deri në 50 000 lekë, nuk është mbajtur procesverbal konstatimi, ku të aplikohet sanksioni për kundërvajtjen në 13045 raste në shumën 260,900 mijë lekë për vitin 2022 dhe vitin 2023.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave:

Për periudhën e veprimtarisë 01.01.2023-31.12.2023, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator përkatës të cilat janë materiale por jo të përhapura, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, bazuar në konstatimet si vijon:

Degët doganore nuk përfshihen në procesin e planifikimit të të ardhurave, por plani sipas çdo muaji përcillet nga DPD për zbatim; Stoku i detyrimeve të papaguara rritet me një ritëm më të lartë se sa pakësohet (mblidhet) dhe përgjatë vitit 2023 nga shlyerja e detyrimit nga subjektet rezulton të jetë në shumën 607,943 mijë lekë ose 1.2% e totalit të detyrimeve të papaguara



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

doganore, çka tregon një situatë të dështuar në rikuperimin e stokut të detyrimeve të krijuar gjatë viteve.

Në lidhje me procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës u konstatua se, gjatë procedurës së lëshimit të Autorizimeve të Përrjashtimit të t.v.sh.-së, për disa operatorë ekonomike të autorizuar më parë, vlerat në planet e investimit nuk arrijnë vlerën e parashikuar prej 500 milionë leke me pasoja në mospagesën e detyrimeve të t.v.sh.-së në import dhe shmangien e detyrimeve doganore të t.v.sh.-së në shumën 66,140 mijë lekë për 4 raste.

Janë deklaruar mallra me qëllim përjashtimin nga detyrimet doganore të t.v.sh.-së për 7 raste në shumën 16,651 mijë lekë, ku nuk janë kryer verifikime konkrete në ambientet e subjekteve deklarues me qëllim evidentimin e përputhshmërisë faktike të gjendjes fizike të mallrave të përjashtuara sipas autorizimeve respektive në funksion të kryerjes së investimit.

Janë evidentuar 51 deklarata doganore me produkte të injektueshme të mirëmbajtjes së lëkurës, fillera/botox nga 9 subjekte, me një vlerë në deklarimi totale prej 65,062 euro dhe 75,743 dollarë, të cilët nuk rezultojnë të jenë pajisur me certifikatën për regjistrimin e pajisjes mjekësore përkatëse në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, produkte të cilat janë zhdoganuar dhe kaluar për tregtim pa miratimet përkatëse si për prodhuesin dhe tregtarin.

Nga auditimi i praktikave të kontrollit të kryer nga grupet e Drejtorisë së Antikontrabandës, rezultoi se kontrollat nuk janë finalizuar me një gjobë doganore sa dyfishi i detyrimeve doganore të papaguara dhe shkelja doganore nuk është trajtuar si “Kundërvajtje doganore të kryera në neglizhencë”, për të cilat janë konstatuar

diferenca të pajustificuara në shumën 1,245 mijë lekë.

Konstatohet mungesë menaxhimi me efikasitet dhe eficientësi i procedurave të përcaktuara nga legjislacioni për akcizat, mungesë planifikimi, miratimi e ushtrimi të kontrolleve nga tre sektorë të saj Sektor i Pijeve Alkoolike (SPA), Sektor i Duhanit dhe Produkteve të Tjera (SDPT), Sektor i Pajisjeve Matëse dhe Linjave Teknologjike (SPMLT), në mënyrë uniforme për gjatë gjithë muajve të vitit 2023 dhe mos dokumentim i relacioneve shpjeguese mbi programet e kontrollit për vitin 2023.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT):

Për periudhën e veprimtarisë 01.01.2023-31.12.2023, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor dhe rregullator përkatës, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, bazuar në sa vijon:

DPT nuk dokumenton kontributin e saj gjatë procesit të përgatitjes të planit të të ardhurave, nëpërmjet analizave lidhur me parashikimin e arkëtimeve, projekt plane, apo raporteve të tilla të ngjashme, duke patur thjesht një rol zbatues të planit të të ardhurave.

Nga ana e DPT raportohen si të ardhura edhe parapagimet e tatim fitimit, gjoba të sistemit tatimor, dhe penalitete, pavarësisht se nga MFE në planin e miratuar nuk përfshihen këto të ardhura.

Gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në fillim të vitit 2023 paraqitet në vlerën rreth 146,767 milionë lekë, që i përket një numri prej 182490 subjektsh debitore, dhe në fund të vitit 2023, këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 155,165 milionë lekë që i përket një numri prej rreth 181023 subjektsh debitore. Detyrimet e shtuara gjatë vitit 2023 janë 40 miliardë lekë ose afërsisht 3 miliardë lekë më shumë krahasuar me vitin 2022. Drejtoria e Përgjithshme e



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

Tatimeve ka gjithashtu një vlerë detyrimi tatimor të papaguar jashtë sistemit C@TS, në vlerën 2,351 milionë lekë.

Rimbursimi për t.v.sh.-në bazuar në ligjin vjetor të buxhetit është programuar në shumën për 18,000 milionë lekë dhe është realizuar në shumën 22,614 milionë lekë, duke rezultuar me tejkalim në shumën 4,614 milionë lekë, ose 25.63% më shumë kundrejt planit të rimbursimit. Në mbyllje të periudhës ushtrimore 2023, rezultojnë 9 kërkesa për rimbursimin e t.v.sh.-së të pranuar por të pa miratuara në vlerën totale për 100,570 mijë lekë, të cilat megjithëse u ka kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre, nuk janë rimbursuar.

Nga vetëdeklarimet e Drejtorive Rajonale Tatimore nuk janë filluar 109 kontrolle nga 2982 kontrolle të planifikuara ose rreth 4% e totalit, duke krijuar një stok të subjekteve të planifikuara për kontroll dhe të pa kontrolluara, si pasojë edhe e mos koordinimit midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorive Rajonale. Nuk ka një rakordim midis Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, lidhur me problematikat, kontrollet e ushtruara dhe rezultatet e Planeve Operacionale sipas listave të gjeneruara për verifikim në bazë të kriterëve të riskut të thyera. Drejtorja e Menaxhimit të Riskut pranë DPT në 5 vitet e fundit nuk ka kryer për asnjë rast propozim kontrolli për subjektet e regjistruara si "OJF", pavarësisht qarkullimit të lartë që këto subjekte realizojnë, ku nga databaza e aktivitetit për 5 vitet e fundit, ekzistojnë OJF me qarkullim deri në 728,808 mijë lekë, por gjithashtu edhe për risqet e tjera që këto biznese mbartin. Nga auditimi i aktkonstatimeve të mbajtura nga inspektorët e DVKT, në sistemin informatik tatimor C@ts, në lidhje me verifikimet në terren ka rezultuar se ato janë jashtë tematikës së përcaktuar për verifikim nga analiza e riskut të

DMR, sipas kriterëve riskut. Gjatë vitit 2023, grupet e verifikimit në terren nuk kanë qenë të pajisur me sistemin elektronik të monitorimit "E-Inspektor", i cili shërben për regjistrimin e veprimeve të punës, monitorimin e inspektorëve gjatë kryerjes së kontrollit në terren, identifikimin dhe regjistrimin e subjekteve të tatueshme, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e monitorimit në procesin e kryerjes së inspektimeve nga administrata tatimore, automatizimin e proceseve të punës si dhe arritjen e objektivave në luftën kundër informalitetit.

Konstatohet mosrealizim i kontrolleve në 2 DRT më të rëndësishme, konkretisht DRT Tiranë dhe DTM. Nga analiza e të dhënave mbi evidencat e fazave në të cilat ndodhen kontrollet në proces, rezulton se stoku i kontrolleve të papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, vijon të jetë i konsiderueshëm.

Nga auditimi për zbatimin e afateve ligjore proceduriale, në lidhje me rastet e ndjekura nga Sektori i Hetimit Tatimor, të cilat janë në proces deri në datë 31.12.2023, rezultojnë tejkalime të këtyre afateve deri në mbi 6 muaj.

Për vitin 2023 efekti në krijim e detyrimeve të prapambetura vlerësohet të jetë 311 milionë lekë.

Në muajin Dhjetor 2023 DPT paraqitet me një shtim të numrit të vakancave krahasuar me fillim vitin, ku konkretisht 238 pozicione pune janë vakante, nga të cilat 207 janë pozicione me status të nëpunësit civil dhe 31 pozicione me kod pune.

Nga totali i 109 ish punonjësve gjyqftues, rezultojnë se 77 prej tyre janë ish nëpunës me status të nëpunësit civil dhe 32 ish punonjës me kod pune. Nga totali i ish nëpunësve civilë, rezulton se 56 prej tyre janë ende të pa sistemuar.

Për ish punonjës gjyqftues, në fillim të vitit



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

2023, rezultojnë detyrime të prapambetura në vlerën 137,268 mijë lekë. Gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 138,422 mijë lekë; si dhe janë likuiduar detyrime në vlerën 216,523 mijë lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit, duke rezultuar me një gjendje të kreditorëve në vlerën 59,167 mijë lekë, nga të cilat likuidime të tarifave përbarimore në vlerën 5,964 mijë lekë.

Me urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023 të Kryeministrit është miratuar struktura organizative e administratës tatimore qendrore dhe me urdhrin nr. 189, datë 08.08.2023 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, është miratuar organigrama, pra mbi 2 muaj më vonë. Ristrukturimi ka qenë ende në proces deri në fund të periudhës objekt auditimi, dhe ka vijuar edhe përgjatë vitit 2024.

Në lidhje me procedurat e prokurimit, janë konstatuar mangësi në zhvillimin e procedurës për hartimin e DST-ve në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë të paargumentuar, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE-së në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE-së me ofertë më të leverdishme.

Në lidhje me strukturën e auditit të brendshëm, pas ndryshimit të emërimit të një sektori të DAB, nuk është përditësuar Karta e Auditit, si dhe nuk është përcjellë për miratim tek titullari i institucionit. Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk ka dërguar në DPT, Vendimin për Planin vjetor 2023 dhe Planin strategjik 2023-2025.

Në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier:

Për periudhën e 01.01.2021 deri në 31.12.2023, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator përkatës, për të cilat është dhënë

opinionit i kualifikuar, bazuar në sa vijon:

Në raportet e kontrollit të inspektorëve tatimorë, nuk është kërkuar arkëtimi i shumës së evidentuar paraprakisht në vlerën rreth 465,322 mijë lekë, si shmangie tatimore të evidentuara si pasojë e faturimeve të situacioneve të punimeve të ndërtimit nën kostot mesatare të miratuara, duke sjellë ulje të pagesës së t.v.sh.-së dhe tatimit mbi fitimin si dhe diferenca të pajustificuara në inventar, të cilat janë rivlerësuar si shitjeve pa faturë tatimore.

Gjithashtu, është konstatuar kreditim i t.v.sh.-së së karburantit jashtë normativave të lejuara, zbatimit të gabuar të koeficientit të rregullimit të t.v.sh.-së për blerjet si pasojë e shitjeve të përjashtuara sipas autorizimeve për punimet e rindërtimit, shitjeve të objekteve ndërtimore poshtë çmimit të referencës të përcaktuar me VKM nr.168, datë 27.3.2019, mos aplikimit të penalteteve për pagesat me vonesë të kësteve të tatim fitimit si dhe mungesa e justifikimit të shumave monetare për të cilat pretendohet se janë dhënë hua nga ortakut i shoqërisë.

Problematika të tjera të konstatuara lidhen me mangësitë në procesin e monitorimit të të ardhurave tatimore, në procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e subjekteve objekt kontrolli në vend, mos realizim i propozimeve për kontroll nga DRT Fier në masën 30%, mangësitë në sistemet e aplikuara duke rezultuar me diferenca në deklarimin e t.v.sh.-së në dogana, krahasimisht me deklarimin në sistemin C@ts tatime etj.

Në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë:

Për periudhën e veprimtarisë 01.01.2021 - 31.12.2023, KLSH ka evidentuar devijime materiale, por jo të përhapura nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator përkatës, për të cilat është dhënë **opinionit i kualifikuar**, bazuar në sa vijon:



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

Në raportet e kontrollit të inspektorëve tatimorë, nuk është kërkuar arkëtimi i shumës së evidentuar paraprakisht në vlerën rreth 223,665 mijë lekë, konkretisht si pasojë e kreditimit të pa drejtë të t.v.sh.-së për situacione të punimeve ndërtimore, të cilat janë faturuar jashtë afatit të lejes së ndërtimit, mangësive në inventar, shitjeve pa faturë tatimore, kreditim i gabuar i t.v.sh.-së së karburantit, zbatimit të gabuar të koeficientit të rregullimit të t.v.sh.-së; si dhe përfitimin e uljes së t.v.sh.-së 6%, për subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e strukturave akomoduese etj. Gjithashtu në raportet e kontrollit në vend kanë rezultuar pasaktësi në transaksionet me ortakun, të kryera në kundërshtim me parimet dhe kushtet e tregut duke mos aplikuar norma interesi.

Problematika të tjera të konstatuara lidhen me masat e ndërmarra në procesin e monitorimit të të ardhurave tatimore, dobësi në procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e subjekteve objekt kontrolli në vend, mosrealizim i propozimeve për kontroll nga DTR Vlorë etj.

Në Institutin e Sigurimeve Shoqërore:

Për periudhën e veprimtarisë 01.01.2021-31.12.2023, janë konstatuar mangësi jo materiale për të cilat është dhënë **opinion i pa kualifikuar, me theksim çështjeje**, bazuar në sa vijon:

Raportimi i planit të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe analizimi i tyre (fakt/plan), është kryer duke përfshirë edhe të ardhurat jo tatimore, ose "Të tjera DPT dhe ISSH" në shumën 1,740,926 mijë lekë. Si rrjedhime, realizimi i të ardhurave nga kontributet e mbledhura nga DPT dhe ISSH, kundrejt planit të miratuar nga MFE është në masën 98,6% dhe jo në masën 100 % të raportuar nga ISSH.

Nga Drejtoria e Inspektimit të Pensioneve (DIP) rezultojnë 9614 dosje të pa inspektuara dhe të pa certifikuara, nga të cilat 8775 dosje pensioni të pa inspektuara, që i përkasin vitit 2020 si dhe 839

dosje që i përkasin viteve 2019-2021, për rishqyrtim.

Në sistemet CMIS dhe PCAMS, janë konstatuar 3 raste të përfitimit të padrejtë, pasi përfituesit kanë rezultuar ekonomikisht aktiv në administratën publike që në momentin e lidhjes së pensionit, në kundërshtim me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në RSH", i ndryshuar.

Në lidhje me të drejtën e përfitimit për pension, janë konstatuar përfitime të padrejta, pasi përfituesit për pension invaliditeti dhe pleqërie kanë rezultuar njëkohësisht edhe të punësuar (kjo në 15 raste në vlerën 360,427 lekë të pa certifikuara nga DIP dhe në 9 dosje në vlerë 192,754 lekë të certifikuara nga DIP); si dhe është konstatuar se në të paktën 20 raste, ndalesa e pensionit është bërë nga ana e DRSSH-ve në masën 20% dhe jo në masën 50%, veprime këto në kundërshtim ligjin 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në RSH", i ndryshuar.

Në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare:

Për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri në datën 30.12.2023 u konstatua se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime materiale por jo të përhapura, nga kuadri ligjor dhe rregullator, për të cilat është dhënë **opinion i kualifikuar**, bazuar në sa vijon:

Në procedurat e licencimit për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime, si në klasat e jetës ashtu edhe të jo jetës, janë konstatuar vonesa në përmbushjen e afateve administrative të parashikuara. Këto vonesa kanë krijuar ngadalësim në hyrjen e subjekteve të reja në treg.

Janë identifikuar mangësi në vendimmarrjen e Bordit të AMF-së, i cili nuk ka ndërmarrë masa penalizuese ndaj shoqërive të sigurimit, pavarësisht shkeljeve të përsëritura dhe mungesës së përmirësimit të situatës financiare dhe treguesve të tyre, duke ndikuar në rritjen e riskut në sektorin e sigurimeve.



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

Konstatohet mosmarrja e masave për sanksionim me gjobë ndaj shoqërive të sigurimeve për shkeljet e konstatuara duke krijuar një dëm të mundshëm në intervalin e vlerave 9,950 – 19,400 mijë lekë, duke ndikuar kështu negativisht në disiplinën dhe rregullsinë e tregut të sigurimeve.

Në mënyrë të vazhdueshme, ndër vite, konstatohet se, nuk është aplikuar norma e interesit në vlerën totale prej 6,948 mijë lekë ndaj shoqërive të sigurimeve që nuk kanë plotësuar pjesën përkatëse të fondit të kompensimit. Mungesa e kësaj mase ka krijuar një efekt negativ në fondin e kompensimit, duke rrezikuar mbulimin e detyrimeve të shoqërive të sigurimeve ndaj të siguruarve.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktiveve për fondet e BE-së, BB-së dhe donatorëve të tjerë:

Për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri në datën 30.06.2024, KLSH ka konstatuar se veprimtaria e subjektit të audituar ka devijime materiale por jo të përhapura, nga kuadri ligjor, dhe rregullator, për të cilat është dhënë **opinionit i kualifikuar**, bazuar në sa vijon:

Në disa projekte, objektivat e parashikuara fillimisht janë reduktuar pa ndonjë argumentim nga përfituesi, ndërkohë që strukturat përgjegjëse të CFCU nuk kanë identifikuar, raportuar apo ndërmarrë masa për adresimin e këtyre ndryshimeve.

U evidentuan raste të mospërmbushjes së objektivave, por kjo nuk ishte reflektuar në uljen e ditëve të punës të dedikuara për këto aktivitete. Angazhimi i ndryshëm nga kushtet e kontratës nuk është shoqëruar me ndryshime në raportimet financiare dhe progres raporteve.

Sa i takon projekteve të financuara nga IPA, BB dhe donatorë të tjerë, u konstatuan parregullsi në mbajtjen e dosjeve fizike, në lidhje me

mungesën e fletëve të inventarit. Në projektet AI/IPA2017/06 dhe AL/IPA2017/8, dokumentacioni justifikues për pagesat dhe aktivitetet e realizuara ishte i paplotë dhe në disa raste në mospërputhje me deklaratat e paraqitura në “letrat e punës” të ekspertëve dhe grupeve të punës.

U konstatuan mangësi në procesin e kontrolleve “on the spot”, të cilat nuk janë realizuar plotësisht dhe në përputhje me planifikimin e parashikuar; vonesa në aprovimin e raporteve finale narrative duke çuar në shtyrjen e pagesave për vitin pasardhës dhe thyerje të afateve kontraktuale, djegie të fondeve të t.v.sh.-së dhe bllokim të fondeve që mund të ishin përdorur për pagesa ose investime të tjera.

Në disa raste, vlera e kërkuar për pagesë finale nga përfituesit ishte më e vogël se ajo e parashikuar në kontratë. Strukturat përgjegjëse nuk kishin kryer një analizë mbi ndikimin e këtij ndryshimi në rezultatet përfundimtare, duke krijuar një risk për mosrealizimin e plotë të aktiviteteve të planifikuara.

Planifikimi i t.v.sh.-së nga CFCU u konstatua të jetë jo realist, pasi nuk është marrë në konsideratë vlera e zbritshme e pagesës së parafinancimit dhe llogaritjet janë kryer mbi formula matematikore të përafërta, duke krijuar devijime midis planifikimit dhe ekzekutimit real të fondeve.

Projekti i “Zhvillimit të Kontabilitetit në Sektorin Publik”, megjithëse ka përfunduar në Dhjetor 2022 pas disa shtyrjeve, gjatë fazës së auditimit në dhjetor 2024, ende nuk kishte një produkt final të implementuar. Strukturat përgjegjëse të CFCU-së nuk kanë identifikuar arsyet e mosrealizimit të produkteve të pritshme dhe nuk kanë ndërmarrë masa për adresimin e pengesave që kanë ndikuar në moszbatimin në praktikë të Standardeve të Kontabilitetit Publik.



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

Janë konstatuar dy raste të ndërprerjes së kontratave pa realizuar të gjitha detyrimet e përcaktuara nga donatori. Përfituesi (AMF) ka marrë pagesën e plotë për fazën e parë të projektit në shumat 10,051\$ dhe 23,272€, pa siguruar produktin përfundimtar të kërkuar.

Në një kontratë të financuar nga BB, CFCU nuk ka mbajtur shumën e t.v.sh.-së nga klienti, por e ka paguar jashtë vlerës së parashikuar në kontratë, duke shkaktuar një shpenzim pa efektivitet në shumën prej 14,436\$.

Në Avokaturën e Shtetit

Në auditimin përputhshmërisë së aktivitetit, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, u konkludua në:

Pasaktësi në raportimin e detyrimeve, që ka Republika e Shqipërisë ndaj palëve paditëse për shumën 13,492,241 euro, si pasojë e mosrakordimit mes të dhënave të raportuara nga Avokatura e Shtetit dhe Ministria e Financës për shkak të përdorimit të metodologjive të ndryshme nga këto të fundit, për raportimin e detyrimeve.

Vonesa në ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit, nga mosveprimi në kohë e palëve të interesit/të paditurve (RSH/MIE,MTM), në lidhje me procedurat e njohjes së vendimeve të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit, duke mos u arkëtuar në buxhetin e shtetit vlera prej 10,013,972 euro; 1,162,125 dollarë; dhe 108,550 paund për 2 vendime arbitrazhi; vonesa në ushtrimin e kërkesës për njohjen e vendimeve të arbitrazhit nga Gjykata e Apelit nga mosveprimi në kohë i paditësve, që ka sjellë si pasojë mos ekzekutimin e detyrimit që ka RSH ndaj tyre, në vlerën 108,439,747.08 euro dhe 59,479,735.64 dollarë për 4 vendime arbitrazhi.

Vonesa në ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ, ku për vendime të mbartura, detyrimi vijon të jetë i pa ekzekutuar duke shkaktuar rritjen e interesave për mos likuidimin në kohë (gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar me vonesë 3 (tre)

vendime të GJEDNJ-së, të mbartura duke shkaktuar detyrimin për kryerjen e pagesave për interesa në total 411 mijë lekë).

Mosnjohja e detyrimeve në pasqyrat financiare, ku detyrimet dhe interesat për vendimet e arbitrazhit nuk janë njohur dhe reflektuar në pasqyrat financiare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), duke çuar në paraqitjen jo të saktë të detyrimeve dhe mosarkëtimin e të drejtave të fituara apo mospagimin e detyrimeve të pranuar.

Ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ, është kryer jashtë afatit ligjor, ku për 21 vendime të dala në vitin 2023, ekzekutimi i tyre rezultoi të jetë bërë jashtë afatit përkatës ligjor.

Auditimi i Kontratës Koncesionare “Për Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve”

Për periudhën nga data e shqyrtimit të propozimit të pakërkuar deri më 31.12.2023, në Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, u konkludua në devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fazën e propozimit dhe miratimit të projektit, procedurën e prokurimit dhe lidhjen dhe zbatimin e kontratës, konkretisht:

Në fazën e propozimit dhe miratimit të projektit: propozimi i pakërkuar për dhënien me koncesion, nuk është mbështetur në prioritetet strategjike të qeverisë dhe rezultoi të mos ketë një studim kosto-përfitimi për të vlerësuar ndikimin e tij në buxhetin e shtetit; raportit përmbledhës, rezultoi pa analizat e nevojshme nga Grupi i Identifikimit të Projektit (GIP), me vlerësim sipërfaqësor të ofertës dhe i pashoqëruar me studime të plota në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga shoqëria koncesionare; si dhe mungesa e përfshirjes së grupeve të interesit, si Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve, në këtë proces, dhe mungesa e konsultimeve me shoqëri të tjera të interesuara (si Bankers Petroleum Albania LTD).



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

Në fazën e procedurës së prokurimit: bonusi i pikëve, propozuar nga GFI (8%) nuk rezultoi i argumentuar dhe ndryshon nga ai i miratuar me VKM (6%), duke krijuar pasiguri dhe një bazë të paqartë për vendosjen e pikëve; dokumentacioni i kërkuar për vlerësimin e ofertave nuk rezultoi në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi, duke bërë të pamundur verifikimin e plotë të procedurës së prokurimit; vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës për propozimin e pakërkuar në kuadër të bashkëpunimit me institucionet shtetërore ka munguar.

Në fazën e lidhjes së kontratës: në kontratë nuk parashikohen formatet tip të raportimit dhe monitorimit, procedurat për trajtimin e pronësisë intelektuale dhe aktiveve të teknologjisë sekrete (solucioni i markimit të përdorur nga koncesionari), masat për parandalimin e lënies si kolateral të aktiveve të kësaj kontrate për qëllimet e angazhimeve financiare të shoqërisë Koncesionare, penalitete për koncesionarin në rastet kur shërbimet e markimit dhe të monitorimit të ofruara nuk janë në përputhje me ofertën teknike, me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DSK; kanë munguar grupet e përhershëm të punës nga autoritetet kontraktore, për monitorimin e zbatimit të kontratës në kundërshtim me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave i ka munguar plani i trajnimit për punonjësit dhe monitorimi i procesit të markimit të karburantit; Pozicioni i Menaxherit të Projektit ka qenë i paplotësuar, duke krijuar mangësi në menaxhimin e projektit; Dokumentacioni për monitorimin dhe raportimin e kontratës është i paplotë dhe nuk ofron informacion mbi kontrollet e kryera për zbatimin e saj.

Në fazën e zbatimit të kontratës, u konstatuan shkelje në realizimin e investimeve të parashikuara në shtojcën nr. 5 të Kontratës, pasi për periudhën 2013-2022 nuk është ndjekur

struktura e planifikuar e investimeve dhe realizimi i tyre rezultoi 68%.

Në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier

Për periudhën nga 13.05.2021 deri më datën 31.12.2023, u konkludua me **opinion të kualifikuar**, bazuar në konstatimet si vijon: Vonesa në marrjen e disa vendimeve nga Bordi drejtues, në disa raste edhe deri në 2 vjet.

Në lidhje me procedurën e prokurimit “Kite Reagentë për Laboratorin Biokimik” për vitin 2023, struktura përgjegjëse për zbatimin e kontratës nuk ka marrë në dorëzim materialet mjekësore sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST. Një prej kriterëve kualifikuese është ofrimi në përdorim i aparateve për realizimin e analizave imunologjike dhe dy aparateve biokimike, ku për një pjesë të kiteve të analizave biokimike dhe imunologjike është kusht prania e aparaturave për funksionimin e tyre.

Spitali Rajonal Memorial Fier si prodhues i mbetjeve spitalore, ka grumbulluar dhe ka magazinuar mbetjet infektive spitalore duke tejkaluar afatin ligjor prej 45 ditësh. Nga regjistri i mbetjeve spitalore, sasia e administruar për periudhën 01.04.2024-15.07.2024 është 6594 kg, sasi për të cilën nga verifikimi rezulton se nuk është kryer ndarja sipas llojit dhe kategorisë përkatëse.

Për 3 shërbimet kryesore të mbarëvajtjes spitalore dhe të pacientëve të hospitalizuar për një periudhë 4 muaj, nuk është ofruar shërbimi i lavanderisë, shërbimi i trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore dhe shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, për të cilat nuk janë realizuar procedurat e prokurimit. Në procedurën e prokurimit “Shërbimi i Lavanderisë”, grupi punës për llogaritjen e fondit limit është bazur në kontratat e ngjashme



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

të realizuara nga Autoritete Kontraktore të tjera si QSUNT dhe jo në kontratën aktuale të shërbimit, me një diferencë me vlerën e përlogaritur prej 315 mijë lekë mbi fondin limit.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore", rezultoi se vlera e fondit limit nga 10,689 mijë lekë pa t.v.sh. e llogaritur në procedurën e anuluar është ri-prokuruar pas një periudhe rreth 3 muaj, në vlerën 13,705 mijë lekë pa t.v.sh., pa u argumentuar nga grupi i punës shtesa prej 3,015 mijë lekë pa t.v.sh..

Nga auditimi i kryer për shpenzimet e karburantit për vitet 2021-2023, u konstatuan mangësi në evidentimin e lëvizjes së mjeteve, si në dokumentet autorizues dhe justifikues, ndërkohë evidentohen në normativat e konsumit dhe distancave/km të përshkruar, tejkalime të pajustificuara në sasinë e karburantit për 10599 litra si edhe 1700 litra diferencë e konsumit të karburantit për makinat e marra me qira, të cilat janë deklaruar si të reja por në fakt janë të përdorura dhe normativa faktike është më e lartë, duke shkaktuar dëm ekonomik në shumën 2,123 mijë lekë.

Konstatohen regjistrime jo korrekte në ditarin e magazinës ,duke pasqyruar gjendjen jo reale të inventarëve. Nga dokumentacioni vërtetues konstatohet se nuk janë regjistruar disa aktive. Evidencat e shpenzimeve dhe të ardhurave nuk rakordojnë me shpenzimet e konstatuara në ditarin e bankës dhe arkës. Në Pasqyrat Financiare janë konstatuar mangësi në regjistrimin e të dhënave kontabile për llogaritë e të ardhurave, të shpenzimeve për paga dhe shpërbime, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të cilat nuk përputhen me dokumentet vërtetues.

Në zbatimin e buxhetit janë konstatuar tejkalime shpenzimesh, janë kryer shpenzime për investime me fonde buxhetore dhe nga të

ardhurat e veta, pa miratim nga Bordi Drejtues. Grupi i auditimit konstatoi se me financimin e FSDKSH-së janë blerë pajisje kompjuterike dhe mjekësore dhe janë lidhur kontrata pa pasur fonde në dispozicion.

Në Spitalin Rajonal Elbasan

Për periudhën nga data 01.01.2020 deri në 31.12.2023 u konkludua me **opinion të kualifikuar**, bazuar në konstatimet si vijon:

Në procesin e inventarizimit të kryer sa i përket aparaturave të Hemodializës rezultoi se, 8 aparatura janë të viteve 2004 dhe tërësisht të amortizuara, pasi jetëgjatësia e tyre është mesatarisht 10 vjet. Për 2 aparatura, të cilat në vitin 2016 rezultojnë të reja, nga Drejtoria e Spitalit nuk është kryer asnjë veprim apo korrespondence në lidhje me procedurën që do të ndiqet, përpara, gjatë dhe pas lidhjes së kontratës koncesionare për këto aparatura të reja dhe në gjendje pune.

Ministria e Shëndetësisë ka dërguar për ndjekje Kontratën e koncesionit/PPP "Për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore" nënshkruar në Prill 2019, me qëllim sigurimin apo ofrimin e Shërbimeve Laboratorike Mjekësore për Popullatën nëpërmjet disa kushteve, rregullave apo udhëzimeve të përcaktuara në kontratë. Nga auditimi rezulton se ka tejkalim të tavanit buxhetor, konkretisht për vitin 2021 në masën 116 %, vitin 2022 në masën 100.7 % dhe vitin 2023 në masën 109.3%. Pra, referuar zbatimit të kontratës rezulton se është tejkaluar tavanit buxhetor i përcaktuar dhe është vazhduar me marrjen e shërbimeve mjekësore vetëm për analizat urgjente.

Përsa i përket planifikimit për barna dhe materiale mjekësore, për vitin 2020-2024, ato janë hartuar nga sektori i kostos dhe planifikimit duke mos u bazuar në kërkesat e shefave të shërbimit dhe farmacive. Kjo mënyre planifikimi për barna dhe materiale mjekësore ka sjellë probleme, duke shkaktuar mangësi për një sasi të konsiderueshme barnash dhe duke



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

detyruar Autoritetin Kontraktor të zhvillojë procedura prokurimi veçmas nga procedurat që zhvillon MSHMS.

Organet kolegjiale si, Këshilli Administrativ dhe Komisioni Mjekësor nuk funksionojnë, bazuar kjo në mungesën e plotë të dokumentacionit mbi mbledhjet zhvilluara dhe vendimet e marra. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt, “Blerje lëndë djegëse briket pellet”, rezultoi se nuk është bërë një ndarje e qartë e detyrave ndërmjet zyrtarëve të caktuar dhe komisioneve të ngritura sipas urdhrave përkatës, vecanërisht referuar këtu dhe ngritjes me urdhër të veçantë të komisionit të emërtuar “komisioni i identifikimit të nevojave”.

Në drejtim të vlerësimit të auditimit të brendshëm u konstatua se, kjo strukturë nuk funksionon si strukturë më vete dhe ka vetëm një punonjës, ende të pa certifikuar, si pjesë e Sektorit të Çështjeve Ligjore dhe Auditimit, kjo në mospërputhje me përcaktimet ligjore.

Në Albcontrol Sh.A.

Për periudhën nga data 01.10.2021 deri në 31.12.2023 u konkludua me **opinion të kualifikuar**, bazuar në konstatimet si vijon:

Për vitin 2021 shoqëria rezultoi me një realizim të ulët si në të ardhurat ashtu dhe shpenzimet. Të ardhurat janë realizuar në masën 92%, shpenzimet në masën 71% dhe investimet në masën 21%; për vitin 2022, të ardhurat janë realizuar në masën 112%, shpenzimet në masën 65% dhe investimet në masën 6%; për vitin 2023 shoqëria ka realizuar zërin e të ardhurave në masën 106%; ndërsa shpenzimet janë realizuar në masën 65% dhe investimet në masën 19%. Realizimi i investimeve për të tre vitet me vlera të ulëta, është një tregues negativ për realizimin e plotë të objektivave si dhe evidenton mangësi në planifikimin e buxhetit për shpenzimet dhe investimet. Gjatë viteve 2021-2023, shoqëria ka

marrë hua nga Autoriteti Portual Durrës, DPSHTRR, Autoriteti i Aviacionit Civil, Korporata e Investimeve Shqiptare Sh.A. dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për arsye të mungesës së likuiditetit si pasojë e bllokimit të fondeve nga një Urdhër Ekzekutimi i Gjykatës Belge. Albcontrol sh.a nuk ka përfshirë në Programin e Zhvillimit Ekonomik 2021-2023 asnjë zë për këto hua, por ka bërë ndryshime në zërat përkatës gjatë vitit sipas relacioneve nga Drejtori i Përgjithshëm, në mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi*.

Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Shpenzime mirëmbajtje sistem finance, prokurimi, buxheti dhe e-ticket” për vitin 2022, për përmbushjen e qëllimit të procedurës së prokurimit, nevojitej dhe autorizimi nga ana e Oracle për OE pjesëmarrës në garë, i cili bazuar në dokumentacionin e sjellë dhe faqen zyrtare të Oracle, nuk rezultoi që operatori ekonomik OE të ketë autorizim aktiv. Pra, shërbimi nga OE mbulohet pa një licencë aktive të autorizuar.

Në lidhje me përcaktimin e fondit limit dhe ofertave të dhëna, mungojnë detaje thelbësore mbi përcaktimin e saktë të vlerës së shërbimit, si numri i licencave (userave).

Në procedurën me objekt: “Trajnimi për ATCO AFIS Kukës” për vitin 2022, u konstatua që kohëzgjatja është planifikuar jo më shumë se 9 javë (teori dhe SIM) si dhe nr. i pjesëmarrësve është 5 kandidatë për kualifikime AFISO, që do të thotë investimi për një kandidatë është në vlerën 5,280 mijë lekë për 9 javë. Në lidhje me dokumentacionin e dërguar nga OE fitues, për përmbushjen e kriterit për punë të ngjashme deri në vlerën 40% të fondit limit, dokumentacioni i sjellë nga OE janë kontratat e ezauruara midis OE dhe Albcontrol Sh.A., ku linden dyshime mbi lidhjen e kontratës së parë me Albcontrolin me nr. 2185/4 Prot., në vitin 2019 në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me

*Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 15 datë 02.05.2018 “Mbi Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

studimin e tregut u konstatua se, dy nga tre OE nga të cilët janë marrë ofertat nuk e kanë për objekt fushën e trajnimit të personelit.

Nga auditimi i preventivit të procedurës së prokurimit me objekt “Kontratë blerje pjesë ndërrimi, mirëmbajtje teknike, rinovim licencash për sistemin VIOP, Cisco, ëireless, Telekonference”, u konstatua se zëri 5 “Suport teknik për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit VOIP, ëireless, telefonat IP, Telekonference, shërbimet IT dhe Sistemi i monitorimit të Rrjetit për periudhën 1-vjeçare”, është vendosur dy herë, njëherë si zë më vete dhe njëherë si pjesë e zërave të veçuar të preventivit, e cila ka sjellë rritje fiktive të shpenzimeve të bëra nga AK dhe përfitim të padrejtë nga BOE, të vlerës 4,317 mijë lekë pa t.v.sh.

Në Shoqërinë Rajonale të Ujësjetës Kanalizimeve (UK), Elbasan

Për periudhën nga data 19.09.2022 deri në datë 31.12.2023, rajonet e ish UK Cërrik, Belsh, Gramsh, Peqin dhe Librazhd për periudhën nga data 01.01.2020 si edhe ish UK Elbasan për periudhën nga data 01.01.2022 deri në ditën e përthithjes nga Shoqëria Rajonale UK Elbasan, u konkludua me **opinion të kundërt**, bazuar në konstatimet si vijon:

Parregullsi në procesin e bashkimit në Shoqërinë Rajonale Ujësjetës Kanalizime Elbasan Sh.A. në lidhje me transferimin e aktiveve. Në dokumentet vërtetuese e shoqëruese të akteve të transferimit mungonin të dhënat e plota e të sakta për identifikimin e aktiveve.

Nga ish shoqëritë UK Sh.A., nuk janë përdorur norma të mirë-argumentuara nga specialistët përkatës, në amortizimin e aktiveve.

Nga ish shoqëritë UK Sh.A., nuk janë kryer zhvlerësimet e aktiveve financiare të bartura në pasqyrat financiare të shoqërisë mëmë.

Në lidhje me zbatimin e kontratave për punime: në 4 raste janë konstatuar punime të pakryera me një dëm ekonomik në vlerën 1,335 mijë lekë.

Llogaritë bankare të SHRUKE Sh.A. janë sekuestruar përgjatë periudhës kohore 2021 - 2022, nga përmbaruesi privat. Detyrimi ndaj OSHEE Group Sh.A., deri në periudhën e auditimit në terren, rezulton në vlerën 2,044 milionë lekë, nga ku vetëm për kamatëvonesat ky detyrim ka arritur në vlerën 986 milionë, lekë. Në shtesë të këtij detyrimi, për shkak të mosveprimeve lidhur me shlyerjen e tij janë paguar shpenzime përmbarimore në vlerën 14,224 mijë lekë, që konsiderohen efekt financiar negativ në buxhetin e SHRUKE Sh.A.

Në vitin 2023 vlera e debisë së kthyer nga debitorët për detyrime ndaj ujësjetës është 288 mijë lekë, kurse vlera e kthyer për pagesën e përmbarimit privat është 3,778 mijë lekë.

Lidhur me vonesat e ndryshme në pagesa, SHRUKE Sh.A. dhe njësitë Elbasan, Peqin dhe Librazhd - Përrenjas, për periudhën objekt auditimi kanë paguar gjoba dhe interesa për pagesa të vonuara në vlerën 10,621 mijë lekë, që konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e SHRUKE Sh.A.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Radio Televizionit Shqiptar

Për periudhën nga data 01.01.2020 deri me datën 30.06.2023 u konkludua me **opinion të kualifikuar**, bazuar në konstatimet si vijon:

Për vitin 2022 dhe 6-mujorin e parë 2023, RTSH ka zhvilluar 27 emisione në cilat janë angazhuar 91 punonjës të RTSH dhe ka shpenzuar për paga në vlerën 28,149 mijë lekë dhe për honorare po për këta punonjës në vlerën 27,535 mijë lekë. Angazhimi i 91 punonjësve të RTSH jo vetëm ka krijuar një marrëdhënie juridike në shitblerjen e të drejtave, të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar dhe në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga pozicioni sipas kontratave



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

individuale të punës, por edhe një standard të dyfishtë, në marrëdhëniet e pagave dhe të shpërblimeve me punonjësit e RTSH-së. Vlera 27,535 mijë lekë përbën dëm ekonomik për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet.

Në lidhje me prokurimin me objekt: “Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH-së, me fond limit 22,231 mijë lekë, RTSH nuk ka kryer një vlerësim kosto-përfitim gjithëpërfshirës dhe afatgjatë për ruajtjen e të dhënave video. Grupi i auditimit vlerëson se RTSH nuk ka justifikuar nevojën e një investimi sistem+storage, pasi ka pasur në pronësi edhe sistemin MAM me Storage Isilon dhe Kasetat LTO9. Vlera 13,860 mijë lekë për RTSH dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet.

Në zbatimin e kontratatave të vitit 2023: me objekt “blerje pajisje ndriçimi për nevoja të RTSH”, në vlerën 15,409 mijë lekë, kontratës kt “Furnizim-vendosje, instalim dhe konfigurim me sistem storage për rritjen e kapacitetit për nevoja të RTSH”, kontratës me objekt “Mirëmbajtje dhe suport për funksionimin e sistemit storage prodhuesi DELL/ose ekuivalent”, në vlerën 3,097 mijë lekë, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht, pajisjet nuk janë të shoqëruara me certifikatën e origjinës, raportet e testeve, certifikatat e cilësisë, certifikatat e garancisë për mallrat, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve nëse ato janë të njëjta me ato të prokuruarra dhe për të cilën operatorët ekonomik kanë fituar procedurat e prokurimit dhe likujduar në vlerën 18,506 mijë lekë, e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet.

Është konstatuar pagesë e dubluar në vlerën 252 mijë lekë në procedurën blerje me vlera të vogla “Inspektim dhe matje profesionale e të gjithë komponentëve të uplinkut satelitor stacionar”, viti 2023.

Në zbatimin e kontratës për bashkëpunim/këmbim reklame, për vlerën 3000 euro për 5 spote, pa përcaktuar kohëzgjatjen për çdo spot, u konstatua një diferencë ndërmjet faturës elektronike të RTSH dhe furnizimeve të bëra në vlerën 1,172 euro, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e RTSH.

Në zbatimin e kontratës për bashkëpunim/këmbim reklame, për vlerën 250 mijë lekë, për 8 spote pa përcaktuar kohëzgjatjen për çdo spot, u konstatua një mosrealizim në vlerën 250 mijë lekë, në mungesë të plotë të dokumenteve që provojnë se është realizuar kontrata/shkëmbimi, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për RTSH-së.

RTSH, për projektin artistik “Festivali i 61” i këngës, ka shpenzuar për punonjësit e saj mbi pagesën mujore të tyre vlerën 3,153 mijë lekë, duke krijuar një marrëdhënie juridike të shitblerjes së të drejtave, të realizuara në mjedisin e punës, orarin zyrtar si dhe një standard të dyfishtë në marrëdhëniet e pagave dhe të shpërblimeve me punonjësit e RTSH, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për RTSH-në.

Nga auditimi i nivelit të pagave të miratuar nga këshilli drejtues me vendim nr. 28, datë 22.07.2021 dhe nr. 34, datë 07.12.2022 “Për miratimin e ndryshimit të librit të pagave të RTSH”, u konstatua që klasifikimi nuk është bërë duke vendosur kriteret specifike për çdo pozicion pune, siç janë niveli i diplomës, arsimimi/kualifikimi, natyra e punës, kushtet e punës, formimi profesional, vjetërsia në punë, vështirësia, përvoja dhe përgjegjësitë, njohuritë



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

nga eksperiencia në vite, trajnimet, specializimet si kusht për të garantuar barazinë në vendosjen e pagave.

Në 3 raste, për vlerën 4,679 mijë lekë, RTSH ka marrë me qira pajisje të ndryshme për realizimin e koncerteve, pa argumentuar më parë nëse i dispononte ose jo pajisjet e marra me qira.

Në procedurat e prokurimit me objekt: “Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, me vlerë 7,330,000 euro pa t.v.sh., viti 2020, “blerje karburanti” me vlerë 32,415 mijë lekë, viti 2021 kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.

Në të gjitha procedurat e prokurimit për periudhën objekt auditimi është vendosur kriter i kualifikimit favorizues: autorizim nga prodhuesi. Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim, ka orientuar operatorët ekonomik drejt një prodhuesi të caktuar në treg, duke ulur kështu konkurrencën dhe favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët kanë autorizime të prodhuesve të caktuar.

Për blerjen e shërbimit për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes DVB-T2, me OE është lidhur marrëveshja kuadër, datë 26.02.2021, për të cilën u konstatua se pagesat janë kryer pa mbajtur akt-kolaudim ndërmjet palëve dhe jo sipas përcaktimeve në anekset e kontratës.

Në 7 kontrata për transmetim reklame, media-planet e transmetimit janë firmosur nga drejtori i shitjes dhe menaxhimit, pa delegim kompetence. Reklamat e transmetuara 2021-2022 nuk janë të ruajtura, janë fshirë, janë shkëputur nga ndeshjet e transmetuara dhe të arkivuara. Për kontratat për transmetim reklame të përshkruara si më sipër, nuk disponohen programet e transmetimit, dhe asnjë dokument tjetër justifikues për realizimin

e kontratave.

Prokurimi i kontratës me objekt “blerje shërbimi për Platformën OTT”, viti 2020, me vlerë të fondit limit 85,113 mijë lekë pa t.v.sh. dhe vlerë të kontratës së lidhur 84,858 mijë lekë pa t.v.sh., për një investim i cili ka parashikuar krijimin e aplikacionit “RTSH Tani” të akesueshëm në të gjitha platformat si Android, i OS dhe pajisjet Smart TV, përmes të cilit të mund të shihen kanalet TV dhe Radio të RTSH, aktualisht shërbimi nuk është më funksional pasi kontrata me vlerë 101,829 mijë lekë me t.v.sh. ka përfunduar në shtator të vitit 2021 dhe RTSH nuk ka asnjë akses në këtë aplikacion.

Konstatohet, likuidimi i shërbimeve të pakryera dhe penalitete të pa aplikuar për vonesat në ofrimin e shërbimeve në shumën prej 7,143 mijë lekë pa t.v.sh. për dy kontrata, konkretisht: kontrata me objekt “blerje shërbimi për Platformën OTT”, viti 2020, për të cilën i është likuiduar BOE fitues MC Networking & ADVAN TECH shuma prej 6,834 mijë lekë pa t.v.sh. dhe kontrata me objekt “Blerje shërbim për transmetimet e sinjalit TV dhe Radio me fibër Optike”, viti 2022, për të cilën i është likuiduar OE fitues VODAFONE shuma prej 299 mijë lekë pa t.v.sh.

Gjithashtu, konstatohet mos marrja e masave nga asnjë prej titullarëve ndër vite, për arkëtimin e të ardhurave që rrejedhin nga 23 kontrata qiraje, në vlerën 75,681 mijë lekë, nga të cilat shuma prej 1,802 mijë lekë si penalitet i pa aplikuar ndaj tyre, për vonesat.

Në Shoqërinë “Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve”

Për periudhën nga krijimi i shoqërisë deri me 31.12.2023, u konkludua me **opinion i kualifikuar** bazuar në konstatimet si vijon:

Kjo shoqëri ka një nivel me të lartë shpenzimesh krahasuar me të ardhurat që gjeneron nga aktiviteti i saj, duke u ndodhur në vështirësi



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

financiare dhe në pamundësi për të bërë investime të reja apo për të kryer shpenzime për të mbajtur në gadishmëri aktivet e saj. Në gjendjen teknike që janë aktivet e ndërmarrjes jo vetëm që nuk janë efektive për veprimtarinë, por paraqesin një rrezik potencial për jetën, shëndetin e punonjësve dhe të efektivave të anijeve, për pasurinë shtetërore dhe atë të palëve të treta.

Këshilli Drejtues, rezulton se gjatë vitit 2018 - 2019 dhe 2020 nuk ka përmbushur detyrimin për zhvillimin mbledhjeve jo më pak se 1 (një) herë në muaj, të përcaktuar në nenin 13 të Rregullores së KRNA-së.

Nga auditimi ka rezultuar se KNRA ka filluar procedurën për shitjen me anë të ankandit të kontenierëve bazuar vetëm në Urdhrin nr. 405 datë 14.06.2016, të Drejtorit të KNRA-së, pa marrë miratim nga Këshilli Drejtues.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje boje dhe aksesore për lyerje”, për mallrat e kërkuara nuk është argumentuar sasia dhe specifikimet e kërkuara.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje vegla pune” viti 2020, certifikata e sjellë nga OE nuk vërtetohet që mallrat e sjella janë ato të cilat janë të përcaktuara në DST, si në rastin e distributorit ALBIO-EA. Gjithashtu Autoriteti Kontraktor ka bërë kërkesa fikse siç janë ato ku kërkohet autorizim nga distributori dhe prodhuesi për mallra të caktuara dhe specifik, pa asnjë argument.

Nga ana e KNRA nuk është hartuar regjistri i riskut në lidhje me zhvillimin e aktivitetit të saj ekonomik financiar nga viti 2017 deri në vitin 2021. Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik; nuk është caktuar koordinatori i riskut dhe sistemi i kontrollit të brendshëm i KNRA vlerësohet jo efektiv.

Ministria e Mbrojtjes nuk ka miratuar pagat e punonjësve të KNRA sipas niveleve të pagave të përcaktuara në VKM. Për vitet 2017 dhe në vazhdim, edhe pse me hyrjen në fuqi të VKM-së

nr. 187, datë 08.03.2017, trajtimi financiar nuk ka ndryshuar por është vazhduar me trajtimin financiar sipas VKM-në nr. 717, datë 23.06.2009. Kjo edhe pse Administrata e KNRA-së me shkresë nr. 350, datë 27.06.2023 “Propozim për ndryshim të nivelit të pagave për KNRA”, i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, ajo në asnjë rast nuk ka kthyer përgjigje. Vlen të theksohet se që prej vitit 2015 nuk është aplikuar asnjë rritje page.

Në Agjencinë për Eficencën e Energjisë

Për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 31.12.2023, u konkludua me **opinionin të kualifikuar**, bazuar në konstatimet si vijon:

Agjencia për Eficencën e Energjisë (AEE) nuk ka ngritur një sistem rregullash të shkruara efikas të menaxhimit financiar dhe kontrollit; Përgjatë periudhës 2019-2023, nuk është hartuar rregullore e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit; nuk janë planifikuar programe trajnimi për punonjësit, duke mos marrë masat e duhura për zhvillimin profesional të stafit; Struktura e AEE-së nuk është e plotësuar me të gjithë numrin e punonjësve të miratuar dhe për pozicionet vakante nuk u konstatuan procedura me qëllim plotësimin e tyre.

AEE ka nisur procedurën e prokurimit me objekt “Projekt pilot për përmirësimin e Eficencës së Energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”, në UK Durrës, me kërkesën e kësaj të fundit, por pa kërkesën dhe bashkëpunimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizime dhe Mbetjeve të Ngurta (AKUM-it), e cila është agjenci përgjegjëse në lidhje me objektin e prokuruar dhe ka si mision zbatimin e politikës specifike shtetërore në sektorin e ujësjetës-kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Përveç kërkesës së UK Durrës për investimin, nuk ka dokumentacion tjetër që të shpjegojë se mbi bazën e cilave kritereve AEE përzgjodhi UK Durrës për kryerjen e këtij investimi.

Në përfundim të investimit me objekt “Projekt



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

pilot për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza”, AEE nuk ka kryer monitorimin e efikasitetit të energjisë reale të arritur. Raporti përfundimtar për efikasitetin e energjisë së projektit nuk është hartuar mbi bazën e konsumit real të energjisë elektrike, menjëherë pas realizimit të investimit, duke mos përcaktuar realisht nëse investimi i kryer ja ka arritur qëllimit lidhur me rritjen e efikasitetit të energjisë.

Në kontratën me objekt “Vendosja e sistemit të ndriçimit, parkimit, furnizimit elektrik të makinave, 2 km Smart City-Rruga e Energjisë Pastër”, të lidhur me operatorin ekonomik “Euroelektra” SHPK, me vlerë 98,999 mijë lekë me t.v.sh. dhe afat përfundimi 6 muaj nga data e marrjes në dorëzim të sheshit të ndërtimit, nga dokumentacioni i dosjes u konstatua se punimet nuk kanë përfunduar plotësisht dhe sistemi i instaluar nuk është vendosur ende në funksion. Projekti i zbatimit të këtij investimi nuk është pajisur me leje ndërtimi/infrastrukturore dhe për të nuk është kryer oponenta teknike.

AEE ka për detyrë të krijojë dhe përditësojë një bazë të dhënash kombëtare lidhur me konsumin final të energjisë dhe arrijtjet në kursimin saj, e cila shërben si bazë për të vlerësuar nëse janë arritur objektivat e efikasitetit të energjisë, por kjo detyrë nuk është kryer prej këtij institucioni. Sistemi i hedhjes së të dhënave EECERT, i cili është sistemi i efikasitetit të energjisë të AEE-së, nuk ka pasur mirëmbajtje apo upgrade të moduleve të tij dhe paraqet problematika të ndryshme, si në hedhjen e të dhënave, ashtu edhe në përpunimin e tyre. Nga auditimi rezultoi pamundësi e gjenerimit të raporteve të ndryshme nga ky sistem, raporte të cilat ishin të nevojshme për të kryer sondazhe në lidhje me hedhjen e të dhënave nga audituesit e pavarur të energjisë.

Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta, u konstatuan:

Në 13 raste u konstatuan parregullsi në hartimin e kriterit të veçanta të dokumenteve të tenderit,

pasi disa prej tyre nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërisht në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Në 2 raste janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në dokumentet e tenderit, në vlerën totale prej 64,765 mijë lekë pa t.v.sh.

Në datën 31.12.2023 u konstatua një detyrim ndaj të tretëve në vlerën 93,379 mijë lekë pa t.v.sh., që do të thotë se AEE nuk ka marrë masat e duhura për likuidimin e kreditorëve.

Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Bashkinë Vlorë, për Projektin “Ndërtimi i qendrës rajonale të menaxhimit të integruar të mbetjeve në Sherishtë të Vlorës”

Për periudhën nga fillimi i projektit deri me datë 31.03.2024, u konkludua me **opinion të kualifikuar**, bazuar në konstatimet si vijon:

Projekti “Ndërtimi i qendrës rajonale të menaxhimit të integruar të mbetjeve në Sherishtë Vlorë”, ka patur si afat realizimin e tij në datë 30.12.2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ka rezultuar se kanë ndodhur tre ndryshime të Marrëveshjes bazë e Huasë ndërmjet Kfë Frankfurt am Main dhe RSH, për “Programin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta” Rajoni Vlorë në shumën 12,000,000 Euro, miratuar me Ligjin nr. 20/2017 datë 23.02.2017, të cilat kanë të bëjnë me shtyrjen e afatit të disbursimit të fondeve me tre vite, deri më datën 30.12.2024. Nga analizimi i faktorëve të cilët kanë çuar shtyrjen e realizimit të këtij projekti përtej afatit të parashikuar, përveç shkaqeve objektive konstatohen raste të mos koordinimit të veprimeve që duhej të ndërmerren strukturat e ndryshme të përfshira për realizimin e tij, si: rishikim në kohë të



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

projektit ekzistues të vitit 2015, pasi ka dalë prej kontekstit kohor; vonesa në marrjen e lejes së ndërtimit për shkak të mosmiratimit në kohë nga Këshilli Kombëtar i Territorit; vonesa në kryerjen e procedurave të prokurimit përtej parashikimeve, për shkak të mos planifikimit real të afateve kohore të procedurave, si dhe vonesa në kryerjen e punimeve, të shoqëruara me pasojat e mëposhtme:

Këto vonesa kanë sjellë shtyrje të disbursimit të fondeve dhe për rrjedhojë shtimin e kostos së tarifës së zotimit financiar përtej planifikimit fillestar të disbursimit, e cila sipas Marrëveshjes së huasë, është 0.25% në vit për shumatat e pa disbursuara të huasë. Referuar planit, ndryshimeve në afatet e disbursimit dhe procedurave të disbursimit, këto shpenzime sipas përlllogaritjeve vlerësohen në shumën 68,070 Euro, ndërsa në fakt rezultojnë pagesa deri në 31.12.2023 në shumën 108,293 euro.

Shtyrja e afatit të zbatimit të projektit dhe të disbursimit të fondeve ka sjellë dhe rritjen e vlerës së kontratës për Konsulentin teknik/Mbikëqyrësit. Sipas Kontratës fillestare, e cila ka parashikuar përfundimin në kufijtë e disbursimit të fundit të fondeve të kredisë, vlera e saj ishte planifikuar 1,395,940 euro, ndërsa me ndryshimet e saj, kjo kontratë shkon në vlerën 1,930,000 euro, me një shtesë prej 534,060 euro, ose në masën 38% kundrejt kontratës fillestare (duke përfshirë këtu dhe efektin e shtesës së grantit e për rrjedhojë dhe kontratave për punë, mallra dhe shërbime).

Për më tej, këto vonesa prej 3 vitesh kanë sjellë pasojat në mos marrjen në kohë dhe me cilësi të shërbimit nga ana e qytetarëve; ndotjen e ambjentit me pasojat në shëndetin e qytetarëve me banim afër venddepozitimeve ekzistuese, por jo vetëm, pasi një komponent i rëndësishëm i këtij projekti është mbyllja e tyre, gjë që nuk është realizuar, pasi kushtëzohet nga vënia në shfrytëzim e landfill-it të ri në Sherishtë.

Nga auditimi mbi kryerjen e pagesave pjesore ka rezultuar se në 6 raste pagesat e kryera janë nën 5% të vlerës së kontratës ose të shumës 490,081 euro, në kundërshtim me kushtin e kontratës. Këto pagesa janë kryer me miratim nga "Konsulenti teknik", referuar kërkesës së Administratorit shtetëror - AAPSK, të datës 16.05.2022, dhe IPC nr. 9, pika 1.6, ku është cilësuar ulja e minimumit të pagesës pjesore deri në 200,000 euro.

Sipas Kontratës "Punime, projektim-furnizim dhe instalim impianti/furnizim pajisje për përpunimin e mbeturinave në Sherishtë Vlorë", Bashkia Vlorë me shkresë nr. 4114/1 prot., datë 06.10.2023, përcakton se grupi i punës i ngritur për analizimin e çështjeve që kanë lidhje me dështimin e kontraktorit për të përmbushur detyrimet kontraktore, ka arritur në konkluzionin se punëmarrësi ka shkelur dhe nuk ka përmbushur disa nga detyrimet dhe kushtet e përcaktuara në kontratë. Bashkia Vlorë në cilësinë e punëdhënësit njofton se ka marrë vendim për zgjidhjen e kontratës me efekt të menjëhershëm, më datë 21.11.2023. Krahas garancisë së performancës, Kontraktori i detyrohet Punëdhënësit (Bashkisë Vlorë), për mos realizim të punimeve brenda afatit të përcaktuar në kontratë për një afat 100 ditësh, vlerën 980,162.4 euro. Kjo vlerë përbën maksimumin e dëmeve të aplikueshme në masën 10 % të çmimit të kontratës.

Nga verifikimi i punimeve të realizuara në objekt rezulton se për ndërtimin e drenazheve sipas zërit 5.1.11 (Drenazh 4), është certifikuar sasia 160 ml. Nga auditimi rezultoi se nuk janë respektuar specifikimet teknike, kryesisht sa i takon vendosjes së shtresës së rërës dhe trashësisë betonit të faqeve anësore të kanaleve. Në të gjitha seksionet e matura, trashësia e betonit nuk përmbush parametrat e përcaktuara në specifikimet teknike, si dhe nuk ishte vendosur hekur përforcues, duke arritur në konkluzionin se për të gjithë gjatësinë (edhe në



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

seksione ku nuk janë realizuar matje), nuk ka respektim të specifikimeve teknike gjë që ndikon në qëndrueshmërinë e drenazheve. Vlera 132,000 euro e certifikuar për realizimin e drenazhit nr. 4, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

Në institucionin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për projektin “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”

Për periudhën nga fillimi i projektit deri në datën 31.12.2023, u konkludua me **opinionin të kualifikuar**, bazuar në:

Vonesa të pajustificuara në implementimin e programit, të cilat kanë ardhur kryesisht nga pala shqiptare pasi, nga viti 2006 deri në vitin 2014 për projektin nuk rezulton të jetë zhvilluar asnjë aktivitet për të vënë në lëvizje strukturat kompetente të cilat do të siguronin zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja dhe arritjen në kohë të objektivave të projektit.

Procedurat e prokurimit kanë filluar në vitin 2015 dhe nga ky moment deri në përfundim të projektit kanë kaluar 5 vjet.

Nuk ka një ndarje të qartë në lidhje me shumat që janë akorduar për secilin nga komponentët e projektit, nuk është hartuar raporti përfundimtar i vlerësimit të projektit dhe nuk mund të evidentohet ndarja e këtyre zërave sipas kontratave të lidhura, pasi në një prej kontratave të lidhura mund të jene përfshirë pajisje që u shërbejnë 2 ose më shumë loteve. Nuk ka dokumentim të të gjitha fazave të implementimit të projektit, në ruajtjen e dokumentacionit, si dhe në ndjekjen dhe monitorimin e projektit nga ana e personave përgjegjës të ngarkuar për menaxhimin e tij, në mos përputhje me përcaktimin e sanksionuar në Marrëveshjen bazë.

Objektivi i projektit “Pajisja me aparatura mjekësore duke e bërë atë të përshtatshme si pikë referimi për pacientët e traumatizuar”

është realizuar me vonesë mbi 16 vjet, nga marrëveshja fillestare.

Nuk është ngritur komiteti drejtues e për pasojë asnjë nga detyrat të cilat citohen në nenin 6 të marrëveshjes së programit nuk rezulton të jetë kryer.

Për shumat e përfituara nga kontraktorët e huaj nuk është marrë në konsideratë mbajtja e tatimit mbi të ardhurat në vlerën 749,475 euro, vlerë e cila përfshin pagesat e kryera për kontraktorët.

Nga pajisjet mjekësore të furnizuara për periudhën 2019-2020, u inspektuan 17 të tilla me vlerë 210,952 euro ku rezultoi se, për këto pajisje, defektet (nëse ka pasur brenda periudhës së garancisë) dhe për kryerjen e riparimeve nuk është mbajtur dokumentacion në Sistemin e Informacionit të Pajisjeve Mjekësore (kartela e shërbimit për dokumentimin e historikut të pajisjes).

Nga auditimi i përputhshmërisë, i ushtruar në subjektin OST Sh.A. për projektet “Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kV Shqipëri Kosovë”; “Linja 400 kV Shqipëri Maqedoni”; “Ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë–Rashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës, loti 1 dhe 2”

Për periudhën nga data prej fillimit të projekteve deri më datë 31.12.2023 rezultuan disa mangësi të cila u janë baza për dhënien e **opinionit të kualifikuar**, bazuar në:

Projekti “Linja 400 kV Shqipëri Maqedonia e Veriut”, ishte parashikuar të përfundonte në Dhjetor të vitit 2020, pra projekti është me 3 vite vonesë deri më datë 23.12.2023. Për më tepër, rezulton se nga data e finalizimit të nënshkrimit të marrëveshjes e deri në miratimin e lejes së ndërtimit, ka kaluar një periudhë kohe prej 7.3 vjetësh.

Sipas marrëveshjes së Huasë, “Linja 400 kV Shqipëri Maqedoni (Fier Elbasan Qafë Thanë)”,



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

ka patur si afat të fundit të disbursimeve datën 30.06.2020, datë e cila është shtyrë dy herë, konkretisht në datat 30.12.2023 dhe 30.12.2025. Aktualisht, deri më 31.12.2023, kemi jë realizim prej 11.25%.

Pagesat e kryera nga OST për tarifën e angazhimit “Linja 400 kV Shqipëri Maqedonia e Veriut”, deri në fund të vitit 2023, janë në shumën 802,441 euro, nga 458,750 euro që ishte parashikuar deri në përfundim të projektit, ose janë paguar 343,691.74 euro më tepër nga programimi, vlerë e cila përbën kosto shtesë për projektin, pra zgjatja e afatit të disbursimeve shoqërohet dhe me pagesa shtesë për tarifën e angazhimit.

Nga auditimi i tarifës së angazhimit për kredinë e marrë për projektin rezulton se pagesat e kryera nga OST për tarifën e angazhimit deri në fund të vitit 2023, janë në shumën 710,625.42 euro, nga 430,945.16 euro që ishte parashikuar deri në përfundim të projektit, ose janë paguar 279,680.26 euro më tepër nga programimi.

Nga auditimi i financimit të projektit rezulton se disbursimet kanë ecur me ritme të ulëta dhe ka vonesa të theksuara nga ku, për vitet 2015, 2016 dhe 2018 nuk është kryer asnjë disbursim.

Vlera e kontratave, për dy lotet dhe konsulencën nga 40,141,726 euro, mbas amendimeve janë në shumën 49,173,745 euro. Nga kjo kosto shtesë, 2,000,000 euro janë financim nga OST (5 % të vlerës së kredisë) sipas Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të OST, me nr. 12 datë 21.12.2021. Për këtë projekt kosto shtesë të pambuluara me fonde janë në shumën 7,173,745 euro.

Zgjatja e afatit të punimeve ka sjellë rritje të koston së konsulentit/mbikëqyrësit në vlerën 1,845,986 euro.

Në lidhje me kolaudimin e linjës “Linja 400 kV Shqipëri – Kosovë”, nga ana e ish Administratorëve të OST Sh.A., kanë dalë urdhra

të brendshëm: për kolaudimin e segmenteve të ndryshëm të linjës deri në kolaudimin e plotë, si dhe për projektin “Programi për eficientë e energjisë në sektorin e transmetimit -ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë – Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës”, për vendosjen e autotransformatorit të ri dhe pajisjeve të tij sekondare në nënstacionin e Rrashbullit, nga ana e Administratorit, kanë dalë urdhra të brendshëm për kolaudimin tyre, me komisione të përbëra nga punonjës të OST Sh.A., të cilët nuk janë të licencuar.

Në projektin Shërbimet Mjedisore i ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencinë për Zhvillim Bujqësore dhe Rural

Për periudhën e veprimtarisë nga data e fillimit të projektit deri në 31.12.2023, është konkluduar si vijon:

Nga tabela e disbursimeve vënë në dispozicion grupit të auditimit, për disbursimet deri në 28 Maj 2021, vihet re që deri në përfundimin e afatit të projektit, të shërbimeve mjedisore, 30.09.2019, nuk është disbursuar as gjysma e totalit të financimit të projektit. Projekti i është nënshtruar dy ristrukturimeve të cilat sipas Raportit Final të hartuar nga Banka Botërore kanë lindur si kërkesë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, dokumentacion që nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit, për të analizuar shkaqet dhe arsyet mbi ristrukturimin e tyre. Gjithashtu, nga ristrukturimi i projektit janë rritur dhe kostot operacionale, duke bërë të mundur alokimin e kostove të planifikuara për zhvillimin e komponentëve të projektit për kostot operacionale të burimeve njerëzore, si dhe të shtyrjeve të afateve të realizimit të kontratave të tjera të konsulencës.

Gjatë viteve 2020 dhe 2021, pra pas afatit ligjor të përfundimit të projektit, janë disbursuar 11.86 milionë dollarë fonde, të cilat përbëjnë 57% të të gjithë fondeve të vënë në dispozicion për 4 vitet



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

e jetës së tij (2015-2019).

Gjatë analizimit të realizimit të objektivave, disa nga nënkomponentët kanë pësuar ndryshime gjatë realizimit të projektit si në numër, përqindje dhe në kosto. Shumë objektiva janë jo të matshëm dhe shumë gjithëpërfshirës duke e bërë të vështirë verifikimin e realizimit të tyre.

Pjesa më e madhe e financimit të projektit 22.8 milionë dollarë, është shpenzuar për shërbime konsulence dhe për shpenzime operative.

Në lidhje me nënkomponentit “Mbi % e dërgimit të sedimenteve të llogaritura në rezervuar, në zonat pilot të mbuluara nga PES (Pagesat e shërbimeve të ujëmbledhësit)”, për të cilin janë lidhur 3 kontrata dhe në total janë shpenzuar, 518,000 euro, rezulton i parealizuar.

Në procedurën e prokurimit me objekt “International consultant ALFIS planning, design and quality assurance”, me kosto të përlllogaritur në vlerën 200,000 euro në planifikim, përfaqësohej nga procedura me të njëjtin objekt por me kosto të ndryshme prej 120,000 euro. Për rritjen e kostove nuk jepen shpjegime të mëtejshme. Shërbimi ishte i planifikuar të përfundonte në vitin 2016, por është realizuar vite me vonë dhe ka pasur amendime kontratash pa dhënë arsytet përkatëse.

Nga auditimi i koncesionit “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë”, të ushtruar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Për periudhën e veprimtarisë nga data 09.12.2016 deri më datën 31.12.2022, u konstatuan, mangësi dhe shkelje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi mbi bazën e të cilave është dhënë konkluzion i përgjithshëm i

auditimit.

Projekt-vendimi për projektin dhe relacioni shoqërues i tij, përcjellë në Këshillin e Ministrave për miratim nga ish Ministri përgjegjës për ekonominë, nuk është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të koncesioneve, të organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Ministrave, kryesisht në përmbajtjen e projekt-akteve që propozohen për miratim.

Procedura e dhënies me koncesion e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, nga MZHETS, është në kundërshtim me kuadrin rregullator të koncesioneve.

Forma e zgjedhur është nëpërmjet propozimit të pa kërkuar, të subjektit “Applus Noa Control” sh.p.k., me argumentin se: “Aktiviteti që kryhet aktualisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), nuk bazohet në teknologji të përparuar, në përpunimin e të dhënave, dhe monitorimin e punës dhe kjo shkakton mungesë efikasiteti në operacione, si dhe vështirësi në monitorimin e punës së kryer”, duke pasur bashkëlidhur propozimit, studimin e fizibilitetit. Objekti i kërkuar në propozim nuk përfshihet në fushat e përcaktuara në kuadrin rregullator të fushës së koncesioneve. Relacioni shoqërues përmban të dhëna jo të sakta, sa i përket mungesës së efekteve në buxhet të këtij projekt vendimi, pasi DPM nga shërbimi i verifikimit të pistoletave të karburantit realizon 76,193 mijë lekë, të cilat kalojnë për llogari të buxhetit të shtetit dhe me dhënien me koncesion këto të ardhura janë të munguara për Buxhetin e Shtetit.

Mendimet e dhëna nga Ministritë e Linjës, kryesisht mendimet e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, bien në kundërshtim me përcaktimet në kuadrin rregullator të fushës, konkretisht në VKM që përcakton fushën e



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

përgjegjësisë shtetërore të ministrive të mësipërme.

MZHETS duhet të ishte shprehur kundër dhënies me koncesion, pasi e ka detyrë që të vlerësojë nëse një projekt-akt është në përputhje me politikat e qeverisë. Në këtë rast, ky projekt-akt bie në kundërshtim me politikat e qeverisë, pasi në strategjinë për mbrojtjen e konsumatorit 2015-2020, miratuar me VKM nr.753, datë 16.09.2015, në planin e veprimit nuk është përcaktuar si objektivi dhënia e shërbimit të verifikimit metrologjik të pistoletave të karburanteve nëpërmjet koncesionit/formë tjetër ligjore. Në procedurën e ndjekur nuk është marrë mendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, nuk është marrë mendimi i Ministrisë së Mjedisit, ku sipas raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, megjithëse në vlera të ulëta, projekti mund të ketë ndikim në mjedis.

Dhënia me koncesion e shërbimit të verifikimit të shpërndarësve të karburantit, ka ndikuar negativisht në efektivitetin dhe eficiencën e investimeve të kryera në DPM, për blerjen e auto-laboratorëve dhe pajisjeve të nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi. Konkretisht për kryerjen e këtij shërbimi, janë investuar 63,975 mijë lekë në blerjen e 9 auto-laboratorëve si dhe pajisjet e nevojshme.

Nuk është respektuar periudha prej 12 muaj për të ndërmarrë angazhimet e nevojshme për ndryshimin e ligjit të metrologjisë apo propozimin e ligjit të ri të metrologjisë, pasi ligji i ri i metrologjisë është miratuar më datë 15.10.2020, ndërkohë kontrata koncesionare është lidhur më datë 21.08.2019.

Në vijim të situatës së mësipërme, MFE i është drejtuar DPM-së për ndërprerjen e shërbimit të verifikimit metrologjik të karburanteve, pasi ky shërbim do të ofrohet nga koncesionari, kur përcaktimet e kuadrit rregullator të fushës, ngarkonin DPM për kryerjen e këtij shërbimi.

Pra sipas kësaj shkrese DPM urdhërohet të ndalohej të kryejë shërbimin të cilin e ka detyrim ligjor, vetëm me arsyen e ekzistencës së kontratës koncesionare. Ndërkohë, në kontratën koncesionare është parashikuar që do të kryhen ndryshimet ligjore që të mundësojnë ofrimin e shërbimit nga koncesionari, veprime këto që kanë sjellë të ardhura të munguara në vlerën 62,756 mijë lekë, për periudhën Mars-Dhjetor 2020.

Shoqëria Koncesionare nuk ka publikuar në faqen e saj ëeb, emrat e pikave të karburantit, të cilat nuk kanë kryer pagesën dhe nuk janë verifikuar etj dhe rezultojnë se kanë në përdorim instrumente matës me probleme metrologjike, duke cënuar transparencën dhe rrezikun për veprime abuzive të ndërsjella.

Nga auditimi i “Marrëveshjet Hidrokarbure të lidhura në Republikën e Shqipërisë” në subjektet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Albpetrol Sh.A.

Për periudhën nga identifikimi / propozimi i lidhjes së marrëveshjeve deri në datën 31.12.2023, bazuar në mangësitë e konstatuara është dhënë konkluzion i përgjithshëm i auditimit.

Rezultoi se MIE, AKBN dhe “Albpetrol” Sh.A. nuk kanë programe periodike për të ushtruar kontrolle në subjekte zotërues të lejeve hidrokarbure.

Nga MIE, AKBN dhe “Albpetrol” Sh.A. nuk u paraqit asnjë informacion në lidhje me monitorimin, mbikëqyrjen e përgjithshme të Marrëveshjeve Hidrokarbure apo inspektimet për vendburimet me krahasime apo vlerësime konkrete të treguesve teknologjikë, realizimit të investimeve etj, me planet e punës, buxhetet e fillestare apo të rishikuara, me treguesit e raportuar në situacionet përkatëse, në kundërshtim me marrëveshjen e huasë dhe LM-së respektive, marrëveshjeve të



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

vendburimeve dhe Rregullores së Brendshme të AKBN.

Nga auditimi i formularit të ofertës të paraqitur nga OE, për vendburimet “Povelcë” dhe “Frakull”, në lidhje me vlerësimin e kapaciteteve financiare dhe teknike u konstatua se, kompania nuk rezulton rentabël për vitet 2018 dhe 2019, si dhe nuk ka likuiditete të mjaftueshme për angazhime në sektorin hidrokarbur. Pra, kompania nuk disponon as burime financiare, dhe as kapacitete teknike për të përmbushur detyrimet që burojnë nga Marrëveshja.

“Shell Upstream Albania” B.V nuk ka përmbushur detyrimin që rrjedh nga VKM Nr.652, datë 10.10.2022 ku parashikohet se “Kontraktori do të investojë 1,000,000 USD në projekte të investimeve sociale të lidhura me burimet e rinovueshme dhe tranzicionin energjetik siç ka rënë dakord me MIE”.

Nuk ka negociata mbi kushtet e amendimit të Kontratës me Ndarje Prodhimi (KNP-së). Grupi Negociator i ngritur me Urdhrin nr. 86, datë 04.05.2022, nuk ka përcaktuar me emra konkretë përfaqësuesit e AKBN-së. Amendimi i KNP është dakordësuar dhe nënshkruar në datën 12.05.2022 midis Ministrit dhe Përfaqësuesit Ligjor të SAB 4, AKBN, të cilët kanë filluar zbatimin e Amendimit të KNP pa prituri miratimin e saj me VKM.

Referuar Aneksit C “Procedura kontabël”, të Marrëveshjes Hidrokarbure për Bllokun 4 në lidhje me kostot e kundërshtuara dhe kostot e pezulluara, palët, deri në përfundim të periudhës së auditimit nuk kanë gjetur një zgjidhje në lidhje me statusin e kostove pezull, në vlerën 2,954,441 USD (pagesë e ekspertëve të filialeve të Shell në vende tjera për punën e kryer për llogari të Bllokut 4), si shpenzim i kryer pa ekonomikitet.

Nga AKBN nuk është shfrytëzuar mundësia e trajnimit në institucionet ndërkombëtare të

stafit, e parashikuar në vlerën 600,000 euro në vit, detyrim që rrjedh nga Neni 27.4 të KNP-së Blloku “Dumrea”.

Detyrimi i Bankers për sasinë totale prej 54,009.9 ton naftë bruto, e pa tërhequr për vitin 2019 - 2023, për llogari të Prodhimi Para Ekzistues (PPE) dhe Pjesës së Albpetrol Sh.A. (PPA) sipas Marrëveshjes Hidrokarbure është 18,659,033 USD, vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara për “Albpetrol” SH.A.

Konstatohet se “Bankers Petroleum Albania” Ltd nuk paguan detyrimin për energjinë elektrike ndaj Albpetrol Sh.A., vlerë e cila deri në 31.12.2023 është 1,654 milionë lekë.

Në shoqëritë OSHEE, KESH dhe OST, për detyrimet e ndërsjella midis tyre

Në periudhën nga data 01.01.2020 deri më 30.11.2024, bazuar në mangësitë e konstatuara është dhënë konkluzion i përgjithshëm i auditimit.

Në procesin e verifikimit të paraqitjes dhe evidentimit të detyrimeve të ndërsjella në pasqyrat financiare të shoqërive OSHEE, KESH dhe OST u konstatua mosaprovimi i pasqyrave financiare në afatet ligjore nga Këshillat Mbikëqyrës dhe Asambleja e Ortakëve, të shoqërive OSHEE dhe KESH, gjë e cila vështirëson procesin e konsolidimit të detyrimeve.

Në marrëdhëniet mes palëve, përfaqësuesit juridikë të shoqërive nuk kanë kryer verifikime e vlerësime të detyrimeve të ndërsjella pas vitit 2021, për shqyrtimin e situatës dhe marrjen e masave korrigjuese. OSHEE me KESH, për periudhën deri më 30.11.2024, kanë një diferencë në vlerën 2.2 miliardë lekë. Kjo problematikë është e lidhur me detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet tranzitore të ndarjes shoqërive dhe penalitete të ndryshme midis palëve.

OST me KESH, për periudhën deri më 30.11.2024,



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

kanë një diferencë në vlerën 1.5 miliardë lekë nga faturat të papranuara nga OST, që janë penalitete për moslikujdime në afat, të energjisë elektrike të ofruar për disbalancat, aktivizime rezervë dhe shërbime të tjera.

OSHEE në marrëdhëniet me OST, për periudhën deri më 30.11.2024, kanë një diferencë në vlerën 2.3 miliardë lekë, e cila përbëhet nga faturime të OST-së ndaj OSHEE-së në zbatim të vendimit të ERE Nr. 110, datë 14.05.2018, vlerë e ankimuar në gjykatë.

Mosdakordësitë që shoqëritë e sistemit energjetik kanë mes tyre për llogaritë përkatëse debitore, pengojnë procesin e konsolidimit të detyrimeve të mbartura dhe kompensimin /shuarjen e tyre.

Detyrimet e prapambetura kanë sjellë vështirësi për likuiditetin dhe planet e investimit.

Procesi i konsolidimit të detyrimeve të mbartura është menaxhuar përmes disa marrëveshjeve ristrukturimi afatgjatë mes kompanive. OSSHE, e cila ka barrën e pagesave ndaj KESH-it dhe OST-së, nuk ka bërë një plan pagesash për ndarjen me këste të detyrimeve që kompanitë OSSH, FSHU dhe FTL do duhet t'ia paguajnë, duke mundësuar dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj KESH-it dhe OST-së. Për marrëveshjet që OSHEE ka ndaj KESH-it dhe OST-së, pagesat janë kryer vetëm nga shoqëria OSSH, por edhe ato pagesa që janë bërë, janë jo të plota dhe në mospërputhje me detyrimin e përcaktuar.

OSHEE ka detyrim ndaj KESH-it në vlerën prej 51,438 milionë lekë, nga të cilat 40,853 milionë lekë për fatura shitjeje energjie elektrike dhe 10,584 milionë lekë, penalitete. Për këtë detyrim shoqëritë në vitin 2018 kanë lidhur Marrëveshjen për Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura, e cila është amenduar në vitin 2021. Nga këstet e pagesave të OSHEE, një pjesë është për të shlyer Huanë e Ristrukturimit të KESH-it ndaj BERZH-it. Pavarësisht marrëveshjes dhe amendimit për periudhën 2021-2023, OSHEE nuk ka realizuar grafikun e

pagesave ndaj KESH-it dhe nuk ka dhënë sqarime për shkaqet e mospagesave. Mosplotësimi i detyrimeve nga OSHEE ndaj KESH-it, si dhe situata emergjente ka detyruar Buxhetin e Shtetit të akordojë ndaj KESH-it kredinë 68 milionë euro si dhe shtesë në kapital 20 miliardë lekë. Sigurimi i fondeve shtesë në Buxhetin e Shtetit në këtë periudhë është realizuar duke rritur borxhin e brendshëm dhe, duke ju referuar të dhënave të buletinit të Ministrisë së Financave, kosto mesatare e borxhit të brendshëm për vitet 2022-2024, nuk ka qenë asnjëherë më poshtë se 4 %.

Kosto financiare e likuiditeteve që OSHEE i detyrohet KESH-it, por që u plotësua nga Buxheti i Shtetit nëpërmjet instrumenteve të borxhit të brendshëm, në vlerën 635,196 mijë lekë, vlerësuar si shpenzim pa efikasitet nga Buxheti i Shtetit.

Në Prefekturën e Qarkut Korçë

Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023, kanë rezultuar pasaktësi dhe parregullsi të cilat janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**, konkretisht:

Në zbatimin e procedurave të prokurimit u konstatua se në 2 raste janë vendosur kritere jo në përputhje me shërbimin/investimin e kërkuar, nuk janë të argumentuara dhe çenojnë pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomik (OE) të interesuar; në 2 raste nuk argumentohet mënyra e përlllogaritjes së fondit limit; në 1 rast OE nuk ka përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në ftesën për ofertë; në 2 raste mallrat nuk janë bërë hyrje në institucion brenda afateve të përcaktuara në kontratën e furnizimit.

Në planifikimin e buxhetit u konstatua se nuk ka të dokumentuar kërkesat për nevojat buxhetore nga secili sektor, por PBA-të dhe Plani Vjetor



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

hartohen duke u mbështetur në realizimin e zërave buxhetorë të dy viteve pararendëse; ka diferenca të vlerave të PBA-ve dhe të Projektplaneve Vjetore si në raport me planin fillestar ashtu edhe me atë të ndryshuar, problematika që tregojnë për një planifikim jo të bazuar mbi nevojat e institucionit.

Në lidhje me përputhshmërinë e akteve, konstatohet se për vitet 2022-2023, në disa raste nga Prefekti i Qarkut Korçë është dhënë konfirmimi i bazueshmërisë ligjore për akte të cilat nuk konsiderohen si akte me karakter normativ por si akte administrative individuale dhe kolektive; nuk janë marrë masat për verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve normative brenda afatit të parashikuar në ligj (çdo tre muaj); nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e Organit Këshillues; në 4 raste Prefekti i Qarkut Korçë nuk është drejtuar gjykatës kompetente për të kërkuar deklarimin e pavlefshmërisë së akteve të rishqyrtuara; janë konfirmuar 13 akte normative të cilat nga bashkitë janë dërguar me mangësi në dokumentacionin shoqëruar (5 akte me objekt dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor kullosor pa statusin juridik të pronës, plan vendosjet dhe raportet teknike; 1 akt normativ për dhënien e ndihmës ekonomike pa formularët e aplikimit dhe të përzgjedhjes së përfituesve të kësaj ndihme dhe 7 akte normative për dhënien e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore pa vërtetimin për rënie zjarri, certifikatat familjare, urdhrat për ngritjen e komisioneve për konstatimin e dëmit, procesverbalet për konstatimin e dëmeve etj.); në 6 raste është dhënë konfirmimi mbi bazueshmërinë të akteve të organeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore i pabazuar në ligj dhe në 1 rast, për Vendimin nr. 111, datë 30.06.2022, të Këshillit Bashkiak Korçë është miratuar nisja e punimeve në pronën shtetërore, për të cilin Prefekti i Qarkut Korçë nuk ka konfirmuar apo refuzuar konfirmimin mbi bazueshmërinë ligjore.

Në Prefekturën e Qarkut Fier

Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023, kanë rezultuar parregullsi të cilat janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**, konkretisht:

Në zbatimin e procedurave të prokurimit është konstatuar se në të gjitha procedurat e audituara mungojnë ftesat për ofertë drejtuar OE-së për pjesëmarrje; anëtarët e komisioneve nuk kanë firmosur deklaratat e pavarësisë; nuk është evidentuar përlllogaritja e fondit limit; nuk është bërë inventarizimi i dosjeve të prokurimit; në 1 procedurë OE i shpallur fitues nuk përmbushte të gjitha kërkesat për kualifikim; në 1 procedurë nuk është kryer oponentenca teknike. Në planifikimin e buxhetit u konstatuan diferenca të vlerave të PBA-ve dhe të Projektplaneve vjetore si në raport me planin fillestar ashtu edhe me atë të ndryshuar; nga ana e titullarit dhe e GMS nuk janë bërë analizat e duhura për të hartuar plane masash për arkëtimin e debitorëve të mbartur ndër vite, në vlerën 1,896 mijë lekë për 23 raste;

Në lidhje me përputhshmërinë e akteve, në 7 raste, verifikimet e vendimeve të këshillave bashkiakë me objekt përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile kanë mungesë të dokumentacionit bazë si akti i vlerësimit të dëmit, referencë të gabuar ligjore etj. Për rrjedhojë, nuk ka një vendimmarrje të unifikuar për vendimet të kësaj natyre, duke sjellë si pasojë që verifikimet e ligjshmërisë të jenë kontradiktore për vendime që për nga natyra dhe objekti janë të njëjta; në 1 rast, verifikimi i ligjshmërisë së aktit normativ me objekt "Për përcaktimin e procedurës për negociim me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me bashkinë e Fierit nëpërmjet marrëveshjes për pronat në pronësi të saj" ka mungesë të bazës ligjore që i atribuon bashkisë të drejtën të përcaktojë me vendim këshilli bashkiak procedurat dhe



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

kriteret për përdorimin e procedurës me negociim; në 3 raste, në verifikimet e ligjshmërisë së vendimeve të këshillave bashkiakë që kanë për objekt përditësimin e inventarit të pronave, rezultuan mospërputhje në sipërfaqe mes pasurive të përditësuar të bashkisë dhe statusit juridik të konfirmuar nga ASHK si dhe formulari i përditësimit nuk është plotësisht sipas formatit standard, pasi mungojnë të dhënat mbi faktin e inventarizimit apo jo të pasurive përkatëse me vendim të Këshillit të Ministrave; në 2 raste, Prefekti i Qarkut Fier nuk ka bërë një vlerësim nëse vendimet e këshillave bashkiakë janë në përputhje me Vendimin nr.9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ, mbi rregullat e raportimit të veprimtarive të institucioneve publike para zgjedhjeve; në 1 rast, për verifikimin e ligjshmërisë së planeve sociale, është konfirmuar ligjshmëria e shtyrjes së afatit ndërkohë që kuadri rregullator përcakton se plani social është tre vjeçar dhe nuk parashikon shtyrje të këtij plani, për një vit buxhetor që nuk është përfshirë në planin 3-vjeçar.

Në Prefekturën e Qarkut Shkodër

Në auditimin mbi përputhshmërinë e aktivitetit për periudhën 01.01.2022- 31.12.2023 kanë rezultuar pasaktësi dhe parregullsi të cilat janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**, konkretisht:

Në zbatimin e procedurave të prokurimit konstatohet se dokumentimi i procedurave “blerje me vlerë të vogël” bëhet në mënyrë tepër formale pa përcaktuar kritere kualifikimi dhe specifikime teknike, pa shpallje fituesi dhe përcaktimi të vendit dhe datës së kryerjes së dorëzimit të mallrave e shërbimeve, apo pa u shoqëruar me argumentimin e detajuar të nevojës për shpenzime. Ndër rastet e audituara ka copëzim të fondit për blerje të të njëjtës natyrë, kryesisht ato me vlerë nën 100 mijë lekë,

për të cilat është shmangur realizimi i procedurës nëpërmjet sistemit elektronik. Në lidhje me përputhshmërinë e akteve, për periudhën 2022-2023, nga 46 Vendime të Këshillit Bashkiak të pa konfirmuara nga Prefekti i Qarkut, vetëm në 3 raste janë rikthyer pranë Prefektit Vendimet e rishqyrtuara nga Bashkitë, ndërkohë që për 43 raste të tjera Prefekti i Qarkut nuk ka marrë masa për ndjekjen e mëtejshme të tyre dhe nuk konstatohet të jetë shprehur për këto Vendime as gjatë procesit të verifikimit në vend.

Gjithashtu, konstatohet se nuk ka një korrespondencë të dokumentuar me Bashkitë nëse këto vendime janë anuluar dhe nuk do të vijohet me miratimin e tyre; në 9 raste janë konfirmuar akte normative të cilat nga bashkitë janë dërguar me mangësi në dokumentacionin shoqërues si psh., procesverbale të parregullta të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak ku vihet re se nuk korrespondon numri i anëtarëve të KB në listëprezencë me numrin e atyre që kanë votuar apo me numrin e nënshkruesve të procesverbaleve; në 11 raste janë konfirmuar akte normative për dhënie pronash në përdorim apo heqje nga fondi kullësor pa certifikatë pronësie dhe pa statusin juridik të pronës nga ASHK, si dhe në 9 raste pa shoqëruar me plan vendosje të sipërfaqeve; në 7 raste për vendimmarrje mbi pronat janë dhënë miratime pa realizuar konsultimin publik me komunitetin; për 1 vendim është konfirmuar ligjshmëria, për dëmshpërblimin e përfituesit duke u trajtuar me kuadrin ligjor në fuqi për ndërtimin nga fillimi të banesës, ndërkohë që referuar certifikatës së pronësisë sipërfaqja e dëmtuar është vetëm një pjesë e sipërfaqes totale të objektit; si dhe në 20 raste janë marrë vendime për dhënie për shfrytëzim apo përdorim të pasurive publike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

Në Prefekturën e Qarkut Vlorë

Për periudhën 01.01.2022- 31.12.2023, kanë rezultuar parregullsi të cilat janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**, konkretisht:

Në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk është identifikuar dhe hartuar një strategji për menaxhimin e riskut; nuk është hartuar regjistër risku për gjithë sektorët, duke shfaqur mangësi të aktiviteteve të kontrollit për arritjen e objektivave të sektorëve.

Për veprimtarinë e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile, nuk ka hartuar për vitin 2022 dhe 2023, raport mbi bashkërendimin dhe bashkëpunimin e veprimtarisë me degët territoriale që veprojnë në qark, raport të cilin duhet t'ia paraqiste ministrisë përgjegjëse dhe Komitetit të Mbrojtjes Civile. Mungojnë gjithashtu raportet periodike, të cilat duhet të paraqiteshin në institucionet raportuese dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Në zbatimin e procedurave të prokurimit, për periudhën 2022-2023, në 3 procedura rezulton të jetë shmangur zhvillimi i procedurave standard të prokurimit për blerje me vlerë të vogël, nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve, duke copëzuar fondet dhe duke kryer me procedura shkresore sipas modelit për shpenzimet deri në 100 mijë lekë; në 14 procedura të audituara për procedurat e prokurimit nga KVO nuk janë plotësuar deklaratat mbi konfliktin e interesave.

Në lidhje me përputhshmërinë e akteve, për periudhën 2022-2023, nga auditimi është konstatuar se pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë nuk ka një regjistër në të cilin të pasqyrohet në mënyrë të detajuar aktiviteti i prefektit, në funksion të verifikimit të ligjshmërisë së akteve. Gjithashtu, në 93

vendime të konfirmuara, nga auditimi ka rezultuar se në 60 raste, nga ana e Prefektit është dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e vendimeve edhe në rastet Vendimet e Këshillit Bashkiak nuk dokumentohet me procesverbalin e mbledhjes; në 28 raste Vendimet e Këshillit Bashkiak rezultojnë se janë vendime me karakter individual dhe jo normativ, duke vlerësuar dhe dhënë vlerësim pozitiv për ligjshmërinë e tyre, në mungesë të kompetencës; në 9 raste Vendimet e Këshillit Bashkiak janë konfirmuar edhe pse ato rezultojnë në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor; në 3 raste Vendimet e Këshillit Bashkiak rezultuan në kundërshtim me ligjin material.

Në Prefekturën e Qarkut Tiranë

Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023, kanë rezultuar parregullsi, të cilat janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**, konkretisht:

Në lidhje me përputhshmërinë e akteve, në 37 vendime të Këshillit Bashkiak Kamëz për dhënie ndihme ekonomike, me një vlerë totale prej 13,342 mijë lekë, u konstatua se miratimi është dhënë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 597, datë 04.09.2019; në 5 raste, vendimet për dhënie ndihme ekonomike për arsye shëndetësore janë konfirmuar në kundërshtim me Ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011; në 5 vendime të Këshillit Bashkiak Tiranë, të miratuara për dhënie prone për zhvillim, është konstatuar se ato nuk janë shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, siç janë procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe dokumentet që vërtetojnë regjistrimin e pronës; në 3 raste, vendimet për transferim prone nuk janë miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe nuk janë shoqëruar me procesverbalet përkatëse; si dhe mangësi në dokumentacionin e vendimeve të miratuara nga



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

Këshilli Bashkiak Tiranë për dhënien e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme nga zjarri, përmbytjet dhe tërmetet. Në Bashkinë Kavajë, në lidhje me aktmarrëveshjen ndërmjet Bashkisë dhe zhvilluesit privat për taksën e ndikimit në infrastrukturë, është konstatuar se aktmarrëveshja nr. 227 prot., datë 18.01.2022, që parashikon këmbimin të detyrimit të pagesës së taksës me apartamente banimi (vlera 11,843 mijë lekë), nuk ka mbështetje ligjore, pasi këmbimi i taksës me apartamente nuk është parashikuar në ligj. Në disa raste, u konstatuan mangësi në dokumentacionin e paraqitur për shqyrtimin e ligjshmërisë, si në rastin e VKB-së nr. 67, datë 23.11.2022, për miratimin e fondit të emergjencave civile nga Bashkia Rrogozhinë, ku mungonte preventivi i vlerësimit të dëmeve për dëmshpërblimin e miratuar në shumën 692 mijë lekë, si dhe në VKB nr. 35, datë 26.04.2022, për dhënien e ndihmës financiare për dëmet në banesë, ku mungonte procesverbali i konstatimit të gjendjes si dhe mangësi në dokumentacionin e disa vendimeve të miratuara për fondet e emergjencës, ku disa vendime janë miratuar në kundërshtim me legjislacionin përkatës, siç është rasti i VKB nr. 72, datë 20.11.2023, për miratimin e fondit 3,349 mijë lekë për ndërhyrje në ish Fabrikën e Letrës, që është konfirmuar në kundërshtim me Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, neni 35.

Në Prefekturën e Qarkut Elbasan

Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023, kanë rezultuar pasaktësi dhe parregullsi të cilat janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**, konkretisht:

Në lidhje me përputhshmërinë e akteve, në 21 raste janë verifikuar vendime të këshillave bashkiak të marra 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe Vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; në 3 raste janë konstatuar mangësi në

dokumentacionin bazë të vendimeve të këshillave bashkiakë për përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile, siç janë mungesa e aktit të vlerësimit të dëmit dhe referenca të gabuara ligjore, duke çuar në një vendimmarrje jo të unifikuar për vendimet e kësaj natyre, si dhe kontradikta në verifikimet e ligjshmërisë për vendime që për nga natyra dhe objekti janë të njëjta; në 5 raste për "Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, ndërtesa në pronësi të Bashkisë Librazhd", janë konstatuar mangësi të rëndësishme në dokumentacionin pronësor të detyrueshëm për objektet, si dhe mungesë e informacioneve për mënyrën e përfitimit të pasurive (nëse ato janë transferuar nga njësitë e qeverisjes qendrore në atë vendore, sipas ligjit nr. 8744 datë 22.01.2001), si dhe kanë munguar arsyet e nxjerrjes nga përdorimi, vlerësimet e ekspertëve dhe metodat e propozuara për daljen nga përdorimi, sipas udhëzimit nr. 11, datë 06.05.2016; në 2 raste janë konfirmuar akte normative për "Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive private për realizimin e projekteve me interes publik", pa certifikatë pronësie dhe pa verifikimin e statusit juridik të pronës nga ASHK, pa vlerë preventivi dhe dokumentacionin përkatës.

Në Agjencinë Kombëtarë të Burimeve Natyrore

Nga auditimi i përputhshmërisë për çështje të veçanta që lidhen me procedurat e rekrutimit, dëmshpërblimet e punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna, si dhe me realizimin e aktiviteteve bazuar në objektivat e vendosura nga njësia, në përfundim u konkludua se: sistemi i kontrollit të brendshëm i ngritur në AKBN, nuk ka funksionuar në mënyrën efektive, pasi janë konstatuar parregullsi në çështjet e lidhura me marrëdhëniet e punës, raste të konfliktit të interesit në realizimin e detyrave funksionale; mangësi në zbatimin e kërkesave të legjislacionit mbi procedurat e prokurimit me vlerë të vogël; vështirësi financiare e mungesë e



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

aftësisë paguese; mosderdhje në afat e detyrimeve financiare për t'u paguar duke krijuar efekte financiare, kamatëvonesa dhe penalitete për institucionin.

Në Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT), nga auditimi i përputhshmërisë, për çështje që lidhen me regjistrimin e pasurisë u konkludua sa vijon:

Pasuria nr. 5/561, pjesë e pasurive të UPT, nuk është regjistruar në kartelat pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), megjithëse godinat përkatëse janë regjistruar në kontabilitet që nga viti 1991, si pjesë e aktiveve afatgjata materiale. Gjithashtu, nuk janë finalizuar procedurat e regjistrimit të pasurisë shtetërore në ASHK. Në llogarinë 210, "Toka, Troje, Terrene", UPT nuk ka regjistruar asnjë truall si aktiv afatgjatë material, duke e lënë vlerën e tyre zero në pasqyrat financiare, në kundërshtim me aktet ligjore përkatëse. Gjithashtu, kjo pasuri është regjistruar vetëm si truall në Kadastër, pa pasqyruar në kartelën e pasurisë objektin përkatës, për të cilin ka të drejtën e parablerjes Kryegjyshata Botërore e Bektashinjve, sipas një vendimi të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Në kartelën për kufizimet mbi pasurinë nuk ka dokumentacion për ndërtime të paligjshme të regjistruara, fakt i konfirmuar nga auditimi dhe informacioni nga ASHK. Aktualisht, objektet shërbejnë për administrimin e automjeteve dhe magazinimin e bazës materiale të fakulteteve të UPT-së.

Në Universitetin e Tiranës është kryer auditimi përputhshmërie për çështje që lidhen me kriteret e vlerësimit të kandidatëve pjesëmarrës për rekrutimin e pozicionit të punës "Administrator i Fakultetit të Drejtësisë", u konkluduan pasaktësi dhe mangësi në procedurat e ndjekura nga strukturat përgjegjëse, konkretisht: u identifikuan dy vendime të ndryshme të Bordit të Administrimit (Vendimi nr.56, datë 29.08.2018 "Për miratimin e

kritereve që duhet të përmbushin kandidatët për Administrator të njërive kryesore në UT" dhe Vendimi nr.80, datë 06.02.2019 "Për miratimin e procedurës së punësimit të personelit administrativ në UT"), të cilat kanë krijuar pasiguri në mënyrën e vlerësimit të kandidatëve; si dhe u konstatua mosplotësimi i kriterit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 80/2015 dhe statuti i Universitetit të Tiranës, ku kërkohet që kandidati të ketë formim universitar dhe përvojë pune në fushat përkatëse.

Në Ministrinë e Drejtësisë

Auditimi për kontratën "Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale" ka zbuluar disa parregullsi si vijon:

Zbatimi dhe monitorimi i kontratës: Ka pasur parregullsi në zbatimin dhe monitorimin e kontratës nr. 8383/10, lidhur midis Ministrisë së Drejtësisë dhe kompanive BOE "Soft Solutions", "Fastech" dhe "Ratech". Sistemi i mbikëqyrjes elektronike nuk ka funksionuar siç duhej, dhe nuk është përdorur nga organet e sistemit të drejtësisë, duke e bërë kontratën të paefektshme për aplikimin e dënimit alternativ. Kontrata është ndërprerë më 19.09.2019, duke bërë të pamundur zbatimin e Ligjit nr. 10494 për mbikëqyrjen elektronike. Kontrata ka pasur mangësi në hartim dhe plotësim, duke përfshirë boshllëqe në disa nene dhe shtimin e pikave në kushte të kontratës që janë në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik.

Nuk është zbatuar neni për pronësinë intelektuale dhe dorëzimin e materialeve të kontratës nga BOE tek Ministria e Drejtësisë.

BOE nuk ka siguruar mirëmbajtjen e sistemit për një vit, siç parashikohet në kontratë.

Kontrata nuk është firmosur në çdo faqe nga Nëpunësi Autorizues dhe nuk ka marrëveshje mbi nivelin e shërbimit (SLA). Vetëm disa zëra të faturës janë dorëzuar, dhe ka mungesë të dokumenteve të nevojshme për likuidimin e plotë të kontratës. Mungon akti i kolaudimit për



3.1 AUDITIME TË PËRPUTHSHMËRISË

mallrat dhe shërbimet, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Këto parregullsi kanë cenuar funksionimin e kontratës dhe zbatimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike.

Në Radio Televizionin Shqiptar, auditimi mbi organizimin e Festivalit të 62 Kombëtar të Këngës në RTSH,

Janë zbuluar disa parregullsi si vijon:

Edhe pse organizimi ka qenë përgjithësisht në përputhje me kuadrin rregullator, janë evidentuar disa mangësi të konsiderueshme me ndikim në buxhetin e shtetit. Një ndër parregullsitë ishte mospërfshirja e specialistëve të fushës dhe mospërcaktimi i saktë i detyrave të tyre në grupin e punës së festivalit.

Gjithashtu, hartimi i kërkesave teknike, që është pjesë e platformës regjisoriale, ka kaluar jashtë kompetencave të regjisorit dhe drejtorit artistik, duke sjellë probleme në përgatitjen dhe organizimin e skenografisë. Nga intervistimi me anëtarët grupit të punës, u konstatua se përgatitja e skenografisë nuk është kryer nga grupi i punës. Anëtarët e grupit të punës, për çështjet teknike të skenografisë, në kushtet kur nuk janë të hartuar nga ana e tyre, nuk duhet të kishin pranuar dhe miratuar një dokument i cili është hartuar nga persona apo subjekte të cilët nuk kanë marrëdhënie kontraktuale me RTSH.

Procesi i marrjes së ofertave nuk ka qenë transparent. Mungojnë korrespondencat dhe informacionet për mënyrën e informimit të OE për ofertat, duke shkaktuar paqartësi në procesin e analizës dhe miratimit të ofertave. Për më tepër, preventivi financiar për shpenzimet e festivalit është i pasaktë dhe nuk ofron informacion të mjaftueshëm për vlerat dhe burimet financiare.

Një problem tjetër ka të bëjë me shpenzimet për akomodimin e punonjësve të OE-së. Ky zë nuk ishte parashikuar në kontratë dhe për pasojë shpenzimet për akomodimin janë bërë pa bazë ligjore, duke përbërë dëm për buxhetin e shtetit. Në preventiv janë përfshirë mallra dhe shërbime

të mbivendosura, duke krijuar një dëm të mëtejshëm financiar për shtetin.

“Mbi disponibilitetin në treg dhe trajtimin në linjën e tretë të mjekimit të pacientëve të diagnostikuar me Leucemi Limfoide Kronike (LLC), me barin “Ibrutinib 140 mg”

Ky auditim trajton problemet e hasura nga pacientët me Leucemi Limfoide Kronike (LLC) lidhur me mungesën e trajtimit me ilaçin “Ibrutinib 140 mg” që nga shtatori 2023. KLSH e ka konsideruar këtë auditim të rëndësishëm për shkak të ndikimit të tij në jetën dhe cilësinë e jetës së pacientëve, duke u bazuar në Kartën Shqiptare të të Drejtave të Pacientëve, që garanton të drejtën për mjekim të barabartë dhe pa kufizime, pavarësisht aftësisë për të paguar. Auditimi ka zbuluar se përdorimi i Ibrutinib është ndërprerë pas një kufizimi të vendosur në protokollin e vitit 2018, i cili parashikon që ilaçi të përdoret për një periudhë të kufizuar prej 18 deri në 24 muajsh. Ky kufizim është në kundërshtim me praktikën e mëparshme, ku Ibrutinib është përdorur pa afat, deri në përparimin e sëmundjes ose derisa pacienti nuk mund ta toleronte më. Ky ndryshim është pasuar nga një shkresë e datës 12.09.2023, dërguar nga Shërbimi i Hematologjisë, e cila ka konfirmuar se përdorimi i Ibrutinib tani është i kufizuar në një periudhë 18-24 muajsh. Në këtë shkresë, FSDKSH ka theksuar se ky kufizim është vendosur pas shqyrtimit të kërkesës së Shërbimit të Hematologjisë për heqjen e kufizimit, duke mbajtur në konsideratë udhëzimet e mëparshme dhe praktikën klinike. Megjithatë, ky kufizim kohor për përdorimin e ilaçit nuk është mbështetur nga ndonjë dokument tjetër, dhe ka krijuar pasiguri dhe probleme për pacientët që kishin nevojë për trajtim të vazhdueshëm.

Gjithashtu, auditimi ka evidentuar mungesën e një organizimi të qartë të strukturave përgjegjëse për miratimin dhe monitorimin e protokolleve të përdorimit të barnave.



AUDITIME FINANCIARE

Auditimi financiar është një proces i rëndësishëm që ka për qëllim të vlerësojë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me standardet dhe kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Objektivi kryesor i audituesit është të sigurohet se pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale, nga mashtrimi apo gabimet. Në përfundim, audituesi jep një opinion mbi besueshmërinë e këtyre pasqyrave, duke përdorur një nga llojet e opinionit të parashikuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit si vijon:

Opinion i pakualifikuar, në rastet kur arrihet në përfundimin se llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Opinion i kualifikuar, në rastet kur Pasqyrat Financiare përmbajnë gabime materiale dhe jo të përhapura, që çojnë në ndryshim të rezultatit financiar.

Opinion të kundërt, në rastet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përshtatshme dhe arrin në përfundimin se parregullsitë janë materiale dhe të përhapura.

Refuzim opinionit, në rastet kur audituesi nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi.



35
Auditime



45
Subjekte të audituara

- 3 institucione të pavarura
- 3 institucione qendrore dhe të varësisë
- 39 institucione të vetëqeverisjes vendore



45
Opinione

- 6 opinione të pakualifikuara
- 10 i pakualifikuar me theksim të çështjes
- 28 opinione të kualifikuara
- 1 opinion i kundërt



980
Rekomandime

- 617 masa organizative
- 175 masa disiplinore dhe administrative
- 188 efekte financiare



Efekte financiare
2,218,392 (mijë lekë)



3.2 AUDITIME FINANCIARE

Në Prokurorinë e Përgjithshme

Në auditimin financiar, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023, u konkludua me:

Opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes për pasqyrat financiare, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit (individuale e të konsoliduara), paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar vjetor të këtij institucioni, përveç disa çështjeve jo materiale, për t'u konsideruar nga menaxhimi i institucionit si: regjistrim i pasaktë i vlerës së logarisë 401 "Furnitorë e llogari te lidhura me to" në shumën prej 467 mijë lekë, vlerë e trashëguar që përpara vitit 2010, duke humbur statusin e detyrimeve afatshkurtra; mos pasqyrim i drejtë i vlerës së aktiveve në pasqyra pasi gjatë procesit të kalimit të kapitalit nga një subjekt në tjetrin nuk janë bashkëngjitur dokumentat e plota justifikuese për disa praktika (autorizimi i tërheqjes së aktivitetit, procesverbali i marrjes në dorëzim, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar); keqklasifikim i zërave: "Pajisje elektronike" dhe përlllogaritje e gabuar e amortizimit me normën 20 % dhe jo 25%; aktive të vlerësuar për t'u nxjerrë jashtë përdorimit në vlerën prej 9,138 mijë lekë të paklasifikuara drejtë në llogarinë 24 "Aktive të Qend.te trupëzuara te dëmtuara"; institucioni nuk ka kryer rivlerësimin e aktiveve, të cilat edhe pse në gjendje pune, në kontabilitet rezultojnë më vlerë 0 (zero); vlera 1,725 mijë lekë, është debituar gabim në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe jo në llogarinë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme".

Në Gjykatën Kushtetuese

Në auditimin financiar për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, u konkludua me:

Opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale,

pozicionin financiar vjetor të këtij institucioni, përveç disa çështjeve jo materiale, për t'u konsideruar nga menaxhimi i institucionit si: mangësi në dokumentimin e procesit të planifikimit e nevojave dhe kërkesës për prokurim pasi në dosjen e procedurës së prokurimit "Auditimi dhe vlerësimi i funksionaliteteve dhe sigurisë së sistemeve dhe infrastrukturës IT, nuk është bashkëngjitur analiza/raporti teknik i vlerësimit gjendjes aktuale të sistemeve IT; nuk është bashkëlidhur dokumentacioni i gjeneruar nga sistemi pas verifikimit të kryer; mungon analiza mbi domosdoshmërinë e disponimit të kritereve "kamera termike" (mjetet, pajisjet) nga operatori, të cilat nuk janë në përputhje me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve të parashikuar në preventiv në procedurën e prokurimit "Rikonstrukcion i Sallës së Gjyqeve në Gjykatën Kushtetuese"; nga BOE nuk është paraqitur kontratë bashkëpunimi për zbatimin e punimeve nga njëri prej tyre, i cili sipas marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë 94.3% të punimeve të zbatimit.

Në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë (ILD)

Në auditimin financiar për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2023, u konkludua me:

Opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar vjetor të këtij institucioni.

Në Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Në auditimin financiar për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2021 - 31.12.2023, u konkludua me:

Opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes për pasqyrat financiare, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar vjetor të



3.2 AUDITIME FINANCIARE

këtij institucioni, përveç disa çështjeve jo materiale, për t'u konsideruar nga menaxhimi i institucionit si: disa parregullsi që lidhen me aktivet, pasi Nëpunësit Autorizues, pas përfundimit të proceseve të inventarizimit të aktiveve, nuk kanë nxjerrë urdhra për kompensimin dhe sistemimin e diferencave në aktive, në kundërshtim me të UMF Nr.30, datë 27.12.2011; shuma prej 371 mijë lekë është hequr nga vlera e aktiveve dhe nga regjistri i aktiveve, por nuk është mbështetur me dokumentacionin përkatës dhe justifikues.

Disa artikuj të marra me qira janë përfshirë gabimisht në llogarinë e aktiveve, duke shkaktuar mbivlerësimin e shpenzimeve të amortizimit për vitin 2022 me 29 mijë lekë; disa pasaktësi në zërat kontabël pasi vlerat e aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra nuk janë të njëjta në formatet e pasqyrave financiare të vitit 2022, amortizimi është përlllogaritur gabim, dhe llogaria 214 "Instalime teknike, makineri dhe pajisje është paraqitur e mbivlerësuar për shkak të pasaktësive në përlllogaritjen e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2022; mosrespektim i disiplinës buxhetore pasi 4% e totalit të transaksioneve të likuiduara për vitet 2022 dhe 2023 janë jashtë afatit 30-ditor, 10% e totalit të transaksioneve të likuiduara nuk janë realizuar sipas parimit "hyrje e parë, dalje e parë", si dhe KLP nuk ka dorëzuar raportet e monitorimit për periudhën 2021-2023, siç kërkohet nga Udhëzimi Nr.22, datë 17.11.2016; dhe disa çështje që lidhen me kontrollat e brendshëm siç janë mungesa e Auditit të Brendshëm si Njësi e Pavarur, apo mungesa e Regjistrimit të Riskut.

Në auditimin financiar për pasqyrat financiare vjetore të **Programit "Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech"**, përcaktuar si pasqyra financiare për qëllime të veçanta, (ISSAI 2800), për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, u konkludua me:

Opinion të pakualifikuar pasi nga auditimi nuk u evidentuan pasaktësi ose mospërputhje materiale në kuadër të kornizës së zbatueshme financiare.

Pavarësisht së laboratorët e ngritur në shkollat objekt verifikimi, janë në përputhje me specifikimet teknike të kontratës, në procesin e kalimit dhe marrjes në dorëzim të aktiveve nga njësitë bazë të Qeverisjes Vendore, (pjesa e menaxhimit të aktiveve të shkollave) u konstatuan mospërputhje në zbatimin e pikave 42, 43 dhe 50 të kapitullit "Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara" dhe kapitullit "Veprimet që kryejnë strukturat e Nëpunësit Zbatues", të Udhëzimit 30 datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe njësitë bazë të Qeverisjes Vendore nuk kanë ngritur komisionet e marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara me specialistë të fushës dhe me pjesëmarrje jo më pak se tre persona.

"Për raportimin e kryer për programin kombëtar të modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri (programi)" në Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve,

Për periudhën nga data 01.12.2023 deri në datën 31.12.2023, u konstatuan disa mangësi në zbatimin e kuadrit rregullator të raportimit financiar, të cilat nuk kane ndikuar në dhënien e **opinionit të auditimit pakualifikuar.**

AKUK akordon çdo vit subvencion për Ujësjellës Kanalizimet që janë në vështirësi financiare dhe ekonomike. Rezultoi se, për vitin 2020 janë dhënë 3 lloje subvencionesh (për energjinë elektrike, Covid dhe detyrimet tatimore), ndërsa për vitin 2021 dhe 2023 subvencioni është dhënë për mbulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike. Situata financiare e ujësjellësve është jo e mirë pasi subvencionet janë përdorur për të kryer pagesat e pagave të punonjësve, sigurimeve shoqërore dhe tatimeve të cilat janë



3.2 AUDITIME FINANCIARE

detyrime të mbartura. Gjithashtu konstatohet se ujësjellësit kanë detyrime energjie elektrike të mbartura, duke e rënduar edhe më tepër situatën me kamatëvonesa për mos shlyerje detyrimesh në kohë.

Nga auditimi i veprimeve të kryera me llogaritë 600 “Pagat” dhe 601 “Sigurime shoqërore” konstatohet se kontabilizimet kanë qenë të sakta, përveç një mosrakordimi në listëpagesën e muajit dhjetor, në llogarinë 600 dhe 601, pasi është përfshirë edhe shpërblimi i dy punonjësve si dhe ndalesa përkatëse për tatimin mbi të ardhurat.

Në llogarinë 231 “Kapitale të Trupëzuara” rezulton se, nuk është mbajtur Garancia e Zbatimit të Kontratës në vlerën 5% të vlerës së saj (ose 16,863 mijë lekë) në kundërshtim me nenin 6 “Zbritja e Garancisë së Kontratës” të Kontratës nr. 468, datë 08.02.2021 të Bashkisë Kuçovë, me vlerë 354,143 mijë lekë, për projektin “Ndërtimi i Ujësjellësit Lumas, Pëllumbas, Bardhaj, Sheqes, Vodes, Krekez dhe Koritas, NJ A Lumas, gjithashtu dhe ndërtimi i pjesshëm në fshatin Tapi, NJ A Perondi, Bashkia Kuçovë”. Vlera e raportuar te BB për llog. 231 është 4,718 milionë lekë, ndërkohë që vlera e paguar realisht nga sistemi i thesarit është 4,504,646 mijë lekë dhe vlera prej 213,675 mijë lekë është garancia e kontratave e mbajtur në një llogari në sistemin e thesarit (Llogaria 466).

Në Bashkinë Belsh

Është konkluduar me **opinion të pakualifikuar, me theksim të çështjes** për pasqyrat financiare, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar vjetor të këtij institucioni, përveç disa çështjeve jo materiale, për t’u konsideruar nga menaxhimi i institucionit që lidhen me: mbivlerësimin e vlerave të raportuara të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” për vlerën 38 mijë lekë; pasaktësi në llogaritë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”

të cilat në pasqyrën e pozicionit financiar nuk kuadrojnë, pasi nuk kanë funksionuar duke pasur kundërparti njëra – tjetrën; nënvlerësim të detyrimeve të prapambetura pasi vlera prej 15,252 mijë lekësh nga vendimet gjyqësore të palikuiduara nuk është kontabilizuar; pasaktësi në vlerën e njohur të amortizimit të aktiveve afatgjata në llogaritë 214 “Instalime teknike, makineri dhe pajisje” dhe 218 “Inventari ekonomik për shkak të mosaplikimit të normave të amortizimit sipas llojit të aktivitetit.

Në Bashkinë Bulqizë

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: mbivlerësim i vlerave të raportuara për llogaritë 31 “Materiale” dhe 32 “Inventar i imët”, për vlerat 452 mijë lekë dhe 4,441 mijë lekë; pasaktësi në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” pasi nuk është zbritur vlera prej 225,599 mijë lekë për 1 artikull të transferuar në Ujësjellës Kanalizime Bulqizë; nënvlerësim i fondit të akumuluar të amortizimi për vlerën 200,483 mijë lekë, për shkak të sistemimeve / lëvizjeve midis llogarive të aktiveve; procesi i inventarizimit në Bashkinë Bulqizë nuk është kryer për asnjë nga fazat e tij; nuk është kryer njohja dhe kontabilizimi i vlerës prej 42,132 mijë lekë, e cila përbëhet nga taksa dhe tarifa vendore në vlerën 3,577 mijë lekë, tarifa për licensimin e subjekteve që tregëtojnë hidrokarbure në vlerën 5,800 mijë lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 1,273 mijë lekë si dhe nga qiradhënia e pyjeve e kullotave në vlerën 31,482 mijë lekë.

Në Bashkinë Delvinë

Është konkluduar me **opinion të pakualifikuar** me theksim të çështjes për pasqyrat financiare, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar



3.2 AUDITIME FINANCIARE

vjetor të këtij institucioni, përveç disa çështjeve jo materiale, për t'u konsideruar nga menaxhimi i institucionit që lidhen me: disa pasaktësi në llog.26 "Aktive afatgjata financiare" e raportuar e nënvlerësuar për vlerën 46,500 mijë lekë dhe në llog.215 "Mjete transporti" raportuar e mbivlerësuar për vlerën 6,702 mijë lekë.

Në Bashkinë Devoll

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: në llogarinë 212 "Ndërtime konstruksione" është kontabilizuar vlera 94,936 mijë lekë pa identifikuar objektin që i përket dhe në llog. 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" vlera 572,125 mijë lekë, pa emërtim objekti; llogaria 26 "Pjesmarrje në kapitalet e veta" është raportuar e nënvlerësuar në vlerën 7,762 mijë lekë, për pjesën e aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.a; llogaria 230 "Investime për aktive afatgjata materiale" dhe 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" nuk kuadron me totalin e llog.115 "Nga fondet e veta të investimeve" dhe llog.105 "Teprica e grandeve kapitale të brendshme"; llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" nuk ka të përfshirë vlerën prej 58,553 mijë lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore të biznesit dhe familjarë.

Në Bashkinë Dimal

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: nuk është kryer inventarizimi dhe përditësimi për vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, si dhe vlerat e trojeve, pyjeve dhe kullotave me vlerat aktuale në llogarinë 210 "Toka, Troje, Terrene" dhe llogarinë 211 "Pyje, Kullota, Plantacione"; nuk janë pasqyruar në llogarinë përkatëse aktivet e nxjerra jashtë përdorimit; nuk janë regjistruar në pasqyrat financiare 246

aktive të cilat janë në përdorim të të Bashkisë.

Në Bashkinë Divjakë

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: nënvlerësim i llogarive 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" për vlerën 21,049 mijë lekë, 231 "Investime" për vlerën 5,846 mijë lekë, 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" për vlerën 389,620 mijë lekë për projektet e investimit për të cilët janë pranuar faturat tatimore; mbivlerësim i vlerës së llogarive 210 "Toka, troje, terrene" për vlerën 2,553 mijë lekë, 211 "Pyje, Kullota, Plantacione" për vlerën 2,041 mijë lekë për aktive që duhet të kontabilizoheshin në llog.213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", si dhe llogarisë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" për vlerën 3,293 mijë lekë si pasojë e kontabilizimeve jo të sakta në llog.210 "Toka, troje, terrene" dhe llog.231 "Investime".

Në Bashkinë Dropull

Është konkluduar me **opinion të pakualifikuar** me theksim të çështjes për pasqyrat financiare, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar vjetor të këtij institucioni, përveç disa çështjeve jo materiale, për t'u konsideruar nga menaxhimi i institucionit që lidhen me, reflektimin në pasqyrat financiare të 25,311Ha (hektarë), nga të cilat 10,641Ha të sipërfaqeve të pyjeve, 14,911Ha të sipërfaqeve të kullotave, 28.1Ha Tokë joproduktive dhe 30Ha shkëmbore e ujore, të kaluara në favor të saj sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive.



3.2 AUDITIME FINANCIARE

Në Bashkinë Finiq

Është konkluduar me **opinion të pakualifikuar** me theksim të çështjes, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar vjetor të këtij institucioni, përveç disa çështjeve jo materiale, për t'u konsideruar nga menaxhimi i institucionit që lidhen me: përfshirjen në llogarinë 202 "Studime dhe kërkime", të vlerës 8,030 mijë lekë, e cila është e paanalizuar sipas studimeve dhe projekteve; marrjen e masave ligjore për njohjen në kontabilitet të të gjithë aktivet në pronësi të bashkisë; analiza në relacione shpjeguese të pasqyrave financiare të vlerës 99,236 mijë lekë në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione"; saktësimin e vlerës së llogarisë 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT", për pagesa për objektet "Rikonstruksioni i rrugës Dermish-Navaricë" dhe objektin "Rikonstruksioni i rrugës Karroq"; si dhe zhbllokimin e fondeve 17,467 mijë lekë, për 19 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Finiq dhe më pas saktësimin llogarisë 466, "Kreditorë për mjete nën ruajtje".

Në Bashkinë Fushë Arrëz

Është konkluduar me **opinion të pakualifikuar** me theksim të çështjes, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar vjetor të këtij institucioni, përveç disa çështjeve jo materiale, për t'u konsideruar nga menaxhimi i institucionit që lidhen me: mbivlerësim i llogarisë 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje" për vlerën 9,194 mijë lekë pasi nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë; nënvlerësim i llogarisë 211 "Pyje, Plantacione" pasi nuk është kontabilizuar vlera e 394 pronave

me sipërfaqe 65,287,847 m² pyje e kullota, të regjistruara në vitet 2012-2013 nga ish bashkia Fushë Arrëz dhe ish Komuna Qaf Mali.

Në Bashkinë Gjirokastrë

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** me theksim të çështjes, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar vjetor të këtij institucioni, përveç disa çështjeve jo materiale, për t'u konsideruar nga menaxhimi i institucionit që lidhen me: vlerësimin dhe më pas kontabilizimin e 10 aktiveve afatgjata Materiale të llojit kullotë, pyll, truall dhe ndërtesë, të pajisur me certifikata pronësie; kryerja inventarizimit, vlerësimit dhe regjistrimit në ASHK për pronat e transferuara me VKM, si dhe plotësimi i informacionit mbi situatën reale të tyre (sa nga këto prona janë të zëna, sa janë funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë); kontabilizimi i detyrimeve për taksa dhe tarifave vendore, nga të cilat janë kontabilizuar vetëm 15,931 mijë lekë.

Në Bashkinë Gramsh

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: llogaria 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara" është nënvlerësuar në vlerën 9,400 mijë lekë pasi nuk janë kontabilizuar aktivet e vlerësuar si të dëmtuara nga procesi i inventarizimit; llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" është nënvlerësuar në vlerën 66,975 mijë lekë, pasi nuk janë kontabilizuar detyrimet nga debitorët për taksat dhe tarifave vendore; janë raportuar jo saktë vlerat: 11,217 mijë lekë në llogarinë 211 "Pyje, kullota, plantacione", 376,538 mijë lekë në llog.212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 343,864 mijë lekë llogarinë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore, të të trashëguara nga bilanci i ish-komunave Gramsh e paanalizuar për efekt të



3.2 AUDITIME FINANCIARE

inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit; pasaktësi në vlerën e raportuar të llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” prej 0 lekë, kur në fakt për vitin 2023 ka kontrata në proces për të cilat janë kryer pagesa për vlerën 56,918 mijë lekë dhe që i përkasin llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione”; llogaritë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” raportohen më vlerë 0 lekë dhe nuk kuadrojnë me llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 693 mijë lekë.

Në Bashkinë Has

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: vlera e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime, prej 1,791 mijë lekë, që i përket 27 projekt-studimeve për investime të kryera në vitet e mëparshme, nuk është kapitalizuar sipas llojit të aktiveve materiale, pavarësisht se punimet kanë përfunduar; në Sektorin e Financës mungon libri i madh për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera nga ditarët deri në bilanc si dhe libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël; llogaria 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën prej 914 mijë lekë është trashëguar nga konsolidimi me ish komunën Gjinaj, për të cilën nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson; llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” paraqitet në vlerën prej 18,586 mijë lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në vlerën 19,759 mijë lekë, pasi kjo gjendje duhet të pasqyrohet detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara; në inventarët kontabël të aktiveve materiale, gjendje në fund të vitit 2023 në llog: 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 1,074 mijë lekë; 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën

966,447 mijë lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,627,644 mijë lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 75,859 mijë lekë, janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv; si dhe nuk është kryer inventari fizik i aktiveve materiale dhe jo materiale si dhe aktiveve afatshkurtra të Bashkisë Has dhe 4 Njësive Administrative.

Në Bashkinë Klos

Është konkluduar me **opinion të pakualifikuar** me theksim të çështjes, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar vjetor të këtij institucioni, përveç disa çështjeve jo materiale, për t’u konsideruar nga menaxhimi i institucionit që lidhen me:

llogaria 210 me vlerë prej 31,683 mijë lekë për projekt-studime rezultoi e pa kapitalizuar sipas aktiveve përkatëse të investuara; llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që në llog. 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në mbyllje të vitit 2023 janë përfshirë 15 fatura të papaguara në vlerën 89,311 mijë lekë të krijuara në periudha kohe para nëntor-dhjetorit (60-ditë), të cilat duhet të ishin pjesë e gjendjes e llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”, pasi klasifikohen si detyrime të prapambetura; procesi i klasifikimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi dhe asgjësimi nuk ka përfunduar; nuk është kryer inventarizimi fizik i AAGJM të kontabilizuara në llogaritë: 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; në librin e aktiveve të hartuar, për një pjesë të aktiveve afatgjata vlerat e tyre janë regjistruar jo në vitin e krijimit por në vitet kur ka filluar kontabilizimi, ku pasqyrohen vlerat e shtuara nga konstruksionet apo mirëmbajtjet.



3.2 AUDITIME FINANCIARE

Në Bashkinë Konispol

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 412 mijë lekë; llogaria 7206 “Inventar i imët” është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 25,040 mijë lekë; si dhe llogaria 26 “Aktivet Afatgjata Financiare” është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 449 mijë lekë.

Në Bashkinë Krujë

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar për vlerën 23,447 mijë lekë, pasi nuk janë kontabilizuar detyrimet e papaguara për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit; llogaria 202 “Studime dhe projekte”, është mbivlerësuar për vlerën 6,235 mijë lekë për një projekt të vënë në zbatim; vlera prej 1,359 mijë lekë e trashëguar nga ish Komunat, nuk është analizuar dhe nuk ka informacion nëse këto projekte janë vënë në zbatim; nga llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, nuk është zbritur vlera për 2 artikuj për ujësjellës-kanalizimeve në shumën 28,866 mijë lekë që janë transferuar UK Kuçovë; në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, nuk është pasqyruar vlera prej 3,500 mijë lekë pjesë e aksioneve të Klubit Sport “NAFTËTARI”; si dhe nuk janë kontabilizuar si detyrim i lindur në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për 2 raste në vlerën 15,442 mijë lekë.

Në Bashkinë Kurbin

Është konkluduar me **opinion të pakualifikuar** me theksim të çështjes për pasqyrat financiare, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në

të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar vjetor të këtij institucioni, përveç disa çështjeve jo materiale, për t’u konsideruar nga menaxhimi i institucionit që lidhen me: njohjen dhe raportimin në pasqyrat financiare të gjithë pronave të paluajtshme që Bashkia Kurbin disponon; të sipërfaqes së pyjeve dhe kullotave prej 11,350 ha, transferuara brenda juridiksionit të territorit të bashkisë Kurbin, dhe ndjekjen e hapave ligjore për pajisjen me certifikatë pronësie; verifikimet dhe saktësimet përkatëse në terren, për të ngritur dhe përditësuar regjistrin për fondin pyjor, pasi të dhënat që disponohen i referohen statistikave para vitit 1990; si dhe hartimit të planeve të mbarështimi për ekonomitë pyjore, dhe regjistrimin e tyre në regjistrat kadastral.

Në Bashkinë Libohovë

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: llogaria 202 “Studime dhe kërkime” pasqyrohet në aktive afatgjata jomateriale në vlerën 5,645 mijë lekë, me emërtimin “vlerë tjetër” e pa analizuar se çfarë përfaqëson; llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” e aktiveve afatgjata materiale, ka të paanalizuar vlerën 4,687 mijë lekë; llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” ka të paanalizuar vlerën 8,296 mijë lekë, pa emërtim objekti dhe vendodhje; për katër zëra sipas klasave respektive të llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”, në shumën totale 19,372 mijë lekë, nuk disponohet dokumentacion kontabël mbi origjinën e tyre; për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” 215 “Mjete Transporti” për vitin ushtrimor 2023 nuk është përlllogaritur vlera e amortizimit; llogaria 210 “Toka, troje, terrene” nuk paraqet gjendjen reale, pasi në këtë llogari nuk përfshihet vlera e trojeve nën objekt, si trualli i godinës së bashkisë, trojet e ndërtesave të shkollave, kopshteve e çerdhe, shtëpisë së



3.2 AUDITIME FINANCIARE

kulturës, të zyrave në Njësive Administrative etj.; llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”, në vlerën 0 lekë, nuk paraqet gjendjen reale pasi në këtë llogari nuk pasqyrohet vlera e 12,140 ha prona, nga të cilat 7918 ha kullotë verore, 3006 ha pyll, 1027 ha kullotë dimërore, 146 ha tokë inproduktive, 42 ha djerrë, 1 ha tokë buke, 814 ha kullotë dimërore, 864 ha kullotë të transferuara sipas VKM-ve përkatëse; llogaria 212 “Ndërtime e Konstruksione” nuk paraqet gjendjen reale të pasurisë së njësive vendore, sepse për një pjesë e objekteve të mbartura nga ish komunat nuk disponohet dokument pronësie; llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nuk paraqet vlerën reale pasi nuk është kontabilizuar vlera e rrugës prej 29 km, kaluar në pronësi të Bashkisë Libohovë me VKM nr. 915, datë 11.11.2015; llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” nuk paraqet vlerën reale pasi nuk është bërë kontabilizimi i vlerës 14,265 mijë lekë, mallra të ardhur pa pagesë nga FSHZH.

Në Bashkinë Mat

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: nuk janë hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara për 3 (tre) ndërmarrje varësie që janë: Ndërmarrja e Shërbimeve, Klubi i Futbollit Burrel dhe Tregu Mat; llogaria 101 “Teprica” në fund të vitit 2023 është mbivlerësuar për vlerën 550,100 mijë lekë; llogaria 210 “Toka, troje, terrene” është paraqitur e mbivlerësuar në vlerën 22,942 mijë lekë e cila përbëhet nga 5 aktive, të cilat duhet të regjistroheshin në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”; llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 50,486 mijë lekë si detyrim i konstatuar i abonentëve familjarë.

Në Bashkinë Memaliaj

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: teprica e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që referuar analizës së debitorëve, ata paraqiten në vlera të konsiderueshme dhe duhet të ishin të kontabilizuar në këtë llogari dhe në llog. kundërparti 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, në vlerën prej 783 mijë lekë; llogaritë 423, 429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba”, llogaria 431 “Tatime e taksa”, llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën prej 10,431 mijë lekë duhet të klasifikohen në llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, e cila është paraqitur në mënyrë të pasaktë në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 783 mijë lekë, për të cilën nuk ka shpjegim se çfarë përfaqëson, pasi nuk pasqyron detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara, por ende të papaguara, kur vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2023 është 61,416 mijë lekë dhe në mosrakordim me gjendjen në llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, e cila paraqitet e pasaktë në vlerën prej 11,214 mijë lekë.

Vlera e mbetur në fund të vitit 2023 prej 3,911 mijë lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 20 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktivitetit ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme dhe për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur; në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 119 mijë lekë dhe llogarinë 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 277 mijë lekë, nuk janë të analizuara me emërtesa se çfarë përfaqësojnë; llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e



3.2 AUDITIME FINANCIARE

AQT”, raportohet gabim me vlerë 0 lekë, pasi për projektin e investimit me objekt: “Ndërtimi i Ujësjiellit Rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qësarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj” vazhdojnë punimet dhe vlera pjesore e kësaj kontrate e financuar prej 174,224 mijë lekë, duhet të ishte kontabilizuar në këtë llogari dhe jo në llogarinë “213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”.

Në Bashkinë Peqin

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Llog. e Aktiveve Afatgjata Materiale, 210 “Toka troje terrene”, llog.212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llog.213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, janë pasqyruar me vlerën historike kontabël pa u krahasuar me inventarin fizik; llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar për vlerën 6,151 mijë lekë, për moskontabilizim të detyrimeve të papaguara për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit; llog.202 “Studime dhe projekte”, llog.212 “Ndërtesa e konstruksione”, llog.213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, janë mbivlerësuar pasi nuk janë kontabilizuar transferimet e 36 artikujve që i përkasin inventarit të Ujësjiellit Kanalizime Peqin, në shumën 589,691 mijë lekë.

Në Bashkinë Përmet

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: llogaria 24 “Aktive afatgjata” është nënvlerësuar në vlerën 45,478 mijë lekë pasi nuk janë kontabilizuar aktivet e vlerësuar si të dëmtuara nga procesi i inventarizimit sipas relacionit të datës 31.12.2023; llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar në vlerën 2,208 mijë lekë pasi në këtë llogari nuk janë kontabilizuar detyrimet nga dhënia me qira

e aktivet që posedon Bashkia Përmet; llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në vlerën 41,840 mijë lekë duhet të kontabilizohet në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”; detyrimet e prapambetura duhet të regjistrohen në debi të llog. 4342 “Operacione me shtetin” (të drejta) dhe në kredi të llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” dhe 467 “Kreditorë të tjerë”; llogaritë: 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 7,182 mijë lekë, 210 “Toka, troje, terrene” në vlerën 5,804 mijë lekë, 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 472,818 mijë lekë dhe 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 949,127 mijë lekë, raportohen me vlera të trashëguara nga bilanci i ish-komunave Përmet të paanalizuara në numër objektësh për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit; llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” është nënvlerësuar në vlerën 11,134 mijë lekë pasi nuk është kontabilizuar 1 kontratë punimesh në proces me objekt “SEMP Piskovë + kanal ujitës”.

Në Bashkinë Pukë

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: diferenca midis vlerave të raportuara në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës në llogaritë e pasivit, në shumën 30,633 mijë lekë, e cila në fakt duhet paraqitur 54,359 mijë lekë; në llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është përfshirë vlera prej 85,000 mijë lekë me emërtimin e objektit “Ujësjielli i Gjegjanit” si kapitalizim i punimeve pa u marrë në dorëzim si investim; është mbajtur jashtë kontabiliteti objekti “Ujësjielli i fshatit Luf- Bashkia Pukë” me vlerë 96,256 mijë lekë, i cili është marrë në dorëzim nga bashkia Pukë me datë 13.11.2023; llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” nuk paraqet një pasqyrim real të gjendjes faktike të aktiveve pasi, për disa kontrata kanë përfunduar punimet dhe janë kryer pagesa në vlerën prej 73,804 mijë



3.2 AUDITIME FINANCIARE

lekë, por vijojnë të paraqiten si aktive në proces; nuk është kryer i plotë dhe i dokumentuar procesi i inventarizimit të aktiveve.

Në Bashkinë Pustec

Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, është konkluduar **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Teprica e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” paraqitet në vlerën 7,047 mijë lekë, e cila nuk rakordon me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit; llogaria 231 “Shpenzime për investime në proces” paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që konstatohen 2 kontrata investimesh të pa mbyllura, ku vlera pjesore e paguar prej 159,504 mijë lekë duhet të ishte kontabilizuar në këtë llogari dhe jo në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; përlllogaritja e amortizimit të aktiveve të llogarisë 218 “Inventar Ekonomik” është bërë mbi bazën e normës së gabuar të amortizimit prej 10% dhe jo 20% apo 25%, siç i takon këtij grup aktivesh; pasaktësi në vlerën e raportuar të llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” e cila paraqitet në vlerën 29 mijë lekë, por nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson, ndërkohë që detyrimet ndaj shtetit nga debitorët në mbyllje të vitit rezultuan në vlerën 17,983 mijë lekë që i korespondojnë gjendjes së llogarisë kundërpartit 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit.

Për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, është konkluduar **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Llogaria 470 “të ardhura për t’u marrë” është nënvlerësuar për vlerën e llogarisë kundër parti llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 22,486 mijë lekë; Mos pasqyrim të vlerës së

aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në rubrikën “pakësime” të pasqyrave Format 7/a e 7/b për shumën 2,196 mijë lekë; Llogaria 26 “Aktivet Afatgjata Financiare”/“pjesëmarrje në kapitalin e vet” është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat Format 1 e “pozicionit financiar” dhe Format 7/a e 7/b për vlerën 64 mijë lekë; Llogaria 218 “inventar ekonomik” është mbivlerësuar për shumën 12 mijë lekë që përfshin 39 aktivet të cilat klasifikohen “fond biblioteke-libra” dhe i përkasin llog.212/nënlllog.2120 “krijim fond biblioteke” me koeficient amortizimi prej 5%, për të cilën llog.2120 “krijim fond biblioteke” është nënvlerësuar për të njëjtën vlerë 12 mijë lekë. Me përfundimin e procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të dëmtuara në vlerën 2,196 mijë lekë, nga ana e SFB në hartimin e pasqyrave financiare nuk është bërë shkarkimi nga kontabiliteti i tyre në llogaritë përkatëse.

Në Bashkinë Selenicë

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, nuk është kryer pakësim i vlerës 93 mijë lekë, që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit sipas procesverbaleve përkatëse; llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” është nënvlerësuar në vlerën 9,057 mijë lekë për mos kontabilizim të aktiveve të vlerësuar si të dëmtuara nga procesi i inventarizimit; llogaria 4342 “Operacion me shtetin (të drejta)” paraqitet në vlerën 87,407 mijë lekë dhe nuk kuadron me llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”; për llogarinë 210 “Troje, toka, terrene” është përlllogaritur me pa të drejtë normë amortizimi në vlerën 58 mijë lekë; llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është e mbivlerësuar në vlerën 526,501 mijë lekë,



3.2 AUDITIME FINANCIARE

e cila i përket aktiveve të transferuara në Shoqërinë Ujësjetllës Selenicë; llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 1,440 mijë lekë; nuk janë identifikuar dhe paraqitur në numër për efekt të inventarit fizik të tyre llogaritë e regjistruara si vlera të trashëguara nga bilanci i ish-Komunave Sevaster, Brataj, Kotë, Armen dhe Vllahinë si vijon:

Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 31,079 mijë lekë; llog. 210 “Tokë, troje, terrene” në vlerën 140,307 mijë lekë kosto historike; llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën prej 282,322 mijë lekë; llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 1,570,622 mijë lekë; llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” në vlerën 11,853 mijë lekë; llogaria 215 “Mjete transporti” në vlerën 11,678 mijë lekë dhe llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 38,702 mijë lekë; llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” është nënvlerësuar në vlerën 530 mijë lekë për vlerën e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Selenicë; në llog.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” evidentohen vlera të kontabilizuara me emërtimin “Pa origjinë” apo “Kaluar gabim nga të ardhurat”, në vlerën prej 764 mijë lekë, për të cilat nuk disponohet asnjë dokumentacion kontabël, dhe në këtë llogari, përfshihet dhe vlera prej 18,800 mijë lekë, e cila i përket ngurtësimeve për 43 objekte të cilave u ka kaluar afati i garancisë dhe Bashkia Selenicë nuk ka kryer asnjë veprim për zhblokimin e këtyre fondeve.

Në Bashkinë Tepelenë

Është konkluduar me **opinion të pakualifikuar**, me theksim të çështjes për pasqyrat financiare, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar

vjetor të këtij institucioni, përveç disa çështjeve jo materiale, për t’u konsideruar nga menaxhimi i institucionit që lidhen me: përfshirjen në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm të vlerës prej 2,785 mijë lekë e pa transferuar nga Ujësjetllës-Kanalizime, e taksave dhe tarifave vendore të mbledhura si detyrim i vitit 2023; përlllogaritjen e amortizimit në masën 15% për projektin “Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ilegale” raportuar në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”; si dhe respektimin e afatit ligjor 30 ditor për likuidimin e faturave pasi u konstatuan 50 raste faturash me vlerë 43,646 mijë lekë, me urdhërpagesa mbi afatin ligjor 30 ditor.

Në Bashkinë Tropojë

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Llogaria 467 “Kreditor të tjerë” është pasqyruar më pak për vlerën 32,666 mijë lekë; llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” është pasqyruar më shumë për vlerën 33,117 mijë lekë; llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është pasqyruar më shumë për vlerën 22,449 mijë lekë; Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, është pasqyruar më pak për vlerën 6,748 mijë lekë; Llogaria 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to” është pasqyruar më pak për vlerën 5,021 mijë lekë; Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, është pasqyruar më pak për vlerën 4,960 mijë lekë; Llogaria 215 “Mjete transporti” është pasqyruar më tepër për vlerën 3,452 mijë lekë; Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” është pasqyruar më pak për vlerën 1,522 mijë lekë; Llogaria 327 “Inventar i imët” është pasqyruar më pak për vlerën 307 mijë lekë.



3.2 AUDITIME FINANCIARE

Në Bashkinë Pogradec

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Bashkia Pogradec për vitin 2023 nuk ka hartuar pasqyrat e konsoliduara, për tre njësit e vartësisë: Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekracionit, Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës Punëve Publike dhe Qendra Arsimore.

Në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” janë përfshirë 41 projekte për të cilat drejtoria e financës nuk ka bërë sistemimin e veprimit kontabël të llogarisë, duke ia bashkëngjitur vlerës së investimit; bashkia nuk ka një regjistër kontabël, analitik të aktiveve për llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 3,874 mijë lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 698,494 mijë lekë; 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 115,508 mijë lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,077,389 mijë lekë; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 11,985 mijë leke dhe 215 “Mjete transporti” në vlerën 9,276 mijë lekë.

Referuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, Bashkia Pogradec është aksionare me 36.10% tek Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Pogradec Sh.A., kapital në vlerë monetare prej 36,100 mijë lekë, i cili nuk është paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël; në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa në vlerën 143,834 mijë lekë, si dhe debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 40,440 mijë lekë. Bashkia Pogradec në datën 01.01.2023 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 347,178 mijë lekë e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta, dhe në planin e buxhetit vjetor 2023 nuk ka planifikuar një grafik për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura por ka likuiduar vlerën prej 146,099 mijë lekë.

Në Bashkinë Vau Dejës

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare të vitit 2022, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: Vlera e raportuar në pasqyra, për llog. 210 prej 6,208 mijë lekë, llog. 211 në vlerën 113,039 mijë lekë, llog. 212 për rritjen prej 25,482 mijë lekë nga viti i kaluar, dhe llog. 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, nuk janë mbështetur në dokumente analitike justifikuese; vlera e raportuar në pasqyrat e pozicionit financiar, për llogaritë: 214 “ Instalime teknike, makineri e pajisje”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat për vlerën 52,772 mijë lekë; llog. 215 “Mjete transporti”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, për vlerën 42,580 mijë lekë; llog. 218 “Inventar ekonomik” e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, për vlerën 104,505 mijë lekë, nuk janë mbështetur në dokumente analitike justifikuese; llog. 202 “Studime dhe kërkime” është mbivlerësuar në vlerën 65,649 mijë lekë; dhe llog. 26 “Aktive afatgjata Financiare”, është nënvlerësuar në vlerën 413,912 mijë lekë.

Në Bashkinë Kamzë

Në auditimin financiar, për periudhën 01.01.-31.12.2023, u konkludua me **opinion të kualifikuar**, bazuar në disa parregullsi materiale dhe jo të përhapura si vijon: uditimi, paraqiten si më poshtë: në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” janë kontabilizuar 14 aktive me certifikatë pronësie jo me vlerë të drejtë; në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” janë kontabilizuar pa certifikatë pronësie 14 asete me vlerë 1,003,473 mijë lekë të cilat janë projekte investimi të përfunduara; dhe në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” janë kontabilizuar pa certifikatë pronësie 97 asete me vlerë 2,841,437 mijë lekë të cilat janë projekte investimi të përfunduara.



3.2 AUDITIME FINANCIARE

Në Bashkinë Vorë

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune” janë përfshirë me pa të drejtë: aktivi “Pemë dekorative” me kosto historike 796 mijë lekë, si dhe aktivi “Program kompjuteri Financa 5” me kosto historike në vlerën 390 mijë lekë; në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” u konstatuan fatura të pa likuiduara të viteve 2006 - 2020, për vlerën 11,506 mijë lekë; në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vlerën totale prej 363,290 mijë lekë të vitit 2023, rezultoi 1 subjekt me emër, datë dhe vlerë detyrimi të njëjtë, në total 888 mijë lekë si dhe vlera prej 60 mijë lekë nuk ka destinacion subjekti apo individ i kreditor; detyrimi tatimor i papaguar në Bashkinë Vorë më 31.12.2023, rezultoi në vlerën 376,289 mijë lekë, kundrejt 302,825 mijë lekë të raportuara nga Bashkia Vorë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore të biznesit ose familjarë në shumën 462,440 mijë lekë, si dhe mos raportimi për detyrimet e prapambetura që i përkasin periudhës 2004 - 2020 në shumën 27,219 mijë lekë, në total 73,463 mijë lekë, nuk paraqet situatën reale të debitorëve.

Në Bashkinë Lezhë

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Llogaria 101 është raportuar në bilanc e mbivlerësuar për vlerën 825 mijë lekë; llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është mbivlerësuar

për vlerën 25,108 mijë lekë e cila përbëhet prej 17 faturave tatimore për mallra, të cilat janë regjistruar në llogarinë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”; njohja dhe raportimi i detyrimeve të prapambetura në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” nuk kryhet në këtë llogari dhe vlera e saj rezultoi e mbivlerësuar për vlerën 165,278 mijë lekë.

Në Bashkinë Kukës

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Pasaktësi dhe mangësi në llogaritë e AAGJ-së; Llogaritë “Studime dhe kërkime” (7,421 mijë lekë), “Toka, Troje, Terrene” (202,601 mijë lekë), “Pyje, Plantacione” (22,187 mijë lekë), dhe të tjera, nuk rakordojnë me vlerat përkatëse në bilanc; Inventarizimi i aktiveve për llogaritë “Materiale”, “Inventar i imët” dhe “Inventar ekonomik” (28,854 mijë lekë) ka filluar pas mbylljes së vitit 2023 dhe ka mangësi dokumentacioni; Llogaria 231 ka përfshirë 51 aktive (257,136 mijë lekë) që duhet të ishin shpërndarë në llogaritë përkatëse. Llogaritë “Kreditorë të ndryshëm” (86,669 mijë lekë) dhe “Debitorë të ndryshëm” (28,128 mijë lekë) kanë paraqitur vlera të pasakta. Po ashtu, Bashkia Kukës nuk ka transferuar investime (13,546 mijë lekë) në Ujësjetllës Kanalizime Sh.A. Kukës. Këto mangësi kërkojnë korrigjime në pasqyrat financiare.



3.2 AUDITIME FINANCIARE

Në Bashkinë Mirditë

Është konkluduar me **opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes** për pasqyrat financiare, pasi ato paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të njësisë vendore, përveç disa çështjeve jo materiale si vijon: gjendja e llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione" paraqitet me vlerë 6,284 mijë lekë, pa ndryshime nga viti i mëparshëm, pasi nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi nga komisioni i ngritur nga Titullari i Institucionit. Po ashtu, në analizën e llogarisë 212 "Ndërtesa Konstrukione" me vlerë bruto 2,360,758 mijë lekë, u konstatuan aktive që nuk janë inventarizuar fizikisht për të verifikuar përputhshmërinë e gjendjes fizike me atë kontabël. Gjendja e llogarisë 466 "Kreditore për mjete në ruajtje" përmban detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, të cilat kanë kaluar afatin e përcaktuar në kontrata, por mbeten të paqartë për shkak të mungesës së informacionit, me vlerë 103,894 mijë lekë.

Në Bashkinë Poliçan

Është konkluduar me **opinion të pakualifikuar** për pasqyrat financiare, pasi ato paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të njësisë vendore, përveç disa çështjeve jo materiale, të cilat duhen mbajtur në konsideratë nga drejtimi, si: mungesë analizash për llogarinë "Studime dhe kërkime", garanci të skaduar për disa objekte pa masa verifikimi nga Bashkia Poliçan, dhe mbivlerësim i llogarisë "Inventar ekonomik" për disa aktive të klasifikuara gabim. Po ashtu, vlera e pyjeve dhe kullotave të Bashkisë Poliçan nuk është pasqyruar siç duhet, dhe shumë pasuri të transferuara nuk janë regjistruar ende.

Në Bashkinë Kuçovë

Është konkluduar me **opinion të kualifikuar** për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" është nënvlerësuar për 23,448 mijë lekë për shkak të moskontabilizimit të detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit; Llogaria 202 "Studime dhe projekte" është mbivlerësuar për 6,235 mijë lekë, dhe vlera prej 1,359 mijë lekë nga ish-komunat është pa analizuar; Vlera 7,992 mijë lekë për sistemim varrezash është kontabilizuar gabim në llogarinë 210 "Toka, troje, terrene"; Llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" nuk ka zbritur vlerën prej 28,866 mijë lekë për artikuj të transferuar në UK Kuçovë; Nuk është pasqyruar vlera prej 3,500 mijë lekë për aksionet në Klub Sport "NAFTËTARI" dhe nuk janë kontabilizuar detyrimet e kreditëve prej 15,442 mijë lekë në llogarinë 467 "Kreditore të ndryshëm".



AUDITIME TË KOMBINUARA

Referuar ISSAI 4000, kur një auditim i përputhshmërisë kombinohet me një auditim financiar, konkluzioni/opinionimi mbi aspektin e pajtueshmërisë duhet të ndahet qartë nga opinionimi mbi pasqyrat financiare.

Ligji(et) dhe rregulloret e identifikuara si kritere auditimi, duhet të përmbajnë të gjitha ligjet dhe rregulloret që mund të ndikojnë në rezultatet e auditimit.

Në përfundim të auditimeve të kombinuara, audituesi del me opinion mbi pasqyrat financiare dhe opinion mbi përputhshmërinë.



35
Auditime



35
Subjekte të audituara

- 3 institucione të pavarura
- 6 institucione qendrore
- 25 institucione të vetëqeverisjes vendore
- 1 inst. i administrimit të aseteve



70
Opinione/konkluzione financiare

- 7 opinione të pakualifikuara
- 4 të kualifikuara me theksim të çështjes
- 50 opinione të kualifikuara
- 3 të kundërt
- 6 konkluzione



35
Opinione/konkluzione përputhshmërie

- 2 opinione të pakualifikuara
- 32 opinione të kualifikuara
- 1 opinion i kundërt



1604
Rekomandime

- 8 përmirësime ligjore
- 850 masa organizative
- 442 masa disiplinore dhe administrative
- 304 efekte financiare



Efekte financiare
5,345,696 (mijë lekë)



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

Në Ministrinë e Mbrojtjes

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, për periudhën 01.07.2021 - 30.06.2023, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: mospërputhje të shpenzimeve mes deklarimit në pasqyrat financiare dhe degës së thesarit për llogaritë 602 “Blerje mallra e shërbime”; 605 “Transferime për Organizatat Ndërkombëtare”; dhe 606 “Transferta Paguara nga Institucione tjera e Organizata e Pushtetit Vendor”; mospërputhje në vlerat e deklaruara në llogarinë 437-438437-438 “Organizma të tjera shtetërorë”; diferenca në llogaritë 215 “Mjete transporti”, 218 “Inventar ekonomik”, si dhe diferenca materiale mes gjendjes së aktiveve të evidentuar nga Komisioni i inventarizimit me gjendjen e aktiveve të pasqyruara në formatin 7/a të pasqyrave financiare.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e aktivitetit, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Mos respektimi i disiplinës buxhetore duke vijuar me projekte të pa parashikuara në PBA konkretisht: 10 projekte në shumën 1,089,925 mijë lekë gjatë vitit 2021; 13 projekte investimi në shumën 1,175,011 mijë lekë, gjatë vitit 2022;

Shkelje të rregullave të prokurimit publik: duke mos argumentuar kriteret e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi në 10 raste, nga 45 procedura prokurimi të audituara; duke kualifikuar operatorë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura; në 3 procedura, në Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU) në përzgjedhjen e procedurave të prokurimit dhe kriterëve kualifikuese nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP-së.

Shkelje të konstatuara gjatë zbatimit të punimeve: për pasaktësi në punime të pakryera,

por të likuiduara dhe mbivendosje të zërave të punimeve në vlerën 4,268,613 lekë; mos respektim i parashikimeve ligjore në zbatimin e kontratës “Hartim Projekt-preventivi ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në Bazën Ajrore Kuçovë” dhe ‘Hartim Projekt-ide paraprake për kampusin e ri të fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të AFA” duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 15,888 mijë lekë;

Shkelje dhe mangësi në programe/projekte sa i takon: raportimit dhe justifikimit të shërbimeve të paguara, duke përfshirë pagesa të padrejta për menaxherët e projektit dhe financierët; menaxhimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit (dëm ekonomik në vlerën 18,396 mijë lekë në projektin “TO BE READY”); mungesave në dokumentacion për të vërtetuar ligjshmërinë e proceseve; si dhe mospërputhje në vlerat e deklaruara për rimbursim në FLC, duke shkaktuar rritje të pajustificuar të fondeve të paguara nga buxheti i shtetit.

Në Akademinë e Sigurisë (AS)

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura, si vijon: mos njohja si shpenzime të periudhave të ardhshme, e detyrimit të krijuar prej vitit 2019 në vlerën 5,416 mijë lekë dhe si pasojë mos raportimi i kësaj vlere si detyrim i prapambetur; përllogaritje e gabuar e amortizimit: për zërin “Toka, Troje, Terrene” ku në vite është llogaritur amortizimi me normën 20% mbi këtë vlerë, me ndikim negativ në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit, pasi për zërin truall/tokë nuk llogaritet amortizim; për zërin “Inventar ekonomik” vlera e amortizimit të akumuluar është më e lartë se kosto historike për 24 aktive duke pasqyruar këto të fundit me vlerë negative për 323 mijë lekë; pasqyrim jo i drejtë i aktiveve pasi rikonstruksioni i tarracës



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

së një godine me vlerë 490,147 lekë është klasifikuar në llogarinë 602 “Blerje mallra e shërbime” dhe jo si “Investime kapitale” duke mos u reflektuar në vlerën e aktivitetit përkatës; etj.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e aktivitetit, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Mungesë koherence dhe harmonizimi midis kuadrit ligjor dhe atij nënligjor në fuqi, për çështje që lidhen me përzgjedhjen e personelit akademik me gradë policore ku referuar VKM-së nr.320, datë 02.6.2021, pika 15 ndryshohet si vijon: “Personeli akademik me gradë policore përzgjidhet nga radhët e punonjësve të policisë së shtetit, sipas kriterëve të përcaktuara në statutin e AS dhe emërohet nga Rektori, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Gjithashtu edhe personeli akademik me gradë sipas statutit të strukturave përfituese emërohet nga Rektori me propozim të titullarëve të strukturave përfituese sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit midis titullarit të AS dhe titullarit të strukturave përfituese, sipas të njëjtës VKM.

Likuidime të kryera në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, si pasojë e trajtimit të pagesave ndaj pedagogëve të jashtëm si honorare dhe jo si paga, duke ndryshuar kështu edhe aplikimin e ndalesave mbi pagë, si dhe mosdeklarimin/pagimin e tatimit nga dy ose më shumë punësime.

Shkelje gjatë zbatimit të punimeve/kontratave:

-Për kontratën “Për blerje uniformash dhe elementesh të tjerë përbërës të tyre”, mallrat e marra në dorëzim, gjendje në magazinë, nuk ishin në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e vlerësimit, duke shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën 1,820 mijë lekë;

-Për kontratën “Për blerje këpucë, atlete sportive”, mallrat e marra në dorëzim, gjendje

në magazinë, nuk ishin në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e vlerësimit, duke shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën 1,969 mijë lekë;

- Për kontratën me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering), procedurat e menaxhimit dhe kontrollit të ushqimit të dorëzuar dhe të marrë në dorëzim, shfaqen parregullsi dhe mangësi duke shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve në shumën 9,450 mijë lekë; në vijim të kësaj kontrate, nuk u gjenden evidenca të shpërndarjes së bonove të ushqimit në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi sa i takon mënyrës së funksionimit, pranimit, administrimit kontrollit dhe zbatimit të kontratës së “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”; gjithashtu u konstatua se është përfshirë me pa të drejtë në këtë kontratë edhe “Instituti i Përgatitjes së Qenve të Policisë”, i cili nuk është pjesë e marrëveshjes kuadër autoritetet/entet kontraktore, dhe si pasojë vlera për shërbimin e të cilit prej 1,705 mijë lekë është likuiduar jashtë parashikimeve të kushteve të kontratës.

Në Autoritetin e Konkurrencës (AK)

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2023, u konkludua me:

Opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes për pasqyrat financiare të vitit 2023, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar vjetor të këtij institucioni, përveç disa çështjeve jo materiale, për t’u konsideruar nga menaxhimi i institucionit që lidhen me dokumentimin e procesit të asgjësimit të aktiveve si dhe mungesës së Regjistrimit të Aktiveve.

Opinion i pakualifikuar për auditimin e përputhshmërisë së aktivitetit pasi në tërësi ka rezultuar se veprimtaria e AK-së është në përputhje, me të gjitha aspektet materiale, me legjislacionin për prokurimin publik; ndërsa



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

raste të konstatuara me shkelje nën materialitet konsistojnë në: mospasqyrimin e të dhënave të plota mbi realizimin e procedurave të prokurimit me vlerë nën 100 mijë lekë në regjistrin e realizimit të prokurimeve; mos mbajtja në konsideratë e kritereve të thjeshtuara të pranimit për kapacitetin ekonomik dhe financiar me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm; gabime të mbartura edhe në aktet e KVO; një rast mos konvertimi i monedhës së ofertës; etj.

Në Komisionerin për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP)

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2023, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, bazuar në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si: Keqklasifikime të llogarive kontabël në rastet kur: vlera prej 1,128 mijë lekë është njohur pa të drejtë si shpenzim korrent dhe kontabilizuar në llog. 602 “Blerje mallra e shërbime” kur në fakt rezultoi shpenzim për investim; vlera totale prej 5,972 mijë lekë është klasifikuar në llog. 203 “Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme” dhe 202 “Studime dhe kërkime”, kur në fakt duhet të ishte klasifikuar në llog. 230; vlera prej 547 mijë lekë për “Programin Alfa” dhe një “Program të trashëguar nga Ministria e Mbrojtjes”, është klasifikuar në llog. 202 “Studime dhe kërkime, kur në fakt i përket llog. 214; përlllogaritje e gabuar e amortizimit mbi vlerën kontabël të llogarive dhe jo në bazë grupi për secilën nga aktivet; shpërblime të trajtuara të shkëputura nga paga, duke ndikuar në llogaritjen jo të saktë të shpenzimeve për pagë; etj.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e aktivitetit, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si: Janë zhvilluar gjithsej 211 procedura

administrative, hetime dhe inspektive, por Komisioneri nuk ka shpallur asnjë akt administrativ përfundimtar për këto procedura, duke shkelur kështu Kodin e Procedurës Administrative dhe Rregulloren e Brendshme të Zyrës së Komisionerit, në kundërshtim me ligjin, duke shkaktuar pasiguri në proceset e vendimmarrjes.

Mangësi të rëndësishme në vendimmarrjen e Komisionerit, ku janë konstatuar shkelje të procedurës së konstatimit të kundërvajtjes administrative dhe mungesë të dokumentacionit të nevojshëm për sanksionet administrative. Në disa raste, procedurat e hetimit nuk janë zbatuar siç parashikohet dhe mungojnë urdhërat për kryerjen e hetimeve administrative, me ndikim në integritetin e procesit ligjor.

Një tjetër konstatim është shpërblimi financiar i dhënë për stafin e Zyrës së Komisionerit, duke përfshirë Komisionerin, i cili ka shpërblyer veten dhe stafin me shuma të konsiderueshme: 816 mijë lekë për vitin 2021, 1,150 mijë lekë për vitin 2022 dhe 2,400 mijë lekë për vitin 2023. Sidoqoftë, për vitin 2022 dhe 2023, nuk është mbajtur dhe llogaritur tatimi mbi të ardhurat e përfituara, në kundërshtim me dispozitat e ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

Në lidhje me kontratat për shërbime dhe furnizime, rezultuan mospërputhje në dokumentacionin e kontratave dhe në origjinën e produkteve të blera, si në rastin e kontratës për rikonstruksionin e ambienteve të KDIMDP, për komponnetin “Blerje e aspiratorit profesional”, për të cilin mungonte certifikatat e origjinës dhe certifikata e cilësisë.

Përdorimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël ka shmangur procedurat konkurruese nëpërmjet copëzimit të kontratave të ngjashme, ku për vitin 2021 janë përdorur 10 procedura me vlerë 4,947 mijë lekë, për vitin 2022, 11 procedura me vlerë 7,529 mijë lekë dhe për vitin 2023, 12 procedura me vlerë 9,500 mijë lekë.



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

Në Ministrinë e Brendshme

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

diferenca të pakontabilizuara në detyrimet prapambetura sa i takon: vlerës prej 13,365 mijë lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në shumën 136,143 mijë lekë për shpenzimet e energjisë elektrike të cilat MB ka kundrejt OSHEE, për periudhën prej vitit 2015 deri në muajin qershor 2022; mos njohja e shpenzimeve sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, për likuidimin e vendimeve gjyqësore në shumën 17,408 mijë lekë; mungesë informacioni mbi planin e amortizimit të kredisë së marrë për projektin e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës (LAMP) nga IBRD prej vitit 2013, reflektuar në llogarinë 17 "Huatë Afatgjata", në shumën prej 34,978 mijë lekë; proces i papërfunduar inventarizimi dhe vlerësimi të aktiveve, pasi nuk janë pasuar nga proceset e daljes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të atyre aktiveve të vlerësuar si të tilla, në shumën 4,830 mijë lekë; për vitin 2021 dhe 2022, Kryetari i komisionit të inventarizimit është përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe anëtarë janë specialistët e Sektorit të Financës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011, i ndryshuar, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e aktivitetit, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Keqmenaxhimi i pronës publike, sa i takon procesit të tjetërsimit të pronës shtetërore ku zhvillonte veprimtarinë e saj, ish- QSHAMT, i cili rezultoi i kryer në mungesë të analizës së detajuar të shkaqeve dhe relacioneve kosto-

përfitim, duke mbartur rrisqe për një proces vendimmarrjeje të paargumentuar dhe të pastudiuar.

Mos respektimi i dispilinës buxhetore, sa i takon:

ndryshimit të destinacionit të fondeve të rindërtimit në vlerën prej 259,699 mijë lekë dhe përdorimit të tyre për qëllime të ndryshme nga sa parashikuar në kuadrin ligjor në fuqi, duke u përdorur për rindërtimin e një godine për QSHAMT-në, të amortizuar në fakt përpara ngjarjes së tërmetit; realizimit të investimeve pa i parashikuar më parë në PBA, konkretisht për 23 projekte në vitin 2022 dhe 15 projekte të realizuara gjatë vitit 2023; detyrime të prapambetura të pa rakorduara me Ministrinë e Financave dhe si pasojë diferenca të pa kontabilizuara në vlerën 13.9 milionë lekë për vitin 2022 dhe 7.3 milionë lekë për vitin 2023.

Menaxhim i fondeve buxhetore jo me efikasitet dhe ekonomikitet, në rastet e: likuidimit të faturave të konsumit të energjisë elektrike përtej afateve ligjore, duke krijuar kosto shtesë për buxhetin e shtetit prej kamatëvonesave në shumën 68,627 mijë lekë; pagesës së tarifave përmbartimore në vlerën 2,953 mijë lekë, për likuidimin e shpenzimeve gjyqësore. Për këto vlera nuk ka fatura tatimore dhe rrjedhimisht nuk është mbajtur tatimi në burim në vlerën 443 mijë lekë; dëmshpërblimit të gjyqëfituesve të larguar nga puna në vlerën 84,238 mijë lekë, përfshirë këtu edhe kamatëvonesa në sigurime shoqërore dhe TAP, të paregjistruara në kontabilitet.

Shkelje të rregullave të prokurimit publik, në rastet e: blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar ku procedurat janë realizuar kryesisht 1-2 ditë para datës së udhëtimit, duke rritur kështu koston e biletës; mos verifikimit të plotësisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit.



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

Në Agjencinë e Prokurimit Publik

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë, në institucionin e Agjencisë së Prokurimit Publik, për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2023, u konkludua me:

Opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar vjetor të këtij institucioni.

Opinion të pakualifikuar të përputhshmërisë së aktivitetit, pasi në tërësi ka rezultuar se sistemi i mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në Agjencinë së Prokurimit Publik është në përputhje, me të gjitha aspektet materiale, me legjislacionin për prokurimin publik.

Ndërsa raste të konstatuara me shkelje nën materialitet konsistojnë në: mungesë harmonizimi dhe koherencë ligjore, në afatet e ankimimit administrativ në fushën e prokurimeve publike për mbrojtjen dhe sigurinë, midis Ligjit nr.36/2020 dhe VKM-së nr.1170, për rregullat e prokurimit në këtë fushë; mospërputhje ndërmjet pikës 3 të nenit 20 të Ligjit Nr.9874 dhe pikës 5.1 të Dokumenteve Standarde të Ankandit, që ka sjellë problematika praktike në zbatimin e prokurimeve; si dhe mungesë harmonizimi ndërmjet udhëzimeve të Ministrisë së Turizmit dhe ligjit për ankandet publike, ku disa kritere për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë janë në kundërshtim me legjislacionin dhe kufizojnë konkurrencën.

Disa problematika në procese koordinuese, si mungesë koordinimi dhe komunikimi ndërmjet APP dhe Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), çka ka sjellë pasaktësi dhe vonesa në monitorimin e kontratave koncesionare dhe mungesë procesesh hetimi administrativ për këto kontrata; mungesa e monitorimit të procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare nga APP për shkak të mungesës së specialistit IT për administrimin e Sistemit të Informacionit të

Klasifikuar (SIK) dhe mungesës së dokumentacionit për përfundimin e implementimit të këtij sistemi; mungesa të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve të specializuara në sektorin e Verifikimit të Procedurave të Koncesioneve/PPP, për shkak të vendeve vakante të paplotësuara dhe mungesës së trajnimeve për stafin në proceset koncesionare.

Disa problematika në administrimin e dokumentacionit dhe dosjeve, si mungesa e inventarizimit dhe arkivimit të rregullt të dosjeve të prokurimeve publike, në dosjet e personelit etj.

Në Institutin e Statistikave

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2023, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: norma e amortizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale (në llogaritë 203, 214, 215, 218) nuk është përlllogaritur sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi; në llogarinë 42 "Detyrime ndaj personelit" kontabilizimi i detyrimeve për qira ambientesh ka sjellë paraqitje jo të saktë të llogarive përkatëse të detyrimeve ndaj personelit dhe ndaj të tretëve; në pasqyrën e pozicionit financiar janë konstatuar teprica në llogaritë 435 "Sigurime shoqërore" (3,960 mijë lekë) dhe 436 "Sigurime shëndetësore" (488 mijë lekë), të cilat nuk përputhen me listën e pagave të deklaruar në sistemin e tatimeve C@TS; (iv) në llogaritë 437, 438 "Organizma të tjerë shtetërore" janë konstatuar teprica prej 6,443 mijë lekë, e cila duhet të ishte kontabilizuar në llogaritë 435 dhe 436 për sigurime shoqërore dhe shëndetësore; në llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" është konstatuar kontabilizimi i gabuar i detyrimeve për paga, dieta, kompensime dhe shpërblime; investimet nga



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

buxheti dhe organizatat e huaja të përfunduara nuk janë kapitalizuar brenda periudhës ushtrimore të vitit 2023.

Mospërputhje midis pasqyrës së performancës dhe aktit të rakordimit të thesarit, ku “Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve” janë paraqitur në shumën 48,487 mijë lekë, ndërsa pasqyrat financiare në 37,704 mijë lekë, duke krijuar një diferencë prej 10,783 mijë lekë; Grantet e huaja janë paraqitur vetëm në vlerën që është përdorur gjatë vitit ushtrimor dhe nuk janë njohur në pasqyrat financiare në total, duke sjellë një pasqyrim jo të drejtë të këtyre fondeve; Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë kontabilizuar gabim në nënlllogaritë e shpenzimeve për blerje mallrash dhe shërbimesh, duke sjellë denatyrim të shpenzimit të kryer.

Detyrimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale, në vlerën totale 1,633 mijë lekë, nuk janë kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare; Sa i takon sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, janë konstatuar parregullsi dhe mangësi që përfshijnë: mos hartimin e raporteve të monitorimit të aktiviteteve për njësitë shpenzuese, mungesën e dokumentacionit të dosjeve të personelit, dhe dokumentet për pagesat e anketuesve.

Opinion të kualifikuar të përputhshmërisë e aktivitetit, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Parregullsi në procedurat e prokurimit pasi janë konstatuar raste ku urdhri i titullarit të AK për ngritjen e komisionit të vlerësimit për procedurat e prokurimit të realizuara (p.sh., “Blerje licenca”, “Blerje tonera”, “Furnizime me automjete me qira për CENS”) ka përfshirë të njëjtët zyrtarë që janë angazhuar në procese të tjera, duke cenuar parimin e shmangies së konfliktit të interesit; anëtarët e grupit të përlllogaritjes së fondit limit nuk kanë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit;

ka munguar dokumentimi i formularit për zbatimin e kontratës; ka munguar argumentimi i kriterëve të kualifikimit në disa procedura prokurimi; ka mangësi në protokollimin dhe arkivimin e dosjeve të prokurimit në sistemin SPE.

Parregullsi që lidhen me shpenzimet operative dhe përfshijnë trajtimin me catering për trajnimet e Cens-it, ku rezultoi se nuk është ngritur një komision për marrjen në dorëzim të shërbimit, dhe mungon procesverbal i datës për marrjen në dorëzim dhe listat e pjesëmarrësve; shpenzimet për dieta jashtë vendit dhe për bileta avioni janë likuiduar në mospërputhje me marrëveshjet me donatorët dhe legjislacionin shqiptar, duke cenuar kriteret e përcaktuara në VKM nr. 870, datë 14.12.2011, si dhe pagesat për pjesëmarrje në konferenca janë kryer pa mbështetje ligjore dhe rregullatore.

Parregullsi në aktivitete të kontrollit, sa i takon procesit të hyrje-daljeve nga magazina, i cili mbahet manualisht dhe jo në sistemin Alpha ëeb, duke mbartur risqe operationale që lidhen me kontrollin e shpenzimeve dhe inventarëve; kontrata për ruajtjen e sigurisë fizike të ambienteve të INSTAT ka pasur mospërputhje mes kushteve të përcaktuara dhe shërbimit të ofruar, si dhe magazina e sigurimit për pajisjet e Cens-it nuk ishte e pajisur me sistem kondicionimi dhe kishte lagështi. Sigurimi i ambientit për pajisjet e Cens-it 2023 gjithashtu ka qenë në kundërshtim me Ligjin nr. 140/2020 “Për censin e popullsisë dhe banesave”, pasi INSTAT ka miratuar një kontratë qiraje për një ambient të papërshtatshëm për ruajtjen e pajisjeve.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Në auditimin financiar dhe përputhshmërisë së aktivitetit u konkludua me:

Opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të këtij institucioni, përveç disa çështjeve jo materiale, për t'u konsideruar nga menaxhimi i institucionit si: klasifikimi jo i saktë i aktiveve afatgjata materiale, pasi gjatë periudhës 2021-2023, rezultuan aktive të regjistruara gabim; disa aktive afatgjata materiale në vlerën totale prej 34,993 mijë lekë, janë regjistruar gabimisht si "Inventar i imët" në llogaritë 31 dhe 32, si dhe regjistruar pa të drejtë 3 sisteme në vlerën 13,884 mijë lekë; debitorët dhe gjobat e pa arkëtueshme, prej 32,990 mijë lekë, që para vitit 2006, dhe për të cilat KQZ nuk ka ndjekur të gjitha rrugë gjyqësore për të mbledhur këtë shumë; klasifikimi i gabuar i softuerëve si: "Moduli i Akreditimit të Vëzhguesve", "Moduli i regjistrimit të subjekteve zgjedhore", "Moduli i EDMS dhe e-akte", dhe "Moduli i aplikacionit mobil të KQZ" janë regjistruar gabimisht në llogarinë 218 "Inventar ekonomik", ndërkohë që ato i përkasin llogarisë 203; si dhe klasifikimi i gabuar i pajisjeve kompjuterike dhe orendive të zyrës, të cilat janë regjistruar në llog. 218 "Inventar ekonomik" dhe jo në llog. 214 "Instalime teknike, makineri dhe pajisje"; mosaplikim i saktë i normës së amortizimit për disa aktive.

Opinion të kualifikuar të përputhshmërisë së aktivitetit, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Mos respektimi i disiplinës buxhetore në rastet kur: janë likuiduar 24 urdhër shpenzime, në shumën 11,195 mijë lekë, për vitet 2022 dhe 2023 në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh; KQZ ka detyrime të cilat janë krijuar për shkak të furnitorëve të pa likuiduar për periudhën 2001-2010, për të cilat janë parashkruar afatet për pagesë; penalitetet e vendosura ndaj subjekteve zgjedhore për periudhën 2020-2022 janë 42,925 mijë lekë, për të cilën nuk ofrohet garanci mbi saktësinë e saj për shkak të mos kontabilizimit dhe mënyrës së mbajtjes së të dhënave; Për penalitetet e vendosura para vitit 2020, mungon

gjurma e auditimit, duke sjellë paraqitjen e një situatë jo reale të detyrimeve të prapambetura; Nuk janë pasqyruar në kontabilitet detyrimet për dëmshpërblimin e gjyqfitesve të larguar nga puna në shumën 11,527 mijë lekë, si dhe gjoba + kamatëvonesa në sigurime shoqërore dhe TAP në shumën 2,062 mijë lekë.

Struktura organike e KQZ ka 26 vende vakante dhe ka lëvizje të shpeshta të punonjësve; Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka kryer aktivitet auditimi dhe Komiteti i Auditit të Brendshëm nuk ka funksionuar sipas kërkesave ligjore.

Në Akademinë e Shkencave

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2023, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

(i) mungesa e inventarizimit të aktiveve, për asnjë nga vitet objekt auditimi, duke çuar në pasiguri për të dhënat mbi gjendjenkontabel të aktiveve të regjistruara në llogaritë 212, 214, 215, dhe 218; (ii) mungesa e Regjistrimit të Aktiveve, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"; keqklasifikimi i Aktiveve në llogarinë 212 "Ndërtime dhe Konstrukione" si për fondin e bibliotekës dhe për shitje, të cilat nuk janë ndarë siç duhet në nënllogaritë respektive.

Mungesa e realacionit shpjegues për shifrat e rakorduara me Thesarin, për më tepër mbi diferencat që rezultojnë midis shifrave të regjistruara dhe vlerave reale, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi; si dhe problematika të lidhur me linjat e raportimit të kostove, për qendrat, projektet dhe studimet e financuara, pasi ka munguar një strukturim i qartë dhe i përditësuar i informacionit mbi shpenzimet e aktiviteteve të financuara, duke sjellë paqartësi në pasqyrimin e kostove dhe me ndikim edhe në saktësinë e pasqyrave financiare.



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e aktivitetit, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon:

Shkelje të rregullave të prokurimit publik si: mungesa e regjistrimit të parashikimit të procedurave të prokurimit me vlera të mëdha ku parashikohen afatet e hartimit dhe miratimit nga titullari i autoritetit kontraktor; ndryshime të paargumentuara në regjistrin e parashikimit disa herë për vitet 2021, 2022 dhe 2023, pa argumentim dhe miratim nga titullari i autoritetit kontraktor, të cilat si pasojë as nuk janë dërguar në Degën e Thesarit, duke përfshirë 4 herë në vitin 2021, 3 herë në vitin 2022 dhe 3 herë në vitin 2023; shkelje në procedurën e “Blerje materiale anticovid-19”, ku 6 ofertat e para të kualifikuara rezultuan më vlerë më pak se 50% e fondit limit, në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”; mungesa e ftesave dhe dokumentacionit në procedurën “Blerje Dinamike të Biletave për Transportin Ajror”; mungesa e procesverbaleve për llogaritjen e fondit limit, pasi për disa procedura, si "Blerje pajisje Elektronike" dhe "Blerje reagentësh për studime sero-epidemiologjike", nuk ishin dokumentuar siç duhet llogaritjet e fondit limit si dhe mungonin procesverbalet e përlllogaritjes së tij.

Problematika në drejtim të sistemit të kontrollit të brendshëm që lidhen me: mungesën e procesit të inventarizimit për vitet 2021, 2022 dhe pjesërisht për vitin 2023, ku grupi i inventarizimit nuk ka realizuar kontrollin në laboratorët pranë qendrave kërkimore dhe në inventarin personal të stafit, në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi; mungesën e raportimeve të kostove të projekteve, pasi në projektet “NanoAlb”, “Imunologji” si dhe në marrëveshjet e bashkëpunimit, mungon dokumentimi i kostove për secilën fazë të projektit. Nuk ka gjurmë të procesit të raportimit të kostove dhe as analize të kostos

përfitim përpara përzgjedhjes së projekteve; parregullsi në nënshkrime kontratash, ku përfaqësuesi i ASH figuron si Kryetar i Akademisë së Shkencave, ndërkohë që ai ka qenë i ngarkuar me rolin e Nënpunësit Autorizues, sipas shkresës nr.9/1 prot., datë 10.01.2020.

Problematika në drejtim të shpenzimeve pa efektivitet për projekte si: “Studimi sero-epidemiologjik” dhe “ArkeoBylis”, pasi dokumentet mbi të cilat është kryer lëvrimi i fondeve rezultuan të mjaftueshme për të justifikuar këto shpenzimet; shpenzime të paargumentuara për projektet e Qendrës Kërkimore Nanoteknologjike NanoAlb, projekt për të cilin janë shpenzuar 9,048 mijë lekë deri në fund të vitit 2023, në mungesë të dokumentacionit të plotë dhe pa arritje të rezultateve të matshme përfundimtare; si dhe shpenzime të pa justifikuara për projektet “Vitrocet” dhe “Seroimunologjia” që arrijnë në 23,388 mijë lekë, për shkak të mungesës së dokumenteve justifikues dhe raportimeve përfundimtare.

U konstatua mungesë dokumentacioni për projektet “Vitrocet” dhe “Seroimunologjia” sa i takon përfundimit të fazave të studimit si dhe mungesë e komunikimit dhe koordinimit me institucionet përgjegjëse si Ministria e Shëndetësisë; mungesa e dokumenteve për menaxhimin e burimeve njerëzore të angazhuar në këto projekte.

Në Bashkinë Berat

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kundërt për pasqyrat financiare bazuar në parregullsitë materiale dhe të përhapura, si: pasaktësi në llogaritë e klasës 2 dhe mos dokumentim të gjithë aktiveve sipas kuadrin ligjor për regjistrimin, kontabilizimin dhe administrimin e pasurive publike; nuk janë kryer sistemitet kontabël për regjistrimin e pjesëmarrjes 65.32% në kapitalin e aksioneve tek



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

“Ujësjetllës Kanalizime Berat Sh.A. me vlerë 572,787 mijë lekë; nuk janë marrë masat për arkëtimin e detyrimeve nga tatim-taksat në vlerën totale 581,285 mijë lekë.

Opinion i të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Berat, bazuar në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si: Në 2 raste janë konstatuar punime të pakryera me një dëm ekonomik në vlerën 853 mijë lekë; në 1 procedurë prokurimi, KVO nuk ka kualifikuar operatorin ekonomik me ofertë më ulët, për devijime të vogla të cilat nuk cenojnë zbatimin e kontratës, duke sjellë mbishpenzim në vlerën 224 mijë lekë; në 7 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit; në 3 raste procedura duhej të ishte ndarë në lot-e, pasi punët dhe shërbimet objekt prokurimi nuk janë të njëjta; në 1 rast të blerjes së karburantit nuk është dokumentuar llogaritja e fondit limit; në 4 raste kualifikimi i OE-së është bërë në kushtet e mos përmbushjes së të gjitha kriterëve të veçanta të përcaktuara në DST.

Në lidhje me çështjet e urbanistikës, u konstatuan në 2 raste ku nuk janë respektuar distancat nga trupi i rrugës, nga kufiri i pronës dhe lartësia maksimale e lejuar e objektit; në 5 raste, projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqëruar; në 2 raste nuk janë kërkuar dhe respektuar mendimet e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit; në 2 raste nuk janë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me kontributin që sektori privat duhet të japë ndaj fondit publik të banesave sociale; dhe në 1 rast IMTV, nuk ka kryer detyrat funksionale në lidhje me inspektimin e objekteve përpara dhe gjatë ndërtimit.

Në Bashkinë Cërrik

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes për pasqyrat financiare, bazuar në: pasaktësitë e konstatuara në llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, në të cilën nuk janë kryer sistemimet kontabël për investimet kapitale në ish-Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Sh.A., në vlerën 79,086 mijë lekë dhe në Shoqërinë “Sport Klubit të Futbollit “Turbina” Sh.A., në vlerën 100 mijë lekë; për mungesë të identifikimit dhe emërtesave të gjithë investimeve të kryera gjatë vitit 2023, të paraqitura në llogaritë e aktiveve: 210 “Toka, Troje, Terrene”, 211 “Pyje, Plantacione”, 212 “Ndërtesa Konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”. Gjithashtu, në llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezulton se, nuk është zbritur vlera e investimeve të kryera në ujësjetllës, të cilat duhet të transferoheshin tek Ujësjetllës Kanalizime Sh.A., Cërrik, për 33 objekte në vlerën 974,489 mijë lekë.

Opinion të kualifikuar mbi përputhshmërinë e aktivitetit, bazuar në parregullsi të cilat janë materiale por jo të përhapura, në çështjet e procedurave të prokurimeve dhe zbatimit të kontratave, konkretisht: në 8 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim; në 7 raste kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të përcaktuara në DST; si dhe në zbatimin e kontratave në 5 objekte, rezultoi dëm ekonomik në vlerën 701 mijë lekë pa t.v.sh., si rezultat i diferencave në volume pune.



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

Në Bashkinë Durrës

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, bazuar në pasaktësi në: llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 634,115 mijë lekë, pasi nuk përmban regjistrime të debitorëve të krijuar progresivisht para vitit 2022; llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” paraqitet e nënvlerësuar në vlerën prej 12,243 mijë lekë; llog. 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet e nënvlerësuar për 27 projekt-studime për investime për të cilat nuk ka të dhëna të plota nëse janë kryer të gjitha investimet dhe kapitalizuar; në llog. 212 “Ndërtesa Konstruksiione” u konstatua se në 8 raste aktivet e kontabilizuara kanë emërtesa të paplota, ta paqarta dhe të pasakta dhe 1 rast në vlerën 1,157 mijë lekë nuk ka emërtim, gjë që do të thotë se inventari kontabël nuk përputhet me gjendjen kontabël për këtë vlerë. Për këto aktive nuk është bërë asnjë inventar fizik për të verifikuar ekzistencën dhe statusin e tyre fizik; llog. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që gjendja e debitorëve në aktiv të bilancit është në vlerën 592,148 mijë lekë. Gjithashtu, llog. 16 “Hua Afat Gjata” paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që Bashkia Durrës ka marrë në vitin 2014 kredi të financuar nga CEB në vlerën 3,341 mijë euro ose në 352,937 mijë lekë për ndërtimin e banesave sociale. Pagesat e kësteve të kredisë janë kontabilizuar në llog. 231 “Investime në proces”, ndërkohë që investimi ka përfunduar dhe financimi ka kaluar në llog.212 “Ndërtesa dhe konstruksiione”.

Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Durrës, bazuar në parregullsitë si:

Në lidhje me urbanistikën, konstatohet se nga struktura IMTV, nga 119 vendime për “Prishje e Objektivit të Kundërligjshëm“ janë ekzekutuar

vetëm 25 vendime ndërsa për 94 vendime nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm; në 34 raste edhe pse ka procesverbal konstatimi për ndërtime pa leje ndërtimi, nga inspektorët e terrenit nuk është vijuar procedura brenda afatit 10 ditor për nxjerrjen e vendimit për “Prishje Objekti të Kundërligjshëm“ dhe nxjerrjen e vendimit për “Dënim me Gjobë“ .

Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit publik për punë publike, mallra dhe shërbime, në 5 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim; në 5 raste kualifikimi i operatorit ekonomik të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të përcaktuara në DST; si dhe nga auditimi i zbatimit të kontratave në 8 objekte, rezultoi dëm ekonomik në vlerën 2,794 mijë lekë, si rezultat i diferencave në volume pune.

Në Bashkinë Fier

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare bazuar në: mos kontabilizimin e saktë në llog.210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” dhe 212 “Ndërtesa e Konstruksiione”; mos llogaritje të amortizimit të aktiveve në llog. 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” si dhe moskryerje e inventarizimit fizik të aktiveve.

Opinion i kualifikuar për përputhshmërinë e aktivitetit të Bashkisë Fier, bazuar në: mungesën e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm; për mos marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën progresive prej 236,826 mijë lekë. Në 15 raste janë lidhur kontrata me subjekte të



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

ndryshme për dhënie me qira të tokave pa frut, për ndërtimin e impiantit gjenerues elektrik fotovoltaiq, me kapacitet të instaluar 2 MË dhe vepra ndihmësë, pa ngritur grupe pune për vlerësimin e dokumentacionit për dhënie me qira të pronës sipas zërave, pa relacione për miratimin dhe përcaktimin e çmimit/ vit si dhe pa përcaktuar individualisht në Vendimin e Këshillit Bashkiak sipërfaqet e dhëna në përdorim. Në lidhje me zbatimin e procedurave të prokurimit u konstatua se: në 5 procedura prokurimi nuk dokumentohet argumentimi i volumit të punimeve që do të kryen, volumi i mallrave që nevojiten si dhe hartimi i fondit limit; në 8 procedura për punë publike, mallra dhe shërbime, u konstatua se, në DST nuk është argumentuar plotësisht vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike; në 4 procedura u konstatua se operatori ekonomik është shpallur fitues në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST.

Në lidhje me urbanistikën në 4 raste u konstatuan parregullsi në fushën e lejeve të ndërtimit dhe zbatimit të tyre në terren dhe në 2 raste u konstatua se miratimi i certifikatave të përdorimit është bërë pa pasur gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Në Bashkinë Himarë

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare bazuar në parregullsi në llogaritë e detyrimeve kreditore dhe të drejtave mbi debitorët të cilat nuk pasqyrojnë gjendjen reale në vlera materiale; si dhe konstatohen llogari të aktiveve të çelura në vitet paraardhëse për të cilat mungon dokumentacioni i nevojshëm kontabël mbi krijimin dhe përmbajtjen ekonomike të tyre. Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë

Himarë, bazuar në parregullsi të cilat janë materiale por jo të përhapura si: në 4 procedura prokurimi janë vendosur kriteret e cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë; në 2 raste, kriteret e vendosura nga njëzia nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumet e punës; në 3 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, në vlerën totale 54,996 mijë lekë.

Në lidhje me urbanistikën, në 6 raste nuk është llogaritur saktë taksa e ndikimit në infrastrukturë për vlerën 6,386 mijë lekë si dhe nuk janë marrë masa për arkëtimin e gjobën së IMTV të aplikuar për ndërtime të paligjshme në vlerën 27,900 mijë lekë.

Në Bashkinë Kavajë

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, bazuar parregullsitë materiale si më poshtë:

Llog.520 “Disponibilitete në thesar” më datë 31.12.2023 nuk kuadron me mbylljen e llogarive 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” dhe 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”. Llogaritë 31 “Materiale” në vlerën 20,194 mijë lekë dhe 32 “Inventar i imët” 25,001 mijë lekë nuk kuadrojnë me llog.63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” me një diferencë prej 18,912 mijë lekë; Çelja e llog.411 “Klientë e llogari të ngjashme” është në vlerën 2,123 mijë lekë ndërkohë që në pasqyrat financiare çelja për këtë llogari është në vlerën 2,839 mijë lekë me një diferencë prej 715 mijë lekë; Llog.423 - 429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)”, e pasqyruar në bilanc



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

për vlerën 91,540 mijë lekë është e pa detajuar për të vlerësuar plotësinë e vlerave të paraqitura në këtë llogari; ka mangësi në përlllogaritjen e normës së amortizimit të llogarive të klasës 2; Llogaritë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, 436 “Sigurime shëndetësore”, 464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë” dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” me vlerë 801,480 mijë lekë, e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin”; Vlera e detyrimeve më datë 31.12.2023, për llog. 42 “Detyrime ndaj personelit” sipas urdhër shpenzimeve dhe akt- rakordimit me Degën e Thesarit është në vlerën 30,061 mijë lekë, ndërsa në pasqyrat financiare është në vlerën 30,181 mijë lekë; Llog.464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 1,242 mijë lekë është e pa detajuar analitikisht; llog. 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar” paraqitet e mbivlerësuar për vlerën 1,536,878 mijë lekë.

Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Kavajë bazuar parregullsitë materiale si: në 7 procedura prokurimi u konstatua se, në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar plotësisht vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike, si dhe se operatorët ekonomik janë shpallur fitues në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit; në 3 raste janë konstatuar mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi ose certifikate përdorimi; si dhe, në 4 raste është konstatuar dëm ekonomik për punime të përfunduara sipas kushteve të preventivit me vlerë 43,468 mijë lekë.

Në Bashkinë Këlcyrë

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare duke evidentuar disa mangësi jo materiale në lidhje me inventarizimin dhe regjistrimin e aktiveve të qëndrueshme afatgjata.

Opinion i kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Këlcyrë bazuar në parregullsi materiale në lidhje me mungesën e masave për arkëtimin e debitorëve, të cilët rezultojnë në vlerën 29,234 mijë lekë për 73 individë dhe subjekte; si dhe për marrjen e masave të plota për uljen e detyrimeve të prapambetura.

Në lidhje me auditimin e procedurave të prokurimit janë konstatuar parregullsi në: hartimin e kriterëve të veçanta të përcaktuara pasi, në 2 procedura janë vendosur kriterë të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën e kontratës dhe nuk janë argumentuar nga ana teknike; në 1 rast është shpallur fitues dhe lidhur kontratë me operatorin ekonomik i cili nuk plotësonte të gjithë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit; si dhe për 2 procedura prokurimi janë caktuar si anëtar të njësisë së prokurimit dhe njëkohësisht persona përgjegjës për prokurimin dy punonjës, të cilët nuk janë pjesë e strukturës organizative të bashkisë.

Në Bashkinë Kolonjë

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, bazuar në pasaktësi në: llog.101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” e paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 29,357 mijë lekë; llog.520 “Disponibilitete në thesar” e paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 2,712 mijë lekë; llog.32 “Inventar i imët” e paraqitur e mbivlerësuar për



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

vlerën 1,542 mijë lekë; llog.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” e paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 64,313 mijë lekë; llog.202 “Studime dhe Kërkime” e paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 115 mijë lekë; llog.212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” e paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 8,552 mijë lekë; llog.26 “Aktivet Afatgjata Financiare” e paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 625 mijë lekë; dhe llog.435 “Sigurime Shoqërore” e paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 55 mijë lekë.

Opinion i kualifikuar të përputhshmërisë së veprimtarisë së Bashkisë Kolonjë, ku rezultuan parregullsitë materiale si : nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët për taksat dhe tarifat vendore të cilët, në mënyrë progresive, paraqiten në vlerën 79,424 mijë lekë.

Në lidhje me auditimin e procedurave të prokurimit, në 7 raste u konstatua se në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar plotësisht vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike; në 6 raste u konstatua se operatori ekonomik është shpallur fitues në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të përcaktuara.

Në lidhje me urbanistikën, në 2 raste Bashkia Kolonjë nuk ka kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit; në 3 raste ka mangësi në lidhje me inspektimin e objekteve me leje ndërtimi të miratuar me qëllim evidentimin e shmangieve nga projekti i miratuar.

Në Bashkinë Korçë

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare bazuar në pasaktësitë si: llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” ishte mbivlerësuar

i me 79,782 mijë lekë, dhe disa pasuri ishin përfshirë gabimisht në llogari si 202 “Studime dhe kërkime” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Këto vlera ishin trashëguar nga ish-komunat dhe nuk ishin analizuar ose rakorduar me inventarin fizik.

Për 1549 pasuri të transferuara me VKM, vetëm 246 kishin certifikatë pronësie, ndërsa 451 pasuri të tjera nuk ishin të dokumentuara si duhet.

Llogaritë 230 dhe 231 për aktive afatgjata materiale nuk kuadronin me llogaritë për investime dhe grante kapitale. Po ashtu, llogaritë 401-408 dhe 431 nuk ishin në përputhje me operacionet me shtetin.

Aktivitetet jashtë përdorimit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, në vlerën 11,899 mijë lekë, nuk kishin dokumentacion për asgjësimin. Të gjitha këto pasaktësi e çuan në një opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare të Bashkisë Korçë.

Opinion të kundërt për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Korçë bazuar në parregullsitë materiale dhe të përhapura si më poshtë:

Nga auditimi i 21 procedurave të prokurimit, me një fond limit prej 629,482 mijë lekë pa t.v.sh. dhe vlerë të kontraktuar prej 507,674 mijë lekë pa t.v.sh., u identifikuan parregullsi në 20 procedura. Këto përfshijnë hartimin e fondeve limit pa respektuar metodat e përcaktuara, përdorimin e punonjësve pa licencat profesionale të nevojshme dhe mungesën e personelit të kualifikuar. Në 18 procedura për blerje me vlerë të vogël, u aplikuan kriterë dhe specifikime teknike të paargumentuara, ndërsa në 11 procedura operatorët fitues kishin mangësi në dokumentacion. Dëm ekonomik prej 1,416 mijë lekësh u konstatua në 4 procedura për punimet e ndërtimit, dhe në 2 procedura të tjera, u identifikua kualifikimi i padrejtë i operatorëve ekonomikë me vlerë 6,887 mijë lekë pa t.v.sh.

Sa i përket urbanistikës, në 3 procedura nuk ishin paraqitur saktë planet e vendosjes dhe nuk u respektuan distancat nga kufiri i pronës dhe



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

trupi i rrugës. Në 1 procedurë, leja e zhvillimit ishte miratuar pa planin dhe kushtet urbane të miratuara më parë. Gjithashtu, në 5 procedura u identifikuan problematika lidhur me kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik. Në auditimin e certifikatave të përdorimit, u konstatuan 2 procedura pa dokumentacionin e nevojshëm në sistemin e- Leje, dhe në 1 objekt leja e ndërtimit nuk përputhej me zbatimin në terren. Për më tepër, 25 subjekte kanë marrë leje ndërtimi, pavarësisht se kanë qenë debitorë ndaj Bashkisë Korçë, me një detyrim prej 2,127 mijë lekësh. U konstatuan gjithashtu diferenca në përlllogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 6 objekte, duke shkaktuar humbje prej 13,847 mijë lekësh për buxhetin e Bashkisë Korçë.

Në Bashkinë Krujë

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare bazuar pasaktësi në llogaritë si më poshtë:

Llogaria 212 “Ndërtesa Konstruksiione” dhe 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” janë të pa detajuara sipas zërave si dhe nuk ka informacion të plotë për secilin aktiv; llog.468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar për vlerën 63,154 mijë lekë, pasi në fund të vitit nuk janë kontabilizuar detyrimet e papaguara për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve; gjendja e llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” nuk kuadron me llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” e cila është paraqitur më shumë në vlerën 726,666 mijë lekë.

Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Krujë, bazuar në parregullsitë materiale si më poshtë:

Në lidhje me auditimin e procedurave të prokurimit, në 5 raste janë konstatuar shpallje fitues të operatorëve ekonomik që nuk

plotësojnë kriteret e miratuara në dokumentet e tenderit; në 6 raste rezulton një rritje e fondit limit në vlerën totale prej 5,883 mijë lekë, si pasojë e mos llogaritjes së çmimit të saktë sipas manualit për zërat e preventivit për punime, si dhe përfshirjen e zërave jo të duhur në shërbimet e pastrimit. Nga auditimi i zbatimit të kontratave për punime e mallra, janë konstatuar volumeve të punës së pa kryera në 4 raste të kontratave me objekt “Sistemi-asfaltim” në vlerën totale prej 928 mijë lekë.

Në lidhje me urbanistikën janë konstatuar mangësi në funksionimin e inspektoratit të mbrojtjes së territorit, ku për asnjë nga vendimet e gjobave nuk është vijuar as me vendime prishje të objektit të paligjshëm dhe as me arkëtimin e vlerave të gjobës, e cila për periudhën objekt auditimi rezulton 1,000,970 mijë lekë, me impakt të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë.

Gjithashtu, u konstatua dëm ekonomik në vlerën 382 mijë lekë, si pasojë e faturimit në mënyrë të padrejtë të vlerës së amortizimit të kontejnerëve në pronësi të Bashkisë dhe për kontejnerë të pa përdorur, si dhe në vlerën prej 894 mijë lekë dëm ekonomik për shpenzime të pa dokumentuara dhe të paautorizuara për karburant gjatë ditëve të pushimit.

Në Bashkinë Lezhë

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, bazuar në pasaktësi në: llog.468 “Debitorë të ndryshëm”, nënvlerësuar me 60,565 mijë lekë; llog.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, mbivlerësuar për vlerën 21,331 mijë lekë; llog.520 “Disponibilitete në thesar”, nënvlerësuar për vlerën 2,301 mijë lekë; llog.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, nënvlerësuar për vlerën 3,071 mijë lekë; llog.467 “Kreditor të tjerë” nënvlerësuar me vlerën 5,082 mijë lekë; llog.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” është



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

mbivlerësuar për vlerën 512,259 mijë lekë.

Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Lezhë bazuar në parregullsitë materiale si më poshtë:

Në lidhje me auditimin e procedurave të prokurimit, nga 8 procedura në 6 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e disa prej kritereve për kualifikim dhe në 4 raste, kualifikimi i operatorit ekonomik të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST. Nga auditimi i zbatimit të kontratave në 6 objekte rezultuan diferencave në volume pune vlerësuar si dëm ekonomik në vlerën 3,776 mijë lekë. Gjithashtu, u konstatuan detyrime debitoare të shtuara nga mos pagesa e autorizimit, për subjektet që tregtojnë hidrokarbure në vlerën 2,400 mijë lekë, detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën 246,341 mijë lekë; si dhe mos taksim i plotë i kategorisë taksapaguese “Familje” për tarifatat e ndriçimit, gjelbërimit dhe arsimit në vlerën 7,675 mijë lekë etj.

Në Bashkinë Librazhd

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar bazuar në pasaktësitë në: Në llog.212 “Ndërtesa Konstruksiione” dhe 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, shtesat për rikonstrukcionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të objektit; llog.468 “Debitorë të ndryshëm” është nënvlerësuar për vlerën 2,206 mijë lekë pasi në fund të vitit nuk janë kontabilizuar detyrimet e papaguara për qira shfrytëzimi të fondit pyjor dhe kullosor; ka rezultuar se gjendja e llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, nuk kuadron me llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” për vlerën 42,577 mijë lekë; në llogarinë 211 “Pyje, Plantacione” është kontabilizuar gabim 1 artikull kontabël në vlerën 4,662 mijë lekë, që i përket llog.202 “Studime e kërkime”.

Llogaritë inventariale janë pasqyruar për vlerën kontabël pa u krahasuar me inventarin fizik ku, nga 603 objekte inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën 4,468,754 mijë lekë, vetëm 19 objekte janë pajisur me titull pronësie dhe për 584 objekte nuk posedohet titull pronësie.

Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Librazhd bazuar në parregullsitë materiale si: në zbatimin e kontratave për punë publike janë kryer pagesa në vlerën 362 mijë lekë pa t.v.sh. për punime të pakryera. Në procedurat e prokurimit janë konstatuar mangësi në hartimin e kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetet teknike, specififikimet dhe argumentimin teknik. Në 4 procedura me vlerë kontrate 173,898 mijë lekë, OE-të e kualifikuar nuk përmbushin kriteret e vendosura. Në lidhje me kontratat për aktivet e dhëna me qira, u konstatua mos respektim i detyrimeve kontraktuale, në vlerën 2,206 mijë lekë.

Në lidhje me urbanistikën, Bashkia Librazhd, në 7 raste nuk ka zbatuar plotësisht kuadrin rregullator në miratimin e aplikimeve për leje ndërtimi dhe certifikate përdorimi.

Në Bashkinë Malësi e Madhe

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar me theksim të çështjes për pasqyrat financiare, bazuar pasaktësi në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” ku janë përfshirë në mënyrë të gabuar 2 aktive me vlerë 3,961 mijë lekë, të cilat i përkasin llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”; në llog.211 “Pyje, Plantacione” janë përfshirë 4 aktive me vlerë 10,743 mijë lekë të cilat nuk kanë emërtime të plota dhe të sakta se kujt njësie administrative apo objekt investimi i përkasin; në llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” konstatohet se është përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 3,664 mijë lekë e 3 aktiveve të cilat, sipas verifikimit i përkasin



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” si dhe janë përfshirë 11 aktive me vlerë 105,767 mijë lekë të cilat nuk kanë emërtime të plota dhe të sakta se cilës njësi administrative apo objekt investimi i përkasin; në llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezultojnë se nuk është zbritur vlera e investimeve të kryera në ujësjellës dhe që duhet të transferohet tek Ujësjellës Kanalizime ShA, Shkodër për 24 aktive në vlerën 1,524,931 mijë lekë; si dhe vlera prej 116,204 në llog.475 “Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse” duhet të ishte pjesë e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”.

Opinion i kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Malësi e Madhe, bazuar në parregullsitë materiale si:

Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit me vlerë të fondit limit 311,595 mijë lekë u konstatua se janë vendosur kritere kualifikuese jo në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet; janë kualifikuar, shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomik që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nga auditimi i zbatimit të kontratave në 9 objekte, rezultoi dëm ekonomik në vlerën 5,698 mijë lekë pa t.v.sh., si rezultat i diferencave në volume pune.

Në Bashkinë Mallakastër

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, bazuar në pasaktësi në lidhje me: llog.520 “Disponibilitete në thesar” nuk kuadron me mbylljen e llog.85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 48,897 mijë lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 10,729 mijë lekë; Në llog.468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është pasqyruar vlera 1,192,034 mijë lekë e cila ka të bëjë me detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore; llog.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në

vlerën 10,419 mijë lekë ku kjo vlerë duhet të kontabilizohet në llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”; llog.230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqitet në vlerën 19,546 mijë lekë dhe llog.231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 669,570 mijë lekë ku totali i tyre, nuk kuadron me totalin e llog.115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llog.105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë; llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksat”, 435 “Sigurime shoqërore”, 436 “Sigurime shëndetësore” dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm”, në total në vlerën 20,983 mijë lekë nuk kuadrojnë me llog.4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” paraqitur në vlerën 28,708 mijë lekë.

Opinion i kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Mallakastër bazuar në parregullsitë si : mungesa e një sistemi efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm; nuk janë realizuar fazat e përgatitjes së PBA-së për vitet 2023-2025; konstatohet gjendje e shtuar e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2023, në vlerën 22,226 mijë lekë; mos marrje e masave të plota për arkëtimin e debitorëve për detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifatat vendore.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit, në 6 raste janë vendosur kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë natyrën dhe vlerën e kontratës; në 4 raste janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe më pas lidhur kontrata në vlerën totale 118,537 mijë lekë me operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për 3 kontrata është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale 26,259 mijë lekë si pasojë e diferencave në realizimin e punimeve.

Në lidhje me urbanistikën, është konstatuar se në 1 rast nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj; në 4 raste projekti ndërtimor nuk është i plotë dhe ka



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

mangësi në dokumentacionin e nevojshëm; në 2 raste nuk është kërkuar/respektuar mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje lejet e ndërtimit. Nga auditimi i vendimeve të marra nga ana e IMTV, konstatohet se në 2 raste nuk është nxjerrë vendimi i prishjes së ndërtimit të kundërligjshëm; në 2 raste të tjera nuk është nxjerrë vendimi i pezullimit të punimeve.

Në Bashkinë Patos

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare, bazuar në pasaktësi në llog.466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, e paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 35,120 mijë lekë, llog.468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 207,517 mijë lekë.

Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë, bazuar në parregullsitë materiale si: mungesa e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm; nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët të cilët më datën 31.12.2023 paraqiten në vlerën 207,517 mijë lekë. Në 6 procedura prokurimi u konstatua se në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar plotësisht vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike; në 3 raste u konstatua se operatorët ekonomik janë shpallur fitues në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit; në 3 raste janë konstatuar mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi ose certifikate përdorimi; si dhe në 4 raste, janë konstatuar punime të parealizuara sipas kushteve të preventivit në zbatimin e kontratave të punëve publike me vlerë 11,772 mijë lekë si dëm ekonomik.

Në Bashkinë Përrenjas

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, bazuar në pasaktësitë në paraqitjen e: llog.468 “Debitorë të ndryshëm” e nënvlerësuar për vlerën 2,672 mijë lekë; llog.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” e mbivlerësuar për vlerën 15,209 mijë lekë; llog.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, e nënvlerësuar për vlerën 280 mijë lekë; llog.467 “Kreditor të tjerë” e nënvlerësuar për vlerën 919 mijë lekë; llog.4342 “Operacione me shtetin (detyrime)” e nënvlerësuar në vlerën 22,401 mijë lekë; llog.202 “Studime dhe Kërkime” të mbivlerësuar në vlerën 11,899 mijë lekë.

Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Përrenjas, bazuar në parregullsitë materiale si: në 14 procedura prokurimi me vlerë totale të fondit limit 110,038 mijë lekë pa t.v.sh. janë konstatuar shkelje në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, pasi nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet; në 7 procedura me vlerë totale të fondit limit 72,284 mijë lekë, pa t.v.sh., operatorët ekonomik të kualifikuar nuk përmbushin kriteret e vendosura.

Është konstatuar gjithashtu, mos respektimi i detyrimeve kontraktuale nga subjektet private për aktive të marra me qira për mos pagesë në vlerën 5,561 mijë lekë pa t.v.sh., përfshirë kamatëvonesat.

Në lidhje me urbanistikën, Bashkia Përrenjas në rolin e autoritetit vendor të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në 8 raste nuk ka zbatuar plotësisht kuadrin rregullator në miratimin e aplikimeve për leje ndërtimi dhe certifikate përdorimi.



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

Në Bashkinë Rrogozhinë

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, bazuar në pasaktësi në llog.520 “Disponibilitete në thesar” në vlerën 285,127 mijë lekë e cila nuk kuadron me llog.85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 285,127 mijë lekë dhe llog.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 49,166 mijë lekë; në llog.468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 228,075 mijë lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore; në llog.202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë projekti me objekt “Studim Projektim i rrjetit të brendshëm ujësjellësi” në vlerën 3,354 mijë lekë, i cili ka përfunduar dhe duhej të ishte kapitalizuar në llogarinë përkatëse; në llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 212,246 mijë lekë në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë pa procesverbalet e transferimit dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Rrogozhinë; në llog.210 “Toka, Troje, Terrene” për vlerën 5,839 mijë lekë, llog.211 “Rrugë rrjete vepra ujore” për vlerën 1,483 mijë lekë, llog.212 “Ndërtesa e konstruksione” për vlerën 319,460 mijë lekë, llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për vlerën 583,641 mijë lekë, llog.214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” është përfshirë vlera 7,951 mijë lekë, llog.215 “Mjete transporti” është përfshirë vlera 7,042 mijë lekë dhe llog.218 “Inventar ekonomik” është përfshirë vlera 31,337 mijë lekë, të gjitha të paanalizuara në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike, si vlera të trashëguara nga bilanci i ish-komunave Rrogozhinë.

Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Rrogozhinë bazuar në parregullsitë materiale si: detyrime të prapambetura në vlerën 148,534 mijë lekë; nuk janë marrë masat për arkëtimin e detyrimeve

nga debitorët për taksat dhe tarifat vendore dhe nga dhënia me qira e sipërfaqeve të plazheve dhe ato të fondit pyjor kullor, detyrime të cilat paraqiten në vlerën 276,936 mijë lekë.

Në 2 procedura prokurimi janë shpallur fitues dhe më pas lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në vlerën totale të fondit limit 14,200 mijë lekë; në 7 raste në procedurat e prokurimeve me vlera të vogla janë vendosur kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në zbatimin e kontratave, në 2 raste është konstatuar dëm ekonomik në vlerën 157 mijë lekë, si pasojë e diferencave të volumeve në realizimin e punimeve.

Në lidhje me urbanistikën janë konstatuar parregullsi në fushën e lejeve të ndërtimit dhe zbatimit të tyre në terren: në 2 raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj; në 3 raste projekti ndërtimor nuk është i plotë dhe ka mangësi në dokumentacionin e nevojshëm; në 1 rast Bashkia Rrogozhinë dhe Drejtoria e Politikave Urbane nuk kanë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me kontributin që sektori privat duhet të japë ndaj fondit publik të banesave sociale. Nga ana e IMTV konstatohet se në 5 raste nuk janë nxjerrë “Vendim për Prishje”; në 7 raste nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e “Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm” dhe në 4 raste IMTV nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor për shkeljet e konstatuara.

Në Bashkinë Roskovec

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kundërt për pasqyrat financiare, bazuar në parregullsitë materiale dhe të përhapura si: Llog.210 “Toka, troje, terrene” dhe 212 “Ndërtime e konstruksione” nuk paraqesin



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

gjendjen reale pasi në këto llogari nuk janë kontabilizuar asnjë prej vlerave të: a) trojeve nën objekt të godinës së re të bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në njësitë administrative etj.. Nuk rezulton të jetë pasqyruar VKM datë 29.09.2021, për sipërfaqen tokë bujqësore (arë) me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 6,242 mijë lekë e cila i ka kaluar Projektit të gazsjellësit TAP. Llog.212 “Ndërtime e Konstruksiione” nuk paraqet gjendjen reale sepse nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për 30 objekte me sipërfaqe trualli nën objekt të objekteve prej 23,303 m2 të trashëguara pa kartela objekti nga ish Komunat.

Në llog.468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton se nuk janë përfshirë debitorët e tjerë që rrjedhin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 6,393 mijë lekë për 219 raste. Gjithashtu, nuk janë regjistruar gjobot e vendosura gjatë vitit 2023 nga IMTV dhe Policia Bashkiake në vlerën 650 mijë lekë për 4 subjekte, ndërkohë që shuma progresive paraqitet në vlerën 1,857 mijë lekë. Llog.520 “Disponibilitete në thesar” në ekstraktin e sistemit të Thesari paraqitet me vlerën 0 lekë me kundërparti llog.466 (kreditorë në ruajtje) e cila paraqitet në shumën 62,536 mijë dhe llog.85 “teprica e periudhës” e cila paraqitet në shumën 58,555 mijë lekë.

Gjithashtu, Bashkia Roskovec nuk ka hartuar regjistër të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim si dhe nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatëse për verifikimin dhe vlerësimin e tyre sipas zërave.

Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Roskovec, bazuar në parregullsitë materiale si: Në 5 procedura prokurimi për punë publike, mallra dhe shërbime, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim dhe në 5 raste, kualifikimi i operatorëve ekonomik të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos

përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në zbatimin e kontratave në 4 objekte, rezultoi dëm ekonomik në vlerën 4,739 mijë lekë pa t.v.sh., si rezultat i diferencave në volume pune. Gjithashtu, rezulton se nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrime tatimore për mos pagesën e taksave dhe tarifave vendore nga abonentët familjar në vlerën 158,982 mijë lekë.

Në Bashkinë Shijak

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare, bazuar në disa pasaktësi në llog.212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” të cilat nuk paraqesin vlerën reale të aktiveve të Bashkisë Shijak, pasi nuk janë kontabilizuar vlera e 54 objekteve të transferuara, përkatësisht: varrezat, lapidaret, repartet ushtarake, qendra shëndetësore, poliklinika, kabina elektrike, posta e re dhe e vjetër, lulishte, fushë grumbullimi e mbeturinave, truall mbi tokat bujqësore.

Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Shijak bazuar në parregullsitë si: Në 5 procedura prokurimi me fond limit 148,938 mijë lekë, janë konstatuar shkelje në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, pasi nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet; në 4 procedura me vlerë kontrate 121,793 mijë lekë, operatorët ekonomik nuk përmbushin kriteret e vendosura; në 3 procedura vlerësimi është kryer përtej afatit 15 ditor të përcaktuar për procedurat nën kufirin e ulët monetar; në 2 procedura prokurimi për punë publike, mungon Oponenca Teknike e projektit. Në auditimin për zbatimin e kontratave për punimet e ndërtimit, në 3 raste u konstatuan punime të porealizuara sipas



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

kontratës në vlerën 4,771 mijë lekë, e cila përbën dëm ekonomik. Në lidhje me urbanistikën, në 3 raste konstatohet përllogaritja e gabuar e taksës së ndikimit në infrastrukturë, për objektet me leje ndërtimi në vlerën 16,934 mijë lekë; mungon Plani i Përgjithshëm Vendor; në miratimin e lejeve të ndërtimit, janë konstatuar mangësi në tipologjinë e objektit të lejes në raport me projektin, kemi mos respektim distancave me rrugën dhe pronën; në 1 rast mungon oponenca teknike për objektet me akses publik si dhe në 2 raste janë lëshuar certifikatat e përdorimit me mangësi në dokumentacion.

Në Bashkinë Shkodër

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare, pasi nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të subjektit, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar vjetor të këtij institucioni, përveç disa është jo materiale, për t'u konsideruar nga menaxhimi i institucionit që lidhen me: llogarinë e debitorëve ku përfshihen gjopa nga IKMT, policia bashkiake dhe kamatëvonesat, të cilat duhet të paraqiten në llog. 709 "Kamatvonesat" sipas strukturës kamatvonesat më vete për sistemin tatimor dhe më vete për sistemin doganor.

Opinion i kualifikuar për veprimtarinë e Bashkisë Shkodër kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si vijon: nuk janë marrë masat e duhura për arkëtimin e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore, të cilët rezultojnë me një nivel të ulët arkëtimi prej 29%; janë kryer shpenzime pa efektivitet për një automjet dhe konsum të karburantit në vlerën prej 531 mijë lekë; janë likuiduar fonde për shërbime të pakryera në shumën 3,662 mijë për kontratën

me objekt "Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër"; nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së ndjekur për miratimin e lejeve rezultoi se nuk është kërkuar mendimi i të gjithë autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve për t'u siguruar për respektimin e distancave nga linjat e tensionit të lartë të OST për 7 raste; rezultuan 6 leje ndërtimore për sipërfaqe mbi 2 000 m², për të cilat nga ana e DPKZHT janë pranuar deklarata noteriale, për të kaluar pa shpërblim 3% të sipërfaqes funksionale në favor të banesave sociale, në kundërshtim me kërkesat ligjore; nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e-leje dhe në databazën e vendosur në dispozicion nga drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit është konstatuar se 25 lejet e ndërtimit të miratuara janë shqyrtuar në kundërshtim me afatin ligjor prej 60 ditësh.

Në Bashkinë Maliq

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si: mbivlerësim i llogarive 101 "Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar" për vlerën 8,033 mijë lekë; 520 "Disponibilitete në thesar" për vlerën 75,616 mijë lekë; 212 "Ndërtesa dhe Konstrukione" për vlerën 22,546 mijë lekë; 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 108,496 mijë lekë; dhe llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 114,275 mijë lekë; ndërsa janë paraqitur të nënvlerësuar llogaritë: 4342 "Të tjera operacione me shtetin (debitor)" për vlerën 185,750 mijë lekë; 26 "Aktivet Afatgjata Financiare" për vlerën 582,418 mijë lekë; gjithashtu rezultuan disa pasaktësi në vlerën e llogarisë 23 për shpenzimet e kryera për investime dhe që aktualisht rezultojnë në proces në vlerën 131,042 mijë lekë.



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

Opinion i kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Maliq, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si: sistem jo efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, dhe mungesë e një kuadri të plotë rregullash dhe procedurash për përmbushjen e objektivave të institucionit; mosrealizim i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) në masën 48.13%; nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive të kenë vlerën 114,176 mijë lekë nga të cilat 43,439 mijë lekë i përket vitit 2022;

në 9 procedura prokurimi rezultoi vendosje e kriterëve të paargumentuara dhe/ose jo të lidhura ngushtë me tipologjinë e procedurës përkatëse; në 5 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 269,675 mijë lekë operatori/ët e shpallur fitues nuk ishin në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve; gjatë zbatimit të 2 kontratave të punëve publike u konstatua dëm ekonomik në vlerën 249 mijë lekë.

Në Bashkinë Skrapar

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si: pasaktësi në raportimin e llogarive të klasës 2 dhe mos dokumentimi i aktiveve sipas kuadrit ligjor për regjistrimin e pasurisë; pasaktësi në raportimin e llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”; mos plotësimi i regjistrimit të aktiveveve sipas të gjitha kërkesave të formatit të aprovuar nga Ministria e Financave; mosplotësim me dokumentacion pronësor të të gjitha aktiveve, si dhe mos reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj; vlera e llogarisë 401-408 nuk

paraqet drejtë dhe saktë gjendjen e debitorëve pasi nuk janë raportuar debitorët nga taksat dhe tarifatat vendore në vlerën 3,358 mijë lekë; nuk janë marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor dhe arkëtimin e këtyre detyrimeve, për debitorët të cilët vijnë nga taksat dhe tarifatat vendore në vlerën totale 102,473 mijë lekë; llogaritë 210, 211, nuk paraqesin drejtë dhe saktë gjendjen e aktiveve pasi nuk janë regjistruar në kartelat kontabël vlerat e: a) trojeve nën objekt të objekteve si godina e re e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në NjA etj, sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”. b) truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë, c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Skrapar; nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre; si dhe nuk janë reflektuar ndryshimet në këtë llogari të VKM nr. 803 datë 30.9.2015.

Opinion i kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë, kualifikimi i të cilit mbështetet në parregullsitë materiale dhe jo të përhapura si: parregullsi në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, mosrespektimin e metodave të përcaktuara për hartimin e fondit limit, sa i takon protokollimit të procesverbaleve të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së auditimit; në të gjitha procedurat e audituara, me vlerë totale të fondit limit 101,804 mijë lekë pa t.v.sh., u konstatua se janë aplikuar kriteret e paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet; në 8 procedura me vlerë totale të fondit limit 40,039 mijë lekë pa t.v.sh., u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST; në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, u konstatua copëzim fondi dhe vlera e këtyre procedurave e tejkalonte shumë tavan prej 1 milionë lekë, të përcaktuar në legjislacionin në



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

fuqi, ndërkohë që kishin funksion të ngjashëm dhe duhet të grupoheshin duke u prokuruar në një procedurë të vetme; në drejtim të zbatimit të punimeve civile rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt konkretisht: në kontratën me objekt “Mur mbajtës përgjatë Lumit Osum tek ish-kantieri i N.N.-së Çorovodë”, në vlerën 337 mijë lekë (pa t.v.sh.); dhe në kontratën me objekt “Rigjenerim urban i zonës afër gjimnazit në Rrugën e Dëshmorëve, Çorovodë”, në vlerën 283 mijë lekë (pa t.v.sh.); rezultuan 2 raste ku nuk janë respektuar kushtet urbane të parashikuara në ligj, siç janë: respektimi i intensitetit të ndërtimit, distancat nga kufiri i pronës, parcela minimale e lejuar për zhvillim, lartësia maksimale e lejuar e objektit, si dhe ajo e katit përdhe; rezultuan 3 raste ku projekti ndërtimor nuk është i plotë, me mangësi në dokumentacionin shoqërues; në 2 raste, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) në Bashkinë Skrapar nuk ka kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit; në 2 raste, zhvilluesi dhe aplikanti nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me dokumentin e “Njoftimit të fillimit të punimeve”.

Në Bashkinë Kamzë

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, bazuar në pasaktësi në llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 4,512 mijë lekë pasi kjo vlerë i përket llog. 212 “Ndërtesa e Konstruksione” për vlerën 240 mijë lekë që i përket llogarisë 211 “Pyje e plantacione”. Nga auditimi ka rezultuar se 1809 prona të transferuara me VKM nuk janë të regjistruara në ASHK dhe nuk janë pasqyruar në kontabilitet dhes në inventarin e aktiveve afatgjata.

Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Kamzë, bazuar në parregullsi:

Në procedurat e prokurimit në 14 raste janë konstatuar se kriteret e veçanta për kualifikim nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore, pasi janë aplikuar kriteret e paargumentuara dhe jo të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit; në 1 rast është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik me vlerë 10,728 mijë lekë pa t.v.sh., në mosplotësim të të gjitha kriterëve të vendosura në dokumentet standarde të tenderit; në 5 raste, në zbatimin e kontratave për punë publike, u konstatuan punime të paraqitura me situacione jo në përputhje me faktin në vlerën 1,676 mijë lekë; dhe në 2 raste u konstatua se nuk është kryer oponenta teknike për projektin e zbatimit me objekte “Ndërtim Rr. Frutikulturë + Rr. “Isuf Gervalla” + Rr. “Brezaret” dhe “Ndërtim rruga OSBE - Bulevardi “Nënë Tereza”.

Është konstatuar mangësi në sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe në menaxhimin jo të mirë të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, si në planifikim dhe arkëtim, duke vlerësuar të ardhura të munguara (borxhit tatimor) për taksapaguesit familjarë dhe privat në shumën 1,202,062 mijë lekë.

Në Bashkinë Vau i Dejës

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kundërt për pasqyrat financiare, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, pasi rezultoi se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale dhe të përhapura, dhe prekin disa prej llogarive financiare me efekt në rezultatin financiar, si vijon: Nga auditimi, është konstatuar se investimet e Bashkisë në njësitë e varësisë, si Ujësjellës Kanalizime Vau i Dejës, Zadrime Agrikulturë dhe Ndërkomunale Bushat, nuk janë konsoliduar dhe nuk janë përfshirë në pasqyrat financiare, me një vlerë totale prej 438,072,449 lekësh. Po ashtu, procesi i



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

inventarizimit i aktiveve nuk është përfunduar, dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm analitik për shumicën e aseteve, duke përfshirë ndërtesa, rrugë dhe pajisje.

Bashkia gjithashtu nuk ka kryer inventarizimin për vitin 2023 dhe ka mbyllur llogaritë pa rakorduar me gjendjen fizike. Debitorët për taksat dhe tarifatat vendore janë paraqitur në vlera të pasakta, duke llogaritur vetëm shtesat e vitit 2023. Për më tepër, nuk janë përfshirë në pasiv të pasqyrës financiare shtesat e granteve të brendshme kapitale që financojnë investime të ndryshme. Këto gabime kanë ndikuar negativisht në pasqyrat financiare dhe transparencën e informacionit.

Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Vau i Dejës, bazuar në parregullsi: Janë identifikuar diferenca në vëllimin e punëve të pakryera, me një vlerë prej 4,443 mijë lekë. Kontrata për rikonstruksionin e shkollës dhe ndërtimin e palestrës është lidhur me një vlerë më të lartë se oferta fituese me 2,752 mijë lekë më shumë. Në procedurën për blerjen e karburantit për 2023, sigurimi i oferte nga OE nuk u transferua në llogarinë e bashkisë. Është konstatuar skualifikimi i padrejtë i OE që ka sjellë humbje financiare prej 13,052 mijë lekë për disa projekte. Po ashtu, në 10 raste, OE fitues nuk kanë plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit. U konstatuan mangësi në likuidimin e shpenzimeve për investime, duke përfshirë një vlerë të tepërt t.v.sh. prej 1,528 mijë lekë për pajisjet elektrike dhe ndriçimin rrugor. Vetëm 3 prona janë certifikuar nga 5044 prona me VKM, dhe 4877 prona dhe asete nuk janë vlerësuar dhe certifikuar. Po ashtu, nuk janë hartuar dhe përcjellë për vitin 2023 dokumentet e nevojshme për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik

Në auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së aktivitetit, u konkludua me:

Opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare, pasi rezultoi se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale dhe jo të përhapura, si vijon: Llogaria nr.466 është pasqyruar më pak për vlerën 782 mijë lekë; Llog.470 është pasqyruar pa vlerë dhe më pak në shumën 14,382 mijë lekë; - Llog 202 "studime dhe kërkime" në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në shumën 215,475 mijë lekë, për asnjë vit, nuk i është llogaritur amortizimi sipas normës përkatëse prej 15%; Llog. 24 "aktive të dëmtuara" paraqitet në vlerën 61,893 mijë lekë ku përfshihen edhe grup aktivesh në vlerën 4,434 mijë lekë, të cilat nuk janë specifikuar sipas llogarive kontabël; Llog. 107 "aktive të caktuara në përdorim" është nënvlerësuar pasi nuk ka të pasqyruar vlerën e objektit të marrë në përdorim nga DPRRNP Tiranë; Llog. 4342 "operacione me shtetin (të drejta)" është nënvlerësuar për shumë 20,931 mijë lekë; Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm", është nënvlerësuar për shumë 29,566 mijë lekë; Llog 212 dhe llog. 210 nuk paraqiten në vlera reale të aktiveve të tyre, pasi nuk janë me titull pronësie.

Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, bazuar në parregullsi si vijon: Nga auditimi i 28 procedurave janë konstatuar shkelje të akteve ligjore të LPP-së, ku 6 procedura me vlerë fondi limit 269,151 mijë lekë kishin OE fitues që nuk përmbushnin kriteret e miratuara. Në 25 procedura të tjera, janë aplikuar kritere të paargumentuara, që pengojnë konkurrencën dhe përdorimin efikas të fondeve. Gjithshtu, u gjetën mangësi në regjistrimin e pesë objekteve nga DPRRNP Tiranë, me dokumentacion të pasaktë. Dy projekte investimi kanë lënë



3.3 AUDITIME TË KOMBINUARA

punime të pakryera dhe kanë shkaktuar një dëm ekonomik prej 896,280 lekësh. Këto gjetje tregojnë nevojën për përmirësim në prokurimet publike dhe administrimin e fondeve.

Në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Fier, Vlorë, Gjirokastrë

Në auditimin e pasqyrave financiare u konkluduan disa problematika si vijon: nuk ka verifikime të dokumentuara në sistemin QKL për statusin aktiv të subjekteve, në kundërshtim me Ligjin nr. 10431/2011. Pasqyrat financiare të vitit 2022 përmbajnë gabime, si llogaritje të pasakta në disa llogari ekonomike, duke shkelur kërkesat e UMFE nr. 8/2018. Po ashtu, për periudhën audituese, nuk është kryer inventarizimi i aktiveve dhe pronës publike për Agjencitë Rajonale në Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë. Shkelje janë gjetur edhe në veprimet me bankë, përfshirë gabime në llogaritjen e shtesës mbi pagë, pagesa gjobash dhe kamatë vonesë, shpenzime udhëtimi pa dokumentacion dhe shkelje të legjislacionit të prokurimeve publike.

Opinion të kualifikuar për përputhshmërinë, për parregullsitë materiale pasi: nuk është hartuar/plotësuar regjistri i aktiveve; nuk janë dërguar kërkesa buxhetore PBA 2021-2023 dhe PBA 2023-2025 në Ministrinë përgjegjëse për financat dhe në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit; Pasqyrat financiare nuk janë dorëzuar në Drejtorinë e Tatimeve Fier nëpërmjet sistemit C@ts; nga auditimi i praktikave për leje mjedisi Tipi A/B, rezultoi se në 43 aplikime janë konstatuar mangësi në dokumentacion; në procesverbalet e inspektimit nuk është i gjithë informacioni i nevojshëm; Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga Sektori i Burimeve Natyrore (Ujëra) rezultoi se, për 3 subjekte nuk janë hartuar vendimet përfundimtare sipas procesverbaleve të shkeljeve të konstatuara;

Përgjegjësi i Sektorit të Mjedisit dhe të Burimeve Natyrore (Ujëra) nuk ka hartuar dhe paraqitur periodikisht pranë Titullarit një raport mbi situatën dhe nivelin e realizimit të kushteve të lejeve të paplotësuara nga subjektet, për verifikimin e detyrave të lëna.






AUDITIME TË PERFORMANCËS

Referuar ISSAI 3000 dhe Manualit të Auditimit të Performancës në KLSH, auditimi i performancës është një ekzaminim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm, nëse ndërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat po veprojnë në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditimi i performancës synon të kontribuojë në përmirësimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në sektorin publik. Ai gjithashtu synon të kontribuojë në mirëqeverisje, llogaridhënie dhe transparencë, duke ofruar informacione, analiza ose njohuri të reja dhe, duke rekomanduar masa për përmirësim.

Auditimet e performancës konkludojnë me Mesazhin e Auditimit, i cili mbështetet mbi një vlerësim dhe analizë të thelluar mbi temën e auditimit dhe aktivitetin e subjekteve të përfshira, mbi gjetjet e konstatuara, pikat e dobëta dhe mundësitë për përmirësim.



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS



Në fushën e shëndetësisë dhe mirëqënies

- 1 Efektiviteti i pajisjeve mjekësore në sistemim spitalor publik;
- 2 Politikat dhe respektimi i të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor në shërbimin spitalor Psikiatrik;
- 3 Efektiviteti dhe siguria e barnave që qarkullojnë në Shqipëri.

Auditimi me temë “Efektiviteti i pajisjeve mjekësore në sistemim spitalor publik”, realizuar në:

SUBJEKTET

Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,
Qendrën Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore,
Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza",
Spitalin Universitar të Traumës,
Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”.

Objektivi kryesor i këtij auditimi ka qenë analizimi dhe vlerësimi i politikave dhe masave të ndërmarra lidhur me administrimin e pajisjeve mjekësore.

Zhvillimi i teknologjisë, ka prodhuar pajisje mjekësore moderne të cilat janë shumë komplekse. Disa prej tyre shpesh janë të lëvizshme, futen në organizmin e pacientit dhe janë të kompjuterizuara. Kështu që kjo infrastrukturë teknologjike kërkon aftësi të larta teknike, njohuri mjekësore bazë dhe përgjigje të shpejtë të menaxhimit të rrezikut. Historiku i përdorimit të pajisjeve mjekësore në diagnostikimin e sëmundjeve apo parandalimin e tyre, dëshmon për një numër gjithnjë në rritje të kërkesës e cila meriton një përgjigje të shpejtë dhe të sigurt për pacientët nga strukturat që mbulojnë shërbimin. Gjatë viteve të fundit i është kushtuar rëndësi riorganizimit të

shërbimeve shëndetësore dhe modernizimit të spitaleve si hapa të nevojshëm dhe të rëndësishëm drejt përmbushjes së standardeve të BE.

Nga auditimi ka rezultuar se strukturat përgjegjëse për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore janë të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme për të garantuar mirë funksionimin e tyre. Pajisjet mjekësore nuk janë të inventarizuara në Sistemin Kombëtar të Inventarizimit të Pajisjeve Mjekësore. Mënyra e inventarizimit, historiku, numri dhe llojet e ndërhyrjeve që kryhen për mirëmbajtjen e tyre nuk janë të unifikuar dhe bazuar në standarde të mirë përcaktuara. Edhe pse pajisjet mjekësore kanë vlera dhe kosto të larta për mirëmbajtjen e tyre, ato nuk shoqërohen me struktura të mjaftueshme dhe me kualifikime të plota teknike. Nuk ka një vlerësim të plotë pajisjeve mjekësore në sistemin spitalor publik, me synim identifikimin e jetës së tyre në përputhje me manualet e përcaktuar nga prodhuesit, nxjerrjen jashtë përdorimit për pajisjet mjekësore “end of life”, nxjerrjen nga sistemi i mirëmbajtjes nëpërmjet kontratave full risk i pajisjeve mjekësore me status “end of support”.

Krahas rekomandimeve për përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor e rregullator për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u dhanë rekomandime lidhur me ngritjen e një grupi pune me ekspertë bio-mjekësorë dhe inxhinierë IT për analizimin dhe vlerësimin e sistemit aktual të inventarizimit të pajisjeve mjekësore “CLINGO”. Gjithashtu, ky grup pune duhet të përcaktojë procedurat e inventarizimit të pajisjeve mjekësore, të dhënat që do të përfshihen në inventar, etiketimin me numër unik të identifikimit, llojin e etiketës që do të përdoret dhe elementët e sigurisë që duhet të përmbajë, regjistrin e pajisjeve mjekësore pranë çdo institucioni si dhe të dhënat që duhet të ketë historiku i pajisjes mjekësore. Një tjetër rekomandim i lënë për MSHMS-në ishte përcaktimi i strukturës përgjegjëse për administrimin, inspektimin dhe monitorimin e



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

procesit të inventarizimit të pajisjeve mjekësore.

Për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, u la si rekomandim zëvendësimi i pajisjeve mjekësore Akselerator Linear, Angiograf dhe mikroskopë të sallave operatore, në mënyrë që shërbimi ndaj pacientëve të Neurokirurgjisë të vijojë normalisht. Ndërsa Spitalit Universitar të Traumës, iu la si rekomandim zëvendësimi i pajisjes mjekësore “Grafi”, pranë shërbimit të Urgjencës.

Auditimi me temë “Politikat dhe respektimi i të drejtave të personave me problem të shëndetit mendor në shërbimin spitalor psikiatrik”, realizuar në:

SUBJEKTET

Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,
Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”,
Spitalin Psikiatrik “Dr. Sadik Dinçi” Elbasan,
Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë,
Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Shkodër,
Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Auditimi kishte si objektiv vlerësimin e politikave të hartuara si dhe praktikave të ndjekura në vendin tonë në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor.

Për këtë arsye auditimi analizoi situatën aktuale të trajtimit të ofruar për personat me çrregullime të shëndetit mendor në vendin tonë, me fokus të veçantë shërbimin shëndetësor mendor me shtretër si dhe institucionet mjekësore të posaçme, për të dënuarit me masë mjekësore.

Vitet e fundit, alarmi mbi shëndetin mendor dhe cilësinë e jetës është në rritje në mbarë botën, si një problematikë që prek, pa asnjë dallim, çdo shtresë të shoqërisë. Në këtë kontekst, sipas një raporti të BERZH-it, në radhët e 38 vendeve në

tranzicion, Shqipëria renditet e 18 për problematikën e shëndetit mendor. Në vendin tonë janë hartuar dhe miratuar politika të cilat synojnë rregullimin dhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore të ofruara kundrejt këtyre individëve, në të gjitha nivelet e shërbimit shëndetësor, në veçanti në shërbimin shëndetësor të specializuar me shtretër dhe në sistemin e burgjeve ku akomodohen individë të dënuar me masë mjekësore.

Në përfundim të auditimit u evidentua se aktualisht në vendin tonë ende nuk garantohet një shërbim shëndetësor cilësor për personat me probleme të shëndetit mendor, përfshirë këtu të dënuarit me masë mjekësore. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka pasur qasje gjithëpërfshirëse për të adresuar çështjet e shëndetit mendor në këtë shërbim, në veçanti sa i takon zgjidhjes së problemit të pacientëve rezidentë kronikë të akomoduar pranë spitalit psikiatrik të Elbasanit dhe të Vlorës, unifikimit organizativ të shërbimit; rishikimit e miratimit të rregulloreve; miratimit të protokolleve të unifikuara për zbatimin e kufizimit fizik si dhe garantimit të fondeve dhe infrastrukturës së duhur për të akomoduar këta pacientë etj.

Po kështu, mosrespektimi i marrëveshjes së bashkëpunimit për ngritjen e institucionit mjekësor të posaçëm nga MSHMS dhe Ministria e Drejtësisë, dhe vendosja e pacientëve të dënuar me masë mjekësore në regjimin penitenciar (IEVP Lezhë e Spitali i Burgut) jashtë kapaciteteve akomoduese, ka shkaktuar mos respektimin e standardeve të trajtimit njerëzor dhe dinjitoz që të gjithë individët duhet të marrin, sidomos në kushtet kur alokimet buxhetore nga institucionet përgjegjëse kanë qenë gjithmonë historike e jo të bazuara në nevojat reale të tyre. Për gjetjet e auditimit janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrë MSHMS, Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e tjera të përfshira në këtë auditim për të gjetur një sistemim alternativ për pacientët rezidentë kronikë të spitaleve



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

psikiatrike si dhe të dënuarve me masë mjekësore.

Ndër të tjera, në këtë auditim është rekomanduar edhe rishikimi dhe përmirësimi i infrastrukturës institucionale dhe fizike të shërbimit shëndetësor të specializuar me shtretër, duke synuar krijimin e kushteve të përshtatshme që këta individë të mund të trajtohen në përputhje me parimet e sanksionuara jo vetëm në legjislacionin e vendit tonë por edhe në konventat në të cilat Shqipëria ka aderuar.

Auditimi me temë “Efektiviteti dhe siguria e barnave që qarkullojnë në Shqipëri”, realizuar në:

SUBJEKTET

Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Këto dy institucione janë respektivisht përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor dhe si një njësi varësie të MSHMS, agjencia është e specializuar për regjistrimin, analizën, kontrollin e barnave dhe pajisjeve mjekësore, si dhe inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike dhe farmakovigjilencën.

Cilësia dhe siguria e barnave që qarkullojnë në tregun e hapur farmaceutik është një temë shumë e ndjeshme dhe një shqetësim i vazhdueshëm për qytetarët shqiptarë, pasi ndikon drejtpërdrejt në shëndetin e tyre dhe duhet të garantohet nga shteti nëpërmjet politikave, ligjeve, programeve dhe institucioneve përgjegjëse të ngritura për zbatimin e tyre. Disponueshmëria e ilaçeve të sigurta, efektive dhe të përbalueshme është një nga treguesit e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në vend. Në Shqipëri qarkullojnë ilaçe të importuara dhe ilaçe të prodhuara nga kompani vendase. Cilësia dhe siguria e tyre ndër

të tjera duhet të garantohet nëpërmjet kryerjes së analizave laboratorike të detyrueshme për barnat, si dhe monitorimeve periodike mbi efektet e padëshirueshme të tyre.

Ky auditim kishte si objektiv kryesor vlerësimin e politikave dhe efektivitetin e tyre, në funksion të garantimit të produkteve farmaceutike të sigurta në treg, për zgjedhje të mirë dhe cilësore, për një sistem transparence dhe informimi për rreziqet e mundshme ndaj konsumatorëve, publikut më të gjerë, si dhe rolin e institucioneve përgjegjëse në këtë drejtim. Më konkretisht ai u fokusua në: Politikat e hartuara dhe kuadrin ligjor aktual, për garantimin e cilësisë së barnave që qarkullojnë në vend; Mekanizmat e ngritur për të garantuar sigurinë dhe efektshmërinë e barit; Bashkëpunimi mes institucioneve në lidhje me monitorimin dhe procesin e tregtimit dhe vendosjes në treg të barit.

Nga auditimi ka rezultuar se AKBPM-së gjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023 nuk i është dhënë asnjë fond për investime në pajisje, mjete dhe materiale të tjera laboratorike. Laboratori i Kontrollit të Barnave është i pa akredituar dhe nuk është i përditësuar me të rejat e fundit të metodikave farmakopeale europiane.

Për periudhën 2020-2023, numri i autorizimeve /ria autorizimeve të tregtimit të barnave që qarkullojnë në vendin tonë është shumë më i lartë në krahasim me analizimin laboratorik të barnave që janë importuar ose prodhuar në vend, ku nuk janë kryer pothuajse as gjysma e analizave. Stafit nuk është i mjaftueshëm dhe i kualifikuar.

Nuk evidentohet roli mbikëqyrës i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si organi epror i AKBPM. MSHMS nuk ka ngritur dhe bërë efektive Njësine e Posaçme për kontrollin periodik, të veprimtarisë së Agjencisë me qëllim mbikëqyrjen e procesit të kontrollit të barnave. AKBPM nuk ka bashkëpunuar me MSHMS dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

të verifikuar 30 autorizimet e ministrit për barna te paautorizuara, të cilat sipas regjistrave të importimit që mban AKBPM nuk rezultojnë të importua barna që janë alternative e parë e barnave të rimbursueshme nuk janë barna të regjistruara në regjistrin e barnave, siç përcakton ligji i barnave. MSHMS nuk ka përcaktim të saktë për rastet e veçanta të importimit të barnave që janë alternative e parë në listën e barnave të rimbursueshme dhe që nuk janë të regjistruar në regjistrin e barnave. Jo të gjitha barnat e regjistrimit të barnave importohen në Shqipëri, pasi nga një kampion i përzgjedhur prej 200 barnash, 38 prej tyre nuk janë importuar në Shqipëri për periudhën 2020-2023. Gjithashtu nga 458 barna të alternativës së parë të listës II të barnave të rimbursueshme, (barna jo spitalore) 46 prej tyre nuk janë importuar në Shqipëri për vitin 2023 dhe nga ana e AKBPM nuk është bërë një analizë nëse këto barna kanë qarkulluar për 6 muajt e fundit për të marrë masa sipas përcaktimeve ligjore.

Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrë MSHMS, lidhur me politikat aktuale në funksion të garantimit të produkteve farmaceutikë të sigurta në treg, përditësimin e akteve ligjore e nënligjore për importimin e barnave. Rekomandimet kryesore të dhëna për AKBPM kanë të bëjnë me përfundimin e procesit të akreditimit të laboratorit, kalibrimin e aparaturave si dhe plotësimin e të gjitha kushteve për funksionimin e tij të plotë, plotësimin e strukturës, fuqizimin e veprimtarisë inspektuese, miratimin e rregullores për Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave pranë saj, përfundimin e procesit të pajisjes me autorizim tregtimi të barnave të cilave u ka mbaruar afati i vlefshmërisë së tyre si dhe si dhe bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në verifikimin dhe rakordimin periodik të autorizimeve të lëshuara nga MSHMS për importimin e barnave pa autorizim për tregtim.



Në fushën e mjedisit

- 1 Ndikimi i aktivitetit minerar në fondin pyjor;
- 2 Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme, në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë
- 3 Respektimi i standardeve në trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve spitalore, në parandalimin e rrezikut për shëndetin e personelit shëndetësor, pacientëve dhe mbrojtjen e mjedisit;
- 4 Zbatimi i planeve të adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike.

Auditimi me temë “Ndikimi i aktivitetit minerar në fondin pyjor” realizuar në:

SUBJEKTET

Ministrinë Turizmit dhe Mjedisit,
Agjencinë Kombëtare të Mjedisit,
Agjencinë Kombëtare të Pyjeve,
Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë,
Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore,
Bashkitë: Selenicë, Skrapar, Krujë, Dimal, Berat.

Roli jetësor i pyjeve, mbrojtja dhe menaxhimi i tyre i qëndrueshëm janë të domosdoshëm për të siguruar një të ardhme të shëndetshme për njerëzit dhe planetin. Referuar dokumenteve zyrtare, vendi ynë nuk po kalon një situatë të mirë sa i përket pyjeve. Sipas të dhënave të INSTAT, shumë shqetësuese shfaqet rënia e volumit të pyjeve me rreth 40% në 15 vitet e fundit, ku në vitin 2022 volumi ishte rreth 50 milionë kub, krahasuar me 80 milionë kub në vitin 2006. Objektivi kryesor i këtij auditimi ishte vlerësimi dhe analizimi i masave të marra nga institucionet përgjegjëse me qëllim mbrojtjen e fondit pyjor nga aktivitetit minerar.



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

Nga auditimi ka rezultuar se procesi i heqjes nga fondi pyjor për lejet minerare pajisura me leje shfrytëzimi dhe leje mjedisi pothuajse në shumicën e rasteve nuk finalizohet me dokumentin për heqjen e fondit pyjor. Mungesa e koordinimit të kompetencave dhe mungesa e koherencës në aktet rregullatorë në inicimin dhe vazhdimin e aktivitetit mineral në fond pyjor dhe mangësitë në plotësimin e infrastrukturës ligjore dhe logjistike, kanë sjellë menaxhim të dobët të ekonomive pyjore, në nivel qendror dhe vendor. Nga institucionet qendrore dhe vendore, nuk ka pasur inspektime dhe monitorime periodike për aktivitetin mineral që ndikon në fondin pyjor në lidhje me detyrimet për rehabilitimin e mjedisit, ripyllëzimet, parandalimin e dëmtimit të fondit pyjor dhe ruajtjen e tij nga aktiviteti i paligjshëm. Në Bashkitë Dimal, Berat, Çorovodë, Selenicë dhe Krujë, subjektet e pajisur me leje minerare që ndikojnë në fondin pyjor nuk disponojnë kontrata mbi marrjen e detyrimit të përcaktuar për pyllëzimin, ripyllëzimin apo përmirësimin e fondit pyjor të hequr si pasoje e aktivitetit mineral.

Në këtë auditim janë dhënë disa rekomandime për subjektet nën auditim ku ndër më kryesoret janë si më poshtë:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, AKBN, në bashkëpunim dhe koordinim midis tyre, të vlerësojnë gjendjen reale të fondit pyjor në vend dhe të marrin masa për hartimin dhe përditësimin të kuadrit rregullator strategjik dhe monitorimin sipas planeve të veprimit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve të marrin masa për fillimin e procesit të inventarizimit kombëtar të pyjeve në rang vendi, duke bashkërenduar punën me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për regjistrimin e ekonomive pyjore sipas planeve të mbarështimit për çdo NJQV. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes

Vendore të marrin masa për hartimin dhe përditësimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore dhe mbikëqyrjen e tyre për arritjen e objektivave strategjike, të përcaktuar në Dokumentin e Politikave të Pyjeve. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, AKBN si dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore pjesëmarrëse në këtë proces, të marrin masa që sipas kompetencave dhe përgjegjësisë funksionale të përditësojnë aktet rregullatorë në mënyrë që procesi i heqjes nga fondi pyjor i këtyre sipërfaqeve të kryhet paralel me marrjen e lejes së shfrytëzimit dhe mjedisit dhe pa mbylljen e këtij procesi të mos zbardhet leja e mjedisit dhe e shfrytëzimit të aktivitetit. Nga ana tjetër të konsiderohet hartimi i një formati leje më vete me përmbajtje dhe detyrime, e cila do të kushtëzojë mos fillimin e aktivitetit mineral, pa u kryer heqja nga fondi pyjor e sipërfaqes ku do të punojë subjekti, i cili e ka marrë lejen e aktivitetit mineral.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe AKBN, gjatë inspektimeve në mënyrë periodike, të marrin masa administrative për të gjithë subjektet minerare, të cilët nuk respektojnë zbatimin e të gjitha kushteve të lejes mjedisore dhe lejes minerare. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, AKBN dhe Bashkitë Krujë, Selenicë, Skrapar, Berat, Dimal në bashkëpunim, të marrin masa për rillogaritjen me vlerat e reja të rritura të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit nga subjektet me aktivitet mineral që ndikojnë në fondin pyjor dhe arkëtimin e tyre si dhe të ndjekë realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit prej tyre.



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

Auditimi me temë “Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme, në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë”, realizuar në:

SUBJEKTET

Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë e Korçë.

Objektivi kryesor i këtij auditimi ishte vlerësimi dhe analizimi i masave të marra nga institucionet përgjegjëse mbi mënyrën e menaxhimit të mbetjeve urbane, ndikimin që ato kanë në buxhetin e shtetit, si dhe impaktin në shëndetin e popullsisë që jetojnë në afërsi të zonave ku bëhet depozitimi final i mbetjeve urbane.

Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, rregullon organizimin dhe funksionimin e njësisive të qeverisjes vendore dhe të organeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre. Në mënyrë të veçantë, “grumbullimi, transportimi, asgjësimi dhe trajtimi i mbetjeve bashkiake” është përcaktuar si një funksion “i veti” i bashkive. Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtë dhe përgjegjësi, për:

- organizimin për ofrimin e shërbimit të grumbullimit, transportimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve bashkiake;
- ndërtimin, pronësinë dhe operimin e objekteve të trajtimit;
- vendosjen e tarifave të shërbimit për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimit dhe mbledhjen e të ardhurave;
- organizimin dhe shpërndarjen e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në vetë bashkinë dhe/ose në bashkëpunim me një ose më shumë bashki të tjera, duke përdorur të gjitha instrumentet ligjore dhe administrative.

Mbetjet urbane, nëse nuk grumbullohen, trajtohen dhe asgjësohen në mënyrën e duhur mund të kthehen në kërcenim serioz për shëndetin e njerëzve dhe mund të shkaktojnë ndikime mjedisore negative në ajër, ujë e tokë.

Nga auditimi rezultoi se menaxhimi i mbetjeve urbane vijon të mbetet një sfidë e vazhdueshme për Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë. Këto bashki nuk kanë garantuar menaxhim të integruar të mbetjeve urbane duke mos zbatuar hierarkinë e mbetjeve në drejtim të parandalimit, ripërdorimit, reduktimit dhe riciklimit. Gjithashtu, këto bashki nuk kanë arritur të minimizojnë kostot e menaxhimit të mbetjeve për të përfituar të ardhura nëpërmjet metodologjisë së trajtimit të tyre.

Në veçanti, në Bashkinë Durrës, menaxhimi i mbetjeve urbane nuk garanton qëndrueshmëri financiare sepse nuk mbulohen shpenzimet me të ardhurat e krijuara. Ndërsa, menaxhimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Vlorë përveç se nuk respekton standardet mjedisore, shkakton probleme serioze shëndetësore në komunitet si dhe efekte negative në ekonominë lokale dhe turizmin bregdetar. Është e rëndësishme që këto bashki të angazhohen për të ndryshuar këtë situatë dhe për të krijuar një mjedis sa më të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë.

Bashkisë Durrës ju la si rekomandim ngritja e një grupi pune për të analizuar kostot e larta të menaxhimit të mbetjeve urbane që rëndojnë financat e saj, duke u orientuar drejt reduktimit të sasisë së mbetjeve që shkojnë në lëndfill, investimit në infrastrukturë për riciklim, si dhe shqyrtimit të alternativave të tjera të depozitimit të mbetjeve në distancë më të afërt. Gjithashtu, Bashkive Durrës dhe Vlorë ju la si rekomandim hartimi dhe miratimi i një plani lokal të mirë detajuar për të rritur mbledhjen e tarifës së pastrimit, uljen e debitorëve dhe në bashkëpunim me Ndërmarrjet e Ujësjellës Kanalizime Durrës dhe Vlorë të rrisin arkëtimet e kësaj tarife.



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

Një tjetër rekomandim ishte edhe grumbullimi i diferencuar i mbetjeve për ripërdorimin/riciklimin e letrës, plastikës, metalit dhe qelqit si dhe kryerja e procesit të kompostimit lidhur me mbetjet bio, i cili ju adresua Bashkive Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë.

Bashkive Korçë, Shkodër dhe Durrës, gjatë përgatitjes së planeve të reja vendore të menaxhimit të mbetjeve urbane ju la si rekomandim specifikimi i tyre me objektiva konkretë e të matshëm lidhur me sasinë e mbetjeve që do të reduktohen, ripërdoren e riciklohen si dhe përcaktimi i qartë i strukturave monitoruese e raportuese.

Auditimi me temë “Respektimi i standardeve në trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve spitalore, në parandalimin e rrezikut për shëndetin e personelit shëndetësor, pacientëve dhe mbrojtjen e mjedisit”, realizuar në:

SUBJEKTET

Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Spitalet Rajonale Shkodër, Durrës, Korçë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbikëqyr zbatimin e strategjive dhe politikave të zhvillimit spitalor si dhe garanton standardet e shërbimit spitalor publik. Spitalet Rajonale, në cilësinë e prodhuesve të mbetjeve spitalore kanë për detyrë të marrin marrë masat e nevojshme për mirë administrimin e mbetjeve spitalore të gjeneruara nga aktiviteti i tyre.

Një pjesë e mbetjeve spitalore për shkak se paraqesin veti infektive klasifikohen si mbetje të rrezikshme. Këto lloj mbetjesh duhet të menaxhohen në mënyrë të tillë, për të mos vënë në rrezik shëndetin e njeriut, duke u kujdesur të mos përdoren procese ose metoda që mund të dëmtojnë shëndetin apo mjedisin. Sipas të dhënave mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve, rreth 1/5 e totalit të mbetjeve spitalore i përkasin kategorisë së mbetjeve të rrezikshme spitalore, nga të cilat pjesën

dërrmuese e zënë mbetjet infektive.

Ky auditim kishte si objektiv, vlerësimin e masave të ndërmarra nga spitalet rajonale dhe ministria e linjës, mbi menaxhimin e mbetjeve spitalore dhe efektivitetin e tyre. Auditimi u fokusua në disa shtylla kryesore si më poshtë:

- kuadri ligjor dhe rregullator që rregullon këtë fushë veprimtarie,
- menaxhimi i mbetjeve referuar standardeve sa i përket ndarjes në burim, grumbullimit, ruajtjes, përpunimit deri në asgjësimin e tyre,
- masat e marra për parandalimin e infeksioneve dhe mbrojtjen e mjedisit,
- kapacitetet e disponuara në infrastrukturë, burime njerëzore lidhur me administrimin e mbetjeve spitalore,
- funksionimin e sistemeve të kontrollit dhe monitorimin e proceseve.

Nga auditimi rezultoi se prodhuesit e mbetjeve spitalore (spitalet rajonale), nuk kanë respektuar masat për administrimin e mbetjeve spitalore të gjeneruara, për sa i përket ndarjes në burim të mbetjeve spitalore, ambalazhimit, etiketimit, magazinimit, trajtimit, transportimit dhe asgjësimit në mënyrën më të mirë të përshtatshme. Ndërkohë, në MSHMS evidentohen paqartësi dhe mungesë e strukturave përgjegjëse në fushën e mbetjeve spitalore, duke mos arritur të përmbushë plotësisht rolin e saj. Baza ligjore e rregullatore e pa përditësuar me legjislacionin aktual, mungesa e mbikëqyrjes direkte mbi spitalet publike kanë krijuar hapësirë për zhvillimin e veprimtarisë duke mos plotësuar standardet e përcaktuara.

Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrë MSHMS, lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor e rregullator mbi menaxhimin e mbetjeve nga spitalet rajonale, kontrollin e infeksioneve spitalore, forcimin e bashkëpunimit me ministrinë përgjegjëse në fushën e mjedisit dhe njësisive në varësi të saj të cilat merren drejtpërdrejtë me verifikimin e



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

përmbushjes së standardeve në trajtimin e mbetjeve si dhe ngritjen prej saj të një mekanizmi efektiv kontrolli dhe/ose monitorimi mbi menaxhimin e mbetjeve spitalore nga spitalet rajonale.

Për spitalet rajonale janë dhënë rekomandime për të rishikuar aktet e brendshme rregullatore mbi administrimin e mbetjeve spitalore dhe t'i përshtatin ato me kërkesat e ligjit përkatës mbi menaxhimi e mbetjeve, të përditësojnë planet e administrimit të mbetjeve, të kryejnë në kohë raportimet e nevojshme mbi transferimin e mbetjeve, të marrin masa për përmirësimin e proceseve dhe kushteve të transportimit dhe magazinimit të përkohshëm të mbetjeve, të përmirësojnë procesin e evidentimit, regjistrimit dhe raportimit të infeksioneve spitalore, të kryejnë trajnime të vazhdueshme të stafit mbi këto procese etj.

Auditimi me temë “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike”, realizuar në:

SUBJEKTI

Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)

Ndryshimet Klimatike përfshijnë jo vetëm rritjen e temperaturave, por edhe ngjarjet ekstreme të motit, rritjen e nivelit të detit, zhvendosjen e popullatave dhe habitateve të kafshëve të egra.

Gjatë dekadave të fundit janë konstatuar një numër i konsiderueshëm ndryshimesh që vijnë si rezultat i aktiviteteve njerëzore. Problemet e lidhura me ndryshimet klimatike janë komplekse dhe rrjedhimisht kërkojnë bashkëpunim të shëndoshë ndërinstytucional për arritjen e objektivave.

Ky auditim kishte si objektiv kryesor vlerësimin e implementimit të Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike. Më

konkretisht ai u fokusua në:

- Ngritjen, themelimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të strukturave të nevojshme që do të monitorojnë arritjen e objektivave kombëtare lidhur me ndryshimet klimatike;
- Ngritjen e një sistemi monitorim-vlerësimi, i cili ndjek statusin e zbatimit të veprimeve prioritare të Planit të Adaptimit ndaj Ndryshimeve Klimatike;
- Ngritjen e një strukture të dedikuar për nxitjen dhe përthithjen e financimeve klimatike;
- Vlerësimin dhe krahasimin e ecurisë ndër vite të projekteve dhe financimeve të përthithura për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Nga auditimi ka rezultuar se MTM nuk ka luajtur një rol proaktiv në respektim të nismës integruese gjithëpërfshirëse për procesin e NAP. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, si një qasje relativisht e re, ende nuk mbështetet me kapacitete adekuate në vend. Nuk është krijuar një sistem i mirëfilltë monitorimi dhe vlerësimi dhe pjesa më e madhe e financimit lidhur me ndryshimet klimatike në Shqipëri është shumë e varur nga komuniteti ndërkombëtar dhe donatorët. Procesi i koordinimit ndërinstytucional mes MTM dhe institucioneve të linjës apo të varësisë sa i përket në angazhimin në trajnime lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike ka qenë i cunguar. Kjo sepse, këto institucione nuk përcaktojnë persona apo struktura përgjegjëse, në përputhje dhe me përshtatjet e tyre të punës, të cilët mund të shërbejnë si pika kontakti dhe koordinimi me MTM në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme, në lidhje me forcimin e kapaciteteve për ndryshimet klimatike. MTM nuk ka monitoruar çdo vit progresin dhe suksesin e veprimeve prioritare të Planit Kombëtar i Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike. Nga viti 2019 e në vijim MTM duhet të kishte gjeneruar çdo vit një progres raport



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

lidhur me zbatueshmërinë e veprimeve prioritare dhe realizimin e objektivave të tyre. Mirëpo, i vetmi raport i progresit të Planit Kombëtar i Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike, është ai i hartuar në vitin 2023, i cili është hartuar në bashkëpunim me UNDP dhe nuk ka fuqi juridike pasi nuk është miratuar. Në MTM nuk është krijuar sektori i financimit klimatik.

Referuar Strategjisë së Ndryshimeve Klimatike, ky sektor duhet të ishte krijuar që në vitin 2020, me qëllim kryerjen e analizave për nxjerrjen e mësimave dhe novacionit për financimet klimatike. Autoriteti Kombëtar i përcaktuar nuk është krijuar me VKM. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të MTM-së, duhet të miratojë vendimin për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër në kuadër të Protokollit të Kyoto-s. Gjithashtu, nuk ka një dokument të miratuar i cili sanksionon procedurën për aplikim për fonde e projekte, lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Nuk ka një afat të përcaktuar për kohëzgjatjen e miratimit të projektit të miratuar me akt të posaçëm.

Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrë MTM lidhur me ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për monitorimin e objektivave kombëtare lidhur me ndryshimet klimatike, themelimin e një strukture të dedikuar për nxitjen, aplikimin dhe përthithjen e financimeve klimatike nga institucioneve të ndryshme veçanërisht ndërkombëtare si dhe monitorim e vlerësim të vazhdueshëm të tyre.



Në fushën sociale dhe barazisë gjinore

- 1 Procesi i birësimit të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirërritje dhe edukim;
- 2 Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës.

Auditimi me temë “Procesi i birësimit të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirërritje dhe edukim” realizuar në:

SUBJEKTET

Komitetin Shqiptar të Birësimeve,
Ministrinë e Drejtësisë, Shërbimin Social Shtetëror,
Institucionet Rezidenciale të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijë dhe
Bashkinë Fier.

Garantimi i të drejtave të fëmijëve, në veçanti i fëmijëve të braktisur, është një prioritet thelbësor për zhvillimin e një shoqërie të shëndetshme dhe solide. Në vendin tonë procedura e birësimit shoqërohet me një praktikë administrative dhe gjyqësore përmes së cilës fëmijës, i cili është shpallur i braktisur dhe është privuar nga mjedisi familjar, i sigurohet një jetë e re. Autoriteti i vetëm qendror në Shqipëri, në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në fushën e birësimit, vendas dhe ndër vendas është Komiteti Shqiptar i Birësimeve (KSHB), i cili është krijuar në vitin 1993. Prej krijimit të tij, Komiteti Shqiptar i Birësimeve ka realizuar 1857 birësime vendase dhe ndër vendase. Birësimi i prodhon efektet e tij nga data që vendimi i gjykatës merr formë të prerë dhe është i përvokueshëm, duke e kaluar kujdestarinë ligjore të fëmijës tek prindërit birësues.

Ky auditim kishte si objektiv kryesor analizimin e procesit të birësimit të fëmijëve në vendin tonë me një fokus të veçantë në garantimin e të drejtave të tyre në gjirin e familjes birësuese përgjatë këtij procesi kaq delikat.



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

Më konkretisht ai u fokusua në:

- Analizimin e bazës ligjore aktuale në fushën e birësimit;
- Analizimin e procesit të birësimit në të gjithë elementët e tij, duke trajtuar edhe casus (raste) konkrete.

Në përfundim të auditimit u evidentua se baza ligjore që rregullon birësimet në vendin tonë nuk është e plotë dhe nuk reflekton në shkallën më të lartë praktikën më të mira ndërkombëtare sidomos në drejtim të vendosjes së një kufiri maksimal të moshës së birësuesit/birësuesve; përcaktimit të kriterit të qëndrueshmërisë dhe sigurisë së lidhjes martesore në kohë për aplikantët birësues të martuar; si dhe përcaktimit të kriterëve ekonomike sa më të sakta për aplikantët birësues. Gjithashtu, u evidentuan mangësi dhe problematika në lidhje me procesin e birësimit në vetvete, sidomos në drejtim të: ngritjes së strukturave të Komitetit sipas përcaktimeve të ligjit; raportimit, monitorimit të veprimtarisë së Institucionit të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijë si dhe Komitetit Shqiptar të Birësimeve; procesit të njohjes, miratimit, licencimit dhe mbikëqyrjes të agjencive ndërmjetësuese të huaja; si edhe mbikëqyrjes nga ana e Ministrisë së Drejtësisë së këtij procesi.

Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrë Komiteti Shqiptar i Birësimeve, Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e tjera subjekt i këtij auditimi lidhur me përditësimin e bazës ligjore/nënligjore në fushën e birësimeve bazuar edhe në praktika të tjera më të mira ndërkombëtare; rishikimin e strukturës organike të Komitetit; analizimin e profileve të aplikantëve birësues gjatë procesit të dhënies së përshtatshmërisë; ndjekjen e përshtatshme të procesit të atashimit prind – fëmijë; ndjekjen dhe monitorimin e duhur të ecurisë pas birësuese; dokumentimin e duhur të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Komitetit për të siguruar që në çdo moment mbrohet interesi më i lartë i fëmijës etj.

Auditim me temë “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”, realizuar në:

SUBJEKTET

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

13 bashki të vendit: Bashkia Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër, Krujë, Elbasan, Kavajë, Divjakë, Lushnje, Pogradec, Berat, Vlorë, Gjirokastrë.

Ky auditim kishte si objektiv kryesor vlerësimin e shërbimeve të ofruara për nxitjen e punësimit të grave në zonat rurale, duke u fokusuar kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë në realizimin e objektivave të tyre institucionale.

AKPA ka si detyrë, të sigurojë përmbushjen e të drejtës së shtetasve, për t’u trajtuar me shërbime dhe programe publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimeve profesionale, me qëllim gjetjen e një pune të përshtatshme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve. Nga ana tjetër bashkitë e vendit kanë detyrimin të sigurojnë qeverisjen e efektshme dhe në një nivel sa më afër qytetarëve. Numri i lartë i subjekteve të përzgjedhura u bë për të vlerësuar angazhimin e institucioneve në nivel vendor lidhur me nxitjen e punësimit të grave në zonat rurale në territorin e tyre.

Megjithëse në Shqipëri gratë luajnë një rol të rëndësishëm në sektorin e bujqësisë pasi përbëjnë rreth 55% të forcave të punës, ato drejtojnë vetëm 7% të fermave bujqësore dhe blegtorale të vendit. Janë të shumta sfidat dhe kushtet me të cilat punojnë gratë në zonat rurale. Në procedurat e ndjekura për t’u përfshirë në tregun e punës ato shpesh hasin problematika si për shembull: për të bërë aplikime, për të hapur një biznes, apo për të drejtuar një biznes në këto prona etj. Faktorë të tjerë që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në punësimin e grave nga zonat rurale janë edhe problematika që dalin nga infrastruktura, zona ku jetojnë, mungesa e transportit, ujit të



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

pijshtëm, mungesa e qendrave shëndetësore 24 orë si dhe e çerdheve dhe kopshteve me drekë.

Nga auditimi ka rezultuar se nxitja e programeve të punësimit (për vitet 2020-2023) për gratë janë të përgjithshme dhe nuk japin plotësisht panoramën e gjithë rajoneve referuar vlerësimit të nevojave. Infrastruktura vendore nuk nxit përfshirjen e grave rurale në tregun e punës, pasi në zonat rurale mungojnë çerdhet, ndërsa shërbimi i kopshteve nuk ofrohet në të gjitha njësitë administrative rurale si dhe mungon transporti publik nga njësia qendër drejt të gjitha njësive administrative të bashkive. AKPA, nuk ka ngritur pika shërbimi në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të cilat nuk kanë zyra vendore punësimi, sikundër është përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisë. Komunikimi midis strukturave qendrore dhe vendore nuk identifikon nevojat e grave në përgjithësi dhe grave rurale në veçanti. Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të merren nga AKPA lidhur me nevojat reale të grave në zonat rurale për shërbimet e programeve të nxitjes së punësimit, në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të këtyre programeve duke përfshirë edhe kategorinë “gra në zonat rurale”, bashkëveprimin me Ministrinë e Financave për zonat dhe sektorët prioritarë, kryerjen e planifikimeve të nevojshme buxhetore në këtë drejtim, zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore për hapjen e kurseve profesionale, monitorimin e kushteve të marrëveshjeve të lidhura me bashkitë, si dhe monitorimin në vijimësi të aktiviteteve të zhvilluara në përmbushje të objektivave të Strategjisë Kombëtare të Punësimit. Për njësitë e vetëqeverisjes vendore është rekomanduar marrja e masave për të vlerësuar situatën aktuale në zonat rurale, mbulimin e tyre me çerdhe dhe kopshte si dhe hartimin e planeve të investimit në varësi të nevojave, mbulimin e zonave me transport publik dhe lidhjen e tyre me zonat urbane etj.



Në fushën e arsimit, shkencës dhe kulturës

- 1 Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës) nga Ministria e Arsimit dhe Sportit
- 2 Orientimi për Karrierë i të Rinjve në Sistemin Arsimor Parauniversitar
- 3 Mbrojtja e vlerave dhe pasurisë së vendit tonë në UNESCO
- 4 Projektet kërkimore-shkencore të realizuara nga Akademia e Shkencave, në nxitjen e përparimit shkencor, teknologjik dhe inovacionit, për të mirën e vendit

Auditimi me temë “Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore - Fondi i ekselencës”, realizuar në:

SUBJEKTI

Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky auditim kishte si objektiv kryesor vlerësimin e politikave dhe efektivitetit të institucioneve përgjegjëse duke u fokusuar kryesisht në: procesin e përfitimit të bursave për studimet jashtë vendit për studentët e ciklit të parë të ciklit të dytë dhe doktoratës; si dhe mbështetjen financiare të nëpunësve civilë për studimet jashtë vendit.

Arsimi i Lartë në Shqipëri, ashtu si në vendet e zhvilluara, konsiderohet një shërbim publik dhe e mirë publike, pavarësisht nga forma e pronësisë. Për rrjedhojë, një nga qëllimet kryesore të reformave arsimore është të ruajë parimet bazë të këtij arsimit, pra mundësi të barabarta, pa diskriminim dhe mbështetje për



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

shtresat në nevojë; konkurrencë e lirë mes institucioneve të arsimit të lartë, personelit akademik dhe studentëve; mundësi për të gjithë mbi bazën e meritës; mbështetje të përparësive strategjike të zhvillimit të vendit nëpërmjet kërkimit shkencor.

Në vendin tonë ka një shqetësim në rritje për largimin e të rinjve nga vendi. Çdo vit, afro 10% e numrit të studentëve, sipas autoriteteve zyrtare zgjedhin të studiojnë jashtë vendit. Ekspertët e shohin me shqetësim këtë fenomen, bazuar në disa sondazhe që thonë se 94 % e atyre që studiojnë jashtë nuk dëshirojnë të kthehen, ndaj është shumë e rëndësishme që nëpërmjet politikave të mirë studiuar, arsimore e të punësimit, të frenohet largimi i të rinjve si dhe të nxitet kthimi i tyre në vend. Bazuar në rëndësinë që ka arsimit të lartë dhe reforma arsimore universitare e cila mbetet një nga temat më të rëndësishme publike në vend, është krijuar edhe "Fondi i Ekselencës" që drejtohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, e cila mbështet studentë dhe shkencëtarë të rinj të shkëlqyeshëm që pranojnë të ndjekin një program studimi master ose doktoratë në një nga 15 IAL-të më të mira të botës, sipas renditjes së Times Higher Education (QS - World University Rankings) për vitin më të fundit.

Nga auditimi ka rezultuar se procesi i realizimit, zbatimit, analizimit dhe monitorimit të Fondit të Ekselencës për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civil ka mbivendosje dhe anashkalim të përgjegjësive nga punonjësit dhe strukturat përgjegjëse. Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe strukturat e saj nuk kanë monitoruar në mënyrë të vazhdueshme, rast pas rasti procesin e mbështetjes financiare nga (Fondi i Ekselencës) të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civil nga fillimi deri në përfundimin e tij. Gjithashtu është konstatuar mos inicim dhe përfundim i procedurave ligjore për ata që nuk kanë përmbushur aktmarrëveshjet e

nënshkruara me MAS.

Në këtë auditim janë dhënë rekomandime për masat që duhet të marrë Ministria e Arsimit dhe Sportit lidhur me monitorimin e performancës dhe ecurisë së Fondit të Ekselencës për periudhën 2014 - 2023, përditësimin dhe harmonizimin në kohë të kuadrit ligjor e rregullator të Fondit të Ekselencës si dhe ndarjen e roleve e detyrave ndërmjet strukturave përgjegjëse në lidhje me ecurinë e Fondit të Ekselencës në ndjekjen e proceseve gjyqësore për të gjithë rastet e mos zbatimit të detyrimeve kontraktuale të studentëve përfitues. Rekomandimet kanë adresuar edhe plotësimin e dosjeve me dokumentet periodikë për çdo përfitues të Fondit të Ekselencës deri në përfundimin e ciklit studimor si dhe kryerjen e inventarizimit të tyre, monitorimin e akt marrëveshjeve të lidhura për fondin e ekselencës dhe respektimin e detyrimeve kontraktuale.

Auditimi me temë "Orientimi për Karrierë i të Rinjve në Sistemin Arsimor Parauniversitar", realizuar në:

SUBJEKTET

Ministrinë e Arsimit dhe Sportit,
Agjencinë Kombëtare të Arsimit
Parauniversitar
Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në
Arsimin Parauniversitar.

Ky auditim ka pasur si objektiv kryesor vlerësimin e vizionit politikë bërës mbi këtë proces dhe mekanizmat e ngritura për realizimin e tij.

Realiteti bashkëkohor, karakterizohet nga ndryshime dinamike, për shkak të evoluimeve teknologjike, ekonomike, politike dhe sociale, e për pasojë, nxënësit përballen me sfida në fushën e të mësuarit, punësimit dhe kohezionit social. Arsimit është një mjet i fuqishëm për



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

zhvillimin e aftësive për punësim dhe produktivitet, ndaj prioritet për sistemin arsimor parauniversitar në Shqipëri duhet të jetë jo vetëm krijimi i kushteve dhe mundësive që nxënësit të ndërtojnë kompetenca, por dhe të këshillohen, informohen dhe orientohen për të përballuar me sukses sfidat e jetës dhe të tregut të punës.

Në përfundim të tij u evidentua se “Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021 - 2026”, nuk përmban asnjë parashikim specifik lidhur me objektivat politike për orientimin e karrierës së nxënësve, sikurse edhe ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk ka asnjë parashikim apo rregullim të drejtpërdrejtë të procesit të orientimit për karrierë të nxënësve, në sistemin arsimor parauniversitar. Rrjedhimisht, në MAS dhe institucionet e varësisë, Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore, nuk ka njësi të dedikuara për orientimin e karrierës, sikurse po ashtu nuk parashikohen fonde buxhetore të dedikuara për këtë në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar. Urdhrat e Ministrit të Arsimit dhe Sportit për procesin e orientimit të karrierës, duke filluar nga viti 2023, rezultojnë të jenë të pa analizuar mirë, fragmentarë, me terminologji të pa unifikuar dhe të pazbatueshëm. Nga ana tjetër, mungojnë analiza dhe monitorime nga ana e MAS mbi ecurinë e procesit të orientimit pavarësisht raportimeve të institucioneve të varësisë.

Për këto arsye, në këtë auditim është rekomanduar që MAS dhe institucionet e varësisë të inkurajojnë një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që orientimi për karrierën të realizohet përmes kurrikulës dhe përmes veprimtarive ekstra - kurrikulare, duke synuar përmirësimin e kuadrit rregullator dhe strategjik të procesit të orientimit për karrierë të nxënësve, si dhe përmirësimin e koordinimit

dhe raportimit midis institucioneve përgjegjëse të sistemit të arsimit parauniversitar, në realizimin e procesit të orientimit për karrierë.

Auditimi me temë “Mbrotja e vlerave dhe pasurisë së vendit tonë në UNESCO”, realizuar në:

SUBJEKTET

Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI),
Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ),
Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK),
Bashkitë Durrës, Rrogozhinë, Fier, Berat, Gjirokastrë dhe Pogradec.

Objekti kryesor i këtij auditimi ishte vlerësimi i masave të marra nga institucionet përgjegjëse, në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore/kulturore natyrore materiale dhe jomateriale me vlera të jashtëzakonshme universale.

Vendi ynë duke njohur rëndësinë që ka ruajtja, mbrojtja apo konservimi i trashëgimisë kulturore/ kulturore natyrore materiale dhe jo materiale me vlerë të jashtëzakonshme universale, si dhe duke marrë parasysh ndërvarësinë midis tyre si përmbledhëse të diversitetit kulturor, ka ratifikuar dy konventa ndërkombëtare që kanë si qëllim ruajtjen dhe konservimin e trashëgimisë të klasifikuar si të njëjti interes të jashtëzakonshëm.

Disa nga problematikat kryesore që rezultuan lidhen me mos hartimin dhe mos miratimin e rreth 46% të akteve nënligjore për trashëgiminë kulturore edhe pse afatet për miratimin e tyre kanë kaluar me 3 - 4 vite. Në strukturën organizative të MEKI-t, nuk ka një njësi që të jetë përgjegjëse për koordinim e punës midis institucioneve në nivel qendror dhe nivel vendor si për shembull: për hartimin e dokumentacionit të dosjeve të kandidimit, përcjelljen e tyre në UNESCO, për zbatimin e rekomandimeve, përkthimin e materialeve në mënyrë sa më



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

profesionale, arkivimin e dosjeve etj. Shqipëria nuk ka të përcaktuar në kuadrin ligjor në fuqi detyrimin që çdo projekt që kryhet në sitet e trashëgimisë kulturore duhet të marrë më parë “Vlerësim të Ndikimit në Trashëgimi (HIA)”.

Konstatohet se Shteti Shqiptar ka anashkaluar rekomandimin e misioneve të Komitetit të UNESCO-s për projektin infrastrukturor të Bypass-it të Gjirokastrës i cili ka vijuar zbatimin pa u bërë më parë HIA. Lidhur me pasurinë natyrore kulturore të Liqenit të Ohrit, Shqipëria në vijimësi ka shpërfillur rekomandimet e Komitetit të UNESCO-s për projektin e Parkut Ujor Drilon – Tushemisht, i cili është konsideruar si i pa përshtatshëm nga Komiteti pasi ka dështuar në marrjen në konsideratë të Vlerave të Jashtëzakonshme Universale të Liqenit të Ohrit.

MEKI nuk ka marrë asnjë masë konkrete për të adresuar zbatimin e rekomandimeve që kanë lënë misionet e UNESCO-s, si dhe nuk ka informacion se çfarë bën apo duhet të bëjë secila strukturë. Nuk rezulton të jenë marrë masa konkrete për plotësimin e kriterëve për regjistrimin në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, të pasurive që janë në Listën Tentative, si dhe për asnjërën nuk ka filluar puna për përgatitjen e dosjes së nominimit edhe pse kanë kaluar vite dhe dekada që kur janë futur në listën tentative. Gjithashtu, nuk është hartuar “Lista e elementëve” me të cilët mund të kandidohet në Listat e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të UNESCO-s.

Disa prej rekomandimeve kryesore të adresuara në këtë auditim janë si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, të marrin masa për të hartuar dhe bërë të mundur përfshirjen në kuadron ligjor / nënligjor vendas, detyrimin që projektet të cilat do të zhvillohen

në sitet e trashëgimisë kulturore t’i nënshtrohen Vlerësimin të Ndikimit në Trashëgimi (HIA).

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të marrë masa për të krijuar një bashkëpunim më efektiv me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore që kanë pasuri kulturore / kulturore natyrore në territorin e tyre pjesë e listave të UNESCO-s, duke dokumentuar komunikimin për çdo çështje, problematikë apo rekomandime të UNESCO-s që i përket pasurive me vlera të jashtëzakonshme universale.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që të planifikojë në buxhetin vjetor fonde të cilat identifikohen si zëra specifikë, duke u adresuar për financime dhe investime për trashëgiminë kulturore në tërësi, si dhe pasuritë që janë pjesë e UNESCO-s dhe në listën tentative.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor, të marrë masat për të kryer një vlerësim të nivelit të realizimit të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Kulturën dhe në vijim të përditësojë Planin e Veprimit të saj për vitin 2025.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të marrë masa për të hartuar udhëzimin për mënyrën e funksionimit të Komisionit Këshillimor, udhëzimin për përpilimin e Katalogut Kombëtar të Pasurive Kulturore, dhe të përfundojë procesin e përzgjedhjes së listës së ekspertëve vlerësues të vlerave kulturore të pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe jomateriale.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit / Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, referuar Regjistrin të Vlerave të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, në bashkëpunim me ekspertët e fushës të hartojë listat e elementëve me të cilët mund të kandidohet në listat e UNESCO-s, dhe bazuar në këto elementë të bëhet një plan për plotësimin e dosjeve të kandidimit me ekspertët e fushës.



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

Auditimi me temë “Projektet kërkimore-shkencore të realizuara nga Akademia e Shkencave, në nxitjen e përparimit shkencor, teknologjik dhe inovacionit, për të mirën e vendit”

SUBJEKTI

Akademia e Shkencave të Shqipërisë

Institucioni i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nuk ka pasur në traditë punë me projekte të mbështetura në buxhetin e saj. Tradita e mëhershme e ngarkimit të saj me detyra projektimi të nivelit qeveritar dhe institucional, me shuarjen e 13 instituteve në vitin 2007, u ndërpre.

Me miratimin e Ligjit nr. 53/2019, veprimtarisë shkencore të ASH-së përmes botimeve dhe konferencave, iu shtuan edhe projektet si një dukuri e re në zhvillimin e progresin e saj. Përmes tyre janë përfshirë në kërkim studiues e profesorë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, si dhe nga komunitetet arbëreshe.

Ky auditim ka pasur objektiv kryesor vlerësimin e paanshëm të procesit administrativ të ASH-së sa i përket aplikimit, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve dhe kërkimeve shkencore të financuara prej saj, për periudhën 2019 - 2023.

Në përfundim u evidentua se, Akademia e Shkencave nuk ka siguruar një menaxhim të përshtatshëm të veprimtarisë lidhur me projektet e kërkimit shkencor. Institucioni nuk ka hartuar një plan strategjik zhvillimor institucional, i cili do të duhej të shpaloste qartë

misionin dhe vizionin e tij, të mundësonte përparësitë strategjike, menaxhimin e burimeve, vlerësimin e performancës si dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk ka siguruar një menaxhim të duhur të dokumentimit të veprimtarisë, lidhur me projektet e kërkimit shkencor duke qenë se mungon një rregullore e qartë për mënyrën e organizimit, orientimit dhe përcaktimit të kriterëve që duhet të përmbushin projektet e propozuara. Gjithashtu rezulton se nuk janë përmirësuar metodikat dhe udhëzuesit mbi programimin, shpalljen e thirrjes për projekte, realizimin, financimin, kontrollin e brendshëm dhe transparencën mbi monitorimin e projekteve kërkimore - shkencore.

Për këto arsye, në përfundim të këtij auditimi KLSH ka rekomanduar që institucioni të ndërmarrë hapat e duhur për të kryer një menaxhim sa më transparent dhe të duhur të projekteve kërkimore - shkencore duke respektuar kuadrin ligjor në fuqi sa i takon menaxhimin financiar dhe kontrollit, duke zbatuar njëkohësisht edhe bazën ligjore për arkivimin e dokumenteve në vendin tonë. Gjithashtu, KLSH ka rekomanduar që institucioni të përmirësojë menaxhimin e vet strategjik dhe operacional duke promovuar transparencën me publikun dhe duke promovuar kulturën dhe vlerat e vendit tonë.

Ndër të tjera, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë iu rekomandua aplikimi i filtrave të kontrollit për të gjitha aplikimet e kryera për projekte kërkimore-shkencore, për t'i koordinuar ato me institucione të tjera, me qëllim shmangien e mundësive për përfitimin nga dy burime të financimit për të njëjtin projekt shkencor nga ana e studiuesve e kërkuesve shkencorë.



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS



Në fushën e menaxhimit dhe mbledhje të ardhurash

Auditimi me temë “Menaxhimi i hapësirave publike në plazhe”, realizuar në:

SUBJEKTET

Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit,
Agjencinë Kombëtare të Bregdetit
Bashkitë Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë,
Himarë dhe Sarandë.

Duke marrë parasysh vlerën e bregdetit tonë, si një aset i çmuar natyror, auditimi ka pasur si objektiv kryesor, vlerësimin e vizionit politikëbërës mbi menaxhimin e hapësirave publike në plazhe.

Nga auditimi rezultoi se, Shqipëria është i vetmi vend në rajon dhe Mesdhe që vazhdon të mos ketë të miratuar një ligj për menaxhimin e integruar të bregdetit, dhe strategji për menaxhimin e vijës bregdetare. Plazhet janë pronë publike në administrim të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV) bregdetare, ndërsa procedurat për dhënien e hapësirës publike në plazhe subjekteve përfitues, kryhen në nivel qendror. Procesi i hartëzimit të zonës bregdetare nga ana e bashkive bregdetare, për përcaktimin e parcelave të plazheve është një proces formal, i cili nuk pasqyron ndryshimet e mundshme në terren.

Të gjitha bashkitë subjekt auditimi nuk kanë krijuar struktura të veçanta të cilat të kenë përgjegjësi funksionale menaxhimin e plazheve si në sezonin zyrtar të plazhit ashtu edhe në periudhë përgatitore apo pas përfundimit të këtij sezoni, si dhe gjatë planifikimit të treguesve të buxhetit nuk ka një zë të veçantë të planifikuar të shpenzimeve për periudhën që zhvillohet aktiviteti turistik i plazhit.

Raporti 30% hapësirë e lirë për publikun nuk është trajtuar me përparësi dhe nuk është i vërtetueshëm në terren, pasi ai aplikohet në një territor të përgjithshëm, dhe jo specifik për çdo zonë plazhi. Hapësira e dedikuar për plazh publik, e cila administrohet nga bashkitë nuk përmbush të gjitha standardet e përcaktuara. Tarifat për zënie e hapësirës publike nuk janë rishikuar nga ana e bashkive nëpërmjet analizave ekonomike, me synim rritjen e të ardhurave të arsyetuara. Të ardhurat e vjela nga dhënia e hapësirës publike në plazhe nuk përdoren në mënyrë direkte për menaxhimin e tyre. Mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit midis institucioneve të përfshira në menaxhimin e hapësirave publike në plazhe, sjell për pasojë mungesën e një vizioni të qartë dhe të qëndrueshëm në kohë. Për të gjitha këto problematika janë adresuar rekomandime në funksion të minimizimit dhe përmirësimit të tyre.



Në fushën e forcimit të institucioneve publike

Auditim me temë “Inspektoratet e vendit në mbrojtje të interesave publike”, realizuar në:

SUBJEKTI

Inspektoratin Qendror, në cilësinë e institucionit përgjegjës për bashkërendimin e veprimtarisë inspektuese.

Ky auditim ka patur si objektiv kryesor të sigurojë një vlerësim të paanshëm dhe objektiv nëse veprimtaria e përgjithshme e funksioneve të inspektimit në nivel qendror dhe vendor në vendin tonë është kryer sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara, me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit në drejtim të uljes së barrës administrative për sipërmarrjen dhe mbrojtjen e interesave publike.



3.4 AUDITIME TË PERFORMANCËS

Në vendin tonë roli kryesor i inspektimit është mbrojtja e interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridik, duke ndihmuar bizneset në respektimin e kërkesave ligjore të parashikuara në legjislacionin përkatës. Sipas një raporti mbi gjendjen e inspektorateve shtetërore në Shqipëri të vitit 2023, ka rezultuar se ende ka nevojë për përmirësim të kuadrit ligjor, përafrim të legjislacionit sektorial me atë të BE-së, përmirësim të kapaciteteve institucionale, burimeve njerëzore, logjistikës dhe kapaciteteve laboratorike, si dhe eliminimi i mbivendosjeve të kompetencave si dhe domosdoshmëri për të forcuar funksionin e inspektimit.

Në përfundim të tij u evidentua se Inspektorati Qendror i ka ushtruar kompetencat e veta për të bashkërenduar inspektimet dhe mbikëqyrur ligjin e inspektimeve, si dhe ka miratuar kriteret për arsimimin e inspektorëve dhe rregulla e udhëzime të tjera metodologjike në këtë fushë. Megjithatë, inspektoratet shtetërore nuk kanë siguruar përputhshmëri midis programeve mujore të inspektimit shkresor me atë elektronik; nuk janë respektuar kriteret e arsimimit të miratuara për punësimin e inspektorëve dhe janë kryer inspektime jashtë portalit “e – inspektimi” etj., jo në përputhje me orientimet bashkërenduese e metodologjike të miratuara. Për shkak të problematikave të bazës ligjore, ka pasur mbivendosje kompetencash e inspektimesh nga më shumë se një inspektorat, në veçanti në fushën e mjedisit midis AKM dhe IKMT – së.

Për të garantuar mbrojtje të interesit publik dhe interesave të tjerë të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë është miratuar ligji nr. 99, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i cili synon të unifikojë dhe bashkërendojë veprimtarinë inspektuese në vendin tonë. Inspektorati Qendror, si promotor në kuadër të ndryshimit të ligjit për inspektimin duhet t’i japë një impuls e kuptim të ri procesit

inspektues si domosdoshmëri e rishikimit të problematikave dhe miratimit të rregullave të reja, duke synuar koordinimin dhe harmonizimin e tij në nivel qendror e vendor.

Në këtë auditim u adresuan një sërë rekomandimesh. Kështu ju rekomandua Inspektoratit Qendror, (i cili do të riemërtohet Inspektorat i Përgjithshëm me ndryshimet ligjore), që në procesin e dhënies së mendimeve për aktet nën ligjore që do të hartohen dhe miratohen për të vënë në zbatim ligjin nr. 99/2024 në kontekstin e riorganizimit të funksioneve inspektuese në rang vendi, të monitorojë dhe raportojë në vijimësi shkallën e përafrimit me legjislacionin e BE – së për këto akte. Në kuadër të rishikimit të bazës nën ligjore që do të rregullojë sistemin “e – Inspektimi”, brenda kompetencave që i janë caktuar nga ligji i ri për inspektimet nr. 99/2024, Inspektoratit Qendror ju rekomandua parashikimi i dispozitave specifike në garantim të përputhshmërisë së plotë midis programeve mujore të inspektimeve shkresore dhe elektronike. Gjithashtu, Inspektoratit Qendror, në kuadër të rikonceptimit të funksioneve inspektuese me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 99/2024, ju rekomandua të kryejë një vlerësim paraprak në lidhje me kriteret e arsimimit për trupën inspektuese sipas fushave të inspektimit, duke pasur parasysh që pranë këtij institucioni do të ngrihet dhe funksionojë Komisioni i rekrutimit dhe ecurisë në karrierë.

Një tjetër rekomandim që ju adresua Inspektoratit Qendror në procesin e dhënies së mendimeve për aktet nën ligjore lidhur me këtë riorganizim, ishte orientimi dhe asistenca në ndarjen e duhur të kompetencave të inspektorateve shtetërore sipas fushave specifike inspektuese, duke pasur një vëmendje të veçantë sa i takon eliminimit të mbivendosjeve midis IKMT – së dhe AKM - së.



AUDITIME TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Roli i auditimit të Teknologjisë së Informacionit (TI) në ofrimin e sigurisë së proceset e duhura janë vendosur për të menaxhuar rreziqet dhe dobësitë përkatëse të TI-së, është thelbësor nëse SAI-et do të raportojnë në mënyrë kuptimplote mbi efikasitetin dhe efektivitetin e operacioneve të qeverisë dhe sektorit publik.

Ritmi me të cilin teknologjia po përparon është më i shpejtë se kurrë, gjë që gjithashtu sjell implikime për auditimet e TI-së. Sistemet e TI janë gjithnjë e më komplekse. Këto sisteme janë të ndërlydhura me sisteme dhe rrjete të tjera të brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë edhe internetin, e duke rritur kështu kompleksitetin e tyre.

Kalimi në sistemet e TI dhe përpunimi dixhital nga njësitë e audituara në sektorin publik, ka sjellë nevojën që edhe KLSH, të zhvillojnë kapacitetet e duhura për të kryer ekzaminimin e plotë të kontrolleve në lidhje me sistemet e TI-së, në përmbushje edhe me mandatin ligjor.

Gjatë auditimeve IT, audituesi duhet të sigurohet që kontrollet e brendshme të TI-së, në lidhje me konfidencialitetin, integritetin, vlefshmërinë dhe disponueshmërinë e të dhënave, janë miratuar dhe funksionojnë me efektivitet, duke i shërbyer objektivave të njësisë së audituar.

Në përfundim të auditimeve IT, grupi i auditimit konkludon në Konkluzionin e Auditimit.



8
Auditime



9
Subjekte të audituara

- 1 institucion i pavarur
- 7 institucione qendrore dhe të varësisë
- 1 shoqëri publike



8
Konkluzione

8 konkluzione në auditimet IT



145
Rekomandime

- 4 përmirësime ligjore
- 137 masa organizative
- 4 masa disiplinore
- 2 efekte financiare



Efekte financiare
52,702 (mijë lekë)



3.5 AUDITIME TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit

Mbi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit janë konstatuar problematika si vijon:

Në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit, nga 102 pozicione të miratuara, 32 u konstauan vakante, kryesisht në Drejtorinë e Sistemeve, Qendrën Operative të Sigurisë dhe Drejtorinë e Programimit dhe Bazave të të Dhënave, çka ndikon në performancën e departamentit.

U konstatua mungesa e fotografive në procesverbalet e kundërvajtjeve, miratuar me VKM nr. 42, datë 30.01.2019, ka ndikuar në rritjen e ankesave nga kundërvajtësit përmes shërbimeve online të e-Albania, duke penguar transparencën dhe besueshmërinë. Në zbatimin e kontratave për sistemin eGjoba të vitit 2018 dhe 2022, u evidentua ndjekje formale e dokumentacionit, mosrealizim i disa specifikimeve teknike dhe mungesë e raportimit të rregullt, si dhe problemeve të vazhdueshme të sistemit deri në fund të vitit 2023.

Gjithashtu, mungesa e përcaktimit të rregullave për administrimin e të dhënave dhe niveleve të aksesit për palët e përfshira, ka vënë në rrezik integritetin dhe sigurinë e të dhënave shtetërore në sistemin e administrimit të kundërvajtjeve rrugore e-Gjoba.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Mbi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit janë konstatuar problematika si: në periudhat zgjedhore 2021 dhe 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në Vendimin e Komisionit Rregullator, ka kërkuar të dhëna mbi foton e zgjedhësve nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, megjithëse ky informacion nuk është përcaktuar si përbërës zgjedhor në Kodin Zgjedhor.

Po ashtu, ndryshimet e udhëzimit nr. 465, datë 10.12.2020, ndërmjet Komisionerit për të Drejtën

e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale dhe Ministrisë së Brendshme, publikuar me nr. 189, datë 4.10.2022, të dhënat personale që KQZ ka marrë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, kishin mbetur të njëjta. Me kërkesë të KQZ-ës, Ministria e Brendshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale, kanë përditësuar të dhënat në Aneksin I, të udhëzimit nr.465, datë 10.12.2020, por pa respektuar emërtimet sipas nenit 45 të Kodit Zgjedhor dhe duke shtuar foton e votuesve, megjithëse ky element nuk është përbërës zgjedhorë sipas këtij neni.

Megjithëse të dhënat që institucioni trajton dhe ruan në sistemet informatike që disponon janë sensitive, në strukturën e KQZ-së nuk ka një pozicion për sigurinë e të dhënave që ruhen dhe përpunohen në këto sisteme, për të cilin është rekomanduar të identifikohen detyrat dhe përgjegjësitë specifike si dhe marrjen e masave tekniko - administrative për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale.

Në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Mbi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit janë konstatuar problematika si: mungesa e një akti ligjor për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të SIRKB-së, duke mos përcaktuar institucionin administrues, të dhënat parësore dhe dytësore, dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera dhe nivelin e aksesimit, siç kërkohet nga ligji nr. 10325/2010.

Deri në fund të vitit 2022, sistemi ishte konsideruar Infrastrukturë Kritike e Informacionit, por me hyrjen në fuqi të VKM nr. 761/2022, nuk rezulton të jetë më pjesë e listës së infrastrukturave kritike, pavarësisht rëndësisë së tij në shëndetin publik, për të cilin është rekomanduar që AKSHI dhe AKBPM të njoftojnë Autoritetin Kombëtar të Sigurisë Kibernetike për rëndësinë kritike të kësaj infrastrukture.



3.5 AUDITIME TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Po ashtu, u evidentua mungesa e një strukture TIK apo specialistëve të IT-së në organikën e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), çka ka vështirësuar mirëmbajtjen e sistemit dhe përmbushjen e detyrimeve teknike. Mungesa e politikave, manualeve dhe udhëzuesve mbi sigurinë e informacionit, si dhe mungesa e një liste të përdoruesve me akses në sistem, cenojnë integritetin, disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e të dhënave.

Gjithashtu, mungesa e asistencës teknike dhe mosplotësimi i vendeve vakante në IT, rrisin ndjeshëm rrezikun e incidenteve të sigurisë siç janë aksesimi i paautorizuar, humbja ose komprometimi i të dhënave me impakt në objektivat e institucionit, për të cilin është rekomanduar që AKSHI të përcaktojë punonjës të do të mbulojnë nevojat në Teknologjinë e Informacionit të AKBPM-s deri në plotësimin e vendit bosh në strukturë.

Në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Mbi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit janë konstatuar problematika si: mungesa e akteve rregullatorë në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në një zhvillim të pa monitoruar të aktivitetit institucional.

Sistemi i Ndihmës Ekonomike ka mungesa në mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke rritur riskun e popullimit të sistemit me të dhëna të pa sakta, e për pasojë nxjerrjen e rezultateve të gabuara. Implementimi i pamjaftueshëm i protokolleve themelore të sigurisë, mungesa e trajnimeve të punonjësve me praktikat më të mira të sigurisë kibernetike, investimet e pakta në teknologjinë e Informacionit, paraqesin rrezik për konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë e informacionit e sistemeve dhe komprometojnë Sigurinë e Informacionit të SHSSH-së.

Konstatohet se është i pamjaftueshëm identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimeve kundrejt qytetareve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit pa ndërprerje nëpërmjet teknologjisë së informacionit.

SHSSH nuk ka kaluar strukturat përgjegjëse TIK tek AKSHI sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosur në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar.

Në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore

Mbi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit janë konstatuar problematika si: sistemi informatik për administrimin dhe monitorimin e aktivitetit të koncesioneve dhe lejeve minerare mbi burimet natyrore të Republikës së Shqipërisë (Revzone), si dhe sistemi i menaxhimit të licensave dhe koncesioneve (GIS) kanë mangësi që ndikojnë në mbarëvajtjen, përdorimin dhe vazhdimësinë e funksionimit të tyre. Me gjithë përpjekjet dhe investimet në fushën e teknologjisë, situata në AKBN në këtë drejtim nuk është e konsoliduar në krahasim me investimet e kryera, nisur nga fakti se zhvillimi i sistemeve ndër vite nuk është zhvilluar sipas një planifikimi strategjik afatgjatë.

Mungesa e rregulloreve për përdorimin e sistemeve që AKBN disponon ka krijuar mundësinë për mos përdorimin e sistemeve, e si rezultat dhe mos adresimin e përgjegjësive për mungesën e efektivitetit të çdo hapi të informatizuar.

Nga analizimi i të dhënave në sistemin për lejet minerare, rezultoi se sistemi Revzone nuk ka mekanizmat e nevojshme për kontrollin e inputit, duke rritur riskun e popullimit në sistem me të dhëna të cilat tejkalojnë përmbushjen e afateve sipas deklarimeve që duhet të bëjnë subjektet si dhe dublikimin e informacioneve, e për pasojë nxjerrjen e raporteve të pasakta.



3.5 AUDITIME TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Sistemet e informacionit nuk kanë arritur qëllimet e investimeve të kryera në lidhje me informatizimin e proceseve, zhvillimin e shërbimeve si dhe sigurimin e vazhdueshmërisë në ofrimin e shërbimeve.

Në Ujësjiellës Kanalizime Shkodër

Mbi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit janë konstatuar problematika si: UKSH Sh.A. nuk zotëron një strategji apo plan të menaxhimit të rriskut. Pa pasur një strategji të qartë ajo mbetet e papërgatitur për zhvillimin e infrastrukturës teknologjike. Mungesa e akteve rregullative mbi menaxhimin e sistemeve IT ka çuar në një aktivitet të pa monitoruar dhe pa ndarje të qartë të përgjegjësive për veprimet e ndërmarra.

UKSH ka mungesë rregulloresh për menaxhimin e përdoruesve siç janë: Krijimi, fshirja, ndryshimi i roleve dhe fjalëkalimeve – paraqet një rrisk të lartë. Pa mekanizma të rregullt monitorimi, pasaktësitë mund të kalojnë pa u identifikuar, duke rritur ekspozimin ndaj sulmeve Gjithashtu, investimet në Teknologjinë e Informacionit janë shumë të kufizuara, çka pengon përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e sigurisë dhe garantimin e vazhdimësisë së punës.

Në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit

Mbi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit janë konstatuar problematika si: mangësi në aktet rregullatore që lidhen me sistemet e teknologjisë së informacionit, të cilat kanë ndikuar negativisht në monitorimin e aktivitetit institucional dhe në delegimin e qartë të përgjegjësive individuale për veprimet e kryera. Gjithashtu, investimet e pamjaftueshme në teknologjinë e informacionit kanë kufizuar përmirësimin e efikasitetit operacional, sigurisë së informacionit dhe modernizimin e proceseve institucionale. Pajisjet që përdoren për shërbimet e komunikimit dhe ruajtjes së të

dhënave janë në kushte jo optimale dhe nuk garantojnë sigurinë e kërkuar. Për më tepër, të dhënat e gjeneruara nga sistemi elektronik i lejeve janë lehtësisht të manipulueshme, pasi transmetimi i tyre kryhet në mënyrë të pasigurt.

Në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural

Mbi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit janë konstatuar problematika si: sistemi informatik për menaxhimin e aplikimeve për përfitim nga grantet që janë dhënë në kuadër të implementimit të projektit IPARD, si dhe sistemi i menaxhimit të informacionit për aplikimet e bëra me qëllim përfitimin nga skemat e subvencioneve që mbështet AZHBR, ende nuk e kanë arritur qëllimet e investimeve të kryera në lidhje me informatizimin e të gjitha hapave të procesit nëpërmjet përdorimit të sistemit, zhvillimin e shërbimeve si dhe sigurimin e vazhdueshmërisë në ofrimin e shërbimeve. Zhvillimi i sistemeve ndër vite nuk është zhvilluar sipas një planifikimi strategjik afatgjatë, ku me gjithë përpjekjet dhe investimet në fushën e teknologjisë, situata në AZHBR në këtë drejtim nuk është e konsoliduar në krahasim me investimet e kryera. Gjithashtu, kontrollet për financim të dyfishtë realizohen manualisht dhe nuk mundësohet ankimimi i aplikantëve përmes sistemit.

Identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet teknologjisë së informacionit është i pamjaftueshëm.






AUDITIME TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Rekomandimet e adresuara përfaqësojnë instrumentet, nëpërmjet të cilave auditimi mund të sjellë një vlerë të shtuar për njësitë publike. Efektiviteti i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nga KLSH, është thelbësor për arritjen e përfitimeve maksimale nga veprimtaria audituese. Nuk janë rekomandimet apo pranimi i tyre, faktorët vendimtar që sjellin vlerë të shtuar të veprimtarisë audituese, por janë veprimet e ndërmarra më tej nga subjektet e audituara, për adresimin e rekomandimeve në funksion të arritjes së pritshmërive të synuara. Në këtë këndvështrim.

Kërkesat e Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP) përcaktojnë qartë rolet e përgjegjësitë e subjekteve të audituara dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI), sipas të cilave është thelbësore që përgjegjësia për implementimin e rekomandimeve në kohe dhe në mënyrë efektive është e subjekteve të audituara, por nga ana tjetër është përgjegjësi e SAI-ve ndjekja e zbatimit të rekomandimeve pra të verifikojë veprimet e ndërmarra dhe nëse janë arritur rezultatet e pritshme.

Procedurat për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve në KLSH, kanë për qëllim identifikimin dhe dokumentimin e shkallës së zbatueshmërisë dhe ato mbështeten në: Kërkesat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë 1 Neni 163 dhe 164, Ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, nenet 15 dhe 30, Kornizën e Deklaratave Profesionale të INTOSAI-t, Standartet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualin Për Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve të Auditimeve të KLSH-së dhe Regjistrin elektronik institucional, si dhe Strategjinë e KLSH-së, 2023-2027.



3.6 AUDITIME TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Rezultatet e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e mëparshme:

Performanca institucionale nuk mund të arrihet pa konsolidimin e një sistemi efektiv të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe kjo është rruga e vetme e përmbushjes së qëllimeve strategjike të misionit dhe vizionit institucional, si dhe pritshmërive të Kuvendit, publikut dhe gjithë palëve të interesit. Kërkesat e Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP), përcaktojnë qartë rolet e përgjegjësitë e subjekteve të audituara dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-eve), sipas të cilave është thelbësore që përgjegjësia për implementimin e rekomandimeve në kohë dhe me efektivitet është e subjekteve të audituara; por nga ana tjetër është përgjegjësi e SAI-ve ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, pra verifikimi nëse veprimet e ndërmarra i shërbejnë rezultatve të pritshme.

Procesi për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe inicimi e zbatimi i masave korigjuese nga subjektet e audituara, jep një informacion të detajuar mbi vlerën e shtuar që sjell puna e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe njëherazi jep garanci për profesionalizmin, pavarësinë dhe objektivitetin e institucionit.

Konsolidimi i një mekanizmi efektiv të verifikimit sistematik dhe raportimit të zbatimit të rekomandimeve, bazuar në metodologji dhe procedura të standardizuara, të qarta dhe të mirë detajuara, i lejon jo vetëm Kontrollit të Lartë të Shtetit por dhe palëve të treta Kuvendit, Qeverisë etj, të sigurojnë në vijimësi, një informacion të plotë, lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e subjekteve të audituara për hartimin e dokumenteve strategjike në nivel institucional dhe kombëtar apo për iniciativa për ndryshime ligjore, administrative dhe organizative.

Skemat dhe qasja e përdorur për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, synojnë të gjenerojnë indikatorë të konsoliduar institucional, sa i takon pranueshmërisë dhe zbatueshmërisë së rekomandimeve, duke mundësuar në këtë mënyrë rritjen e mbikëqyrjes parlamentare nga ana e Kuvendit ndaj ekzekutivit, me efekt rritjen e përgjegjshmërisë së menaxhimit të fondeve publike.

Gjatë vitit 2024, KLSH kreu verifikimin e zbatimit të rekomandimeve për 97 auditime të cilat kanë përfshirë ndjekjen dhe monitorimin e 3937 rekomandimeve, rezultatet e të cilit janë dërguar në:

- Kuvendin e Republikës së Shqipërisë me shkresat: nr 962 prot, datë 25.07.2024; dhe nr 282 prot, date 25.02.2025.
- Ministrit të Shtetit për Marrëshëniet me Parlamentin, me shkresat nr. dhe 962/1 prot datë 25.07.2024, dhe nr. 282/1 prot, datë 25.02.2025.

Nga verifikimi në terren, i zbatimit të rekomandimeve, rezultoi se nga 3937 rekomandime të lëna gjatë vitit 2023, 3882 rekomandime janë pranuar, ose rreth 99% e tyre; dhe nuk janë pranuar 55 rekomandime, ose rreth 1%.

Nga 3882 masa të pranuar, 1261 masa rezultuan të jenë zbatuar plotësisht (ose rreth 33 % e total masave të pranuar), 578 masa zbatuar pjesërisht (ose rreth 15 % e total masave të pranuar), 866 në proces zbatimi (ose rreth 22 % e total masave të pranuar) dhe 1177 masa janë ende pa zbatuar (ose rreth 30 % e total masave të pranuar).



3.6 AUDITIME TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE


Në përfundim, statusi i rekomandimeve, organizuar sipas lloji, rezultoi si vijon:

✓ **25** “Masa për përmirësime ligjore”, nga të cilat janë pranuar 25 masa ose 100%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar 9 masa ose 36%, janë zbatuar pjesërisht 4 masa ose 16%, janë në proces zbatimi 7 masa ose 28% dhe nuk janë zbatuar 5 masa ose 20%.

✓ **2372** “Masa organizative”, nga të cilat janë pranuar 2358 masa ose 99% e tyre dhe nuk janë pranuar 14 masa ose 1%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 742 masa ose 31%, janë zbatuar pjesërisht 338 masa ose 14%, janë në proces zbatimi 584 ose 24% dhe nuk janë zbatuar 694 ose 29% e tyre.

✓ **436** “Masa për eliminimin e efekteve negative” nga të cilat janë pranuar 420 masa ose 96% dhe nuk janë pranuar 16 masa ose 4%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar 62 masa ose 14%, janë zbatuar pjesërisht 98 masa ose 22%, janë në proces zbatimi 129 masa ose 29% dhe nuk janë zbatuar 131 masa ose 30%.

✓ **195** “Masa për shpërblim dëmi”, nga të cilat janë pranuar 184 masa ose 94% dhe nuk janë pranuar 11 ose 6%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve në subjekte rezultoi se nga 184 rekomandimet e pranuar, janë zbatuar plotësisht 53 masa ose 27%, pjesërisht 47 masa ose 24%, janë në proces zbatimi 28 ose 14% dhe 56 masa ose 28% nuk janë zbatuar.



✓ **863** “Masa disiplinore”, nga të cilat janë pranuar 849 masa ose 98% dhe nuk janë pranuar 14 masa ose 2%. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar 389 masa ose 45%, zbatuar pjesërisht 63 masa ose 7%, në proces zbatimi 118 ose 14% dhe nuk janë zbatuar 279 ose 32% e tyre.

✓ **46** “Masa administrative”, nga të cilat janë pranuar 46 masa ose 100% e tyre. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga masat e pranuar janë zbatuar 6 masa ose 13% e tyre, zbatuar pjesërisht 28 masa ose 61%, dhe nuk janë zbatuar 12 masa ose 26% e tyre.

KLSH, ka rikërkuar nga të gjitha subjektet përsheptimin e zbatimit të masave të pranuar por “të pazbatuara”, si dhe të të gjitha masave që kanë rezultuar “në proces zbatimi” ose “të zbatuara pjesërisht”.







04

Menaxhimi
institucional dhe
zhvillimi strategjik

4.1 MONITORIMI VJETOR I “STRATEGJISË TË ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL 2023-2027”

Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së 2023 - 2027 është dokumenti strategjik më i rëndësishëm i institucionit, i cili e udhëheq Kontrollin e Lartë të Shtetit në aktivitetin e tij institucional auditues dhe jo auditues, duke u përshtatur dhe përgjigjur në kohë dhe me përgjegjshmëri dinamikave dhe zhvillimeve lokale dhe globale. Ky dokument tashmë ka përfunduar tashmë vitin e dytë të zbatimit të tij.

Përgjatë këtij viti, zbatimi i kësaj strategjie është zbërthyer në nën objektiva dhe aktivitete të ndryshme, nëpërmjet të cilave institucioni ka synuar rritjen e cilësisë së auditimeve, duke iu përgjigjur zhvillimeve të standardeve, në veçanti sa i takon ndërtimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë së auditimit. KLSH ka konsoliduar praktikën e planifikimit vjetor, strategjik dhe operacional sipas metodologjive të përditësuara, duke rritur përdorimin e vizualizimeve për të përmirësuar efektivitetin e përcjelljes së punës audituese. Njëkohësisht, ka përmirësuar komunikimin e rezultateve të auditimeve dhe veprimtarisë së KLSH nëpërmjet mediave sociale, prezencës në shtypin e shkruar dhe atë audio - viziv, si dhe nëpërmjet broshurave, buletineve dhe aktiviteteve të tjera ndërgjegjësuere si për shembull Java e Integritetit etj. Duhet theksuar këtu, se konsolidimi i marrëdhënieve me Kuvendin dhe Nën Komisionin Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik nëpërmjet dëgjësive parlamentare dhe raportimeve të vazhdueshme në të ka rritur vizibilitetin e punës audituese për publikun e gjerë.

Me qëllim përmbushjen e objektivave strategjike, nën objektivave dhe aktiviteteve specifike, KLSH ka zbatuar planin e veprimit për implementimin e strategjisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 144, datë 01.08.2023, edhe përgjatë vitit 2024. Ky plan është monitoruar në mënyrë sistematike për vlerësimin e nivelit të arritjes së objektivave kundrejt parashikimit. Monitorimi i kësaj strategjie ka kërkuar nga ana e KLSH - së

angazhimin e vazhdueshëm të të gjitha strukturave të institucionit në drejtim të realizimit të aktiviteteve specifike të planit të veprimit dhe raportimin mbi rezultatet e arritura nga ky zbatim, për tre qëllimet strategjike të këtij dokumenti:

Qëllimi 1: Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH-së si mbështetës i kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike

Qëllimi 2: Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve

Qëllimi 3: Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese

Sa i takon zbatimit të objektivave dhe nën aktiviteteve të qëllimit të parë strategjik, KLSH ka hartuar dhe miratuar Planin Vjetor të Auditimeve të vitit 2024 duke ndjekur Metodologjinë e Planifikimit Vjetor të Auditimeve (miratuar në vitin 2023). Kjo metodologji është përdorur dhe për planifikimin e auditimeve të performancës, duke u ndërthurur me Manualin e Departamentit të Auditimit të Performancës dhe Udhëzuesin e Fushave me Risk. Kështu ka vijuar konsolidimi i procesit të hartimit të Planit Vjetor të Auditimeve në KLSH. Në përmbushje të angazhimit që KLSH ka marrë për të audituar tematika të caktuara performance në fushën e OZHQ - ve, në 2024, Departamenti i Auditimit të Performancës ka kryer 7 auditime në fushën e OZHQ - ve (4 auditime më shumë se viti 2023), duke mbuluar me auditim 2 OZHQ të reja, konkretisht: OZHQ SDG 13 “Veprim për Klimën” me 1 auditim me temë “Zbatimi i Planit Kombëtar për Zbutjen dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike”; dhe OZHQ SDG 15 “Jeta në tokë” me 1 auditim me temë “Ndikimi i aktivitetit minerar në fondin pyjor”.

Për të reflektuar në shkallën më të lartë përputhshmërinë me ISSAI - et, në vijim të



4.1 MONITORIMI VJETOR I “STRATEGJISË TË ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL 2023-2027”

ndryshimit të ISSAI 140 “Menaxhimi i Cilësisë për Institucione Supreme të Auditimit”, përgjatë vitit 2024, KLSH ka qenë pjesë e projektit Pilot mbi zbatimin e ISSAI 140 të rishikuar, të zhvilluar me asistencën e IDI – t (Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI – t). Në përfundim të këtij projekti, KLSH ka hartuar dhe miratuar dokumentet kryesore që në do të rregullojnë menaxhimin e cilësisë në KLSH në vijim, pra “Politika e Menaxhimit të Cilësisë në KLSH”, Udhëzuesi i Menaxhimit të Riskut të Cilësisë, Regjistri i Riskut të Cilësisë. Me miratimin e këtyre dokumenteve janë përgatitur letrat e punës për vlerësimin e dosjeve të auditimit sipas standardeve ndërkombëtare tëauditimit.

Angazhimi i institucionit për të qenë gjithmonë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit ka vijuar me rishikimin e Kodit Etik të institucionit, i cili është miratuar me Vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 217, datë 15.11.2024. Falë këtij përditësimi është siguruar përputhshmëri e plotë me ISSAI 130 “Kodi i Etikës”, duke sjellë përmirësime dhe ndryshime të nevojshme të Kodit Etik të mëparshëm i cili datonte në vitin 2015.

Po kështu, KLSH ka hartuar dhe miratuar Manualin për auditimin e koncesioneve dhe partneriteteve private publike (PPP), përgatitur në kuadrin e projektit “Forcimi i kapaciteteve profesionale të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) në auditimin e Kontratave Koncesionare dhe të Partneritetit Privat Publik në Shqipëri”, financuar nga Sekretariati i Shtetit për Bashkëpunim Ekonomik i Zvicrës (SECO).

Në fushën e Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit ka vijuar bashkëpunimin me ekspertët e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë (OANG) për të përmirësuar cilësinë e auditimeve, duke zhvilluar workshop – e online dhe fizike, me në fokus Sigurinë e Informacionit dhe Sigurinë Kibernetike, në veçanti sa i takon

përdorimit të mjeteve IT Open Source, në të cilat OAGN bazohet për Auditimet e Teknologjisë së Informacionit.

Gjatë vitit 2024 KLSH, ka intensifikuar marrëdhënien me Kuvendin dhe me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave. Kjo marrëdhënie është konsoliduar edhe më tej me krijimin e Nën Komisionit Parlamentar për Auditimin e Sektorit Publik, pasi tashmë çështjet e auditimit të sektorit publik diskutohet në një forum të dedikuar. Marrëdhënia e institucionit me Kuvendin ka vijuar të intensifikohet edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete të organizuara nga palët e interesit apo edhe nga vet Kuvendi, për të promovuar dialogun dhe llogaridhënien në mbikëqyrjen e financave publike.

Sa i takon realizimit të qëllimit strategjik të dytë, KLSH ka paraqitur dhe komunikuar punën audituese duke përdorur kanalet më efektive të komunikimit për të mbërritur deri tek përdoruesit më të fundit, qytetarët, duke u ofruar atyre mundësinë dhe aksesin e plotë në informacion për të kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët, që është mirëqeverisja. Për këto arsye, në vitin 2024, KLSH ka publikuar në faqen web 139 raporte auditimi. Gjithashtu, për auditimet me ndjeshmëri të lartë, ka promovuar rezultatet e auditimit nëpërmjet takimeve, përgatitjes së broshurave, dhe shpërndarjen e tyre tek të gjithë të ftuarit, gjatë aktiviteteve të analizave vjetore të departamenteve të auditimit apo edhe takime të tjera të organizuara për të promovuar raporte specifike auditimi, si për shembull takimi prezantuesi i gjetjeve të raportit të auditimit të performancës me temë “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”, i kryer në bashkëpunim me zyrën UN Women në Shqipëri. Në shtypin e shkruar dhe në median audio – vizive janë publikuar gjithsej 1830 artikuj, nga të cilët 382 në shtypin e shkruar dhe 1448 në



4.1 MONITORIMI VJETOR I "STRATEGJISË TË ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL 2023-2027"

median audiovizive dhe online. Nga këto të fundit, 205 kanë qenë kronika dhe materiale të zgjeruara mbi gjetjet e auditimeve të KLSH-së. Faqja zyrtare e institucionit ka vijuar të pasurohet me informacione në gjuhën angleze si njoftimet mbi takimet e Kryetarit apo bashkëpunimet me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit etj. Risi e vitit 2024 ka qenë hapja e profileve të institucionit në mediat sociale si Facebook, Instagram dhe LinkedIn, ku KLSH ndan të dhëna mbi veprimtarinë e tij.

KLSH ka administruar 290 letra, ankesa/ kërkesa për informacion nga individë dhe subjekte të ndryshme. Koordinatori për të Drejtën e Informimit, në cilësinë e strukturës së ngarkuar me detyrën e trajtimit të kërkesave për informacion, ka trajtuar 36 kërkesa për informacion të cilat janë përcjellë tek kërkuarit brenda afateve ligjore të përcaktuara.

KLSH ka vijuar të punojë për hartimin e raporteve të auditimit miqësore me lexuesit, sipas metodologjisë mbi shkrimin e raporteve të auditimit të vitit 2023, me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, në mënyrë që të gjenerohen raporte të qarta, të vlefshme dhe të dobishme. Duke pasur parasysh këtë synim, në KLSH është vendosur Njësia e Redaktimit e cila në bashkëpunim me Sektorin e Komunikimit dhe Botimeve redakton raporte auditimi dhe materiale e dokumente audituese të ndryshme. Gjithashtu në bashkëpunim edhe me Departamentin e Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional janë përdorur programe të dedikuara për krijimin e infografikëve dhe vizualizimeve, nëpërmjet të cilave janë prodhuar dokumente cilësore dhe profesionale si: Politika e Menaxhimit të Cilësisë në KLSH; Udhëzuesi i Menaxhimit të Riskut të Cilësisë; Buletinet statistikore; 2 Broshura për Javën e Integritetit; Raporti mbi zbatimin e rekomandimeve etj.

Këto programe vijnë të përdoren për hartimin e dokumenteve raportuese më të rëndësishme

të KLSH-së, Raporti Vjetor i Aktiviteti të KLSH-së; Raporti për Zbatimin e Buxhetit; Raporti Vjetor i Monitorimit të Strategjisë 2023 - 2027, si dhe në raste të veçanta sipas nevojës. Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Komunikimit që prej muajit nëntor 2024 ka nisur përgatitjen dhe shpërndarjen e Neësletter të KLSH-së, në të cilën paraqiten informacionet kyçe, shifrat e auditimeve, si dhe fakte nga auditimet e kryera. Në faqen zyrtare të institucionit në Instagram dhe LinkedIn publikohen periodikisht Facts and Figures. Drejtoria e IT është duke punuar për të krijuar dhe një dritare të veçantë në faqen zyrtare të KLSH-së, për Facts and Figures.

Sa i takon realizimit të qëllimit strategjik të tretë, KLSH, nëpërmjet programit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, ka bërë të mundur rritjen e njohurive dhe aftësive që ju nevojiten audituesve në realizimin e objektivave, duke ndikuar për rrjedhojë në përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së punës audituese në funksion të rritjes së transparencës, mirëqeverisjes dhe përdorimit të parasë publike, si dhe rritjes së besimit të publikut dhe palëve të jashtme, tek KLSH.

Institucioni ka vijuar bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në programe internship - i dhe fellowship - i me institucionet homologe. Kështu, aktualisht po ndjekin internship - in në Gjykatën Evropiane të Llogarive (ECA) 5 auditues të KLSH-së, dhe ka përfunduar me sukses felloëship - it pranë Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA - ve (GAO) 1 auditues.

Me qëllim motivimin dhe shpërblimin e punonjësve, gjatë vitit 2024 në KLSH:

- audituesit kanë ndjekur trajnime brenda dhe jashtë vendit duke zhvilluar njohuritë e tyre në fusha specifike të auditimit të jashtëm publik, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit audituesit;



4.1 MONITORIMI VJETOR I “STRATEGJISË TË ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL 2023-2027”

- audituesit janë promovuar nëpërmjet ngritjes në detyrë dhe nëpërmjet rotacionit në punë;
- auditues të ndryshëm kanë përfituar njohuri dhe ekspertizë në fusha të ndryshme auditimi, e cila njëkohësisht u ka shërbyer;
- për nxitje dhe zhvillim profesional dhe personal në këndvështrimin e marrëdhënieve njerëzore gjithashtu.

Objektivat e vitit 2025

Edhe gjatë vitit 2025, puna e KLSH-së do të vijojë të udhëhiqet nga misioni, vizioni dhe qëllimet strategjike të Planit Strategjik të KLSH-së 2023 - 2027, ku:

Në përmbushje të **Qëllimit Strategjik nr. 1**, institucioni do të vijojë të punojë për konsoliduar edhe më tej praktikatat e planifikimit strategjik të auditimeve bazuar në analizë të përditësuar rrisht sipas metodologjive bashkëkohore, si pjesë e pandashme e planifikimit strategjik të auditimeve për të siguruar një mbulim më efektiv dhe cilësor me auditim. KLSH do të angazhohet maksimalisht në implementimin e plotë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira gjatë gjithë fazave të auditimit, në përfitim të rritjes së profesionalizmit dhe objektivitetit, duke evidentuar nevojat për ndryshim. Po kështu, do të thellojë bashkëpunimin me Kuvendin, institucionet e tjera ligjzbatuese dhe palët e interesit, në luftën për të parandaluar rastet abuzive, si kontribut në luftën kundër korrupsionit dhe në të njëjtën kohë, duke promovuar rezultatet e punës audituese.

Në përmbushje të **Qëllimit Strategjik nr. 2**, me qëllim promovimin e vazhdueshëm të rolit të KLSH-së dhe punës audituese, si garantues i mirë përdorimit të fondeve publike, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit, në veçanti rrjeteve sociale do të angazhohet të rrisë transparencën dhe llogaridhënien kundrejt

publikut, sa i takon rezultateve të auditimeve me ndjeshmëri të lartë e jo vetëm. Po kështu, për të rritur lehtësuar përdorimin e raporteve të auditimit nga publiku, institucioni do të vijojë angazhimin për të hartuar raporte auditimi, të kuptueshëm, të qartë dhe aktual për çdo lexues. Në këtë mënyrë KLSH do të mund të rrisë impaktin e përgjithshëm të gjeneruar nga raportet e auditimit, pasi kështu do të mundësohet përcjellje e informacioneve, gjetjeve dhe rekomandimeve në mënyrë të qartë, koncize dhe efektive.

Në përmbushje të **Qëllimit Strategjik nr. 3**, edhe gjatë vitit 2025 do të synohet optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese, nëpërmjet pjesëmarrjes në aktiviteteve të ndryshme për shkëmbimin e njohurive, si për shembull: pjesëmarrje në seminare, workshop - e, internship - e, projekte dhe auditime të përbashkëta/paralele me organizma si INTOSAI, EUROSAI, GAO, ECA, OAG të Norvegjisë dhe SAI - e të tjerë homologe, ekspertë të fushës dhe personalitete në fushën akademike. Strategjia e Zhvillimit të institucionit do të vijojë të monitorohet me qëllim evidentimin me prioritetet të arritjeve të KLSH-së në këtë drejtim.

Në përmbushje të Qëllimit 3 të Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2023-2027, “Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese”, KLSH edhe gjatë vitit 2024 është përpjekur që të sigurojë një staf auditues i cili zotëron kompetencat e duhura, profesionale për të kryer detyrat funksionale në mënyrë efektive dhe eficiente, me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e veprimtarisë audituese dhe duke kontribuar kështu në arritjen e objektivave të institucionit.



4.2 MBI MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

Për menaxhimin e burimeve njerëzore KLSH:

- Zbaton kuadrin ligjor në fuqi;
- zbaton Standardet Ndërkombëtare të INTOSAI-t në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe praktikat më të mira, të përshtatshme për KLSH-në;
- synon rekrutimin e individëve me kualifikime të larta, që njohin gjuhë të huaja, ekspertë dhe specialistë me kontribute në fusha të ndryshme si të teknologjisë së informacionit etj.;
- siguron zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe rritje të kapaciteteve nëpërmjet programeve internship, fellowship, si dhe trajnimeve të vazhdueshme;
- zbaton një sistem objektiv të vlerësimit të stafit bazuar në performancë, në përmbushjen e objektivave individuale dhe kërkesave të kompetencave profesionale etj.

Organizimi strukturor i Kontrollit të Lartë të Shtetit është i miratuar me Vendimin nr. 19, datë 31.01.2022 të Kryetarit të KLSH-së, “Për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në KLSH”, i ndryshuar. Për vitin 2024 numri i punonjësve të miratuar ka qenë 243, i barabartë me numrin e punonjësve në vitin 2023. Në fund të vitit 2024, numri faktik i punonjësve është 216, nga të cilët trupa audituese përbën 75% të numrit total faktik ose 162 auditues*.

Klasifikuar sipas arsimimit, në strukturën organizative për vitin 2024, punonjësit me arsim të lartë janë 200 punonjës ose rreth 93% kundrejt numrit total faktik të punonjësve.

Të ndarë sipas profilit të diplomimit, klasifikimi i punonjësve me arsim të lartë përfshin kryesisht ekonomistë, financierë, kontabilistë, juristë, inxhinierë, arkitektë dhe profile të tjera. Me qëllim aftësimin profesional dhe metodologjik në funksion të përmirësimit të performancës, një pjesë e punonjësve kanë

përfunduar studimet universitare në degë të dyta apo janë trajnuar dhe certifikuar brenda dhe jashtë vendit në përgjigje të zhvillimeve të reja në fushën e auditimit publik.

87 | Ekonomistë, Financierë dhe Kontabilistë

51 | Juristë

22 | Inxhinierë

40 | Fusha të tjera

Të ndarë sipas profilit të diplomimit 200 nëpunësit që zotërojnë diplomë universitare janë:

- 31 nëpunës (16%) zotërojnë diploma të dyta sipas profileve që vijon:
- 21 nëpunës kanë diplomë të dytë në Shkenca Juridike;
- 4 nëpunës kanë diplomë të dytë në Shkenca Ekonomike/Financë-Kontabilitet;
- 6 nëpunës kanë diplomë të dytë në fusha të tjera.

Stafi i KLSH-së ka kualifikime shtesë për zhvillimin e vazhdueshëm profesional ku për vitin 2024 kemi:

- 1 nëpunës zotëron titullin “Prof.As”;
- 1 nëpunës ka certifikim CPA;
- 2 nëpunës zotërojnë titullin “Doktor i Shkencave”;
- 18 nëpunës aktualisht në marrëdhënie pune me KLSH-në kanë ndjekur ndër vite programin e intershipit në ECA (në vitin 2024 kanë ndjekur programin 5 auditues);
- 5 nëpunës aktualisht në marrëdhënie pune me KLSH-në kanë ndjekur ndër vite programin e Felloëship në GAO (në vitin 2024 ka ndjekur programin 1 auditues);
- 4 nëpunës kanë certifikatën “Kontabël i miratuar”;
- 21 nëpunës kanë certifikatën e Auditit të Brendshëm;

* Trupa audituese përbëhet nga 15 Kryeauditues dhe 147 auditues.




4.2 MBI MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE

- 13 nëpunës kanë certifikatën e Vlerësimit të Pasurive të Palujtshme;
- 3 nëpunës janë certifikuar në programe trajnimi ndërkombëtare të ofruara nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI).

Përbërja strukturore e stafit sipas funksioneve

Stafi drejtues përbën rreth 8% të numrit total faktik të punonjësve ose 17 punonjës; Stafi auditues (Kryeauditues dhe Auditues) përbën 75% të numrit total faktik të punonjësve ose 162 punonjës; Stafi mbështetës (Përgjegjës Sektori, specialistë, juristë, punonjës shërbimi etj.) përbën rreth 17% të numrit total faktik të punonjësve, ose 37 punonjës.



Mbi proceset e rekrutimit

Procedurat e rekrutimit të punonjësve përgjatë vitit 2024, janë zhvilluar në koherencë me Strategjinë e Zhvillimit të institucionit 2023-2027, si dhe politikave të miratuara të menaxhimit të burimeve njerëzore me qëllim që KLSH të sigurojë stafin e duhur me kualifikimet, aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të plotësuar nevojat aktuale dhe të perspektivës. Si një proces shumë i rëndësishëm që ndikon drejtpërsëdrejti në përmirësimin e performancës së institucionit, gjatë vitit 2024 për plotësimin e vendeve vakante janë nxjerrë në total 25 urdhra të Kryetarit të KLSH-së, në kategorinë staf profesional auditues, specialist etj.

Nga zhvillimi i procedurave kanë rezultuar fitues 33 kandidatë.

Punonjësit e rekrutuar janë emëruar rast pas rasti në departamentet e auditimit apo në departamentet dhe drejtoritë mbështetëse në plotësim të nevojave që ka secila njësi për realizimin e planit vjetor të auditimeve apo përmbushjen e objektivave dhe detyrave funksionale. Ndërsa në pozicionet që menaxhohen në zbatim të përcaktimeve të Kodit të Punës janë emëruar 2 punonjës.

Politikat e ngritjes në detyrë dhe nxitjes së karrierës

Përgjatë vitit 2024, është treguar kujdes për zhvillimin e karrierës brenda institucionit, duke e vlerësuar si faktor të rëndësishëm që i shërben drejtimit më të mirë dhe sigurimit e rritjes së cilësisë së veprimtarisë audituese. Aktualisht, zhvillimi profesional dhe përparimi në karrierë realizohet nëpërmjet sistemit të vlerësimit periodik të performancës dhe aftësive individuale, testimit të njohurive nga formimi profesional dhe konkurrimit transparent për të gjitha pozicionet pjesë e shërbimit civil.

Çdo punonjës ka të drejtën e ngritjes në detyrë dhe qëllimi i politikës së ngritjes në detyrë në KLSH është të sigurojë qëndrueshmërinë e stafit auditues, në një linjë me kuadrin rregullator institucional dhe Standardet Ndërkombëtare ISSAI. Në referencë dhe zbatim të standardeve ndërkombëtare, ku një institucion suprem auditimi duhet të ruajë dhe të zhvillojë trupën profesionale në funksion të qëllimit të krijimit të mundësive për promovimin dhe për integrimin



4.2 MBI MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE


për plotësimin e vendeve vakante me procedura të ngritjes në detyrë, konkretisht janë shpallur 7 pozicione vakante dhe janë plotësuar të gjitha.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, në zbatim të përcaktimeve të bëra në Dokumentin e Politikave të Menaxhimit të BNJ ka patur ngritje në detyrë dhe qarkullim të stafit midis departamenteve të auditimit sipas nevojave, apo për të motivuar punonjësit që të zgjerojnë njohuritë e tyre në lloje të ndryshme auditimesh.


Politikat e sigurimit të Barazisë Gjinore

KLSH, në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore i ka kushtuar vëmendjen e duhur respektimit të parimit të barazisë gjinore në të gjitha politikat, aspektet, veprimtaritë institucionale duke synuar eliminimin e fenomeneve të diskriminimit përshkak të gjinisë. Raporti i punonjësve femra/meshkuj, është përmirësuar duke pësuar një rritje të lehtë prej 1.6% krahasuar me një vit më parë. Politika e KLSH-së në mbështetje të zhvillimit në karrierë të gjinisë femërore, reflektohet në numrin e konsiderueshëm që femrat zënë në të gjitha nivelet drejtuese, duke përfaqësuar 45 % të pozicioneve drejtuese.

Raporti femra/meshkuj




Niveli drejtues, viti 2024



Mosha mesatare e nëpunësve dhe vjetërsia në institucion

Një tregues mjaft i rëndësishëm i politikave të ndjekura në drejtim të garantimit të vijueshmërisë së punës dhe të gërshetimit të përvojës së audituesve të vjetër me stafin e ri janë dhe treguesit moshës dhe të vjetërsisë në punë. Mosha mesatare në KLSH në fund të vitit 2024 është 42.2 vjeç nga 41.2 vjeç që ishte në vitin 2023. Ndërsa vitet e eksperiencës në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në vitin 2024 janë mesatarisht 7.5 vite.

Mosha mesatare/Vite në KLSH



4.3 ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL



Trajnimi dhe zhvillimi i audituesve, është një proces investimi strategjik i kohës, energjisë dhe burimeve, drejt përmirësimit të kapaciteteve audituese. KLSH i ka kushtuar një vëmendje të veçantë zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit të KLSH-së, si një prej prioriteteve kryesore në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve audituese, në bashkëpunim kjo me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm, për vitin 2024, KLSH

ka kryer në analizën e nevojave për trajnim, nëpërmjet pyetësorëve në google form nga i gjithë stafi auditues. Mbështetur në këto nevoja, në praktika të mira të institucioneve homologe, si dhe në referencë të qëllimeve strategjike të KLSH-së, është miratuar Programi i Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së, për vitin 2024, me Vendimin nr. 22, datë 05.02.2024, të Kryetarit të KLSH-së.

prioritet kryesor për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve audituese, kjo në bashkëpunim dhe me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm si, INTOSAI, EUROSAL, SIGMA, Zyra e Llogaridhënies së SHBA-ve (GAO), Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA), Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPAS); OSBE/SIGMA; Iniciativa për Zhvillimi e INTOSAI - t (IDI); Qendra e Ekselencës në Financë (CEF); SAI - e homologe etj.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024, u realizuan gjithsej 173 tema trajnimesh, nga të cilat 56 të organizuara nga ASPA, 47 nga KLSH dhe 70 nga partnerët ndërkombëtarë dhe vendas. Falë këtyre aktiviteteve, u realizuan mesatarisht 26 ditë trajnimi, nga 20 - 25 ditë trajnimi që është objektivi vjetor, për stafin auditues, dhe mesatarisht 20 ditë trajnimi për stafin jo-auditues, nga minimum 14 ditë që është objektivi vjetor.

Tabela nr. Kontributi në % sipas organizatorit



Referuar Plan - Veprimit mbi zbatimin e “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së” për vitin 2024, institucioni i ka kushtuar një vëmendje të veçantë zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit të tij, si

Përgjatë vitit 2024, KLSH ka vijuar të jetë promotori dhe organizator i një sërë aktiviteteve për zhvillimin profesional të stafit, në përputhje kjo me orientimet strategjike për periudhën 2023 – 2027, duke mbajtur peshën më të madhe të ditëve të trajnimeve të organizuara, ndjekur nga partnerët ndërkombëtarë dhe ata lokalë. Ndërsa sa i takon larmishmërisë së temave të

*Nr i referohet të gjithë stafit auditues të trajnuar gjatë vitit, përfshirë edhe stafin e larguar



4.3 ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL

auditimit, rreth 68 tema ose 34 % e totalit të tyre, janë organizuar nga partnerë ndërkombëtarë si SAI-e homologe, INTOSAI, EUROSAL, CEF etj.

Një pjesë e rëndësishme e temave të auditimit është realizuar me burime të brendshme të KLSH-së, konkretisht 47 tema, ose 27% e total temave të organizuara gjatë vitit 2024, janë zhvilluar duke shfrytëzuar ekspertizën e stafit të KLSH-së, në veçanti të atyre audituesve, të cilët janë specializuar dhe trajnuar në vitet paraardhëse, duke kontribuar kështu në konsolidimin e transferimit të njohurive brenda institucionit. Trajnimet me organizatorë partnerët ndërkombëtarë përmbajnë kryesisht tema që kanë të bëjnë me: menaxhimin e cilësisë; transferimin e njohurive për auditimin e performancës si proces, auditime në fushën e mjedisit si dhe mbi sigurinë kibernetike, auditimin e koncesioneve dhe PPP – ve; planifikimin strategjik; shkrimin e raporteve; antikorrupcionin etj.

Po kështu, plani i trajnimeve është mbështetur edhe nga ASPA dhe partnerët e brendshëm, të cilët kanë mbuluar 68 tema trajnimi, ose rreth 41% të numrit total të temave të trajnimeve, të organizuara gjatë 2024. Në veçanti, ASPA ka kontribuar në total me 56 tema trajnimi (32%), nga të cilat 24 janë tema trajnimi me certifikim dhe 32 tema të tjera trajnimesh, që kanë ndikuar në rritjen e njohurive profesionale të stafit auditues dhe jo – auditues të institucionit tonë. Aktivitetet trajnuese të KLSH-së, të kryera me synim konsolidimin e kapaciteteve audituese dhe jo – audituese, janë zhvilluar me prezencë fizike në sallën e trajnimeve të institucionit, si dhe online nëpërmjet platformës Microsoft Teams. Po kështu edhe partnerët ndërkombëtarë dhe të brendshëm kanë organizuar trajnime fizike dhe on line.

Më konkretisht, rreth 60% e trajnimeve të zhvilluara gjatë vitit 2024 kanë qenë trajnime on line, duke siguruar kështu një harmonizim më të

përshtatshëm të nevojës për përditësim të njohurive me misionet audituese dhe jo – audituese të stafit, duke marrë parasysh këtu edhe ngarkesën e punës në institucion.


Rreth 40% e trajnimeve të tjera janë zhvilluar me prezencë fizike, qoftë në KLSH, apo edhe në institucione të tjera jashtë vendit ose brenda tij, duke shfrytëzuar kështu avantazhet që sjell ndjekja e trajnimeve specifike me prezencë fizike.



4.4 VETËVLERËSIMI VJETOR SIPAS KORNIZËS SË INDIKATORËVE TË MATJES SË PERFORMANCËS, INTOSAI

Kontrolli i Lartë i Shtetit edhe për vitin 2024 ka përdorur Kornizën e Matjes së Performancës së SAI - ve (SAI PMF) si mjet monitorimi të veprimtarisë së institucionit. Përdorimi i këtij mjeti i mundëson institucionit një vlerësimin holistik të veprimtarisë së tij duke e ndërthurur atë edhe me procesin e monitorimit të strategjisë së zhvillimit institucional. INTOSAI e ka cilësuar SAI PMF - në si një e Mirë Publike Globale e INTOSAI - t1, të cilën institucionet supreme të auditimit mund ta përdorin sipas konteksteve të tyre specifike.

Për vitin 2024, KLSH ka kryer vetëvlerësimin sipas kuadrit SAI PMF, bazuar në Udhëzuesin e ri të IDI (Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI - t) për Përdorimin e SAI PMF për monitorimin vjetor dhe vlerësime të pjesshme*, i cili rekomandon kryerjen e vetëvlerësimit vjetor për grup komponentësh tashmë, pasi jo të gjithë treguesit dhe dimensionet e SAI PMF - së janë të përshtatshme për monitorim vjetor**, duke qenë se janë ndërtuar në mënyrë të tillë që kërkojnë një periudhë më të gjatë kohe për t'u materializuar ndryshimet e si pasojë për të prodhuar rezultat.



Duke marrë në konsideratë: (i) Udhëzuesin ***; (ii) krijimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit, sipas ISSAI 140, të rishikuar, fokusi i të cilit është cilësia e auditimeve; (iii) vetëvlerësimin

që KLSH ka kryer sipas kuadrit SAI PMF, për vitin 2023; (iv) procesin e kontrollit të cilësisë së auditimeve të përfunduara; si dhe (v) rëndësinë që mbart koncepti i pavarësisë së SAI-t me qëllim përmbushjen e misionit kushtetues të tij, për vitin 2024 në kuadër të vetëvlerësimit, KLSH ka kryer monitorim të pjesshëm të:

- të pavarësisë dhe implikimeve të saj në praktikë,
- aftësisë për të përmbushur mandatin përmes planifikimit të auditimeve,
- politikave të brendshme organizative, dhe
- cilësisë së punës audituese së KLSH - së

Pavarësia dhe implikimet e saj në praktikë****

Koncepti i pavarësisë së SAI - ve, sipas parashikimeve të Deklaratës së Limës, zbërthehet në shumë dimensione, të cilat marrin kuptim të veçantë në kontekstet specifike të SAI - ve. Në këtë këndvështrim, përveç kërkesave specifike të pavarësisë të sanksionuar në Kushtetutë dhe në ligjet organike të SAI - ve, koncepti i pavarësisë kërkon edhe plotësimin e tij me dimensionin financiar dhe operacional të SAI - t, pa përjashtuar këtu edhe detyrimin e SAI - t për llogaridhënie dhe transparencë kundrejt parlamentit dhe qytetarëve. Kështu, shumë institucione supreme auditime përballen me sfida të shumta të pavarësisë, veçanërisht sa i takon pavarësisë financiare dhe operacionale.

Nga vlerësimi i dimensioneve të SAI PMF, që lidhen me konceptin e pavarësisë financiare dhe operacionale, zhvillimet më të rëndësishme kanë ardhur gjatë vitit 2024, me konsolidimin e marrëdhënieve me Kuvendin e Shqipërisë, nëpërmjet krijimit të Nën Komisionit Parlamentar të Auditimit për Sektorin Publik. Krijimi i një forumi të dedikuar për të diskutuar çështjet specifike të auditimit të jashtëm publik në Kuvend, vjen si një mënyrë për të promovuar transparencën dhe llogaridhënien e sektorit publik por edhe të KLSH-së. Në përgjigje të sa më sipër, KLSH ka ngritur strukturën përkatëse për të koordinuar marrëdhënien me Kuvendin, Drejtorinë e Marrëdhënieve me Nën - Komisionin Parlamentar.

* <https://www.idi.no/our-resources/global-public-goods/well-governed-sais-gpg>

** <https://www.idi.no/elibrary/well-governed-sais/sai-pmf/1705-final-guidance-using-sai-pmf-for-additional-monitoring/file>

*** Në paragrafin 13 të kreut D, të këtij udhëzuesi parashikohet se, vetëm disa tregues dhe dimensione të PMF të KLSH-së janë të përshtatshëm për qëllimet e një monitorimi të rregullt vjetor. Shumica e treguesve dhe dimensioneve janë ndërtuar në atë mënyrë që nuk do të jepte ndonjë vlerë për t'u monitoruar çdo vit, pasi do të duhej një periudhë më e gjatë kohore që të materializoheshin ndryshimet, të cilat do të reflektoheshin në ndryshimin e pikëve (ndaj është vështirë që të ketë ndryshime të thella pikëzimi nga viti në vit). Prandaj SAI-et duhet të marrin në konsideratë vlerësimet e njëhershme në një kohë kur ata realisht do të prisnin ndryshime ose do të kishin planifikuar që ndryshimet të kishin ndodhur.

****SAI -1 Pavarësia e SAI-t, SAI - 21 Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Shërbimet Mbështetëse, dhe SAI - 22 Menaxhimi e Burimeve Njerëzore.



4.4 VETËVLERËSIMI VJETOR SIPAS KORNIZËS SË INDIKATORËVE TË MATJES SË PERFORMANCËS, INTOSAI

Në diferencë nga Institucione të tjera Supreme të auditimit në komunitetin e INTOSAI - t, të cilat kanë problematika të kuadrit ligjor që kushtëzon mandatin e tyre, KLSH vepron në një mjedis kushtetues dhe ligjor të konsoliduar, i cili përkufizon në mënyrë të qartë mandatin auditues. Në këtë rast, angazhimi i KLSH lidhet ngushtësisht me aftësinë e institucionit për të mbuluar me auditim institucionet më të rëndësishme, fushat më me risk etj. Për të kryer vlerësimin e kësaj kërkesë të standardeve, Udhëzuesi (cituar më sipër) sugjeron që SAI – et të vlerësojnë qasjen e bazuar në risk, gjatë planifikimit vjetor të auditimeve. Në këtë drejtim, KLSH ka konsoliduar përdorimin e Metodologjisë së Planifikimit Vjetor të Auditimeve, dokument ky i miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 166, datë 26.09.2023, si mjetin kryesor që siguron harmonizimin e duhur midis detyrimit për të audituar, kapaciteteve audituese dhe burimeve. Që një institucion suprem auditimi të funksionojë mirë, duhet që ai të ketë ndërtuar dhe konsoliduar një mjedis të kontrollit organizativ të shëndoshë, i cili fokusohet kundrejt ruajtjes së kërkesave etike dhe përmirësimit të cilësisë së punës së institucionit. Sipas Udhëzuesit (cituar më sipër), kjo qasje e përgjithshme e institucionit në drejtim të politikave të brendshme** të organizatës mund të vlerësohet duke shqyrtuar politikën, sistemet dhe praktikën e brendshme*.

Në këtë drejtim për vitin 2024, nga vetëvlerësimi i kryer për këto çështje nga KLSH ka rezultuar se menaxhimi i lartë i institucionit ka konfirmuar angazhimin kundrejt ISSAI – ve, duke vendosur theksin pikërisht kundrejt etikës dhe cilësisë, si dy parime udhëheqëse të punës në KLSH, nëpërmjet rishikimit të Kodit Etik të institucionit, në linjë me ISSAI 130 “Kodi Etik”, të rishikuar. Po kështu, sa i takon angazhimin kundrejt cilësisë së punës audituese dhe jo audituese të KLSH-së, në vitin 2024 janë miratuar ndryshimet e politikave në fushën e

menaxhimit të cilësisë, duke kaluar nga koncepti i kontrollit të cilësisë/sigurimit të cilësisë, në atë të menaxhimit të cilësisë në KLSH, sikundër edhe kërkohet nga ISSA 140, i rishikuar.

Për të reflektuar këtë ndryshim, KLSH ka marrë pjesë në projektin pilot të udhëhequr nga IDI, në përfundim të të cilit ka miratuar dokumentet përkatëse si vijon: Politika e Menaxhimit të Cilësisë në KLSH, Udhëzuesi i Menaxhimit të Riskut të Cilësisë, Regjistri i Riskut të Cilësisë. Për kontrollin e cilësisë, KLSH mbështetet në rishikimin hierarkik të dokumenteve të auditimit nga përgjegjësi i grupit, Kryeaudituesi, Drejtorët e Departamenteve, Departamenti i Shqyrtimit, Mbikëqyrjes dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit dhe Zbatimit të Standardeve, Drejtori i Përgjithshëm dhe Kryetari. I gjithë aktiviteti auditues i nënshtrohet procedurave të kontrollit të cilësisë, nga fillimi i auditimit deri në publikimin e raportit përfundimtar. Një element i rëndësishëm, me ndikim në cilësinë e veprimtarisë audituese është kuadri rregullator në të cilën bazohet kontrolli dhe sigurimi i cilësisë së auditimit, si: Rregullorja e Procedurave të Auditimit e përditësuar, Manuali i Auditimit Financiar; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë; Manuali i Auditimit të Performancës; Manuali i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve, Udhëzuesi për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit.


Gjatë vitit 2024, kontrolli i cilësisë “në të ftohtë” është kryer në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të KLSH-së nr. 104, datë 24.10.2024 “Për kontrollin e sigurimit të cilësisë në procesin auditues për vitin 2024”. Ky urdhër ka përcaktuar afatet, grupin e punës, drejtimet kryesore ku duhet të përqendrohet kjo veprimtari, si dhe listën verifikuese me 19 kritere për analizën e cilësisë në të gjitha fazat e ciklit auditues. Në zbatim të këtij urdhri janë kontrolluar “në të ftohtë” 30% e auditimeve të evaduara në vitin 2024, ose 40 dosje auditimi, rezultatet e të cilave bëhen pjesë e programit të zhvillimit profesional vjetor, të stafit të KLSH-së.

*SAI - 7 Planifikimi i Auditimit dhe/ose i kombinuar me SAI - 8 Mbulimi i Auditimit.

** SAI - 4 Mjedisi i Kontrollit Organizativ, SAI - 6 Udhëheqja dhe Komunikimi i Brendshëm.









05

Komunikimi dhe
bashkëpunimi
institucional


KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL


- 

2
Raportime të KLSH-së në Kuvend

 - Raporti i Performancës së KLSH-së për vitin 2023;
 - Raporti për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2023;
- 

139
Raporte auditimi të dërguara

 - 3** Raporte Përmbledhëse të Zbatimit të rekomandimeve
 - 2** Buletine mujore
 - 3** Buletine 4-mujore të Veprimtarisë së KLSH-së
- 

3
KLSH pjesëmarrëse në komisione parlamentare
- 

9
Aktivitete të përbashkëta dhe me fokus veprimtarinë Kuvend-KLSH.



15
Aktivitete në kuadër të bashkëpunimit me shoqërinë civile



382
Artikuj në shtypin e shkruar

1830
Artikuj të publikuar në media



1448
Artikuj në median audio-vizive / online



205
Kronika / emisione televizive



Publikime në web

106
Raporte përfundimtare auditimi

2
Buletine mujorë



2
Marrëveshje të reja bashkëpunimi të nënshkruara me institucione homologe



58
Konferenca, trajnime, seminare, takime ndërkombëtare ku KLSH ka marr pjesë.



3
Auditime paralele



5.1 KLSH DHE KUVENDI

Në zbatim të objektivave strategjike të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por dhe si kërkesë e institucioneve të BE e specifikuar në progres raportet e Komisionit European, Kapitulli 32 “Kontrolli financiar/Auditimi i jashtëm”, ku është rekomanduar në vazhdimësi thellimi i bashkëpunimit KLSH-Kuvend dhe ngritja e strukturave të dedikuara dhe efikase për rritjen e këtij bashkëpunimi, gjatë viti 2024, me asistencë nga National Democratic Institute (NDI) është punuar intensivisht për ngritjen Nënkomisionit për Auditimin në Sektorin Publik, i finalizuar me Vendimin e Kuvendit nr. 70, datë 25.07.2024.

Në vijim, Kryetari i KLSH-së ka krijuar strukturë të veçantë për të koordinuar veprimtarinë me Nënkomisionin dhe Kuvendin.

Përmirësimi jo vetëm i formës por dhe i përmbajtjes së këtij komunikimi KLSH-Kuvend është domosdoshmëri jo vetëm për rritjen e efektivitetit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, por dhe për rritjen e rolit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj ekzekutivit.

Në nëntor 2024 është zhvilluar dëgjesa e parë në Nënkomisionin për Auditimin në Sektorin Publik, për shqyrtimin e Raportit të Auditimit të Performancës, me temë “Kujdesi ndaj të moshuarve”, ku pas dëgjësës së subjekteve të audituara, Nënkomisioni ka dalë me raport për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke i kërkuar subjekteve të përfshira në këtë auditim zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara.

KLSH vlerëson maksimalisht bashkëpunimin dhe mbështetjen e Kuvendit të Shqipërisë për përmbushjen e misionit kushtetues të KLSH-së, si dhe beson që ky komunikim do të ndikojë në rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së dhe për rrjedhojë në përmirësimin e mirë-qeverisjes, përdorimin e parasë publike dhe uljen e korrupsionit.

Raportime të Kontrollit të Lartë të Shtetit në Kuvend

Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, gjatë vitit 2024, KLSH ka përcjellë në Kuvend:

- Raportin e Performancës së KLSH-së për vitin 2023, dërguar me Shkresën nr. 43/2, datë 29.03.2024, referuar Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, neni 31 “Raportimi në Kuvend”, pika 3;

Raportimi i KLSH-së mbi veprimtarinë e vitit 2023, është shtrirë në 5 seanca dëgjimore (datë 16.07.2024; 17.07.2024; 19.07.2024; 23.07.2024 dhe 08.10.2024) në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

- Raportin për zbatimin e buxhetit të vitit 2023, dërguar me Shkresën nr. 1267/1, datë 22.10.2024, referuar Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, neni 31 “Raportimi në Kuvend”, pika 1;

Raportimi i Kryetarit të KLSH-së “Mbi Raportin e Zbatimit të Buxhetit të vitit 2023”, në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, është zhvilluar në seancën dëgjimore të datës 29.10.2024.

- 139 raporte auditimi, referuar Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, neni 31 “Raportimi në Kuvend”, pika 1.
- 2 Raporte përmbledhëse mbi zbatimin e rekomandimeve, me shkresën nr. 962 prot., datë 25.07.2024 dhe nr. 282, datë 25.02.2025 drejtuar Kryetares së Kuvendit dhe me shkresën nr. 962/1 prot, datë 25.07.2024, dhe nr. 282/1 prot, datë 25.02.2025, drejtuar Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Kuvendin
- 2 Buletine informuese, mujore (për muajt nëntor dhe dhjetor 2024), në zbatim edhe të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për veprimtarinë e KLSH për vitin 2023;
- 3 Buletinet statistikore, 4-mujore të Veprimtarisë së KLSH-së:



5.1 KLSH DHE KUVENDI

Pjesëmarrja e KLSH-së në komisione parlamentare gjatë vitit 2024.

Gjatë vitit 2024, auditues të KLSH-së kanë marrë pjesë në dy komisione parlamentare në cilësinë e dëshmitarit në Komisionin Hetimor "Për shërbimet publike të sterilizimit dhe të check-up-it në shëndetësi" dhe në nivel ekspertit në Komisionin e Posaçëm "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian". Gjithashtu KLSH, ka qenë dhe do të jetë prezent në çdo mbledhje të Nënkomisionit për Auditimin në Sektorin Publik.

Komisioni hetimor "Për shërbimet publike të sterilizimit dhe të check-up-it në shëndetësi" i ngritur me Vendimin nr. 19, datë 21.03.2024 të Kuvendit. Audituesit e KLSH kanë marrë pjesë në disa seanca dëgjimore në Komisionin Hetimor, në cilësinë e dëshmitarit, ku kanë dhënë dëshmitë e tyre dhe sqarime rreth pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e Komisionit, mbi gjetjet dhe rekomandimet e lëna në auditimet e kryera nga KLSH me temë Kontratat e Partneritetit Publik-Privat (PPP) "Kontrolli mjekësor bazë" dhe "Sterilizimi".

Komisioni i Posaçëm "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian", i ngritur me Vendimin nr. 50, datë 30.05.2024, të Kuvendit. KLSH, është përfaqësuar në këtë komision në nivel ekspertësh dhe sekretariati teknik, duke kontribuar në tre shtyllat e kësaj reforme ligjore: Mirëqeverisja; Antikorrupsioni dhe Sundimi i ligjit.

Aktivitete të përbashkëta dhe me fokus veprimtarinë Kuvend-KLSH.

Gjatë vitit 2024, janë zhvilluar një sërë aktivitete të përbashkëta me objekt, intensifikimin e bashkëpunimit midis Kuvendit dhe KLSH, ku ka patur përfaqësim nga dy institucionet dhe më pjesëmarrje të Kryetarit dhe stafit të KLSH-së.

Kryetari i KLSH-së ka zhvilluar një sërë takimesh në kuadër të thellimit të bashkëpunimit KLSH-Kuvend, me përfaqësues të organizatave dhe institucioneve të ndryshme, si vijon:

- Takim me përfaqësuesit dhe ekspertët e Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) në kuadër të mbështetjes që NDI ka ofruar për Kuvendit të Shqipërisë me qëllim krijimin e një nënkomisioni parlamentar që do të përmirësojë transparencën, përgjegjësinë dhe efikasitetin në menaxhimin financiar.
- Takim me ekspertin e NDI-së, z. Juhan Parts, i cili ka shërbyer si Kryeministër, Ministër i Financave dhe Auditor i Përgjithshëm i Estonisë dhe znj. Ana Kovaçeviç, Drejtoreshë e Lartë e NDI.
- Takimin e zhvilluar nga Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë me drejtuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, i cili kishte në fokus të diskutimeve raportimin dhe monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të këtyre institucioneve.



5.1 KLSH DHE KUVENDI

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, përfaqësues të KLSH-së kanë marrë pjesë në aktivitetet si më poshtë:

- Tryezë diskutimi me temë “Rritja e përgjegjshmërisë së Parlamentit ndaj shqetësimeve të qytetarëve”, me ftesë të Institutit Shqiptar të Shkencës (AIS), ;
- Tryezë diskutimi "Mbi standardet dhe praktikat e procesit raportues në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë", organizuar nga Instituti i Studimeve Politike, për grupin e institucioneve: KLSH, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) dhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP);
- Përfaqësues të KLSH-së dhe anëtarët e Nënkomisionit për Auditimin në Sektorin Publik në Kuvendin e Shqipërisë, kanë marrë pjesë në takimin e punës, iniciuar nga National Democratic Institute (NDI) mbi intensifikimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis Nënkomisionit të Auditimit të Sektorit Publik në Kuvendin e Shqipërisë dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Takim i organizuar nga National Democratic Institute (NDI) mbi intensifikimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis Parlamentit dhe SAI-t, me KLSH dhe anëtarë të Nënkomisionit për Auditimin në Sektorin Publik, mbi intensifikimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis Parlamentit dhe SAI-t.
- Takim me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA).
- Workshop mbi promovimin e “Parlamentit të hapur” në Shqipëri, ku u diskutua situata aktuale dhe plani për përmirësim.

Zbatim i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit, mbi Raportin e Performancës së KLSH-së për vitin 2023.

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë mbi vlerësimin e Raportit të Performancës së KLSH për vitin 2023, miratuar nga Kuvendi më datë 17.10.2024, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka miratuar Plan-Vepimin mbi zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 1309/1 prot., datë 18.11.2024.

Në ndryshim nga vitet e mëparshme Rezoluta e Kuvendit mbi Performancën e KLSH-së për vitin 2023, u miratua më datë 17.10.2024, si dhe i është përcjellë KLSH-së nga Kuvendi me shkresë nr. 4065 prot., datë 29.10.2024, ku afati i zbatimit të rekomandimeve është përcaktuar 30.06.2025.

Aktualisht niveli i zbatimi i rekomandimeve, me afat realizimi deri më datë 30.06.2025, paraqitet si më poshtë:

Rekomandimi nr. 1

“KLSH të përmirësojë punën audituese nëpërmjet implementimit të metodologjisë për auditimin e koncesioneve dhe PPP-ve”.

- Për të përmirësuar cilësinë e auditimeve me fokus PPP dhe koncesionet së fundmi është hartuar Manuali mbi auditimin e PPP-ve, i cili u realizua në kuadër të Projektit “Forcimi i kapaciteteve profesionale të Kontrollit të Lartë të Shtetit në auditimin e Kontratave Koncesionare dhe Partneritetit Publik Privat (PPP)”, financuar nga Sekretariati i Shtetit për Bashkëpunim Ekonomik i Zvicrës (SECO), publikuar në web-KLSH;
- Gjatë vitit 2024 mbi auditimin e koncesioneve dhe PPP-ve, janë zhvilluar 5 trajnime dhe 209 ditë-njerëz trajnimi.
- Në Planin e trajnimeve dhe zhvillimit profesional për vitin 2025, është planifikuar të zhvillohen 2 trajnime mbi Manualin e auditimit të PPP, si dhe një trajnim mbi koncesionet.



5.1 KLSH DHE KUVENDI

- Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të fazës së fundit të implementimit të projektit “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat (PPP) në Shqipëri” financuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), 20 auditues të KLSH-së vizituan Gjykatën Turke të Llogarive (TCA). Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte shkëmbimi i eksperiencës së TCA-së në auditimin e kontratave koncensionare dhe të partneritetit publik privat (PPP).

Rekomandimi nr. 2

“KLSH të intensifikojë bashkëpunimin me SAI-et homologe, në veçanti për zhvillimin e një numri më të madh auditimesh të përbashkëta të performancës dhe IT-së, për tema që prekin çështjet mjedisore, ndërmarrjen e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimin e klimës, sigurinë ndaj sulmeve kibernetike”.

Gjatë vitit 2024 janë kryer dhe në planin e vitit 2025, janë parashikuar të kryhen disa auditime në bashkëpunim me SAI-et homologe.

- Në bashkëpunim me IDI, është realizuar dhe evaduar auditimi i performancës me temë "Zbatimi i planeve të adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike". Krahas auditimit, janë zhvilluar nga grupi i auditimit edhe trajnime online nga ekspertet e IDI dhe INTOSAI WGEA, të cilët kanë mentoruar grupin e auditimit përgjatë të gjithë ciklit të auditimit.
- Një tjetër auditim performance, i cili ka filluar në vitin 2024 dhe që po realizohet në bashkëpunim me Institucionin Suprem të Auditimit të Norvegjisë, është edhe auditimi me temë "Cilësia e ujërave në plazhe". Ky auditim pritet të përfundojë në mesin e vitit 2025.
- Sa i përket çështjeve të teknologjisë së informacionit, KLSH është duke zhvilluar një auditim performance me temë "Siguria kibernetike në infrastrukturën E-taxation", auditim edhe ky që po realizohet në bashkëpunim me SAI-n e Norvegjisë (2025).

Të tjera:

- Edhe pse jo në fushat mjedisore dhe IT, Departamenti i Auditimit të Performancës është duke zhvilluar një auditim performance me temë "Shërbimi Psiko-Social në Sistemin Arsimor Parauniversitar" përsëri në bashkëpunim me SAI-n e Norvegjisë. Ky auditim pritet të përfundojë në mesin e vitit 2025.
- Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim, është një auditim paralel me disa SAI-e/Udhëhiqet nga SAI i Izraelit

Rekomandimi nr. 3

“KLSH të bashkëpunojë me Nënkomisionin për Auditimin e Sektorit Publik, për zbatimin e rekomandimeve, duke i pajisur anëtarët e tij gjithashtu edhe me informacione nga praktikat më të mira, duke përmirësuar cilësinë e raporteve dhe rekomandimeve, duke vendosur një balancë të drejtë midis rekomandimeve me ndikim afatgjatë dhe atyre afatshkurtër, nën shembujt e NAO (Zyra Kombëtare e Auditimit) në Angli dhe të prezantojë brenda dhjetorit të vitit 2024, Newsletter-i mujor si dhe modele raportimi më të thjeshta, më të përmbledhura dhe më të kuptueshme”.

Janë zhvilluar, sipas kalendarit të Nënkomisionit mbledhjet dhe dëgjesat, si dhe i është ofruar Nënkomisionit ekspertizë dhe dokumentacioni i kërkuar. Nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Nënkomisionin Parlamentar, janë përgatitur informacione dhe Raporte auditimi në format të shkurtuar, Informacion përmbledhës mbi zbatimin e rekomandimeve, mbi raportet e auditimit të cilat janë shqyrtuar nga Nënkomisioni përgjatë kësaj periudhe.

Nga Drejtoria e Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, hartohet çdo muaj në formën e një “Newsletter” Buletini mujor mbi çështje kryesore të veprimtarisë së KLSH-së, i cili publikohet në web-KLSH, si dhe i është



5.1 KLSH DHE KUVENDI

përcjellë Nënkomisionit për Auditimin në Sektorin Publik. Aktualisht KLSH po realizon një program me NAO-n, i cili do të zbatohet nga WFD në Shqipëri me kohëzgjatje tre mujore. Mbështetja për KLSH do të jetë në disa drejtime që përfshijnë komunikimin në tërësi dhe shkrimin e raporteve të auditimit.

KLSH ka marrë pjesë në workshop-in e organizuar nga SIGMA dhe CEF-Sloveni me SAI-e të vendeve kandidatë dhe kandidatë potenciale, me temë “Përmirësimi i shkrimit të raporteve”, me mbështetje nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë (SNAO).

Gjithashtu, trajnimet lidhur me shkrimin e raporteve, janë përfshirë edhe në planet vjetore të miratuara, të trajnimeve.

Rekomandimi nr. 4

“KLSH të realizojë auditime të performancës për fusha që lidhen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, siç janë ndërtimi i institucioneve efektive etj.”

Në vijim të rekomandimit të mësipërm, si dhe në përmbushje të Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) sipas Axhendës 2030, nëpërmjet punës audituese, në përputhje edhe me prioritetet strategjike të INTOSAI-t, dhe me planin strategjik të KLSH-së 2023-2027, gjatë vitit 2024, KLSH ka kryer 7 auditime (ose 4 auditime më shumë se viti 2023), që mbulojnë fushat e OZHQ-ve, si më poshtë:

- Për OZHQ 3 “Shëndeti dhe Mirëqenia” tema: “Politikat dhe respektimi i të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor në shërbimin spitalor Psikiatrik”;
- Për OZHQ 4 “Arsim Cilësor”, tema: “Orientimi për Karrierë i të Rinjve në Sistemin Arsimor Parauniversitar”.
- Për OZHQ 13 “Veprim për klimën”, tema: “Zbatimi i Planit Kombëtar për Zbutjen dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike”.

- Për OZHQ 15 “Jeta në tokë”, tema: “Ndikimi i aktivitetit minerar në fondin pyjor”.

Në planin e auditimeve të vitit 2025, gjithashtu janë përfshirë tema që lidhen me OZHQ-të.

Rekomandimi nr. 5

“KLSH të ketë prioritet auditimet në të gjitha institucionet e pavarura që raportojnë në Kuvendin e Shqipërisë dhe rezultatet e këtyre auditimeve t'i paraqesë hollësisht në raportin vjetor të veprimtarisë për vitin në vijim.”

Kontrolli i Lartë i Shtetit në vazhdimësi ka patur prioritet auditimin e institucioneve të pavarura. Nga 26 institucione të pavarura që kanë detyrim raportimin në Kuvend, KLSH ka audituar 10 institucione në vitin 2024.

Në vitin 2024 janë audituar: Akademia e Shkencave, Autoriteti i Konkurrencës, Banka e Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese, Keshilli i Lartë i Prokurorise, Komisioneri për të drejtën për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Prokuroria e Përgjithshme, Radio Televizioni Shqiptar, Universiteti Politeknik i Tiranë.

Rekomandimi nr. 6

“KLSH të planifikojë kryerjen e auditimit të marrëveshjeve të nënshkruara në sektorin e hidrokarbureve, në veçanti atyre kontratave të cilave u ka përfunduar afati i zbatimit.”

Në zbatim të këtij rekomandimi në Planin e auditimeve të vitit 2025, është planifikuar 1 (një) auditim mbi përfitimin nga shfrytëzimi i burimeve kombëtare të hidrokarbureve (Bankers Petroleum për periudhën 2019 - 2024).

Rekomandimi nr. 7

“KLSH t'i paraqesë Kuvendit, rekomandimet e nevojshme për përmirësime në kuadrin ligjor nga auditimet e kryera në institucionet e administratës shtetërore e publike.”



5.1 KLSH DHE KUVENDI

Përmbledhja e rekomandimeve për përmirësime ligjore do të jetë pjesë e këtij Raporti të Performancës së KLSH-it, si aneks i veçantë, ku do të përfshihen të gjitha rekomandimet për përmirësime ligjore, nënligjore dhe rregullative të propozuara nga KLSH, sipas adresimit të tyre.

Rekomandimi nr. 8

“KLSH të rrisë angazhimin për plotësimin dhe përditësimin periodik të Platformës Ndërinstitucionale Online të Kuvendit mbi zbatimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara si dhe të pasurojë buletinet e auditimeve me të dhëna statistikore për statusin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.”

KLSH vazhdon të popullojë dhe përditësojë Platformën on-line të Kuvendit, por përgjatë kësaj periudhe ka patur mungesë aksesit në Platformën online të Kuvendit, të cilat KLSH i ka bërë prezent.

Në vijimësi Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka përcjellë Kuvendit dhe Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Kuvendin, Raportet Përmbledhëse mbi Zbatimin e Rekomandimeve referuar “Manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 134/2018.

Rekomandimi nr. 9

“KLSH të angazhohet për plotësimin e vakancave, me qëllim plotësimin e kapaciteteve dhe miradministrimin e burimeve njerëzore, në veçanti të stafit të angazhuar me veprimtarinë audituese.”

K Kontrolli i Lartë i Shtetit për shkak të dinamikës institucionale, shpall dhe zhvillon procedura rekrutimi në vazhdimësi, me qëllim plotësimin e vendeve vakante. Bazuar në VKM nr. 108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” pika 11, me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 22, datë 30.01.2025 është miratuar Plani vjetor të pranimit në KLSH, për vitin 2025.

Në fund të vitit 2024, numri faktik i punonjësve ka qenë 216 punonjës nga 243 të miratuar, duke rezultuar me 27 vende vakante. Aktualisht janë 5 procedura rekrutimi në proces.

Rekomandimi nr. 10

“KLSH të rrisë ekspertizën profesionale audituese në përputhje të plotë me Rregulloren e re të Procedurave të Auditimit, udhëzuesin mbi shkrimin e Raporteve dhe me manualet përkatëse, me qëllim përmirësimin e rregullave për shkrimin e raporteve, në përmbajtje të të cilave të ketë gjetje dhe rekomandime të qarta, të realizueshme dhe të matshme.”

K Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë vitit 2024, ka realizuar një sërë trajnimesh në zbatim të Planit Vjetor të trajnimeve dhe zhvillimit profesional.

Lidhur me trajnimet për Rregulloren e Procedurave të Auditimit, janë zhvilluar 2 trajnime, ose realizuar 124 ditë njerëz trajnimi; Lidhur me trajnimet mbi Udhëzuesin mbi shkrimet e raporteve, janë zhvilluar 5 trajnime, ose realizuar 191 ditë njerëz trajnimi; Lidhur me manualet e auditimit, janë zhvilluar 5 trajnime, ose realizuar 221 ditë njerëz trajnimi.

Në Planin e trajnimeve dhe zhvillimit profesional të KLSH-së për vitin 2025, janë planifikuar të zhvillohen trajnime mbi të gjitha manualet e auditimit, manuale specifike dhe Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH-së.

Rekomandimi nr. 11

“KLSH të angazhohet në përcaktimin e mënyrës dhe metodologjinë e përlogaritjes së dëmit ekonomik që i shkaktohet buxhetit të shtetit, të evidentuar mbi bazë periodike vjetore, referuar praktikave më të mira dhe ta publikojë atë në faqen zyrtare të institucionit.”



5.1 KLSH DHE KUVENDI

Nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional dhe Drejtoria Juridike, në bashkëpunim me Departamentet e auditimit, është hartuar gjurma e auditimit mbi vlerësimin e “dëmit ekonomik” praktikuar nga KLSH, e cila do të bëhet pjesë e Rregullores së Procedurave të Auditimit, referuar Urdhrit të Kryetarit të KLSH-së nr. 20, datë 30.01.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e ndryshimeve dhe përditësimin e akteve nënligjore të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Rekomandimi nr. 12

“KLSH të nisë e zhvillojë me partnerët e huaj përfshirë SIGMA etj., një proces të vlerësimit dhe analizës së strukturës dhe burimeve njerëzore si dhe rritjen e efektivitetit të tyre në punën audituese.”

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të bashkëpunimit me SIGMA-n, më datë 03.02.2025 ka nisur procesin e vlerësimit “Peer review” për të cilin, ka përfunduar me sukses faza e intervistimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar nga ana e vlerësuesve. Raporti Përfundimtar i Vlerësimit, do t’i vihet në dispozicion Komisionit, në momentin e finalizimit të tij.

Rekomandimi nr. 13

“KLSH të ridimensionojë në përputhje me ligjin, rolin dhe përgjegjësinë e tij në raport me Auditimin e Brendshëm të Institucioneve, funksionimin, integritetin dhe efektivitetin e tyre.”

Referuar Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, neni 16 dhe 31, KLSH në raportin “Mbi Zbatimin e Buxhetit” shprehet për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik (KBFP), një nga shtyllat e të cilit është edhe Auditi i Brendshëm.

Rekomandimi nr. 14

“KLSH të angazhohet më shumë në drejtim të shtimit të kanaleve të komunikimit me qëllim përmirësimin e aksesueshmërisë së palëve të interesuara, përfshirë krijimin e një hapësire të dedikuar për anketime, për ankesat/ kërkesat e publikut etj.”

Në faqen zyrtare të KLSH-së, në rubrikën denoncime ofrohet aksesimi për ankesat e publikut. Në zbatim të këtij rekomandimi, KLSH ka shtuar kanalet e komunikimit me qëllim përmirësimin e aksesueshmërisë së palëve të interesuara, nëpërmjet faqeve zyrtare të Instagramit dhe Facebook.

Rekomandimi nr. 15



“KLSH të zhvillojë rregulla të brendshme për të bërë më shumë transparent procesin e caktimit të audituesve për një auditim, për të bërë publike në nisje të një auditimi planin e auditimit dhe kohëzgjatjen maksimale të tij.”

KLSH ka miratuar dhe publikuar në faqen zyrtare Planin Vjetor të auditimeve të vitit 2024, Planin vjetor të vitit 2025, si dhe plane mujore në të cilat jepen të dhëna sipas kërkesave të rekomandimit nr. 15. Konkretisht të dhëna mbi:

- Subjektin që do të auditohet;
- Periudhën e veprimtarisë së subjektit, e cila do të auditohet;
- Afati i auditimit duke detajuar tre procese (terrenin; Projektraportin dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit);
- Grupin e auditimit;
- Personin mbikëqyrës të auditimit.




5.2 KLSH DHE MEDIA



Bashkëpunimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit me median, vlerësohet si një aspekt i rëndësishëm për promovimin e transparencës, llogaridhënies dhe informimin e publikut mbi përdorimin e fondeve publike dhe rezultatet e auditimeve. Media, si një aktor i pavarur merr një rol të rëndësishëm në promovimin e punës audituese. Media është një kanal kryesor për të siguruar që raportet e auditimeve dhe gjetjet e KLSH-së të arrijnë tek një audiencë më e gjerë, përfshirë qytetarët, autoritetet dhe aktorët e tjerë të shoqërisë civile. Përmes publikimit të këtyre raportimeve, media ndihmon në ngritjen e ndërgjegjësimit për shpenzimet dhe keqmenaxhimin e mundshëm të fondeve publike. Bashkëpunimi me median ndihmon në krijimin e një mjedisi më transparent, duke mundësuar që publiku të ketë akses në informacionet e rëndësishme mbi menaxhimin e financave publike. Kjo mund të çojë në shtimin e përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve shtetërore që menaxhojnë burimet financiare.

Pasi KLSH publikon raportet e auditimeve në faqen zyrtare, ku paraqiten mangësitë në menaxhimin e fondeve publike, media e shkruar dhe auditovizive ka një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e këtyre informacioneve te publiku i gjerë. KLSH vlerëson se bashkëpunimi me median gjithashtu kontribuon në edukimin e publikut mbi rëndësinë e kontrollit të financave publike dhe ndikimin që ka ky proces në jetën e përditshme të qytetarëve. Përmes lajmeve dhe raportimeve të ndryshme, media mund të krijojë një mundësi për qytetarët të informohen dhe të angazhohen në kërkesën për një qeverisje më të drejtë dhe më të përgjegjshme.

Veprimtaria e KLSH, gjatë vitit 2024, ka gjetur pasqyrim në media me një total prej 1830 artikujsh, nga të cilët: 382 artikuj në shtypin e shkruar; 1448 artikuj në median audio-vizive dhe online dhe 205 kronika/emisione televizive, që pasqyrojnë gjetjet e raporteve përfundimtare të auditimit dhe rekomandimet e lëna për subjektet e audituara.



5.2 KLSH DHE MEDIA

KLSH, në respekt të detyrimit të tij ligjor për informimin e publikut siguron natyrën publike të punës së tij nëpërmjet: publikimit të raporteve vjetore që KLSH paraqet në Kuvendin e Shqipërisë; publikimit të raporteve individuale të auditimit; buletinet statistikore; buletinet mujorë, planet vjetore dhe mujore të auditimeve, njoftimeve për shtyp dhe çdo informacion tjetër që përcaktohet nga Kryetari i KLSH-së.

Gjatë vitit 2024 janë publikuar në faqen zyrtare 106 raporte përfundimtare auditimi si dhe 2 buletine statistikore, në të cilat përmbledhet aktiviteti auditues në periudha 4-mujore.

Komunikimi efektiv i KLSH-së me publikun nuk kufizohet vetëm përmes faqes zyrtare të institucionit www.klsh.org.al, por në vazhdimësi është ndjekur një politikë e hapur ndërvepruese me të gjitha grupet e interesit dhe median në veçanti si “ura” lidhëse me qytetarët.

Në zbatim të ligjit “Për të Drejtën e Informimit” dhe parimeve të INTOSAI-P 20 për Transparencën dhe Llogaridhënie, KLSH komunikon në kohë dhe gjerësisht mbi aktivitetin e tij institucional dhe rezultatet e auditimit nëpërmjet medias dhe mjeteve të tjera të komunikimit në platformat “Facebook” dhe “Instagram”.

Aktualisht, në faqen e internetit të KLSH-së ekziston një dritare komunikimi, e cila është përdorur nga qytetarët, si një mënyrë komunikimi për të paraqitur ankesat, denoncimet apo pyetjet e tyre.



5.3 KLSH DHE PARTNERËT STRATEGJIKË

Më Pranë Publikut dhe Grupeve të Interesit

Për të garantuar një komunikim më efikas dhe transparent me publikun dhe grupet e tjera të interesit, KLSH ka nisur nga muaji nëntor 2024 publikimin e Buletinit informues Mujor.

Ky buletin synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të përmbledhur të veprimtarisë së institucionit, duke përfshirë: aktivitetet kryesore të zhvilluara gjatë muajit; rezultatet e auditimeve më të fundit; bashkëpunime dhe marrëveshje me partnerë vendas e ndërkombëtarë; trajnime të stafit me institucione të ndryshme homologe.

Buletini publikohet rregullisht në:



Faqen zyrtare website të KLSH-së



Rrjetet sociale të institucionit



Gjatë vitit 2024, KLSH ka intensifikuar bashkëpunimin me partnerët e tij të brendshëm dhe ndërkombëtarë, duke ndjekur praktikat më të mira në fushën e auditimit. Ky angazhim ka synuar fuqizimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të institucionit, përmes shkëmbimit të eksperiencave, për të përmirësuar vazhdimisht performancën e tij, si dhe të sigurojë një përshtatje optimale me zhvillimet dhe sfidat e mjedisit ku operon.

Marrëveshje të nënshkruara gjatë vitit 2024

Bashkëpunimi në nivel bilateral nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe vizitave zyrtare u konkretizua si vijon:

R. KLSH DHE SAI I NORVEGJISË

Marrëveshja e Bashkëpunimit e firmosur më datë 3 korrik 2024 me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Norvegjisë. Marrëveshja e rinovuar do të mbulojë një periudhë 5-vjeçare në fushat e IT dhe të auditimit të performancës, por edhe në fushën e komunikimit dhe të procedurave të auditimit në industrinë nxjerrëse.

Në kuadër të planeve të punës mbi aktivitetet e përbashkëta me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Norvegjisë janë zhvilluar një sërë aktivitetesh të parashikuara me homologët, ku përmendim përgjatë vitit 2024:

Në fushën IT:

- workshopi mbi “Cybersecurity” me objektiv, mundësimin për KLSH-në të kryerjes së një auditimi në këtë fushë.
- workshopi mbi “Cybersecurity” me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve nga ZKA e Kosovës dhe SAI i Maqedonisë së Veriut me objektiv, trajtimin e çështjeve të sigurisë kibernetike, kriteret, aplikimin e teknikave në auditim, si dhe hapat e zhvillimit të këtij lloji auditimi.



5.3 KLSH DHE PARTNERËT STRATEGJIKË

- workshop praktik IT me temat kryesore “Auditimi i avancuar ëindoës” dhe “AD si dhe Auditimi Financiar”.

Në fushën e Performancës:

- workshop me objektiv, hartimin e planeve të reja të auditimit, gjuha e qartë e të shkruarit të raporteve, përmirësimi i vizualizimit të të dhënave dhe rekomandime sa më të qarta.
- workshop për auditimin me temë “Cilësia e ujrave në plazhe”.
- workshop për auditimin me temë “Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor para-universitar”.



KLSH DHE SAI I TURQISË

Vizita zyrtare e Presidentit të Gjykatës Turke të Llogarive z. Metin Yener dhe delegacionit shoqërues në datat 3-4 tetor 2024 në KLSH, gjatë së cilës u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit dypalëshe. Kjo marrëveshje do të shërbejë në shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira në fushën e auditimit të jashtëm publik me fokus sigurinë, IT, dhe analizën e të dhënave. Gjithashtu, ndërmjet të dy institucioneve do të zhvillohen projekte kërkimore të përbashkëta, si dhe aktivitete të tjera.

Në vijim të këtij bashkëpunimi, u krye edhe një vizitë studimore në Gjykatën Turke të Llogarive, me qëllim shkëmbimin e njohurive në fushën e auditimit të koncesioneve dhe kontratave PPP, me pjesëmarrjen e 20 audituesve.



KLSH DHE SAI I KOSOVËS

Vizita e punës e Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu dhe delegacionit shoqërues në Prizren, më datë 25 tetor 2025, me ftesë të Auditorës së Përgjithshme të Kosovës, znj. Vlora Spanca, pati në fokus thellimin dhe forcimin e angazhimit të ndërsjellë për të rritur ndërveprimin institucional me përfitime në përmirësimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe rritjes së rezultateve të punës.

Në vijim të sa më sipër, në ambjentet e KLSH-së, u zhvillua një vizitë studimore e drejtuesve të Departamentit për Çështjet Juridike kundër Mashtrimit të ZKA, Kosovë me derjtues të Drejtorise Juridike, në KLSH.

Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira lidhur me procesin e përcjelljes së rasteve në Prokurori të procedimeve penale, parandalimi dhe identifikimi i rasteve abuzive dhe veprave penale etj.



KLSH DHE SAI I MAQEDONISË SË VERIUT

Vizita e punës e zhvilluar në KLSH më datë 13 qershor 2024, gjatë së cilës Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, priti Auditorin e Përgjithshëm të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut, z. Maksim Acevski.

Kjo vizitë u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit tashmë të konsoliduar dhe të suksesshëm ndërmjet dy institucioneve në vijim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit dypalëshe të nënshkruar në muajin nëntor 2022, gjatë së cilës u shkëmbyen eksperiencat dhe ide mbi auditimet e kryera nga palët në fushën e burimeve natyrore, aktivitetit minerar dhe ndikimin e tyre në mjedis etj, si dhe u paraqitën prezantimet respektive. I pranishëm gjatë kësaj vizite ishte dhe z. Alastair Sëarbrick, Këshilltar i Lartë pranë SIGMA-s.



5.3 KLSH DHE PARTNERËT STRATEGJIKË

KLSH DHE GAO

KLSH mori pjesë në International Auditor Felloeship Program, i organizuar nga Government Accountability Office (GAO) në Washington DC, gjatë periudhës 17 prill 2024 deri më 12 korrik 2024, më 1 auditues. Angazhimi në këtë aktivitet që ka për qëllim rritjen e kapaciteteve të institucioneve supreme të auditimit në të gjithë botën, realizuar nëpërmjet një programi intensiv trajnimi, ku përfshihen fusha si: lidhshipi dhe menaxhimi i ndryshimit, e deri në shembuj konkretë të procesit të angazhimit auditues në GAO.

KLSH DHE NAO

Në datat 23-24 prill 2024 është zhvilluar vizitë studimore në Londër, e organizuar nga Westminster Foundation for Democracy, në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Anglisë.

Është vendosur bashkëpunimi nën programin “Rritja e llogaridhënies së qeverisë përmes një parlamenti më reagues, i zbatuar nga Fondacioni Westminster për Democraci (WFD), nëpërmjet të cilit synohet këshillimi teknik dhe trajnimi i punonjesve dhe audituesve, për shkrimin e raporteve të auditimit, shkrimin e buletineve dhe neësletter për Parlamentin, hartimin e Strategjisë së Komunikimit etj.

KLSH DHE SAI I POLONISË

Është rivendosur komunikimi aktiv me NIK Polak në kuadër të rivitalizimit të marrëveshjes ekzistuese me këtë institucion homolog, si dhe draftuar një plan veprimi dy palësh me qëllim shkëmbimin e eksperiencave në disa fusha auditimi.



KLSH DHE GJYKATA EVROPIANE E AUDITUESVE (ECA)

Një nga bashkëpunëtorët më afatgjatë të Kontrollit të Lartë të Shtetit është pa dyshim Gjykata Evropiane e Audituesve. Si një anëtar aktiv i INTOSAI-t dhe EUROSAT-t, në përmbushje të plotë të të gjitha parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të bashkëpunimit ndërinstitucional, KLSH vijon ndër të tjera, prej vitit 2014, të forcojë bashkëpunimin e suksesshëm me një nga 5 institucionet më të rëndësishme të Bashkimit Evropian. Kjo praktikë e konsoliduar vijon të krijojë kështu një gjeneratë audituesish të rinj, të cilët përcjellin më tej në KLSH të gjithë eksperiencën dhe formimin e tyre profesional nëpërmjet standardeve dhe praktikave më të mira evropiane. ECA është një nga partnerët kryesorë dhe nga nxitësit më të fuqishëm të zhvillimit profesional të SAI-ve evropiane, veçanërisht të SAI-ve të vendeve kandidatë dhe kandidatë të mundshme për në BE, ku bën pjesë edhe KLSH. Janë 22 auditues të integruar, nëpërmjet internshipeve në ECA për dekadën 2014-2024.

BASHKËPUNIMI NË AUDITIME PARALELE

Me qëllim shkëmbimin e eksperiencave më të mira dhe praktikave audituese, KLSH përgjatë vitit 2024 ka vijuar angazhimin në auditimet e përbashkëta:

Auditimi paralel i performancës me titull “Barazia gjinore dhe fuqizimi i gruas nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës” në partneritet me ZKA të Kosovës dhe SAI-n e Maqedonisë së Veriut, si dhe në bashkëpunim me organizatën UN Women;

Auditim i Përbashkët Global mbi “Veprimet e Adaptimit ndaj Ndryshimeve Klimatike” të ideuar nga IDI dhe INTOSAI WGEA. Në këtë fushë u realizua një auditim i performancës me temë “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike”;



5.3 KLSH DHE PARTNERËT STRATEGJIKË

Auditim Paralel i Performancës me temë “Moshimi i Popullsisë” i cili drejtohet nga SAI i Izraelit. Departamenti i Auditimit të Performancës të KLSH-së do të kryejë auditimin “Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim”. Në këtë temë auditimi do të angazhohen në total 6 SAI-e (Shqipëria, Portugalia, Paraguai, Maqedonia e Veriut, Sllovakia dhe Izraeli).

Për t’u angazhuar në këtë auditim paralel kishin shfaqur interes 15 SAI përfshirë edhe KLSH, konkretisht, Austria, Bullgaria, Republika Çeke, Franca, Hungaria, Izraeli, Lituania, Malta, Meksika, Maqedonia e Veriut, Paraguai, Polonia, Portugalia dhe Sllovakia.



KLSH DHE INTOSAI

Në kuadër të anëtarësisë së KLSH-së në Task Forcën e INTOSAI-t për “Pjesëmarrjen qytetare dhe angazhimin e shoqërisë civile” të kryesuar nga SAI i Perusë, vijon angazhimi në këtë Task Force.

KLSH u bë pjesë gjatë vitit 2024 e iniciativës së Komitetit të Standardeve Profesionale të INTOSAI-t (INTOSAI PSC) në kuadër të zbatimit të Planit Strategjik të Zhvillimit për Deklaratat Profesionale të INTOSAI-t 2025-2028 për dy Iniciativa, respektivisht Iniciativa A “Përmirësimi i aksesit në deklarata” dhe Iniciativa G “Zhvillimi i një qasjeje më të mirë për dhënien e udhëzimeve”. Këto iniciativa ndiqen nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional, si dhe nga Drejtoria IT.

Gjithashtu në kuadër të bashkëpunimit me INTOSAI-n, stafi i KLSH-së është angazhuar në një sërë aktiviteteve si:

- Simpoziumi i 26 UN/INTOSAI me temë “Zbatimi i SDG-ve mbi klimën: roli, kontributi dhe eksperiencia e SAI-ve”.

- Trajnimi ndërkombëtar online “Mbi Industrinë Nxjerrëse”.
- Webinari “Përdorimi i analizës gjeohapsinore në auditim”.
- Workshop mbi platformën “Skeneri i Klimës”.
- Workshop me temë "Auditimi për institucione publike efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në zbatimin e SDG-ve”.



BASHKËPUNIME ME INICIATIVËN PËR ZHVILLIM TË INTOSAI-T (IDI)

Një ndër partnerët kryesorë të KLSH-së vijon të mbetet IDI. Gjatë vitit 2024, IDI ka vijuar të asistojë ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe njerëzore të audituesve në KLSH.

Nga datat 19-23 shkurt 2024 u zhvillua në mjediset e KLSH, takimi i me prezencë fizike i programit pilot “Pilotimi i SAI-ve për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, në kuadër të rishikimit të ISSAI 140”, i cili përfshiu 12 SAI respektivisht me përfaqësues të EUROSAI, CAROSAI, ASOSAI dhe AFROSAI.

Si pjesë e EUROSAI-t, KLSH mori pjesë në këtë projekt me një ekip shumë disiplinor me ekspertizë në standardet e auditimit, metodologjinë e auditimit, sigurimin e cilësisë, planifikimin strategjik dhe zhvillimin e politikave. I udhëhequr nga IDI, ky ekip siguroi që Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë (SoAQM) të përputhet edhe me objektivat strategjike të KLSH-së.

Në përfundim të programit, KLSH hartoi dokumentin e “Analizës së Nevojave dhe Politikën e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në KLSH”, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 128, datë 01.07.2024; si dhe Udhëzuesin e Menaxhimit të Riskut, miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 219, datë 18.11.2024, të cilat përbëjnë Kornizën ligjore dhe rregullatore për implementimin e suksesshëm të sistemit efektiv të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me gjithë çfarë diktojnë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.



5.3 KLSH DHE PARTNERËT STRATEGJIKË

Ka vijuar gjithashtu angazhimi nëpërmjet “resource person” në programin e IDI-t për SPMR III në pjesëmarrje në vizita studimore, të organizuara në këtë kuadër.

Trajnimi ndërkombëtar, në bashkëpunim ndërmjet IDI-t, SECO dhe SDC, me temë “Mbi bashkëpunimin ndërmjet SAI-ve dhe autoriteteve të Auditimit të Brendshëm”.

KLSH mori pjesë në eventin vjetor online LOTA Talks 2024 me temë “Zgjidhjet për Monitorimin e Vazhdueshëm”. Tematika i orientoi diskutimet drejt prezantimit të qasjeve praktike për të adresuar dobësitë në qeverisjen lokale, zbulimit sesi automatizimi revolucionarizon auditimin financiar dhe mundëson monitorimin në kohë reale, të mësuarit mbi implementimin e platformave analitike për transparencë të shtuar dhe eficiencë në auditim.

KLSH ka vijuar të jetë pjesë e programit “Kursi Profesional për Audituesit e SAI-t – Pilot” ose PESA-P i organizuar nga IDI, me tre auditues.

Në vitin 2024, KLSH është bërë pjesë gjithashtu e programit të IDI-t mbi “Sigurinë e Informacionit” një program, i cili ka për qëllim ngritjen e kuadrit të sigurisë në institucione dhe KLSH u përzgjedh ndërmjet 5 SAI-ve nga rajoni EUROSAT. Janë zhvilluar në këtë kuadër workshop-e “Mbi sigurinë informatike” dhe “Mbi ndryshimin dixhital”.

Në vitin 2024 KLSH u bë pjesë gjithashtu e Auditimit të Përbashkët Global mbi “Veprimet e Adaptimit ndaj Ndryshimeve Klimatike” të ideuar nga IDI dhe INTOSAI ëGEA. Në këtë fushë u realizua një auditim performancë me temë “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike” (i cili lidhet me Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm nr. 13).

EUROSAT | KLSH DHE EUROSAT

KLSH mori pjesë në punimet e Kongresit të XII të Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAT), i cili u organizua dhe u drejtua në platformën online nga SAI i Izraelit, në datat 27-28 maj 2024 me temë kryesore “Ndarja e ideve – SAI më të fuqishëm”;

Konferenca VI Young EUROSAT (YES) e zhvilluar në datat 24-28 shtator 2024 në Varshavë me temë “Po Inteligjencës Artificiale” dhe trajtoi përdorimin e mjeteve IT në auditime



Grupi i Punës së EUROSAT-t për Auditimet e Mjedisit – WGEA

Disa nga aktivitetet e Grupit të Punës së EUROSAT-t për Auditimet e Mjedisit – ëGEA, janë:

- Sesioni i pranverës në formatin online, me temë “Çështjet e sigurisë së Energjisë”, i cili u ndoq nga 4 auditues
- Takimi vjetor me temë “Ngjarjet ekstreme të motit dhe strategjitë e gatishmërisë” ku morën pjesë 2 auditues.
- Kursi formativ i organizuar online në bashkëpunim me Universitetin e Tartusë në Estoni mbi “Auditimin e Çështjeve të Ujit”, ndjekur nga 3 auditues.
- Takimi i grupit të punës mbi “Ndryshimet klimatike”, në bashkëpunim me ECA-n dhe SAI-n e Anglisë, ndjekur nga 2 auditues.
- Seminari mbi çështjet e ujit i organizuar online në ditën botërore të ujit, ndjekur nga 3 auditues.
- workshopi mbi “Krimet Mjedisore” i organizuar online, në bashkëpunim me Agjencinë Evropiane të Hapësirës, ndjekur nga 2 auditues.



5.3 KLSH DHE PARTNERËT STRATEGJIKË



Grupi i Punës së EUROSAI-t për Teknologjinë e Informacionit – ITWG:

Në kuadër të këtij grupi pune, u krye seminari me temë “Audituesi inteligjent në një shtet inteligjent artificial (të auditosh AI)”, i cili u ndoq online nga 2 auditues; seminari me temë “Shpenzimet e qeverisë për ICT”, ndjekur nga 4 auditues; si dhe takimi online mbi aktivitetet e zhvilluara, ku u prezantuan tematikat dhe aktivitetet e mundshme për të ardhmen.



Grupi i Punës së EUROSAI-t për Auditimin e Bashkive – WGMA:

Takimi i VIII vjetor i Grupit të Punës së EUROSAI-t për Auditimin e Bashkive si dhe seminari me titull “Projektet infrastrukturore të qeverisjes vendore”, pati në fokus eksperiencat e SAI-ve në auditimin e projekteve infrastrukturore si dhe bashkëpunimet me institucionet e vetëqeverisjes vendore. Ky aktivitet u ndoq nga 2 drejtues.

Një tjetër aktivitet i ndjekur online, ishte dhe masterklas mbi aspektet metodologjike të auditimit me temë “Të ardhurat e bashkive për shërbime cilësore ndaj qytetarëve”.



Grupi i Punës së EUROSAI-t për Auditimin e Fondeve të Alokua në raste Fatkeqësish dhe Katastrofash - WGAFADC:

Takimi i X vjetor i këtij Grupi Pune, i cili përkon me përvjetorin e krijimit të tij, u zhvillua në Varshavë në datat 22-23 prill 2024.

Prej vitit 2023 që është dhe viti i krijimit, KLSH është anëtare e Projekt Grupit të EUROSAI-t “Përdorimi i metodologjive të auditimeve në kohë reale” i ngritur nën Qëllimin Strategjik 1 “Bashkëpunimi Profesional”. Takimi II i këtij projekt grupi u zhvillua në Budapest në datat 4-5 qershor 2024.



KLSH dhe SIGMA

KLSH ka vijuar komunikimet dhe takimet me ekspertët e SIGMA-s përgjatë vitit 2024. Një kontribut i vlefshëm është dhënë nga ekspertët e SIGMA-s në hartimin e kuadrit ligjor dhe planit të punës për ngritjen e nën-komisionit parlamentar “Për Auditimin e Sektorit Publik”.

KLSH ka marrë pjesë edhe në disa prej aktiviteteve të organizuara nga SIGMA me prezencë fizike dhe online si: webinarin “Etika dhe profesionalizmi”; workshopin “Raportimi i praktikave me qëllim rritjen e impaktit”, si dhe Konferencën “Mbi auditimin e llogarive përfundimtare të buxhetit të shtetit” e organizuar nga SAI i Malit të Zi në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta të SAI-ve të Rrjetit të vendeve candidate dhe candidate të mundshme për në BE.



KLSH dhe SECO

Projekti “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat (PPP) në Shqipëri” u zyrtarizua me firmosjen e Marrëveshjes nr. 307, datë 09.03.2020 mes Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit. KLSH realizoi me sukses produktet dhe aktivitetet e parashikuara në Marrëveshje, si më poshtë:

- 3 auditime pilot në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve, të mbështetura në të gjitha fazat e auditimit nga eksperti i jashtëm i kontraktuar si pjesë e projektit, si vijon: (i) “Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”; (ii) “Dhënia me koncesion e shërbimit të kontrollit ligjor të



5.3 KLSH DHE PARTNERËT STRATEGJIKË

instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë” dhe (iii) Marrëveshjet hidrokarbure;

- hartimi i “Manualit për auditimin e koncesioneve dhe PPP-ve”, i cili reflekton eksperiencën e fituar përgjatë kryerjes së 3 auditimeve pilot, shoqëruar me trajnimet e nevojshme;
- organizimi i aktivitetit përmbyllës ku morën pjesë auditues, përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë të jashtëm, si dhe përfaqësues të Ambasadës Zvicerane në Shqipëri dhe të Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës, për Çështjet Ekonomike (SECO).



KLSH dhe NDI

Ekspertët e NDI-së ofruan përgjatë gjithë vitit 2024, asistencën e tyre në kuadër të krijimit të Nën-komisionit parlamentar “Për Auditimin e Sektorit Publik” me qëllim përmirësimin e transparencës, përgjegjësisë dhe efikasitetit në menaxhimin financiar, si dhe forcimit dhe zhvillimit të rolit të Parlamentit në politikat dhe masat anti-korrupsion, ku KLSH është një nga institucionet me rol thelbësor.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, janë zhvilluar një sërë aktivitetesh si, takime pune në KLSH dhe aktivitete të përbashkëta me Kuvendin e Shqipërisë si ai i zhvilluar në Prishtinë, ku u mundësuan ndër të tjera, takime në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm për eksperiencë të ngjashme.

PJESËMARRJA NË KONFERENCA TRAJNIME, SEMINARE DHE TAKIME

Gjatë vitit 2024, KLSH mori pjesë në një sërë aktivitetesh, duke përfshirë takime, konferenca, seminare dhe trajnime, si me prezencë fizike ashtu edhe online. Këto angazhime shërbyen për shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira, duke forcuar bashkëpunimin institucional dhe rritjen e kapaciteteve profesionale. Në vijim, paraqitet një pasqyrë e aktiviteteve ku stafi i KLSH-së ka marrë pjesë gjatë vitit 2024: Simpoziumi i 8 ndërkombëtar “Trajektorja e re në luftën kundër korrupsionit” në Hong Kong; kursi formativ “Bashkëpunimi mes audituesve dhe kontabilistëve në luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit”, i zhvilluar nga CEF (Qendra për Ekselencë në Financë); konferenca “Shpenzimet Publike” e zhvilluar në Vjenë e organizuar nga Banka Botërore; takimi i Bordit të Audituesve të NATO-s etj.



5.3 KLSH DHE PARTNERËT STRATEGJIKË



Raportimi i Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu në Komisionin për Ekonominë dhe Financat mbi Raportin e Zbatimit të Buxhetit, për vitin 2023



Kryetari i KLSH -së, z. Arben Shehu merr pjesë në takimin e Kryetares së Kuvendit me drejtuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj



Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu, zhvillon vizitë pune në Prizren me ftesë të Auditorës së Përgjithshme të Kosovës, znj. Vlora Spanca



Takimin me Ambasadorin e Delegacionit të BE-së, z. Silvio Gonzato



Takimin me Ambasadorin e Prezencës së OSBE-së në Tiranë, z. Michel Tarran



Takimin me Presidentin e Gjykatës Turke të Llogarive, z. Metin Yener



5.3 KLSH DHE PARTNERËT STRATEGJIKË

KLSH DHE BASHKËPUNIMI ME SHOQËRINË CIVILE

Bashkëpunimi i KLSH-së me organizatat e shoqërisë civile është një aspekt i rëndësishëm i angazhimeve të tij për forcimin e mekanizmave të kontrollit, transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimin e qeverisjes, duke kontribuar në një mjedis më të sigurt dhe të drejtë për përdoruesit e fondeve publike.

Ky bashkëpunim ka vijuar edhe gjatë vitit 2024, duke marrë pjesë dhe kontribuar në disa tryeza diskutimi, takime etj., si vijon:

- KLSH në bashkëpunim me organizatën Qëndresa Qytetare organizon workshop-in “Mbi prezantimin e gjetjeve të auditimeve të performancës dhe monitorimin e qeverisë nga Qëndresa Qytetare”.
- KLSH merr pjesë në aktivitetin “Mbikëqyrja e Financave Publike - Roli i Parlamentit, Institucioneve dhe Shoqërisë Civile”, organizuar nga Instituti Shqiptar i Shkencës (AIS) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM).
- KLSH merr pjesë në ditën e diskutimit publik në Shkodër, me temë: “Pjesëmarrja qytetare dhe bashkëpunimi me institucionet në luftën kundër korrupsionit”, organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.
- KLSH merr pjesë në tryezën e diskutimit “Rritja e përgjegjshmërisë së Parlamentit ndaj shqetësimeve të qytetarëve” organizuar nga Instituti Shqiptar i Shkencës (AIS).
- KLSH merr pjesë në tryezën e diskutimit mbi transparencën dhe llogaridhënien në sektorin e shëndetësisë, organizuar nga shoqata “Together for life”.
- Kryetari i KLSH-së, z. Arben Shehu merr pjesë në takimin “IDM Morning Briefing”, organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.
- KLSH merr pjesë në prezantimin e gjetjeve të sondazhit të opinionit publik “Besimi në Qeverisje 2023”, organizuar nga IDM.
- KLSH merr pjesë në tryezën “Ndërlidhja mes opinionit publik dhe politikave: Gjetje dhe perceptime nga Barometri Shqiptar i Sigurisë 2024” organizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG).
- KLSH prezanton në bashkëpunim me Un Women Albania, gjetjet e auditimit të performancës “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”.
- KLSH merr pjesë në tryezën “Vlerësimi i Sistemit të Vlerësimit të Performancës së Prokurorëve në Shqipëri: Problematika dhe Rekomandime”, zhvilluar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG).
- KLSH merr pjesë në një tryezë të nivelit të lartë lidhur me problematikat dhe praktikat e deritanishme mbi raportimin vjetor të institucioneve kushtetuese dhe atyre të pavarura në Kuvend organizuar nga Instituti i Studimeve Politike (ISP).
- KLSH merr pjesë në takimin e organizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes me temë: “Vlerësimi i performancës dhe progresit: Një rishikim gjithëpërfshirës i rolit të SPAK dhe Gjykatave Speciale në luftën kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar (2020-2023)”.
- KLSH merr pjesë në workshop-in mbi promovimin e “Parlamentit të Hapur”, organizuar nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike.
- KLSH merr pjesë në takimin e organizuar nga Qëndresa Qytetare mbi Transparencën dhe Demokracinë e brendshme në universitetet publike.
- KLSH merr pjesë në workshop-in e organizuar nga ACER dhe eFD për vlerësimin parandalues të korrupsionit në Projektligjin për Investimet e Huaja direkte në Shqipëri.



5.3 KLSH DHE PARTNERËT STRATEGJIKË

BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETET

KLSH ka vijuar bashkëpunimin me universitetet publike duke qenë prezent edhe në auditoret e tyre në prezantime dhe diskutime rreth rolit dhe punës së auditimit të jashtëm publik, duke u mundësuar institucioneve akademike dhe atyre shtetërore që të punojnë së bashku për të rritur efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien e menaxhimit të burimeve publike. Ky bashkëpunim ndihmon në forcimin e strukturave të kontrollit dhe auditimit brenda institucioneve publike dhe në krijimin e një marrëdhënie të sinergjisë midis teorisë dhe praktikës për profesionistët e ardhshëm. Në këtë kuadër, me rastin e 99-vjetorit të themelimit si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Republikën e Shqipërisë, si dhe mbështetur në standardin ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI 12, “Vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit - të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve”,



KLSH, nga data 20 deri më 24 maj 2024 organizoi në mjediset e institucionit aktivitetin “Java e hapur”. Në kuadër të këtij aktiviteti, studentë nga Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit të Tiranës dhe Universiteti “Fan Noli”, Korçë, morën pjesë në takime informuese mbi historikun dhe aktivitetin auditues.



Bashkëpunimi me universitetet për njohjen dhe promovimin e rolit dhe punës së KLSH-së te profesionistët e rinj është një nga objektivat e Strategjisë së Komunikimit, të KLSH-së.

Në këtë kuadër, KLSH gjatë muajit tetor 2024 ka zhvilluar takime në disa universitete publike për

zhvillimin e workshop-eve të hapura, mbi planin e auditimeve të vitit 2025. Konkretisht:

Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qëndrore dhe Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja në Universitetin “Fan S. Noli”,



Departamenti i Auditimit të Performancës në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër,



Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit dhe Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër.

Pjesë e këtyre takimeve kanë qenë drejtues të universiteteve, pedagogë, studentë, të cilët kanë vlerësuar bashkëpunimin me KLSH-në në këtë drejtim, për të kontribuar në ngritjen e transparencës dhe përmirësimin e standardeve akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë publik.



5.4 VLERËSIME NGA INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE

RAPORT PROGRESI SHQIPËRIA 2024

Kapitulli 32: Kontrolli financiar- Auditimi i jashtëm



“Kuari ligjor i Shqipërisë garanton pavarësinë e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Gjatë periudhës raportuese është miratuar një plan i ri strategjik për 2023-2027. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vazhduar të përmirësojë kapacitetin e tij institucional. Numri i stafit u rrit në 216. KLSH kryen veprimtari zhvillimi profesional vjetor për stafin auditues.

Cilësia e punës audituese është përmirësuar dhe përputhet me standardet ndërkombëtare të Organizatës së Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Objektivat e Kontrollit të Lartë të Shtetit janë zhvendosur drejt auditimeve të performancës dhe atyre financiare.

Ndikimi i punës audituese ka treguar progres. Në vitin 2023 janë dorëzuar 160 raporte auditimi në Parlament.

Kontrolli i Lartë i Shtetit raporton rregullisht mbi zbatimin e rekomandimeve të tij. Shqipëria duhet të përmirësojë zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm. Megjithëse 98% e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022 u pranuan, vetëm 47% ishin plotësisht ose zbatuar pjesërisht deri në fund të vitit 2023.

Kontrolli i Lartë i Shtetit raportoi në Prokurori katër kallëzime penale në vitin 2022 për 16 zyrtarë. KLSH vijon bashkëpunimin dhe ofron informacion për prokurorinë në lidhje me gjetjet që mund të kenë aspekt penal. KLSH ka raportuar 67 materiale në Prokurorinë Speciale në vitin 2023.

Në korrik 2024, Parlamenti ra dakord për ngritjen e një nën-komisioni, Nën Komisionin Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, i dedikuar ndaj ndjekjes së raporteve të KLSH-së dhe monitorimit dhe dialogut ndërmjet Kuvendit dhe KLSH-së. Gjetjet e KLSH-së u diskutuan edhe në komisionet e posaçme hetimore të ngritura nga Parlamenti.

Rritja e përdorimit të auditimeve të KLSH-së në procesin e mbikëqyrjes parlamentare të buxhetit duhet të sigurohet nëpërmjet funksionalizimit të Nën Komisionit Parlamentar të sapo krijuar”.




5.5 PROGRAMI I TRANSPARENCËS DHE E DREJTA PËR INFORMIM

KLSH, për të përmbushur detyrimet ligjore për transparencë dhe informim të publikut, siguron akses të plotë në aktivitetet e tij përmes publikimit të raporteve përfundimtare të auditimit, njoftimeve për shtyp dhe çdo informacioni tjetër të nevojshëm. Ky informacion është i aksesueshëm për të gjithë, përveç atij informacioni që përfshin të dhëna të klasifikuara si sekrete shtetërore, tregtare apo konfidenciale. Në këtë mënyrë, KLSH siguron që puna e tij të jetë e qartë dhe e kuptueshme për të gjithë qytetarët, përfshirë palët e interesuara dhe institucionet e tjera publike.

E drejta për informim është e garantuar nga Kushtetuta dhe është parashikuar në ligjin "Për të drejtën e informimit", si e drejtë themelore për qytetarët, shoqërinë civile, median dhe aktorët e tjerë të një shoqërie demokratike. Ky ligj siguron që çdo individ të ketë mundësinë të kërkojë informacion nga institucionet publike dhe të marrë përgjigje brenda afateve të përcaktuara. KLSH ka trajtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash për informacion nga vit në vit, duke siguruar një nivel të lartë transparence. Në kuadër të zbatimit të këtij ligji, Koordinatori për të drejtën e informimit ka trajtuar:

Gjatë vitit 2024, KLSH ka trajtuar me korrektësi dhe profesionalizëm letrat dhe ankesat e qytetarëve. Të gjitha ankesat janë shqyrtuar në mënyrë të detajuar dhe janë marrë masa për t'u përgjigjur sipas procedurave të përcaktuara, brenda afateve ligjore. KLSH ka trajtuar gjithsej 290 letra/ankesa nga individë dhe subjekte të ndryshme. Ky numër i konsiderueshëm tregon rritjen e interesit të publikut për aktivitetet e institucionit dhe për shqyrtimin e çështjeve të ndjeshme. Shumica e ankesave kanë qenë të lidhura me çështje të Vetëqeverisjes Vendore, me rreth 86 ankesa të administruara. Çdo kërkesë dhe ankesë është trajtuar dhe përgjigjur, duke siguruar që qytetarët të kenë mundësinë të marrin informacion të saktë dhe në kohë. Një pjesë e kërkesave janë ende në proces verifikimi dhe do të shqyrtohen gjatë auditimeve që do të zhvillohen në periudhat e ardhshme. Pas përfundimit të auditimeve, qytetarët ankimes informohen menjëherë mbi rezultatet dhe masat që janë ndërmarrë. Ky proces siguron një transparencë të plotë duke përmbushur kështu funksionin e ligjit "Për të drejtën e informimit".







06

Treguesit buxhetor dhe
financiarë të KLSH-së dhe
opinionit të auditit të
brendshëm

6 TREGUESIT BUXHETORË DHE FINANCIARË TË KLSH-SË

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese e KLSH-së”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2024-2026 dhe është në funksion të kësaj Deklarate. Politika buxhetore e KLSH-së është fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave, si dhe prioriteteve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2023-2027, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe reformave në kuadër të anëtarësimit në BE.

Për vitin 2024, performanca e realizimit të buxhetit, për Kontrollin e Lartë të Shtetit është mbështetur në Ligjin nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9, datë 20.07.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”

Buxheti i akorduar me Ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, për vitin 2024, për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në vlerën për 684,000 mijë lekë ndahet sipas zërave të poshtëm:

-Shpenzime për Paga dhe Sigurime në vlerën për 598,100 mijë lekë

-Shpenzime për mallra dhe Shërbime në vlerën për 70,900 mijë lekë

-Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm në vlerën për 15,000 mijë lekë

Ky buxhet është shtuar në zërin 606 “Ndihmë Financiare” në vlerën për 1,500 mijë lekë si dhe KLSH, ka trashëguar nga viti 2023 Grandin Kapital me Financim të Huaj, në vlerën për 3,181 mijë lekë (kapitulli 06). Bazuar në nevojat për mjete financiare plani vjetor i buxhetit është rishpërndarë brënda zërave të shpenzimeve korente dhe kapitale.

Tabela në vijim paraqet planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2024.

Në mijë lekë

Kap	Art	Kod Projekti	Kod Projekti	Fakti 2023	Ligji i Buxhetit Viti 2024	AN. Nr.5 19.12.2024	Fakti 2024	Diferenca	%
1	600	92401AA	Paga	402,587	531,300	466,300	456,121	10,179	97.80%
1	601	92401AA	Sigurime	62,524	66,800	71,800	69,813	1,987	97.20%
	600+601	Paga dhe Sigurime		465,111	598,100	538,100	525,934	12,166	97.70%
1	602	92401AA	Mallra dhe shërbime	71,424	70,500	75,500	71,082	4,418	94.10%
1	605	92401AA	Transferta me jashtë	116	400	400	292	108	73.00%
1	606	92401AA	Ndihma	643	1,500	1,500	1,151	349	76.70%
	602-606	Mallra dhe Shërbime		72,183	72,400	77,400	72,525	4,875	93.70%
1	231	M240009	Pajisje informatike	2,229	4,200	4,200	0	4,200	0.00%
1	231	M240002	Mjete transporti	0	5,200	5,200	4,920	280	94.60%
1	231	M240003	Rikonstruksion ndërtesa	634	1,600	0	0	0	0.00%
1	231	M240010	pajisje Zyre	3,191	2,000	1,530	1,522	8	99.50%
3	230	19AA402	Kosto Lokale	0	1,000	2,250	2,190	60	97.40%
4	230	M24008	TVSH	1,817	1,000	1,820	1,817	3	99.80%
	231	Investime me Fin. te Brendshëm		7,870	15,000	15,000	10,450	4,550	69,7%
6	231/6	Grand i Huaj				3,181	2,908	273	91.40%
2	230	Financim I Huaj (Projekti SECO)					4,129	0	100%
		Totali I Përgjithshëm		545,164	685,500	630,500	615,946	21,865	97.60%

Shpenzimet buxhetore të planifikuara për vitin 2024 në vlerën totale për 637,811 mijë lekë (përfshirë Financimi i Huaj në vlerën për 7,311 mijë lekë nga i cili: Grand i huaj i trashëguar nga viti 2023 në vlerën për 3,181 mijë lekë dhe grandin i huaj nga SECO në vitin 2024 në vlerën për 4,129 mijë lekë), janë realizuar në vlerën për 615,946 mijë lekë ose në masën për 98 %.

Realizimi sipas zërave kryesorë të shpenzimeve paraqitet si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 98%
- Shpenzimet e tjera operative 94%
- Shpenzimet kapitale të Brendshme 70%
- Financimi i Huaj 100%.



6 TREGUESIT BUXHETORË DHE FINANCIARË TË KLSH-SË

Analiza e realizimit të buxhetit të KLSH-së, për vitin 2024, paraqitet si në vijim:

Shpenzime Personeli. Llogaria 600-601.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2024 në zbatim të Ligjit nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar me akte normative, për zërin “Paga dhe Sigurime ” është në vlerën për 538,100 mijë lekë dhe numri i miratuar i punonjësve të KLSH-së për vitin 2024 është 243 punonjës. Për vitin 2024, buxheti i planifikuar në vlerën për 538,100 mijë lekë është realizuar në vlerën për 525,934 mijë lekë ose realizuar në masën 98%.

Shuma e shpenzuar në zërin “Shpenzime Personeli”, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar konform kontratave të nënshkruara me ta.

Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2024, në zbatim të Ligjit nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar me akte normative, për zërin shpenzime operative, është në vlerën për 75,500 mijë lekë, ose 12% e planit buxhetor të vitit 2024. Ky zë, është realizuar në vlerën për 71,082 mijë lekë ose është realizuar në masën 94%.

Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar nevojat administrative të shpenzimeve si shpenzime për shërbimin e sigurisë, energjia elektrike, ujë, telefon, kancelari, bateri për ups etj. Një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet operative e zënë shpenzimet për udhëtim, dieta dhe hotel brenda vendit në vlerën për 40,380 mijë lekë dhe përfaqësojnë 57% të shpenzimeve faktike të këtij zëri. Aktualisht, për vitin 2024, KLSH, ka realizuar disa procedura prokurimi në lidhje me: -Rinovim suporti të licenca të Fireëall dhe E-Mail Security. Prokurimi i rinovimit të licencave të sipërpërmendura i ka shërbyer KLSH-së për funksionimin optimal të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, rritjen e sigurisë

së rrjetit si dhe lehtësimin e punës së përdoruesve të infrastrukturës teknologjike të KLSH-së.

-Shërbim interneti për institucionin, mirëmbajtje ashensori, mirëmbajtje sistem alarmi, mirëmbajtje kondicionerësh, shërbim dhe pjesë këmbimi automjete etj.

Transferta korrente dhe të huaja. Llogaria 605.

Për periudhën raportuese 2024, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, si dhe kuotat e pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare në shumën 292 mijë lekë nga 400 mijë lekë të planifikuara.

Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606.

Gjatë periudhës ushtrimore 2024, është dhënë Fondi i Veçantë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vlerën 1,500 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie, sëmundjeje si dhe dhënien e ndihmës financiare punonjësve mbështetës organikë në mbyllje të vitit ushtrimor. Ky fond, është realizuar në vlerën për 1,151 mijë lekë, ose është realizuar në masën për 77% të buxhetit vjetor të planifikuar.

Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 230-231.

Bazuar në Ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, fondi i miratuar për Shpenzime Kapitale është vetëm për investime Financim të Brendshëm në vlerën për 15,000 mijë lekë. Këtij fondi i është shtuar edhe vlera për 3,181 mijë lekë trashëguar nga viti 2023 nga granditë e huaja në kapitullin 06. Detajimi dhe rishpërndarja e fondeve buxhetore të miratuara në këtë zë, është kryer duke mbajtur në vëmendje nevojat për shpenzime kompjuterike, rikonstruksion ndertesa, kostot lokale dhe t.v.sh. për projektin me financim të huaj si dhe nevojat për paisje zyre.



6 TREGUESIT BUXHETORË DHE FINANCIARË TË KLSH-SË

Financim i Brendshëm

Tabela në vijim paraqet planifikimin e investimeve kapitale me Financim të Brendshëm.

Në mijë lekë

Art	Kod Projekti	Kod Projekti	Ligji I Buxhetit	AN. Nr.5 19.12.2024	Fakti 2024	Diferenca	%
231	M240009	Pajisje informatike	4,200	4,200		4,200	0.0%
231	M240002	Mjete transporti	5,200	5,200	4,920	280	94.6%
231	M240003	Rikonstruksion ndertesa	1,600	0		0	0.0%
231	M240010	Pajisje Zyre	2,000	1,530	1,522	8	100%
230	19AA402	Kosto Lokale	1,000	2,250	2,190	59,587	97.4%
230	M24008	TVSH	1,000	1,820	1,817	3,300	99.8%
231	Investime me Financim te Brendshem		15,000	15,000	10,450	4,550	69.7%

- Në buxhetin e vitit 2024, fondet e miratuara në zërin 231 “Pajisje Zyre” me kod projekti M240010, janë në vlerën për 1,530 mijë lekë. Bëjmë me dije se, KLSH, ka realizuar kontratën në vlerën për 4,431 mijë lekë nga të cilat vlera për 1,523 mijë lekë janë nga kapitulli 01, buxheti i shtetit dhe vlera për 2,908 mijë lekë nga kapitulli 06, grandit i huaj i trashëguar nga viti 2023. Ky projekt investimi konsiston në rimodelimin e sallës së mbledhjeve të KLSH-së si dhe në blerjen e pajisjeve të reja. Adresimi i fondeve të investimeve në këtë projekt investimi ka ardhur si domosdoshmëri, pasi salla ekzistuese e mbledhjeve nuk i përmbushte kërkesat e një standardi të punës dhe prezantimin dinjitoz si institucion suprem auditimi, që të jetë në nivelin e kërkesave të kohës, kjo pasi pjesa më e madhe e pajisjeve ekzistuese ishin të amortizuara.
- Plani i buxhetit në zërin “Blerje automjeti”, në vlerën për 5,200 mijë lekë është realizuar në vlerën për 4,920 mijë lekë
- Plani i buxhetit në zërin “Kosto lokale” në vlerën për 2,250 mijë lekë i përket shpenzimeve për projektin e investimit “Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri”. Për vitin 2024, ky zë është realizuar në masën për 2,190 mijë lekë ose në masën për 97,4%.
- Plani i buxhetit në zërin “t.v.sh.”, në vlerën për 1,820 mijë lekë dhe që i përket shpenzimeve për projektin e investimit “Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri”. Për vitin 2024, ky zë është realizuar në masën për 1,816 mijë lekë ose 100 %.
- Në zërin “Pajisje informatike”, KLSH, ka prokuruar fondet për blerjen e pajisjeve informatike kompjuterike, në funksion të veprimtarisë audituese. Për vitin 2024, ky zë i planifikuar në vlerën për 4,200 mijë lekë nuk është realizuar nga AKSHI.

Financim i Huaj

Bazuar në Ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, nuk ka patur një plan buxheti me destinacion Investimet Kapitale me Financim të Huaj në artikullin 230 për zbatimin e projektit “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat në Shqipëri”, financuar nga Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO). Ky projekt, në vlerën totale për 21,800 mijë lekë, bashkëfinancimi u zyrtarizua me firmosjen e Marrëveshjes nr. 307, datë 09.03.2020 mes Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ky projekt kishte për qëllim forcimin e llogaridhënies gjatë përdorimit të fondeve publike



6 TREGUESIT BUXHETORË DHE FINANCIARË TË KLSH-SË

nëpërmjet promovimit të mbikëqyrjes dhe shmangies së korrupsionit në hartimin dhe implementimin e kontratave të koncesioneve dhe të PPP-ve në Shqipëri.

Nëpërmjet këtij projekti, KLSH realizoi me sukses produktet dhe aktivitetet e parashikuara në Marrëveshje, si më poshtë:

1.Kryerjen e 3 auditimeve pilot në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve, të mbështetura në të gjitha fazat e auditimit nga eksperti i jashtëm i kontraktuar si pjesë e projektit, për kontratat koncesionare, si vijon:

“Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”, “Dhënia me koncesion e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë” dhe “Marrëveshjet hidrokarbure”.

2.Hartimi i “Manualit për auditimin e koncesioneve dhe PPP-ve”, i cili reflekton eksperiencën e fituar përgjatë kryerjes së 3 auditimeve pilot, shoqëruar me trajnimet e nevojshme

3.Vizitë studimore në Gjykatën Turke të Llogarive, me qëllim shkëmbimin e njohurive në fushën e koncesioneve, ku morën pjesë rreth 20 auditues të KLSH-së.

4.Aktivitetet përmbyllës/ tryezë e rumbullakët për prezantimin e rezultateve të këtij projekti.

Konkluzioni i auditit të brendshëm mbi pasqyrat financiare 2024

Bazuar në Planin Vjetor të Auditimit, miratuar me Vendimin nr. 192, datë 20.10.2023, i ndryshuar me anë të Vendimit nr.186, datë 01.10.2024, “Për miratimin e ndryshimit të Planit Vjetor të vitit 2024” të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe në kuadër të veprimtarisë së saj, Njësia e Auditimit të Brendshëm, ka kryer misionin e auditimit “Mbi auditimin e sistemeve dhe përputhshmërisë në Sektorin e Financës” për periudhën 1 janar 2024 deri më 31 dhjetor 2024, raporti përfundimtar i të cilit, është protokolluar me nr. 1474/4, datë 21.03.2025, ku në përfundim të angazhimit është dhënë ky Opinion/Konkluzion nga auditimi:

“Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare të institucionit për periudhën e mbyllur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2024, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve monetare, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto, si dhe shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të KLSH-së paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të institucionit më datë 31 dhjetor 2024, dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të raportimit financiar”.

Auditimi u krye në përputhje me Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar e Kontrollin” i ndryshuar, UMF nr.86, datë 10.12.2015 “Për miratimin e Kodit të Etikës për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik” etj.



6 TREGUESIT BUXHETORË DHE FINANCIARË TË KLSH-SË

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 13, datë 18.12.2024 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit të vitit 2024”.

Qëllimi i auditimit është të ndihmojë institucionin e KLSH-së dhe të japë siguri, që të arrijë objektivat nëpërmjet një veprimtarie në përputhje me kërkesat ligjore, standardet dhe rregulloret në fuqi, duke identifikuar aktivitetet me risk dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit.

Gjatë kryerjes së këtij auditimi është synuar vlerësimi i përgjithshëm mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe dhënia e një opinionit mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2024, nga ku rezulton se, menaxhimi financiar dhe kontrolli në përgjithësi dëshmon një proces funksional e efektiv, që ofron siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve tjera të kontrollit. Nga auditimi është konstatuar se të gjithë proceset dhe transaksionet janë kryer në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, siç trajtohet dhe në Raportin Final të Auditimit me nr. 1474/4 prot, datë 21.03.2025, “Mbi auditimin e sistemeve dhe përputhshmërisë në fushën e menaxhimit financiar të Sektorit të Financës”, janë dhënë gjithsej 2 rekomandime, të cilat janë pranuar dhe është përgatitur dhe dërguar në afat Plani i Veprimit për zbatimin e tyre (shkresa nr. 1086/5, datë 12.03.2024), statusi i të cilave rezulton të zbatuara plotësisht.





07

Anekse

ANEKSE

ANEKSI 1: Auditimet/ Temat e realizuara nga KLSH, për periudhën Janar – Dhjetor 2024

Nr.	Nr.	Subjekti/ Tema
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja		
1	1	Agjencia për Eficencën e Energjisë
2	2	Albcontrol Sh.a
3	3	Auditimi i Zbatimit të rekomandimeve të vitit 2023 (6 - mujori I)
4	4	Auditimi i Zbatimit të rekomandimeve të vitit 2023 (6 - mujori II)
5	5	Auditimi i Zbatimit të rekomandimeve të vitit 2024 (6 - mujori I)
6	6	Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës
7	7	Kantieri i Ndërtimit dhe të Riparimit të Anijeve dhe Ministrinë e Mbrojtjes
8	8	Mbi auditimin e përputhshmërisë në detyrimet e ndërsjella në KESH, OSHEE dhe OST
9	9	Mbi disponibilitetin në treg dhe trajtimin në linjën e tretë të mjekimit të pacientëve të diagnostikuar me Leucemi Limfoide Kronike (LLC), me barin "Ibrutinib 140 mg"
10	10	Ministria e Turizimit dhe Mjedisit - Agjencia Kombëtare Ujësjiellës Kanalizime - Bashkia Vlorë "Ndërtimi i Qendrës Rajonale të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Sherishtë të Vlorës"
11	11	Ministria e Turizimit dhe Mjedisit dhe Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural "Mbi përputhshmërinë e zbatimit të projektit Shërbimet Mjedisore"
12	12	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit 400 kv Shqipëri - Kosovë; Linja 400 kv Shqipëri - Maqedoni"; Ndërtimi i Linjës së Transmetimit me dy qarqe 220 kv Tiranë - Rrashbull dhe Unaza 110 kv e Tiranës, Loti 1 & 2".
13	13	Operatori i Sistemit të Transmetimit Sh.a
14	14	Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë
15	15	Për marrëveshjet hidrokarbure të lidhura në Republikën e Shqipërisë
16	16	Për raportimin e kryer për programin kombëtar të modernizimit të sektorit të Ujësjiellës - Kanalizimeve në Shqipëri, për vitin 2023, në AKUK
17	17	Radio Televizioni Shqiptar - Drejtoria e Përgjithshme
18	18	Radio Televizioni Shqiptar - Organizimi i Festivalit të 62 Kombëtar të Këngës
19	19	Spital Rajonal "Memorial", Fier
20	20	Spitali Rajonal, Elbasan
21	21	Ujësjiellës - Kanalizime, Elbasan
Departamenti i Auditimit IT		
22	1	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
23	2	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
24	3	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore - Auditim IT
25	4	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural "Mbi sistemet e teknologjisë së informacionit"
26	5	Drejtoria e Përgjithshme të Policisë për Kundravajtjet Rrugore
27	6	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
28	7	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - Në fokus skema e ndihmës sociale
29	8	Ujësjiellës Kanalizime Shkodër Sh.a
30	9	Zbatimi i Rekomandimeve të vitit 2023 (6 mujori I) - IT
31	10	Zbatimi i rekomandimeve të vitit 2023 (6 mujori II) - IT
Departamenti i Auditimit të Mbrojtjes, Sigurisë dhe Pronës Publike		
32	1	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve për 6 mujorin I të vitit 2023, për subjektet e DVASHK
33	2	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve për 6 mujorin II të vitit 2023, për subjektet e DVASHK
Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit		
34	1	Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera
35	2	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve për 6 mujorin e II të vitit 2023
36	3	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
37	4	Banka e Shqipërisë
38	5	Dega Doganore Tiranë
39	6	Dega e Doganës Kakavijë
40	7	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
41	8	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë
42	9	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
43	10	Drejtoria Rajonale Tatimore, Fier
44	11	Drejtoria Rajonale Tatimore, Vlorë
45	12	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
46	13	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare
47	14	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)

48	15	Ministria e Financave: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Thesarit, Borxhit, Harmonizimit dhe Kontrollit të Brendshëm dhe Aparati i Ministrisë
Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore		
49	1	Agjencia e Prokurimit Publik
50	2	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
51	3	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Projekti “Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit GOVTECH”
52	4	Akademia e Shkencave
53	5	Akademia e Sigurisë Tiranë
54	6	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të vitit 2023 (6-mujori I) - Institucionet Qendrore
55	7	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të vitit 2023 (6-mujori II) - Institucionet Qendrore
56	8	Autoriteti i Konkurrencës
57	9	Avokatura e Shtetit - MIE, MTM, AKBN, ALBETROL Sh.a - Patos
58	10	Gjykata Kushtetuese
59	11	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
60	12	Instituti i Statistikave (INSTAT)
61	13	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
62	14	Komisioneri për të drejtën për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale
63	15	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
64	16	Ministria e Brendshme
65	17	Ministria e Drejtësisë "Mbi zbatimin e kontratës për përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale"
66	18	Ministria e Financave dhe Ekonomisë “Mbi përputhshmërinë e zbatimit të kontratës koncesionare për markimin e karburanteve”
67	19	Ministria e Mbrojtjes
68	20	Prokuroria e Përgjithshme
69	21	Universiteti i Tiranës
70	22	Universiteti Politeknik i Tiranës
Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore		
71	1	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Berat
72	2	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Krujë
73	3	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Librazhd
74	4	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Skrapar
75	5	Bashkia Belsh
76	6	Bashkia Berat
77	7	Bashkia Bulqizë
78	8	Bashkia Cërrik
79	9	Bashkia Delvinë
80	10	Bashkia Devoll
81	11	Bashkia Dimal
82	12	Bashkia Divjakë
83	13	Bashkia Dropull
84	14	Bashkia Durrës
85	15	Bashkia Fier
86	16	Bashkia Finiq
87	17	Bashkia Fushë Arrëz
88	18	Bashkia Gjirokastrë
89	19	Bashkia Gramsh
90	20	Bashkia Has
91	21	Bashkia Himarë
92	22	Bashkia Kamëz
93	23	Bashkia Kamëz, për pasqyrat e vitit 2023
94	24	Bashkia Kavajë
95	25	Bashkia Kavajë, për pasqyrat e vitit 2023
96	26	Bashkia Këlcyrë
97	27	Bashkia Klos
98	28	Bashkia Kolonjë
99	29	Bashkia Konispol
100	30	Bashkia Korçë
101	31	Bashkia Krujë
102	32	Bashkia Kuçovë
103	33	Bashkia Kukës
104	34	Bashkia Kurbin
105	35	Bashkia Lezhë

106	36	Bashkia Lezhë, për pasqyrat financiare te vitit 2023
107	37	Bashkia Libohovë
108	38	Bashkia Librazhd
109	39	Bashkia Malësi e Madhe
110	40	Bashkia Maliq
111	41	Bashkia Mallakastër
112	42	Bashkia Mat
113	43	Bashkia Memaliaj
114	44	Bashkia Mirditë
115	45	Bashkia Patos
116	46	Bashkia Peqin
117	47	Bashkia Përmet
118	48	Bashkia Pogradec
119	49	Bashkia Poliçan
120	50	Bashkia Përrenjas
121	51	Bashkia Pukë
122	52	Bashkia Pustec
123	53	Bashkia Roskovec
124	54	Bashkia Rrogozhinë
125	55	Bashkia Selenice
126	56	Bashkia Shijak
127	57	Bashkia Shkodër
128	58	Bashkia Skrapar
129	59	Bashkia Tepelenë
130	60	Bashkia Tropojë
131	61	Bashkia Vau i Dejës, auditim financiar i vitit 2023
132	62	Bashkia Vau i Dejës, auditim i vitit 2024
133	63	Bashkia Vorë
134	64	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik
135	65	Prefektura e Qarkut Elbasan
136	66	Prefektura e Qarkut Fier
137	67	Prefektura e Qarkut Korçë
138	68	Prefektura e Qarkut Shkodër
139	69	Prefektura e Qarkut Tiranë
140	70	Prefektura e Qarkut Vlorë
141	71	Zbatimi i rekomandimeve i 6 mujorit të I, të vitit 2023
Departamenti i Auditimit të Performancës		
142	1	Zbatimi i rekomandimeve për auditimet e performancës evaduar 6 mujorin e I, të vitit 2023
143	2	"Mbrojtja e Vlerave dhe Pasurive të vendit tonë në UNESCO", ushtruar në Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Bashkitë: Durrës, Rrogozhinë, Fier, Berat, Gjirokastrë dhe Pogradec
144	3	"Ndikimi i aktivitetit mineral në fondin pyjor" ushtruar në Ministrinë Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Bashkitë: Selenicë, Skrapar, Krujë, Dimal, Berat
145	4	"Inspektoratet e vendit në mbrojtje të interesave publike" ushtruar në Inspektoratin Qendror
146	5	"Menaxhimi i hapësirave publike në plazhe" ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Bregdetit dhe degët Rajonale, Bashkitë: Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë dhe Sarandë
147	6	"Orientimi për karrierë i të rinjve, në Sistemin Arsimor Parauniversitar", ushtruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar
148	7	"Projektet kërkimore - shkencore të realizuara nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, në nxitjen e përpërimit shkencor, teknologjik dhe inovacionit, për të mirën e vendit"
149	8	Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë
150	9	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonal rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës
151	10	Efektiviteti dhe siguria e barnave që qarkullojnë në Shqipëri
152	11	Efektiviteti i pajisjeve mjekësore në sistemin spitalor publik
153	12	Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)
154	13	Politikat dhe respektimi i të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor, në shërbimin spitalor psikiatrik
155	14	Procesi i birësimit të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirërritje dhe edukim
156	15	Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë

157	16	Respektimi i standardeve në trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve spitalore, në parandalimin e rrezikut për shëndetin e personelit shëndetësor, pacienteve dhe mbrojtjen e mjedisit
158	17	Zbatimi i planit kombëtar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike
159	18	Zbatimi i rekomandimeve të Agjencive Rajonale të Mjedisit

ANEKSI 2: Masat e rekomanduara për ndryshime apo përmirësime ligjore

Nr.	Subjekti/ Tema	Nr. Masave
1	"Menaxhimi i hapësirave publike në plazhe" ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Bregdetit dhe degët Rajonale, Bashkitë: Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë dhe Sarandë	2
2	"Projektet kërkimore-shkencore të realizuara nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, në nxitjen e përparimit shkencor, teknologjik dhe inovacionit, për të mirën e vendit"	1
3	Agjencia e Prokurimit Publik	3
4	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	2
5	Akademia e Sigurisë Tiranë	2
6	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	1
7	Dega Doganore Tiranë	2
8	Drejtoria e Përgjithshme të Policisë për Kundërvajtjet Rrugore	1
9	Efektiviteti i Pajisjeve mjekësore në sistemin spitalor publik	3
10	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	1
11	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)	1
12	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – Auditim IT	1
13	Ministria e Mbrojtjes	3
14	Për marrëveshjet hidrokarbure të lidhura në Republikën e Shqipërisë	3
15	Procesi i birësimit të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirëritje dhe edukim	1
16	Respektimi i standardeve në trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve spitalore, në parandalimin e rrezikut për shëndetin e personelit shëndetësor, pacientëve dhe mbrojtjen e mjedisit	1
Total		28

ANEKSI 3: Masat Organizative të rekomanduara

Nr.	Subjekti/ Tema	Nr. Masave
1	"Mbrojtja e Vlerave dhe Pasurive të vendit tonë në Unesco" ushtruar në Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Bashkitë: Durrës, Rrogozhinë, Fier, Berat, Gjirokastrë dhe Pogradec	21
2	"Ndikimi i aktivitetit minerar në fondin pyjor" ushtruar në Ministrinë Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Bashkitë: Selenicë, Skrapar, Krujë, Dimal, Berat	16
3	"Inspektoratet e vendit në mbrojtje të interesave publike" ushtruar në Inspektoratin Qendror	7
4	"Menaxhimi i hapësirave publike në plazhe" ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Bregdetit dhe degët Rajonale, Bashkitë: Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Himarë dhe Sarandë	14
5	"Orientimi për karrierë i të rinjve, në Sistemin Arsimit Parauniversitar", ushtruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar	10
6	"Projektet kërkimore - shkencore të realizuara nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, në nxitjen e përparimit shkencor, teknologjik dhe inovacionit, për të mirën e vendit"	8
7	Agjencia e Prokurimit Publik	11
8	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	13
9	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	11
10	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	7
11	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore - Auditim IT	24
12	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Projekti "Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit GOVTECH"	1
13	Agjencia për Eficencën e Energjisë	19
14	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural "Mbi sistemet e teknologjisë së informacionit"	20
15	Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë	32
16	Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera	20
17	Akademia e Shkencave	38
18	Akademia e Sigurisë Tiranë	36
19	Albcontrol Sh.a	13
20	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Berat	5
21	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Krujë	5

Nr.	Subjekti/ Tema	Nr. Masave
22	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Librazhd	7
23	Auditim i pasqyrave financiare, Bashkia Skrapar	5
24	Autoriteti i Konkurrencës	12
25	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	18
26	Avokatura e Shtetit - MIE, MTM, AKBN, ALBETROL Sh.a - Patos	7
27	Banka e Shqipërisë	6
28	Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës	11
29	Bashkia Belsh	10
30	Bashkia Berat	13
31	Bashkia Bulqizë	14
32	Bashkia Cërrik	17
33	Bashkia Delvinë	7
34	Bashkia Devoll	15
35	Bashkia Dimal	9
36	Bashkia Divjakë	15
37	Bashkia Dropull	12
38	Bashkia Durrës	39
39	Bashkia Fier	32
40	Bashkia Finiq	14
41	Bashkia Fushë Arrëz	8
42	Bashkia Gjirokastrë	9
43	Bashkia Gramsh	23
44	Bashkia Has	12
45	Bashkia Himare	7
46	Bashkia Kamzë	37
47	Bashkia Kamzë, për pasqyrat financiare të vitit 2023	14
48	Bashkia Kavajë	18
49	Bashkia Kavajë, për pasqyrat financiare të vitit 2023	32
50	Bashkia Këlcyrë	27
51	Bashkia Klos	8
52	Bashkia Kolonjë	23
53	Bashkia Konispol	14
54	Bashkia Korçë	28
55	Bashkia Krujë	10
56	Bashkia Kuçovë	15
57	Bashkia Kukës	18
58	Bashkia Kurbin	15
59	Bashkia Lezhë	21
60	Bashkia Lezhë, për pasqyrat financiare te vitit 2023	12
61	Bashkia Libohovë	10
62	Bashkia Librazhd	14
63	Bashkia Malësi e Madhe	18
64	Bashkia Maliq	27
65	Bashkia Mallakastër	49
66	Bashkia Mat	15
67	Bashkia Memaliaj	16
68	Bashkia Mirditë	9
69	Bashkia Patos	19
70	Bashkia Peqin	16
71	Bashkia Përmet	27
72	Bashkia Pogradec	17
73	Bashkia Poliçan	14
74	Bashkia Përrenjas	21
75	Bashkia Pukë	19
76	Bashkia Pustec	24
77	Bashkia Roskovec	21
78	Bashkia Rrogozhinë	36
79	Bashkia Selenice	33
80	Bashkia Shijak	17
81	Bashkia Shkodër	20
82	Bashkia Skrapar	14
83	Bashkia Tepelenë	8

Nr.	Subjekti/ Tema	Nr. Masave
84	Bashkia Tropojë	18
85	Bashkia Vau i Dejës, për pasqyrat financiare të vitit 2023	18
86	Bashkia Vau i Dejës, auditim i vitit 2024	26
87	Bashkia Vorë	29
88	Dega Doganore Tiranë	16
89	Dega e Doganës Kakavijë	16
90	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	34
91	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë	27
92	Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik	13
93	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	34
94	Drejtoria e Përgjithshme të Policisë për Kundravajtjet Rrugore	19
95	Drejtoria Rajonale Tatimore, Fier	21
96	Drejtoria Rajonale Tatimore, Vlorë	17
97	Efektiviteti dhe siguria e barnave që qarkullojnë në Shqipëri	35
98	Efektiviteti i pajisjeve mjekësore në sistemin spitalor publik	17
99	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	22
100	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare	36
101	Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës	11
102	Gjykata Kushtetuese	10
103	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë	3
104	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)	19
105	Instituti i Statistikave (INSTAT)	36
106	Kantieri i Ndërtimit dhe të Riparimit të Anijeve dhe Ministrinë e Mbrojtjes	20
107	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	11
108	Komisioneri për të drejtën për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale	30
109	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	20
110	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – Auditim IT	14
111	Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës)	7
112	Mbi auditimin e përputhshmërisë në detyrimet e ndërsjella në KESH, OSHEE dhe OST	6
113	Mbi disponibilitetin në treg dhe trajtimin në linjën e tretë të mjekimit të pacientëve të diagnostikuar me Luecemi Limfoide Kronike (LLC), me barin "Ibrutinib 140 mg"	6
114	Ministria e Brendshme	35
115	Ministria e Drejtësisë "Mbi zbatimin e kontratës për përmirësimin e sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale"	4
116	Ministria e Financave dhe Ekonomisë "Mbi përputhshmërinë e zbatimit të kontratës koncesionare për markimin e karburanteve"	17
117	Ministria e Financave: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Thesarit, Borxhit, Harmonizimit dhe Kontrollit të Brendshëm dhe Aparati i Ministrisë	49
118	Ministria e Mbrojtjes	33
119	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - Në fokus Skema e Ndihmës Sociale	15
120	Ministria e Turizimit dhe Mjedisit - Agjencia Kombëtare Ujësjellës Kanalizime - Bashkia Vlorë	8
121	Ndërtimi i qendrës rajonale të menaxhimit të integruar të mbetjeve në Sherishtë të Vlorës	
122	Ministria e Turizimit dhe Mjedisit dhe Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural	14
123	Mbi përputhshmërinë e zbatimit të projektit Shërbimet Mjedisore	
124	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit 400 kv Shqipëri - Kosovë; Linja 400 kv Shqipëri - Maqedoni"; Ndërtimi i Linjës së Transmetimit me dy qarqe 220 kv Tiranë - Rrashbull dhe Unaza 110 kv e Tiranës, Loti 1 & 2".	2
125	Operatori i Sistemit të Transmetimit Sh.a	14
126	Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë	14
127	Për marrëveshjet hidrokarbure në Republikën e Shqipërisë	32
128	Për raportimin e kryer për programin kombëtar të modernizimit të sektorit të Ujësjellës - Kanalizimeve në Shqipëri, për vitin 2023, në AKUK	8
129	Politikat dhe respektimi i të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor, në shërbimin spitalor psikiatrik	12
130	Prefektura e Qarkut Elbasan	13
131	Prefektura e Qarkut Fier	18
132	Prefektura e Qarkut Korçë	12
133	Prefektura e Qarkut Shkodër	8

Nr.	Subjekti/ Tema	Nr. Masave
134	Prefektura e Qarkut Tiranë	22
135	Prefektura e Qarkut Vlorë	13
136	Procesi i birësimit të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirëritje dhe edukim	16
137	Prokuroria e Përgjithshme	13
138	Radio Televizioni Shqiptar - Drejtoria e Përgjithshme	57
139	Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë	10
140	Respektimi i standardeve në trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve spitalore, në parandalimin e rrezikut për shëndetin e personelit shëndetësor, pacientëve dhe mbrojtjen e mjedisit	31
141	Radio Televizioni Shqiptar - Organizimi i Festivalit të 62 Kombëtar të Këngës	4
142	Spital Rajonal "Memorial", Fier	25
143	Spitali Rajonal, Elbasan	34
144	Ujësjetllës - Kanalizime Shkodër Sh.a – Auditim IT	21
145	Ujësjetllës - Kanalizime, Elbasan	22
146	Universiteti i Tiranës	2
147	Universiteti Politeknik i Tiranës	4
148	Zbatimi i Planit Kombëtar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	12
Total		2,594

ANEKSI 4: Evidenca përmbledhëse e masave të rekomanduara për dëmin ekonomik të konstatuar

Në 000 lekë

Nr.	Emërtimi i subjektit ose temës	Shpenzime	Të Ardhura	Total
1	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	121		121
2	Agjencia për Eficencën e Energjisë	3,421		3,421
3	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural "Mbi sistemet e teknologjisë së informacionit"	52		52
4	Agjencia Rajonale e Mjedisit, Fier, Vlorë, Gjirokastrë	861		861
5	Akademia e Shkencave	2,764		2,764
6	Akademia e Sigurisë	1,704		1,704
7	Albcontrol SHA	4,317		4,317
8	Bashkia Berat	853		853
9	Bashkia Cërrik	702		702
10	Bashkia Durrës	1,795		1,795
11	Bashkia Fier	5,558		5,558
12	Bashkia Himarë	6,902		6,902
13	Bashkia Kamëz	2,456		2,456
14	Bashkia Kavajë	44,974		44,974
15	Bashkia Kolonjë	20,970		20,970
16	Bashkia Korçë	1,527		1,527
17	Bashkia Krujë	1,310		1,310
18	Bashkia Kurbin	14		14
19	Bashkia Lezhë	3,776		3,776
20	Bashkia Librazhd	363		363
21	Bashkia Malësi e Madhe	5,774		5,774
22	Bashkia Maliq	250		250
23	Bashkia Mallakastër	14,482		14,482
24	Bashkia Patos	11,773		11,773
25	Bashkia Roskovec	4,739		4,739
26	Bashkia Rrogozhinë	158		158
27	Bashkia Shijak	6,717	16,935	23,652
28	Bashkia Shkodër	3,662		3,662
29	Bashkia Skrapar	554		554
30	Bashkia Vau i Dejës, auditim i vitit 2024	9,128		9,128
31	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik	738		738
32	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	372		372
33	Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	1,920		1,920
34	Ministria e Brendshme	423		423
35	Ministria e Mbrojtjes	38,552		38,552
36	Ministria e Turizimit dhe Mjedisit - Agjencia Kombëtare Ujësjetllës Kanalizime - Bashkia Vlorë, Ndërtimi i Qendrës Rajonale të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Sherishtë të Vlorës	122,500		122,500

Nr.	Emërtimi i subjektit ose temës	Shpenzime	Të Ardhura	Total
37	Ministria e Turizimit dhe Mjedisit dhe Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural "Mbi përputhshmërinë e zbatimit të projektit shërbimet mjedisore"	27,440		27,440
38	Operatori i Sistemit të Transmetimit Sh.a	14,691		14,691
39	Radio Televizioni Shqiptar - Drejtoria e Përgjithshme	83,373		83,373
40	Radio Televizioni Shqiptar - Organizimi i Festivalit të 62 Kombëtar të Këngës	3,002		3,002
41	Spitali Rajonal "Memorial", Fier	3,259	80	3,339
42	Spitali Rajonal, Elbasan	9,487	240	9,727
43	Ujësjetës - Kanalizime, Elbasan	4,942		4,942
Total		472,373	17,255	489,628

ANEKSI 5: Evidenca e pasqyrimin të parregullive të dispozitave ligjore në fuqi, për të ardhura të munguara ose shpenzime jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, të cila kanë sjell efekt negativ financiar në të ardhurat e subjekteve dhe buxhetin e shtetit

Në 000 lekë

Nr.	Emërtimi i subjektit ose temës	Shpenzime	Të Ardhura	Total
1	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	1,633		1,633
2	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore – Auditim IT	52,650		52,650
3	Agjencia për Eficencën e Energjisë	78,114		78,114
4	Akademia e Shkencave	26,604		26,604
5	Akademia e Sigurisë	13,561		13,561
6	Albcontrol Sh.a	125,299		125,299
7	Bashkia Belsh		49,837	49,837
8	Bashkia Berat	224	51,213	51,437
9	Bashkia Bulqizë	10,328	47,046	57,374
10	Bashkia Cërrik	232,433	73,037	305,470
11	Bashkia Delvinë	6,000	6,204	12,204
12	Bashkia Devoll		23,540	23,540
13	Bashkia Dimal		63,685	63,685
14	Bashkia Divjakë	3,803	11,708	15,511
15	Bashkia Dropull		7,909	7,909
16	Bashkia Durrës	42,348	140,702	183,050
17	Bashkia Fier	37,981	282,582	320,563
18	Bashkia Finiq		68,982	68,982
19	Bashkia Fushë Arëz	5,516	8,979	14,495
20	Bashkia Gjirokastrë		63,493	63,493
21	Bashkia Gramsh	3,173	28,080	31,252
22	Bashkia Has		10,486	10,486
23	Bashkia Himarë	372,795	54,310	427,105
24	Bashkia Kamëz		828,259	828,259
25	Bashkia Kamëz, viti 2024		230,065	230,065
26	Bashkia Kavajë	770,116	120,277	890,393
27	Bashkia Këlcyrë		19,379	19,379
28	Bashkia Klos		14,163	14,163
29	Bashkia Kolonjë		7,650	7,650
30	Bashkia Konispol		7,770	7,770
31	Bashkia Korçë	49,459	191,442	240,901
32	Bashkia Krujë	12,635	198,022	210,657
33	Bashkia Kuçovë		39,668	39,668
34	Bashkia Kukës		51,364	51,364
35	Bashkia Kurbini		55,018	55,018
36	Bashkia Lezhë	312	302,461	302,773
37	Bashkia Libohovë	10,261	3,446	13,707
38	Bashkia Librazhd		39,084	39,084
39	Bashkia Malësi e Madhe	303,439	37,576	341,015
40	Bashkia Maliq		53,273	53,273
41	Bashkia Mallakastër	7,999	17,873	25,872
42	Bashkia Mat	30,243	23,732	53,974
43	Bashkia Memaliaj		23	23
44	Bashkia Mirditë		46,279	46,279
45	Bashkia Patos		83,346	83,346
46	Bashkia Peqin		18,746	18,746
47	Bashkia Përmet	13,554	10,964	24,519

Nr.	Emërtimi i subjektit ose temës	Shpenzime	Të Ardhura	Total
48	Bashkia Pogradec		93,306	93,306
49	Bashkia Poliçan	2,652	6,302	8,954
50	Bashkia Përrenjas	1,634	25,961	27,596
51	Bashkia Pukë	277	2,992	3,269
52	Bashkia Pustec		3,675	3,675
53	Bashkia Roskovec	104,355	37,305	141,660
54	Bashkia Rrogozhinë		50,822	50,822
55	Bashkia Selenice	11,942	514,396	526,338
56	Bashkia Shijak	1,000	2,185	3,185
57	Bashkia Shkodër	3,219	301,965	305,184
58	Bashkia Skrapar		89,236	89,236
59	Bashkia Tepelenë		47,264	47,264
60	Bashkia Tropojë	4,373	40,134	44,507
61	Bashkia Vau i Dejës		83,545	83,545
62	Bashkia Vau i Dejës, auditim i vitit 2024	36,847	240,429	277,275
63	Bashkia Vorë		83,624	83,624
64	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë	5,757		5,757
65	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik	14,802		14,802
66	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	216,523		216,523
67	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	114,647		114,647
68	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare	10,767	449,807	460,574
69	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)	322		322
70	Instituti i Statistikave (INSTAT)	5,300		5,300
71	Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve dhe Ministria e Mbrojtjes	25,589		25,589
72	Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	7,955		7,955
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	13,590	42,925	56,515
74	Mbi auditimin e përputhshmërisë në detyrimet e ndërsjella në KESH, OSHEE dhe OST	635,197		635,197
75	Ministria e Brendshme	86,026		86,026
76	Ministria e Financave	651,511		651,511
77	Ministria e Mbrojtjes	21,442		21,442
78	Ministria e Turizimit dhe Mjedisit - Agjencia Kombëtare Ujësllës Kanalizime - Bashkia Vlorë			
79	Ndërtimi i Qendrës Rajonale të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Sherishtë të Vlorës	31,704		31,704
80	Ministria e Turizimit dhe Mjedisit dhe Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural "Mbi përputhshmërinë e zbatimit të projektit Shërbimet Mjedisore"	107,471		107,471
81	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit 400 kv Shqipëri - Kosovë; Linja 400 kv Shqipëri - Maqedoni"; Ndërtimi i Linjës së Transmetimit me dy qarqe 220 kv Tiranë - Rrashbull dhe Unaza 110 kv e Tiranës, Loti 1 & 2".	884,544		884,544
82	Operatori i Sistemit të Transmetimit Sh.a	10,171		10,171
83	Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë	63,976	62,756	126,732
84	Për marrëveshjet hidrokarbure në Republikën e Shqipërisë		1,984,614	1,984,614
85	Prefektura e Qarkut Elbasan	2,400		2,400
86	Prefektura e Qarkut Shkodër	982		982
87	Prefektura e Qarkut Tiranë	11,843		11,843
88	Radio Televizioni Shqiptar - Drejtoria e Përgjithshme	164,840	75,681	240,521
89	Radio Televizioni Shqiptar - Organizimi i Festivalit të 62 Kombëtar të Këngës	14,851		14,851
90	Spitali Rajonal "Memorial", Fier	28,857		28,857
91	Spitali Rajonal, Elbasan	47,375		47,375
92	Ujësllës - Kanalizime, Elbasan	1,021,633	18,050	1,039,683
	Total	6,576,853	7,648,646	14,225,499

ANEKSI 6: Evidenca e mangësive në aktivitetin kontrollues me ndikim negativ në të ardhurat tatimore dhe doganore

Në 000 lekë

Nr.	Subjekti/ Tema	Të Ardhura	Total
1	Dega Doganore Kakavijë	87,073	87,073
2	Dega Doganore Tiranë	889,636	889,636
3	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	91,823	91,823
4	Drejtoria Rajonale Tatimore, Fier	465,352	465,352
5	Drejtoria Rajonale Tatimore, Vlorë	223,665	223,665
Total		1,757,548	1,757,548

ANEKSI 7: Evidenca e Masave Disiplinore të rekomanduara

Nr.	Emertimi i subjektit ose temes	Ligji nr. 152/2013 dt.30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” Neni 58, shkronjat (a,b,c ç)	Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës	Sipas kuadrit ligjor të institucionit përkatës	Total
1	“Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës) ”	28			28
2	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	5			5
3	Agjencia për Eficencën e Energjisë	12			12
4	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural "Mbi sistemet e teknologjisë së informacionit"	2	2		4
5	Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë	25			25
6	Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer			3	3
7	Akademia e Shkencave	7			7
8	Akademia e Sigurisë		7	1	8
9	Albcontrol SHA		11		11
10	Autoriteti i Konkurrencës	5			5
11	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare		1		1
12	Bashkia Belsh	1			1
13	Bashkia Berat	13	3		16
14	Bashkia Bulqizë	1			1
15	Bashkia Cërrik	4	2		6
16	Bashkia Delvinë	1			1
17	Bashkia Devoll	8			8
18	Bashkia Dimal	10			10
19	Bashkia Divjakë	1			1
20	Bashkia Dropull	6			6
21	Bashkia Durrës	40	5		45
22	Bashkia Fier	7			7
23	Bashkia Finiq	1			1
24	Bashkia Fushë Arëz	1			1
25	Bashkia Gjirokastrë	1			1
26	Bashkia Gramsh	1			1
27	Bashkia Has	9			9
28	Bashkia Himare	11			11
29	Bashkia Kamëz	35			35
30	Bashkia Kamëz, auditim i vitit 2024	6			6
31	Bashkia Kavajë	10	1		11
32	Bashkia Këlcyrë		13		13
33	Bashkia Klos	1			1
34	Bashkia Kolonjë	3			3
35	Bashkia Konispol	4			4
36	Bashkia Korçë	39	1		40
37	Bashkia Krujë	21			21
38	Bashkia Kuçovë	1	1		2
39	Bashkia Kukës	10			10
40	Bashkia Kurbin	7			7
41	Bashkia Lezhë	2			2
42	Bashkia Libohovë	4			4
43	Bashkia Librazhd	6			6
44	Bashkia Malësi e Madhe	15	1		16
45	Bashkia Maliq	15			15
46	Bashkia Mallakastër	3			3
47	Bashkia Mat	3			3
48	Bashkia Memaliaj	1			1
49	Bashkia Mirditë	7	1		8
50	Bashkia Patos	8			8

Nr.	Emertimi i subjektit ose temes	Ligji nr. 152/2013 dt.30.05.2013 "Për Nëpunësin Civil" Neni 58, shkronjat (a,b,c ç)	Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës	Sipas kuadrit ligjor te institucionit përkatës	Total
51	Bashkia Peqin	1			1
52	Bashkia Përmet	3			3
53	Bashkia Pogradec	2			2
54	Bashkia Poliçan	11			11
55	Bashkia Përrenjas	9			9
56	Bashkia Pukë	5			5
57	Bashkia Pustec	2			2
58	Bashkia Roskovec	8			8
59	Bashkia Rrogozhinë	7	2		9
60	Bashkia Selenice	7			7
61	Bashkia Shijak	5	7		12
62	Bashkia Skrapar	28			28
63	Bashkia Tepelenë	1			1
64	Bashkia Tropojë	5			5
65	Bashkia Vau i Dejës	33			33
66	Bashkia Vorë	12	2		14
67	Dega Doganore Tiranë	39	12		51
68	Dega e Doganës Kakavijë	1			1
69	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	12	14		26
70	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë	1			1
71	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik	1	1		2
72	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	2	1		3
73	Drejtoria Rajonale Tatimore, Fier	21			21
74	Drejtoria Rajonale Tatimore, Vlorë	1			1
75	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	32			32
76	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare		1		1
77	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)		58		58
78	Instituti i Statistikave (INSTAT)	12			12
79	Kantieri i Ndërtimit dhe të Riparimit të Anijeve dhe Ministrinë e Mbrojtjes	15	9		24
80	Komisioneri për të drejtën për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale	4			4
81	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1			1
82	Ministria e Brendshme	1			1
83	Ministria e Financave	1			1
84	Ministria e Mbrojtjes	1			1
85	Ministria e Turizimit dhe Mjedisit dhe Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural "Mbi përputhshmërinë e zbatimit të projektit Shërbimet Mjedisore"	1			1
86	Operatori i Sistemit të Transmetimit Sh.a		13		13
87	Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë	2			2
88	Për marrëveshjet hidrokarbure të lidhura në Republikën e Shqipërisë	2	10		12
89	Prefektura e Qarkut Elbasan	10		4	14
90	Prefektura e Qarkut Fier	6			6
91	Prefektura e Qarkut Korçë	14		1	15
92	Prefektura e Qarkut Shkodër	3			3
93	Prefektura e Qarkut Tiranë	5			5
94	Prefektura e Qarkut Vlorë	6		1	7
95	Radio Televizioni Shqiptar - Drejtoria e Përgjithshme		24		24
96	Spital Rajonal "Memorial", Fier		16		16
97	Spitali Rajonal, Elbasan		14		14
98	Ujësjetës - Kanalizime, Elbasan		16		16
Total		734	249	10	993

ANEKSI 8: Evidenca e Masave Administrative të rekomanduara

Nr.	Subjekti/ Tema	Total
1	Akademia e Sigurisë	1
2	Bashkia Berat	9
3	Bashkia Fier	17
4	Bashkia Kolonjë	6

Nr.	Subjekti/ Tema	Total
5	Bashkia Krujë	6
6	Bashkia Malësi e Madhe	2
7	Bashkia Mallakastër	5
8	Bashkia Patos	2
9	Bashkia Përrenjas	2
10	Bashkia Shijak	2
11	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1
12	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	2
13	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare	1
14	Gjykata Kushtetuese	1
15	Ministria e Mbrojtjes	3
16	Operatori i Sistemit të Transmetimit Sh.a	1
17	Prefektura e Qarkut Elbasan	1
18	Prefektura e Qarkut Tiranë	1
19	Spital Rajonal "Memorial", Fier	1
20	Spitali Rajonal, Elbasan	2
Total		66



Telefon
+355 4 2247294



Email
klsh@klsh.org.al



website
www.klsh.org.al



Adresa
“ Abdi Toptani”, Tiranë, Al